

Falenderime

Ky punim është realizuar falë ndihmesës së jashtëzakonshme të kolegëve, për të cilët ndjej detyrimin t'i falenderoj me shumë respekt. Rreshtat e parë të falenderimeve shkojnë për udhëheqësin tim të parë të këtij punimi, Prof. Dr. Skënder Begeja, i cili tashmë është ndarë nga jeta. Edhe pse udhëtimi ynë gjatë këtij bashkëpunimi shkencor nuk zgjati shumë, urtësia, erudicioni dhe eksperiencia e tij më kanë shoqëruar gjatë gjithë kohës së hartimit të punimit.

Falenderimet e mia, do të vazhdojnë për udhëheqësin tim shkencor Prof. Dr. Kudret Çela, i cili me përkushtimin, dijen, kulturën gjithnjë, më ka rritur besimin tek vetja në përballjen me sfidën e madhe që kam patur përpara. Këshillat e tij metodike dhe profesionale kanë qënë të domosdoshme, ndërsa mbështetja e tij morale më ka inkurajuar në mënyrë të vazhdueshme.

Dëshiroj të falenderoj gjithashtu Departamentin e të Drejtës Penale, të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, në mënyrë të veçantë profesorin Skender KACUPI për mbështetjen dhe mirëkuptimin e treguar.

Falenderime të veçanta ju shpreh familjarëve të mi, për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme që më kanë dhënë.

Lista e shkurtimeve

KRSH	Kushtetuta e RSH-së
K.Pr.Penale	Kodi i Proçedurës Penale
K.P	Kodi Penal
K.E.D.NJ.	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore
GJ.E.D.NJ.	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJ.K.R.SH	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
GJ.SH.K.R	Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda
Prot. P	Protokolli i Palermos
TQNJ	Trafikimi i qenieve njerëzore
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KE	Këshilli i Europës
BE	Bashkimi European
GJ.L.R.SH	Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë

METODOLOGJITË SHKENCORE TË PËRDORURA

Tema e disertacionit “*Aspekte teorike dhe praktike për studimin e trafikimit të qënieve njerëzore*” është një temë mjaft e gjerë dhe shumë aktuale e cila përfshin si trajtimin teorik, ashtu dhe atë praktik. Gjatë punimit janë përdorur metodologji të ndryshme studimore, si metodologjia e analizës së rasteve, e sintezës, metodologjia krahasuese, metodologjia historike, statistikore dhe ajo grafike. Me anë të metodologjisë historike jemi përpjekur të pasqyrojmë trajtimin e dukurisë së trafikimit të qënieve njerëzore që në fillimet e saj, duke nxjerrë në pah ato dukuri kryesore, ngjarje ose sjellje, të cilat kanë ndikuar në lindjen dhe zhvillimin e trafikimit të qënieve njerëzore.

Nëpërmjet analizës së rasteve, kemi dashur të sjellim në vëmendje raportin e trafikimit të qënieve njerëzore me praktikën gjyqësore, duke u përqëndruar në trajtimin që i është bërë trafikimit, si fakt penal. Një vend të rëndësishëm në këtë trajtim zë dhe pasqyrimi i shtrirjes në vite të veprave penale të gjykuara, duke marrë në analizë si provat ku bazohet vendimi gjyqësor ashtu dhe aspektet proceduriale në lidhje me gjykimin e këtyre veprave penale. Nëpërmjet metodës së analizës, janë kryer hulumtime mbi rastet e çështjeve të gjykuara, ecurinë e këtyre proceseve gjyqësore, si dhe masat e dënimit të zbatuara ndaj autorëve të kryerjes së veprave penale. Një vend të veçantë në këtë punim, zë dhe doktrina juridike penale sidomos përsa iu përket zgjidhjeve apo propozimeve të bëra në lidhje me problematikat e ndryshme që karakterizojnë hetimin dhe gjykimin e plotë dhe objektiv të këtyre veprave penale.

Është marrë në analizë ecuria në vite e parashikimeve ligjore në lidhje me këto figura veprash penale, duke zbatuar dhe metodën krahasuese me parashikimet ligjore të disa vendeve të tjera.

Duke treguar ngjashmëritë dhe diferencat që karakterizojnë këto parashikime kemi vëzhguar në një këndvështrim shkencor krahasimor, në raport me disa vende të tjera dhe kemi evidentuar dhe përfundime dhe rekomandime.

Për shkak se, kodi ynë penal ka pësuar ndryshime kohët e fundit, në raport me veprat penale që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore pjesë e këtij punimi janë dhe këto ndryshime konkrete. Gjatë punimit janë shfrytëzuar burime të ndryshme, si kodet, ligjet, e sistemit tonë të brendshëm, por dhe atij ndërkombëtar. Metoda statistikore zë një rol të rëndësishëm në këtë punim, për të kuptuar përmes shifrave ecurinë e këtyre veprave penale në raport me hetimin dhe gjykimin. Gjithashtu metoda grafike na ka ndihmuar në paraqitjen grafike të të dhënave së kësaj

vepre penale. Gjithashtu nuk mund të lëmë pa përmendur vendimet e Gjykatës së Lartë, por dhe vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Në përfundim, në mënyrë të përmbledhur do të pohoja se ky punim është mbështetur mbi një metodologji të bazuar në raste të shumta të praktikës gjyqësore të vendit tonë dhe atë të huaj.

Fjalët kyçe

- Kushtetuta
- Kodi Penal
- Kodi i Proçedurës Penale
- Të drejtat e Njeriut
- E drejtë penale
- Kriminalogji
- Trafikimi i Qënieve Njerëzore
- Shfrytëzim i punës së të tjerëve
- Shfrytëzim prostitucioni
- Skllavëri dhe punë e detyruar
- Kontrabandim
- Emigracion
- Transportim
- Viktima të trafikimit
- Rekrutim për trafikim
- Trafikim i femrave dhe fëmijëve,
- Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda
- Mbrojtja e dëshmitarëve
- Masa parandaluese
- Kompesimi i viktimave të trafikimit
- Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokollet shtesë të saj,
- Konventa e Këshillit të Europës për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore
- Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit në luftën kundër trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit
- Mekanizmi kombëtar referues
- Qendra pritëse dhe strehëza për asistencë dhe mbrojtjen e viktimave
- Komitete rajonale kundër trafikimit të qënieve njerëzore
- Zyra e kordinatorit kombëtar kundër trafikimit
- Njësia antitrafikim
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit
- Marrëveshje ndërkombëtare

PËRMBAJTJE

HYRJE	1
KREU I	6
TRAFIKIMI NE PLANIN HISTORIK.....	6
1.1 Vështrim historik në lidhje me fenomenin dhe trafikimin e qenieve njerëzore, si figurë e veprës penale.....	6
1.2 Trafikimi i qenieve njerëzore në historinë e Shqipërisë.....	12
KREU II.....	15
TRAFIKIMI SI FENOMEN DHE SI FIGURE E VEPRES PENALE	15
2.1 Kuptimi i trafikimit	15
2.2 Trafikimi i qenieve njerëzore sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.	16
2.3 Zhvillime të tjera në legjislacionin shqiptar	19
2.4 Bashkëpunimi me drejtësinë.....	20
KREU III	23
TRAFIKIMI DHE KRIMI I ORGANIZUAR	23
3.1 Kuptimi i trafikimit dhe viktimës së trafikimit.....	23
3.2 Shkaqet e trafikimit	31
3.3 Dhuna në familje si faktor që ndikon në trafikim.	33
3.4 Teknikat e trafikimit.....	36
KREU IV.....	40
GJENDJA AKTUALE E TRAFIKIMIT TE QENIEVE NJEREZORE	40
4.1 Trafikimi i qenieve njerëzore si figurë e veprës penale.....	40

4.2 Veprimi ose mosveprimi kriminal	44
4.3 Elementet përbërës të anës objektive te veprës penale.....	46
4.4 Subjektet e veprës penale	49
4.5 Kuptimi i anës subjektive dhe rëndësia e saj.....	51
KREU V	59
TRAFIKIMI DHE KRIMI I ORGANIZUAR	59
5.1 Trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimi i organizuar	59
KREU VI.....	63
PROVAT KRYESORE NË PROCESIN PENAL PËR TRAFIKIMIN E QËNIEVE NJERËZORE.	63
6.1 Provat kryesore në një proces penal për trafikimin e qenieve njerëzore.	63
6.2 Sigurimi i provës në procesin penal	71
KREU VII.....	73
PROBLEME TEORIKE DHE PRAKTIKE GJATË GJYKIMIT	73
DHE HETIMIT TË ÇËSHTJEVE.....	73
QË LIDHEN ME TRAFIKIMIN E QËNIEVE NJERËZORE.....	73
7.1 Ndjekja penale dhe trafikimi i qenieve njerëzore.....	73
7.2 Gjendja aktuale e trafikimit të qenieve njerëzore ne RSH-së.	86
KREU VIII	100
PROBLEME TEORIKE DHE PRAKTIKE GJATE GJYKIMIT TE CESHTJEVE QE LIDHEN ME TRAFIKIMIN E QENIEVE NJEREZORE	100
8.1 Zhvillimi i çështjes në formën e gjykit të zakonshëm.	100
8.2 Zhvillimi i çështjes në formën e gjykit të shkurtuar	106
8.3 Gjykimi në mungesë	108

KREU IX.....	111
PANORAME KRAHASUESE DHE AKTET NDERKOMBETARE NE LIDHJE ME TRAFIKIMIN E QENIEVE NJEREZORE.....	111
9.1 “Trafikimi” i parë në këndvështrimin e legjislacionit penal të vendeve të ndryshme.	111
9.2 AKTET DHE INSTRUMENTAT NDERKOMBETARE NE LIDHJE ME TRAFIKIMIN E QENIEVE NJEREZORE.....	125
Përfundime dhe rekomandime	133
BIBLIOGRAFI	135

HYRJE

Ky punim është një përpyetje për studimin e trafikimit të qenieve njerëzore¹⁾ si fenomen dhe si figurë e veprës penale. Ekzistojnë shumë faktorë të cilëve mund t'ju referohemi për të shpjeguar shkaqet e ekzistencës së trafikimit të personave. Këto shkaqe mund të përfshijnë mundësitë e kushtëzuara të punësimit, varfërinë, shkaqet ekonomike, mangësitë e kontrollit kufitar, brishtësia e stabilitetit politik, si dhe konfliktet.

Trafikimi i qenieve njerëzore si fenomen në shoqërinë shqiptare ka lindur mbas përmbyesjeve të mëdha të ndodhura pas vitit 90-të. Shndërrimet e mëdha të karakterit politik dhe ekonomik të vendit, sollën si pasojë të menjëhershme edhe përballjen me disa dukuri të panjohura më parë.

Situata e krijuar rishitas duhet parë e lidhur ngushtë me ekzistencën e faktorëve nxitës drejt kësaj dukurie, që janë në pajtim të plotë me pritshmëritë e pamjaftueshme të cilat u referohen kërkesave për punësim, standarteve më të larta të jetesës, dhe perceptimit real në shumë shoqëri të varëfra se standarti i jetesës është më i mirë në vendet e zhvilluara, dhe në rastin konkret, përgjithësisht perceptimit të shoqërinë shqiptare se jetesa jashtë kufijve, në përfundim, është shumë më e mirë se në vendin tonë.

Trafikimi është fenomen në përhapje dhe ka njohur rritje në dekadat e fundit.

Trafikimi i qenieve njerëzore dhe, në veçanti ai i femrave, renditet në treshen e parë të biznesit fitimprurës, pas trafikimit të drogës dhe atë të armëve.²⁾

Faktori kryesor që ndikon në rritjen e trafikimit është prirja për kërkesa të paligjshme, e cila e bën këtë dukuri një biznes në zhvillim.

Në përgjithësi, ka një ndërgjegjësim të madh të individëve, të cilët sillen në mënyrë të matur kur bëhet fjalë për përfitimin nga trafiket e paligjshme të lëndëve narkotike apo dhe të

¹⁾ Në fjalorin e shqipes së sotme nuk përmendet termi “*trafikim*” por “*trafikant*”, që merr kuptimin e atij që merret me tregtimin e mallrave të ndaluara, të sendeve me vlerë etj, duke i kaluar fshehurazi e në mënyrë të jashtëligjshme në kufirin shtetëror për ti shpëtuar kontrollit doganor (Fjalori i Shqipes së sotme Tiranë 2002 fq 1352).

Në fjalorin juridik (Black's Law Dictionary 1991, fq 1040 jepet kuptimi i përgjithshëm i termit “*traffic*” si tregti, biznes, pra në shkëmbim të mallrave, transportimit të paligjshëm të personave, kafshëve, mjeteve, narkotikëve etj. Në Vocabulaire Juridique Paris 1987, në fq 811 jepet vetëm termi “*Traffic d' influence*”.

Po kështu edhe Enciclopedia Del Diritto 1992 nuk jep kuptimin juridik të trafikimit.

Botimet më të reja përcaktojnë kuptimin e trafikimit në përgjithësi dhe atij të qenieve njerëzore në veçanti.

²⁾ Shegani A., The Harmonisation of the Albanian criminal legislation in the field of Trafficking and Terrorism, pg 2.

armëve. Ndërsa, në rastet e trafikimit të personave, individët përfitojnë nga shërbimet e ofruara, qofshin këto shërbime seksuale ose shërbime pune, pa u menduar thellë se çfarë fshihet pas këtij shërbimi. Përkundrazi, ata janë të kënaqur, duke qenë se iu është dhënë mundësia e përfitimit me çmim të mirë dhe konkures. Njerëzit me prirje kriminale synojnë të punësojnë apo dhe të përfitojnë seksualisht, duke mundësuar në këtë mënyrë krijimin dhe ndikimin në përgatitjen dhe zhvillimin e terrenit për trafikimin e personave.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim shumë kompleks. Në lidhje me këtë veprimtari, institucionet ligjzbatuese përballen me probleme të gjera, të cilat fillojnë që me evidentimin e veprimtarisë kriminale, identifikimin e viktimës së trafikimit, hetimin e plotë të çështjes dhe marrjen e masave që çështja të ndjekë rrugën e drejtë, deri në përballjen e autorit me dënimin e merituar. Një moment i rëndësishëm i kësaj pune është dhe rehabilitimi i viktimës së trafikimit.

Evidentimi i veprimtarisë kriminale dhe identifikimi i viktimave të trafikimit, mbetet në shumë raste i vështirë për tu realizuar. Kjo ndodh në barazpeshë me një sërë faktorësh:

Së pari, viktimat e trafikimit janë të prirura të mos tregojnë ose të mos vihen në kontakt të drejtëpërdrejtë me organet përkatëse. Por janë këto organe të cilat vijnë në dijeni për ekzistencën e fenomenit dhe të viktimës së trafikuar në mënyrë indirekte.

Së dyti, në shumicën e rasteve dëmet që i janë shkaktuar viktimës së trafikimit janë të shumta, ku më të spikaturat janë ato të karakterit psikologjik. Përballja me fenomenin kriminal e vë viktimën e trafikimit në një situatë të jashtëzakonshme duke i shkaktuar probleme të mëdha të tipit psikologjik. Dhuna dhe abuzimi seksual i ndodhur gjatë fazës së trafikimit mundet të kenë shkaktuar probleme të pariparueshme në shëndetin mendor të viktimës së trafikimit. Parë në këtë këndvështrim, edhe historia e treguar nga viktima e trafikimit mund të jetë derivat i ndikimit psikologjik të saj dhe jo një realitet i ndodhur.

Së treti, ndjekja penale e çështjeve që lidhen me trafikimin ndodh të fillojë dhe si rezultat i kallëzimeve të bëra nga familjarët e viktimës, të cilët në të shumtën e rasteve nuk kanë dijeni të drejtëpërdrejtë për atë çfarë ndodh por u janë drejtuar organeve të hetimit duke qenë se janë të bindur që diçka nuk shkon mbarë në jetesën e të afërmit të tyre. Problemet që hasen në këtë rast lidhen me dhënien e të dhënave jokorrekte për shkak të padijenisë për fenomenin apo dhe për shkak të perceptimit të gabuar.

Së katërti, në të shumtën e rasteve për shkak të natyrës së kësaj vepre penale, hetimi i çështjes penale ka nevojë për veprime hetimore të cilat çojnë në marrjen e provave të nevojshme, prova këto që janë të detyrueshme për tu marrë në territorin e një shteti të huaj. Në kushtet në të cilat i vetmi mjet juridik i përdorshëm në rastin konkret është kërkesa për ndihmë juridike e parashikuar në ligjin proçedural, mbetemi në pritje të ardhjes së përgjigjes së letërporosisë nga autoriteti i huaj për vijimësinë e proçesit dhe vendimarrjen në lidhje me çështjen.

Ky punim ka si qëllim studimin e trafikimit të qenieve njerëzore si fenomen në përgjithësi dhe si figurë e veprës penale në veçanti. Gjatë këtij punimi do të nxjerrim në pah aspektet teorike dhe praktike të trafikimit të qenieve njerëzore që nga momenti i parë i fillimit të proçedimit penal e deri në momentin e fundit të këtij procedimi. Gjatë këtij punimi duke marrë në analizë

në mënyrë të detajuar aspektet kryesore të hetimit të këtyre figurave të veprave penale por dhe të gjykimit të tyre, do mundohemi të prezantojmë disa elementë të hasur në veprimtarinë e përditëshme të cilat e përballin trafikimin e qenieve njerëzore me problemet kryesore në rangun procedural, me problemet kryesore në fazën e mbledhjes dhe sigurimit të provave, me problemet në fazën e gjykimit të çështjes penale dhe me problemet e hasura me qëllim vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor. Duke marrë në analizë këta elementë synojmë të konkludojmë në propozime konkrete, me qëllim përmirësimin e situatës qoftë në fazën e ndjekjes penale ashtu dhe në fazat e tjera të ecurisë së procesit.

Parë në këtë këndvështrim synojmë të nxjerrim në pah vlera të karakterit teorik, praktik dhe shkencor, të dala në vite për trafikimin e qenieve njerëzore nga organet tona ligjzbatuese. I gjithë punimi është bazuar në legjislacionin në fuqi, parashikimet e Kodit Penal, parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, si dhe në akte ndërkombëtare të ratifikuara nga ana e shtetit shqiptar. Natyrisht që, kur flasim për trafikimin e qenieve njerëzore në aspektin teorik dhe praktik, problemet e hasura janë nga më të ndryshmet dhe fusha e studimit është mjaft e gjerë, por ajo çfarë synohet të prezantohet gjatë këtij punimi ka të bëjë me prezantimin e elementëve më të spikatur në vite, elementë këta të cilët kanë dalë nga praktika e përditëshme dhe elementë të cilët kanë induktuar ndryshime.

Në funksion të këtij qëllimi analiza e aspekteve që lidhet me detyrimin për përmirësime në legjislacion, për çështjet e trafikimit, dhe nxjerrjen në pah të sfidës që legjislacioni ynë synon të arrijë në përqasjen sa më maksimale me aktet ndërkombëtare të ratifikuara, me europianizimin e të drejtës tonë penale.³

Për të kryer kërkime mbi një temë, është e nevojshme të përcaktohet fenomeni nën hetim. Eksplorimi i kërkesës për punën si dhe i kërkesës për shërbimet e personave të trafikuar nxjerr në pah dy probleme shumë serioze për tu trajtuar.

Së pari, si do të përcaktohet personi i trafikuar, kush do të llogaritet si i tillë dhe, Së dyti, çfarë nënkuptohet me kërkesë dhe ofertë.⁴

Këto probleme, por dhe të tjera nuk gjejnë zgjidhje të plotë me përkufizimin e miratuar nga Kombet e Bashkuara sipas Protokollit të Palermos mbi Trafikimin e Personave (2000).

Kur flasim se nuk gjen zgjidhje kemi parasysh se sipas këtyre parashikimeve nuk arrihen të përcaktohen disa prej elementeve përbërëse të trafikimit.

Për shembull, termat shfrytëzim seksual dhe shfrytëzim i prostitucionit të të tjerëve, nuk janë të përcaktuara. Kjo e bën praktikisht të pamundur për të specifikuar se kush ka qenë ose nuk ka qenë trafikuar në tregëtinë e seksit komercial.

Evidentimi i të dhënave konkrete në këtë punim është bërë mbi bazën e studimit të thelluar në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Ky studim përfshin çështje të hetuara dhe të gjykuara në vite. Nga ana tjetër bazë e këtij punimi është analizimi i detajuar i legjislacionit në fuqi në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, aktet ndërkombëtare dhe praktikën e njehsuar

³ 'Europianizimi i të drejtës penale', programi i BE-së për Shqipërinë, Broshura 5, Tiranë 2007, fq 7-20.

⁴ 'Ballafaqimi i kërkesës me ofertën, jep rezultatin e përfutur në treg. Oferta ashtu si në ekonomi paraqet kapacitetin total të prodhimeve/shërbimeve që prodhuesit/shërbyesit në përgjithësi, brenda një segmenti të tregut apo brenda një tregu të tërë, janë në gjendje të e ofrojnë. Teoria ekonomike supozon që në tregun e lirë kërkesa dhe oferta do të ekuilibrohen dhe do të përcaktojnë nivelin e çmimit.

Ëikipedia, enciklopedia e lirë.

të mbajtur nga Gjykata e Lartë e R.Sh-së. Studimi i prezantuar ka si objekt figurat e veprave penale në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në Republikën e Shqipërisë, duke analizuar aspektet teorike në planin juridiko-penal, aspektet krahasuese me vendet e tjera, aspektet kriminologjike si dhe politikës së ndjekur gjatë këtyre viteve për parandalimin e veprimtarisë dhe dënimin e autorëve si dhe për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.⁵

Ky punim është konceptuar i ndarë në disa krerë.

Në pjesën e parë kemi trajtuar hyrjen e këtij punimi duke bërë dhe prezantimin në lidhje me qëllimin dhe metodologjinë studimore të këtij punimi, interesin që paraqet dhe objektin e studimit.

Pjesa e parë është e përmbledhur në dy krerë kryesorë.

Kreu i parë i është kushtuar trafikimit të qenieve njerëzore parë në rrafshin historik duke specifikuar jo vetëm trafikimin e qenieve njerëzore si figurë e veprës penale por dhe si fenomen social. Është parë e rëndësishme të trajtohet në këtë mënyrë, duke marrë si bazë mbi të gjitha karakteristikat e veçanta në planin social që paraqet kjo figurë veprës penale. Kreu tjetër vazhdon me dhënien e përkufizimeve në lidhje me kuptimin që i jepet viktimës së trafikimit, si dhe pjesëve përbërëse të këtij procesi. Më tej do të analizojmë në mënyrë të detajuar shkaqet e trafikimit duke u bazuar në një analizë specifike për secilin duke qenë se për përmirësimin e situatës në drejtim të kësaj veprimtarie duhet luftuar fillimisht elementi që shkakton fenomenin.⁶

Duke vazhduar më tej me trajtimin e punimit do shohim kërkesën dhe ofertën si elementë të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në çështjet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore. Përshtatshmëria kërkesë – ofertë dhe trafikimi i qenieve njerëzore janë dy procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Gjatë këtij analizimi do nxjerrim në pah evidentimin e profileve të viktimave të trafikimit si profilin e një viktime të përdorur për qëllime seksuale, profilin e një viktime të përdorur për punë si dhe profilin e një viktime të përdorur për lypje.

Edhe pse në përgjithësi biem dakord se është e rëndësishme dhe interesante për të konkluduar dhe pyetur se cila është arsyeja që e shtyn një person drejt të qenurit “klient” i përfitimit seksual, është shumë më e vështirë dhe e pakuptimtë të japim një definicion duke konkluduar se çfarë e shtyn një punëdhënës drejt përfitimit të shërbimit për punë, aq më tepër, kur niveli i papunësisë është në rritje.

Fenomeni paraqitet ndryshe në rastin kur veprimtaria e trafikimit kryhet duke punësuar një punonjës për punë dhe ndryshe kur është paguar për seks.

Në të shumtën e rasteve zgjidhja është perceptuar përgjithësisht si rezultat i zgjedhjes individuale dhe morale. Në rritjen e kërkesës për punë në ekonominë familjare kanë ndikuar ndryshimet demografike dhe problemet që lidhen me strukturën e familjes, feminizimin e krahut të punës dhe mungesa e kujdesit publik. Kjo tregon se shteti është i implikuar në krijimin e rrethanave që gjenerojnë kërkesën. Në mënyrë të detajuar do trajtohet më tej dhe lindja dhe zhvillimi i trafikimit në territorin e R.Sh-së. Shqipëria është vend origjine e viktimave të trafikimit, duke u nisur dhe nga pozicionimi gjeografik i saj. Në kohën tonë trafikimi i qenieve njerëzore është shndërruar në një fenomen global. Trafikimi është më i përhapur dhe më i destinuar për zhvillim në vendet e zhvilluara sesa në vendet në zhvillim e sipër siç është dhe

⁵ ‘Ekzekutimi i vendimeve penale’(probleme të ligjit dhe të praktikës shqiptare, Tiranë 2004 fq 20-37 dhe 93-100.

⁶ Kjo ide themelore nënvizohet në tekstin mësimor të Prof. Dr Elezi I ‘E drejta Penale’ (Pjesa e Posaçme, Tiranë 2007, fq 5-7)

vendi ynë. Duke patur parasysh pozitën gjeografike të shtetit shqiptar por dhe të dhënat që lidhen me ekonominë në këtë vend, shohim se vendi ynë mbetet vend origjine dhe tranziti. Një fenomen i tillë është i lidhur ngushtë dhe me kërkesën për shërbime që vijnë nga vendet e tjera. Pjesa e dytë e punimit.

-Kjo pjesë i është kushtuar trajtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me saktësimin e situatës ligjore ndërkombëtare në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore si dhe përqasja e legjislacionit shqiptar me këto akte ndërkombëtare.

-Pjesa tjetër i është kushtuar ndjekjes penale⁷të figurave të veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, duke specifikuar të drejtat që ka viktimat e trafikimit në procesin penal, rastet dhe mënyrat e dëmshpërblimit për viktimat e trafikimit si dhe mjetet ligjore në dispozicion të viktimës së trafikimit.

Më tej punimi vazhdon me kreun në të cilin përmbledhen:

-Gjendja aktuale e trafikimit të qenieve njerëzore në R.SH-së, në të cilin do pasqyrohet gjendja aktuale duke marrë parasysh evidentimin e viktimave të trafikimit por dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

- Proçesi gjyqësor në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, do të vijojë analizimin e këtij punimi duke evidentuar mënyrat e kryerjes së këtij proçesi, problemet e hasura që nga momenti i përballjes së viktimës me Gjykatën e deri në momentin e kualifikimit të duhur të figurës së veprës penale. Nisur dhe nga parashikimet proçeduriale do të ndalojmë në përcaktimet që lidhen me zhvillimi e çështjes në formën e gjykimit të zakonshëm, zhvillimi i çështjes në formën e gjykimit të shkurtuar dhe zhvillimi i çështjes në formën e gjykimit të drejtëpërdrejtë.

-Kreu i fundit i punimit trajton Problemet kryesore që hasen në hetimin e veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore si dhe problemet kryesore që hasen për gjykimin e veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

⁷⁾ Kompetencën lëndore të ushtrimit të ndjekjes penale e ka Prokuroria për Krime të Rënda, sipas parashikimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale të RSh-së. Me l i g j nr.9110, datë 24.7.2003 Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda, u vendos krijimi, organizimi dhe funksionimi i gjykatave për krimet e rënda, me synim rritjen e efektivitetit të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe përmirësimin e cilësisë së gjykimit të tyre.

KREU I

TRAFIKIMI NE PLANIN HISTORIK

1.1 Vështrim historik në lidhje me fenomenin dhe trafikimin e qenieve njerëzore, si figurë e veprës penale.

Shoqëria njerëzore është njohur me fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit në forma të ndryshme përgjatë gjithë kohërave. Kur flitet për trafikimin jemi mësuar shpesh ta përcaktojmë si “skllavëria e kohëve moderne”. Ndaj dhe në një këndvështrim historik duhet të marrim në analizë këtë fenomen që nga shoqëria e lashtë greke, për të kaluar tek romakët në kohën e Mesjetës dhe për të vazhduar më tej, deri më sot, kohëra në të cilat njerëzit i janë nënshtruar formave të ndryshme të skllavërisë fizike dhe seksuale. Secila etapë njerëzore ka përfaqësuar fenomenin e trafikimit në përshtatshmëri me kohën dhe nevojat e saj.

Disa nga pikat më të spikatura të trafikimit të qenieve njerëzore në vite përfaqësohen nga fenomene të tilla si lindja dhe zhvillimi i skllavërisë, tregëtia me skllavër,⁸ shfrytëzimi i personave për shërbime seksuale, shfrytëzimi i personave për shërbime të tjera etj. Për të nxjerrë në pah historikun në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore do të na duhet të marrim në analizë periudhën më të hershme të shfaqjes së trafikimit, duke analizuar skllavërinë, kuptimin e saj dhe tregëtinë me skllavër. Skllavëria e përkufizuar ndryshe si mohim i të qënurit i lirë i personit, është baza kryesore që çoi më tej në tregëtinë me skllavër.⁹ Tregëtimi i skllavërve ka lindur që në kohë të lashtë¹⁰ dhe ka gjetur lulëzimin e saj deri në ditët tona. Lashtësia përfaqëson një ndër etapat njerëzore ku tregëtia e skllavërve kishte përhapjen më të madhe. Ajo çfarë i lidh të gjitha etapat njerëzore me fenomenet negative është elementi i realizimit të përfitimeve. Janë këto përfitime të cilat bëhen promotor lëvizës për të gjitha këto fenomene. Në kohërat e lashta ndodhte shndërrimi i skllavërve në një prej burimeve kryesore për realizimin e punëve të ndryshme dhe të detyrueshme. Skllavërit shiheshin si objekte dhe si të tilla dhe trajtoheshin¹¹). Kjo bënte që ata të përjashtoheshin nga një sërë të drejtash duke përfshirë dhe të drejtën për të

⁸E Drejta Romake, Mandro A, Tiranë 2011, fq 136-138.

⁹La sciavitu del nostro tempo. 2010. Fq 53-62.

¹⁰Trafikimi i qenieve njerëzore, trajtim juridiko-penal dhe kriminologjik, Leskoviku M, Tiranë 2006, fq 11-22.

mos qenë të lirë. Ky kufizim avanconte deri në mohimin e plotë të të drejtave jetësore. Duke mos u njohur atyre asnjë të drejtë, skllëverit shiteshin dhe bliheshin në mënyrë të njëjtë me objektet apo sendet e ndryshme.

Tregëtia e skllëverve ka qënë më e përhapur duke filluar nga shek XV deri në shekullin XIX. Janë dukuritë që lidhen me krijimin e perandorive siç mundet të përmendim krijimin e Romës, si element ku nis zanafilla për tregëtinë me skllëvër. Periudha e lashtë ku u shfaq tregëtia e skllëverve nis me krijimin e Romës viti 753,¹² (p.e.s) deri në shek. II (p.e.s). Nëse i referohemi periudhave më të hershme kategoria e personave me statusin “skllav” nuk ekzistonte, kjo dukuri filloi të shfaqej për shkak të luftërave të shumta të ndodhura dhe për shkak të trofeve të përftuara gjatë luftimeve. Si rrjedhojë e këtyre luftimeve dhe trofeve të marra nga lufta, ku pjesa më e madhe e trofeve përfaqësohej nga njerëz të kthyer në robër, numri i skllëverve pati një rritje të madhe dhe për pasojë lindi dhe tregëtia me ta.

Nuk ekzistonte asnjë lloj e drejte për personat e kthyer në skllëvër, pasi ata konsideroheshin si sende që flasin, por që nga ekzistenca e tyre dhe çdo gjë tjetër ishte në favor të pronarit të tyre apo të ashtuquajturit “padronit”. Në bazë të përcaktimit që i jep e drejta romake skllëverit ishin nën pushtetin e pakufizuar të padronit të tyre. Skllëverit¹³ e kësaj periudhe ndaheshin në këto kategori:

Së pari

Fëmijët e lindur nga një nënë skllave në çastin e lindjes. Bëhet fjalë për ata fëmijë të cilët në momentin e lindjes së tyre mamaja natyrale ishte një person jo i lirë ose e thënë në fjalë të tjera ishte e skllavëruar.

Së dyti

Robërit e luftës ose personi që është zënë. Kjo periudhë kohe karakterizohet nga luftëra të shumta dhe me mbarimin e betejave ndodhte dhe fenomeni i robërimit të popullsisë që kishte humbur betejën. E gjithë masa e popullsisë që kishte humbur betejën kthehej në robër të cilët përfaqësonin thuajse numrin më të madh të skllëverve.

Së treti

Personat që i përkisnin një komuniteti të huaj dhe që kryenin shkelje ligjore. Në rastin konkret bëhet fjalë për ata persona të cilët nuk ishin romakë por që për shkak të ndonjë shkelje të bërë prej tyre në Romë ktheheshin në skllëver¹⁴.

Së katëri

¹²) Mandro A., E Drejta Romake. Tiranë 2011, fq 138-139.

¹³) Mandro A., E Drejta Romake. Po aty.

¹⁴) Mandro A., Punim i cituar, Tiranë 2011, fq 139-140.

Një kategori tjetër skllavërisht ishin dhe vetë romakët të cilët ktheheshin në skllavëri për shkak të marrjes së borxheve dhe mosshlyerjes së tyre.

Së pesti

Në skllav kthehej dhe personi që dezertonte në mënyrë të vullnetshme nga fronti i luftës.

Së gjashti

Kthehej në skllav dhe personi që nuk pranonte ose nuk paraqitej për t'u regjistruar në regjistrat e popullsisë.

Megjithatë për romakët e kthyer në skllavëri, ata nuk mbeteshin si të tillë në Romë por shiteshin tek të huajt me preteksin se një qytetar romak nuk mund të bëhej skllav në Romë.

Lashtësia përfaqëson periudhën ku skllavëria arriti kulmin e lulëzimit duke e përdorur këtë kategori njerëzish për punë të ndryshme.

Përfitimet e marra nga ekzistenca e skllavërisë ishin të ndryshme si: përfitime monetare për shkak të shitjes, përfitime në shërbim për shkak të punës si skllavëri dhe përfitimet nga shitja e punës së skllavëve. Ajo çfarë vihet re është fakti që në të gjitha rastet flitet dhe bëhet fjalë për përfitime. Përgjatë viteve një tjetër dukuri që ka ndikuar në tregëtimin njerëzor,¹⁵ është dhe prostitucioni.

E parë për efekt analizimi, trafikimin dhe prostitucionin duhet ti trajtojmë si dy fenomene të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, duke e kategorizuar dhe prostitucionin si shkak që ndikon në trafikim por normalisht jo si trafikim i mirëfilltë. Kur folëm për skllavërinë, folëm për kategoritë e personave që ktheheshin në skllavëri dhe faktin që këta persona përdoreshin për punë të ndryshme. Këta persona, sidomos femrat skllave edhe pse përdoreshin për punë të ndryshme, përdoreshin dhe për shërbime seksuale për padronët e tyre apo dhe për shërbime seksuale karshi të tjerëve.

Nga kjo mundet të konkludojmë për origjinën e hershme të ekzistencës së prostitucionit si fenomen. Prostitucioni është një formë sjelljeje shoqërore e cila është kryer në kundërshtim me normat e sjelljes morale dhe të çdo lloj etike në shoqëri. Fjala "prostitucion" e ka origjinën e saj nga gjuha latine dhe e përkthyer në gjuhën shqipe do të thotë "*çoje në rrugë të keqe*", ku në një kuptim më të plotë do e cilësonim si dhënie e nderit për qëllime fitimi jo vetëm prej atyre që e ushtrojnë por dhe e atyre që e organizojnë dhe që e përfitojnë si shërbim. Prostitucioni si dukuri është shfaqur që në periudha të lashta dhe në të shumtën e rasteve është konsideruar si një zakon. Megjithatë ka shoqëri në të cilat prostitucioni kishte njëfarë veshje normale apo prezantohej si një situatë normale dhe kur flasim për këtë iu referohemi atyre shoqërive në të cilat shoqëria i detyronte vajzat e reja të pamartuara si formë zakonore sjelljeje, të kryenin marrëdhënie seksuale me miqtë që vinin për vizitë, si një mënyrë për të nderuar praninë e tyre. Ky fenomen është hasur në Kinë dhe në Greqi. Dhe kjo mënyrë jetese është konsideruar si një

La Schiavitu delle done, John Stuart Mill. 2011, Fq 22-56.

lloj forme prostitucioni. Nga ana tjetër do të ndalemi dhe në një trajtim tjetër që na vjen nga kohët e lashta, konkretisht tek “e drejta e natës së parë”. Menyre jetese është konceptuar si një formë e prostitucionit. E drejta e natës së parë, përfaqëson të drejtën që ka pronari apo feudali që të provojë çdo grua që martohet me një bujkrob. Kjo lloj mënyre është hasur dhe në rritja religjioze.

Me kalimin e viteve këto lloj sjelljesh,¹⁶ sidomos me evoluimin e rilindjes, patën një stepje të tyre duke qenë se u çmuan si të pamoralshme. Por më i përhapuri i cili gjen trajtim dhe në ditët e sotme është prostitucioni profesional, i njohur që në shoqëritë e lashta ku hasej prania e shtëpive publike. Shprehur me fjalorin e përditshëm prostitucioni si “zanati më i vjetër në botë” përfaqëson një fenomen negativ, të sjelljes shoqërore duke qenë një fenomen i keq për etikën e saj. Ky fenomen ka njohur zhvillim të madh përgjatë gjithë kohërave. Në raport me moralin ka dijetarë që janë munduar ta përfaqësojnë si një devijim dhe si një flajim moral. Prostitucioni është njëra prej formave të shfrytëzimit seksual, ku trupi i femrës shndërrohet në send për shit-blerje. Pra, bëhet objekt tregëtimi shërbimi i ofruar.¹⁷

Femrat si subjekte të shfrytëzuara, në të shumtën e rasteve janë nga shtresat sociale të kategorive të ulëta shoqërore, të cilat në rrethin e tyre ku punojnë dhe veprojnë kanë një ndikim të vogël shoqëror. Të gjitha ato që zakonisht përfundojnë si prostitutë janë nga shtresat më të varfra të shoqërisë. Edhe pse realisht prostitucioni përfaqëson një fenomen negativ dhe shoqëria kalon në urrejtje për ato që merren me prostitucion, është kjo shoqëri e cila në mënyrë indirekte vetë arrin të prodhojë dhe të ndikojë në lulëzimin e këtij fenomeni. Prostitutat, zakonisht përfaqësohen nga femra që kanë alternativa të pakta ose që nuk kanë asnjë alternativë tjetër që të mbijetojnë apo të realizojnë të ardhura jetësore, së pari për veten e tyre dhe së dyti për familjarët apo për fëmijët që mund të kenë në ngarkim. Meqë papunësia dhe lufta për ekzistencë janë shkaqet më themelore që i shtojnë shumicën e femrave të merren me këtë profesion, zgjidhja e problemit të papunësisë së shprehur në një shoqëri, patjetër duhet të jetë prioritet qeveritar. Pasi prostitucioni si dukuri është shumë e përhapur në të gjitha shoqëritë kudo në botë, ajo fatkeqësisht edhe tentohet të konsiderohet si normale, dhe këtu flasim për ato shoqëri të cilat kanë bërë legalizimin e kësaj veprimtarie.

Kjo veprimtari përfaqëson një biznes shumë fitimprurës. Mund të evidentojmë dy mënyra të nxitjes së femrave për prostitucion: mënyra e vullnetshme dhe e ajo dhunshme. Mënyra më e përhapur është ajo e dhunshme, por njihet dhe mënyra e vullnetshme paçka se vullneti mundet të jetë i deformuar apo i drejtëpërdrejtë. Tek shkaktarët e vullnetshëm, më tepër dominojnë motivet materiale e shumë më pak ato fiziologjike dhe psikologjike të nevojave të shfrenuara epshore tek femrat. Megjithatë historia njerëzore ka njohur disa forma të tregëtisë së prostitucionit.

1. Tregëtia me femra për shkaqe seksuale

Në vendet e zhvilluara e sidomos personat e pasur arrijnë që t'i blejnë femrat në rrugë të ligjshme dhe të paligjshme. Deri para disa viteve, numri më i madh i femrave të blera në këtë mënyrë sigurohej nga Azia dhe Amerika Latine. Kurse, kohët e fundit, ky fenomen është më i

¹⁶La Schiavitu delle done, John Stuart Mill. 2011, Fq 22-56.

hasur në shoqëritë postkomuniste duke bërë që dhe femrat më të shitura të jenë ato që vijnë nga ish vendet socialiste¹⁸ të Evropës Lindore, duke përfshirë dhe Shqipërinë.

Në këto raste, mënyra e vënies së kontaktit të ndërsjelltë, më tepër arrihet përmes shpalljeve të publikuara nëpër revista të ndryshme, ndërsa në vitet e fundit me zhvillimet e reja teknologjike të ndodhura, këto kontakte realizohen përmes internetit.

2. Prostitucioni në shtëpitë legale publike.

Bëhet fjalë për atë veprimtari e cila në vetvete përfaqëson një veprimtari të ligjësuar por i nënshtrohet kontrollit. Ky lloj prostitucioni është një formë e ushtrimit legal të kësaj veprimtarie, ku femrat që dëshirojnë të merren me këtë profesion, për këtë “marrëdhënie pune” paraqiten vullnetarisht dhe pa imponim duke kontraktuar për kushtet e veprimtarisë dhe mënyrat e kryerjes qoftë të shërbimit, qoftë të pagesës. Kjo si veprimtari kryhet në objekte të përcaktuara më parë dhe vende të përcaktuara më parë. Kjo formë e prostitucionit, është më e përhapur në qendrat e mëdha botërore dhe qendrat e ndryshme të biznesit, për shkak të ekzistencës së parash në këto ambiente. Vendi apo objekti ku kryhet kjo veprimtari, mund të jetë si banesë apo lokal turistik, i cili, përveç ofertës turistike-hoteliere për klientët, është i kombinuar edhe me këtë shërbim specifik.

3. Prostitucioni ushtarak

Kjo formë e prostitucionit është e shprehur në zona të ndryshme të konflikteve ndërkombëtare; më së shumti nëpër ato vende dhe regjione ku janë të përqendruara kontingjentet e mëdha të trupave ushtarake. Bëhet si shërbim me pagesë për kënaqjen e dëshirave seksuale të ushtarëve të ndryshëm.

Kjo gjë realizohet jo vetëm si shërbim por edhe për të mbajtur ushtarët në beteja pa dezertuar. Siç e pamë më sipër format e skllavërisë kanë ekzistuar para viteve 1400. Por pas këtyre viteve u shënuar totalisht fillimi i tregëtimit Evropian të skllavëve në Afrikë dhe Portugali, duke bërë transportin e njerëzve nga Afrika në Portugali dhe përdorimin e tyre si skllavë. Në vitin 1562, britanikët u bashkuan mbi tregëtinë e skllavëve në Afrikë. Zhvillimi i kolonive dhe plantacioneve ka ndikuar në rritjen e volumit të tregëtisë së skllavëve.

Më vonë në të gjithë vitet 1600, edhe vende të tjera u përfshinë në tregëtinë e skllavëve. Këtu mundet të përmendim: Spanjën, Amerikën Veriore, Holandën, Francën, Suedinë dhe Danimarkën (Agatucci). Rreth viteve 1900 u nënshkrua dhe u vu në zbatim Marrëveshja Ndërkombëtare për Shtypjen e trafikut “White Slave”. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje ishte për të mbrojtur gratë, të rinjtë dhe të vjetërit, nga të qenit të përfshirë në “trafik të bardhë rob”. Megjithatë ka mendime të shprehura nga historianët se ky akt ishte krijuar vetëm për të siguruar një kontroll mbi numrin e grave evropiane të cilat kishin destinacion jashtë vendit. Megjithatë, marrëveshja u manifestua si një veprim moral kundër trafikimit të grave.

Në planin e mëtejshëm historik arrijmë tek Lidhja e Kombeve, e cila u themelua pas Luftës së Parë Botërore, dhe kishte synim ruajtjen e paqes në botë dhe gjithashtu duke u fokusuar në çështjet ndërkombëtare të tilla si trafikimin e qenieve njerëzore. Gjatë Luftës së Dytë Botërore,

¹⁸) Strategjia Kombëtare e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. 2012.

Japonia kishte ngritur një sistem të tmerrshëm dhe të egër, ku gratë në të gjithë Azinë ishin të detyruara në skllavëri seksuale. Gratë ishin vendosur në ato që ishin të njohur si “stacione rehati”. Kushtet në këto stacione kanë qenë mizore, ku çdo grua e paraburgosur ishte në një dhomë fjetjeje të vogël, duke u përballur me keqtrajtime dhe totura të tjera në qoftë se ato kundërshtonin. Për shkak të kësaj situate, shumë femra gjetën vdekjen si nga sëmundja, kequshqyerja, lodhja, vetëvrasja, etj. Stacionet ishin të rrethuara edhe nga tela me gjemba, duke e bërë të pamundur arratisjen prej tyre. Qeveria japoneze kishte ngritur këto stacione me shpresë për parandalimin e krimeve si përdhunim në publik, parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse seksuale si dhe për t’u dhënë rehati ushtarëve në mënyrë që ata të silleshin mirë dhe për t’u siguruar që nuk do të tregonin sekretet ushtarake.

Reagimi ligjor në lidhje me këtë problem e ka zanafillën që në vitin 1895, kohë në të cilën në Paris u mbajt konferenca e Parë, e dyta u mbajt në Londër në viti 1899, ndërsa e treta në Budapest në vitin 1904. Në vitin 1905, Kombet e Bashkuara mbajtën Konferencën e katërt Botërore për të trajtuar çështjen e trafikimit të grave. Në këtë takim, një arritje e madhe ishte fakti se trafikimi është njohur në të vërtetë si një akt i dhunës kundër grave dhe koncepti i trafikimit është definuar në një mënyrë të saktë. Më e rëndësishmja e kësaj konference është dhe nxjerrja në pah e veprimeve që duhet të ndërmerren kundër një veprimtarie të tillë. Këto përfshinin zbatimin e Konventave ndërkombëtare mbi trafikimin dhe skllavërinë njerëzore, për të adresuar faktorët që nxisin trafikimin, për të ngritur zbatimin efikas të ligjit dhe për të përcaktuar gamën e institucioneve të cilët do të punojnë për të eliminuar trafikimin si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe zbatimin e programeve, duke përfshirë institucionet arsimore dhe rehabilituese.

Në vitin 1937¹⁹⁾ Lidhja e Kombeve hartoi një Konventë ku shtetet ranë dakord që të dënojnë çdo person, i cili me qëllim shkakton kënaqjen e pasionit të tjerëve; Punëson, tërheq apo mashtron me qëllim prostitucionin një person tjetër, pavarësisht nga pëlqimi i tij apo saj, Shfrytëzon prostitucionin e një personi tjetër, me qëllim që të tjerët të kryejnë prostitucion. Të gjitha palët e kësaj konvente ranë dakord të ndërmarrin masa legjislative dhe masa të tjera të domosdoshme, për të mundësuar implementimin e Konventës. Pas luftës së Dytë Botërore, trafikimi i njerëzve pati një përhapje më të madhe në funksion të vëmendjes duke qenë se iu dha një rol i posaçëm respektimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Gërshetim i këtyre përpjekjeve është Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 1949, e cila bëri unifikimin e traktateve të mëparëshme në një traktat, dhe konkretisht Konventa për parandalimin e trafikut me persona, dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të tjerëve. Por në një mënyrë më të madhe, u morën masa në drejtim të luftës kundër kësaj forme të Krimit të Organizuar në një periudhë të mëvonshme. Në dhjetor të vitit 1998 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, formoi një komitet ad-hoc, i cili kishte për detyrë dhe qëllim të merrej me elaborimin e konventës kundër krimit të organizuar. Në drejtim të kësaj u zhvilluan re protokolle; Për parandalimin e tregtisë me gra dhe fëmijë, Kundër tregtisë jolegale dhe transportit të emigrantëve, Kundër prodhimit dhe trafikimit të armëve të zjarrit.

¹⁹⁾ Leskoviku M. Trafikimi i qënieve njerëzore, trajtim juridiko-penal dhe kriminologjik. Tiranë 2006, fq 7-9.

Për të ardhur më tej tek Konventa e Palermos e vitit 2000 të cilën do e trajtojmë në një kapitull tjetër. Instrumenti më i fundit ligjor për luftimin e trafikimit të qënieve njerëzore është Konventa e Këshillit të Europës për Veprim kundër Trafikimit të qënieve njerëzore. Trajtuam ato fenomene të cilat i shohim të lidhura ngushtë me trafikimin dhe zhvillimin e tij, duke nxjerrë në pah se si prostitucioni dhe skllavëria janë elemente të cilat kanë sjellë trafikimin e ditëve të sotme. Themi trafikimin e ditëve të sotme duke qenë se është forma e moderuar e këtyre fenomeneve. Në dallim nga format e vjetra të skllavërisë të cilat bazoheshin në nevojën për kryerjen e punëve të rënda, sot trafikimi i qënieve njerëzore përbën një treg të rëndësishëm bazuar në veprimtari kriminale por që në fakt prodhon të ardhura marramendëse në favor të organizatave kriminale.

1.2 Trafikimi i qënieve njerëzore në historinë e Shqipërisë

Kur flasim për trafikimin në historinë e Shqipërisë nga shumë studiues është pranuar se ky fenomen në vendin tonë nuk ka histori. Duke qenë se trafikimin e pamë të lidhur ngushtë me prostitucionin, duhet të marrim në analizë duke konkluduar se megjithëse prostitucioni në Shqipëri është njohur në të gjitha kohërat, krahasuar me vendet e tjera ka patur një përhapje më të pakët. Arsyet të cilat kanë bërë që prostitucioni të mos jetë një formë e përhapur në vendin tonë gjithmonë para shndërrimeve të ndodhura në vitin 90-të, lidhen me një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me:

Traditat shoqërore dhe zakonet,
Pozita e dobët të gruas shqiptare në shoqëri,
Mënyra e jetesës në shoqërinë shqiptare.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore flitet për një shtëpi publike që ka ekzistuar në Tiranë, konkretisht në vendin e quajtur Zogu i Zi, i cili ka marrë këtë emërtim për shkak të kësaj veprimtarie. Edhe gjatë periudhës së komunizmit prostitucioni ka njohur zhvillimet e veta, por e shprehur në mënyrë të fshehur, gjithsesi edhe në këtë periudhë flasim për një shkallë më të ulët të zhvillimit të tij në krahasim me vendet e tjera të botës.

E parë në një vështrim historik mund të themi se kjo dukuri që lidhet me trafikimin e qënieve njerëzore nuk e ka burimin nga vendi ynë. Megjithatë për shkak të pozitës gjeografike dhe për shkak të zhvillimeve historike dhe vendi ynë është bërë "pre" e kësaj dukurie shkatërruese për shoqërinë e cila çënon të drejta dhe liri themelore të individit. Me një shtrirje gjeografike të pëlqyeshme dhe të favorshme Shqipëria është bërë shpesh arenë e luftërave të ndryshme, ku pushtuesit së bashku me shkatërrimin sillnin dhe kulturën e tyre të sjelljes. Shqipëria është përballur dhe ka jetuar një sërë luftërash të cilat së bashku me shkatërrimin sillnin dhe dukuri të panjohura më parë. Duke u populluar me pushtuesit vendi ynë është përballur dhe me kultura të ndryshme të tyre. Shqipëria ka qene në udhëkryqe historike e gjeografike²⁰ dhe është 'populluar' nga pushtues të kulturave të ndryshme: kristiano-romake, turko-islame, austro-hungareze, sllavobullgare apo sllavo-serbomalazeze, greke, italiane, gjermane etj. Rruga "Egnatia", për shembull, që përkolonizoi Shqipërinë, mbart një histori mbi 23 shekuj dhe, sic është logjike apo edhe sic theksohet në burime të ndryshme, përgj

²⁰⁾ Leskoviku M., Trafikimi i qënieve njerëzore, trajtim juridiko-penal dhe kriminologjik. Tiranë 2006 fq 15-25..

ate saj ka patur motele e hane ne te cilat edhe seksi eshte ofruar si sherbim. Megjithate shqiptaret lane ruajtur identitetin e tyre 'vendor': gjuhen, zakonet, kodin e tyre etiko moral etj. Fale imunitetit kulturor te shqiptareve dhe paraardhesve te tyre, pushtimet nuk kane lene gjurme te genesishme, megjithe ndikimin e pamohueshem. Kete pohim e gjejme edhe per pushtimin lene gjurme.

Ne forma te ndryshme, eshte pohuar se ka patur njerez, te vleresuar si te degjeneruar, qe trafikonin gra dhe vajza te reja shqiptare apo i benin ato "dhurate" per haremet e Stambollit. Nuk vertetohet qe trafikimi i grave dhe adoleshenteve te kete ekzistuar si fenomen edhe Shqiperi, madje edhe legalizimi i tij (vitet 1920-1944); ne ate kohe e vleresuar si mase per ruajtjen e shendetit dhe moralit publik. Lidhur me kete çështje ka patur disa hulumtime, kryesisht arkivore. Dhe, nga dokumentacioni i arkivuar, del se ne Shqiperine e kësaj periudhe tregu legal i prostitucionit plotesohej vetem ose kryesisht nga prostituta 'vullnetare'. Pra, nuk njihej trafikimi i grave dhe vajzave per shfrytezim seksual apo qellime te tjera fitimpruese. Kjo konfirmohet edhe nga burime zyrtare. Ne nje leterkembim te Ministrit te Puneve te Brendshme, per shembull, te dates 11 shtator 1935, thuhet:

"Kam nderin t'ju parashtroj se, ne Shqiperi, nuk ekziston tregtia e te bardheve, qofte per gra ose per diem".

Per me teper, ne tetor 1937, Shqiperia ka aderuar edhe ne konventen nderkombetare per zhdukjen e tregtise se grave dhe femijeye. Krejt ndryshe nga c'ndodh sot, edhe kahja e levizjes se prostitutave te asaj kohe ishte "nga jashte-brenda" dhe jo e kunderta. Pra, tregu shqiptar i prostitucionit plotesohej edhe nga femra te huaja. Por edhe ato nuk rezulton te kene gene te trafikuar, por vullnetare. Per shembull, ne nje urdher te Ministrit te Puneve te Brendshme, me 20 korrik 1936, thuhet:

"Kemi konstatuar se kohet e fundit nje numer grash te huaja kane ardhur ne vendin tone me pasaporta te rregullta, me viza te perfaqesive tona diplomatike, te cilesueme si turiste. Keto gra, me shume greke e hungareze, ne realitet nuk jane turiste, por prostituta dhe vine ne Shqiperi per te ushtruar profesionin e kurverise".

Vendosja e regjimit komunist ne Shqiperi,²¹ i dha fund epokes se prostitucionit profesionist te krijuar deri ne ate kohe. Por ai, gjithashtu, nuk lejoi kurrfare trafikimi te grave, adoleshenteve e, pergjithesisht, te qenieve njerezore. Madje edhe lufta kunder ketij lloj trafikimit qe konsiderohej si "plage e kapitalizmit", vleresohej si pjese e luftes se klasave, nclersa te trafikuarit droguarit, prostitutat etj., konsideroheshin si 'te hedhurit tej te shocierise'. Por regjimi komunist e evitoi trafikimin "me menyren e vet. Kete e pohon edhe akademiku Luan Omari, i cili thote: *"Para viteve '90-te, ne Shqiperi nuk njihej koncepti i trafikanteve dhe i trafikimit dhe Kodi Penal parashikonte te denohej, madje ashper, vetem ushtrimi i prostitucionit".* Ne Shqiperi trafikimi i grave dhe adoleshenteve filloi pas vitit 1990, ne kushtet e mungeses se nje "ligji antitrafik". Gjate viteve 1992-1995, pothuajse mungonte legjislacioni per trafikimin e qenieve njerezore. Mbas vitit 1995 hyn ne fuqi Kodi i ri Penal, por edhe ai nuk e specifikon trafikun e qenieve njerezore si figure te vecante te vepres penale. Vetem ne Janar miratohet ligji Nr.8733, date 24.1.2001 "Per disa shtesa e ndryshime ne Kodin Penal te Republikes se Shqiperise", i cili

²¹⁾ Leskoviku M., Punim i cituar , Tiranë 2006, fq 14-20.

percakton si vepra penale te vecanta trafikimin e qenieve njerezore, trafikimin e femrave per shfrytezim per prostitucion si dhe trafikimin e femijëve me qëllim abuzimi dhe përfitimi. Në ditët e sotme trafikimi i qënive njerëzore si një ndër format e krimit të organizuar mbetet akoma shqetësuese për vendin tonë.

KREU II

TRAFIKIMI SI FENOMEN DHE SI FIGURE E VEPRES PENALE

2.1 Kuptimi i trafikimit

Trafiku I qenieve njerezore konsiderohet nje forme e krimit te organizuar per vete karakterin maksimalisht shoqerisht te rrezikshem, I cili eshte I asimilueshem edhe me format e skllaverise moderne – forma kriminaliteti qe prodhojne miliarda dollare²² dhe qe cenojne ne format me te renda te mundshme lirite dhe te drejtat themelore te njeriut.²³ Sipas statistikave te Organizates se Kombeve te Bashkuara dhe Keshillit te Evropes, trafiku I qenieve njerezore gjeneron rreth 32 miliarde dollare ne vit dhe perben formen e trete te trafikimit me te perhapur ne bote, pas trafikut te droges dhe atij te armeve.²⁴ Cdo vit rreth 2,5 milione persona ndodhen nen rrezikun e trafikimit. Sipas statistikave te publikuara nga Komisioni Evropian (Eurostat-DG),²⁵ ne 2013 numri I personave te prezumuar te trafikuar eshte rritur me 18% nga 2008 ne 2010. Permes ketyre viktimave 68% ishin femra, 17% burra, 12% vajza dhe 3% djem.²⁶ Vendet kryesore te origjines se trafikimit jane Rumania dhe Bullgaria per vendet e BE-se, Nigeria dhe Kina per vendet jashte BE-se. Pervec ketyre vendeve, vendet e Afrikes subsahariane, Vietnami, Filipinet dhe vendet e Evropes lindore llogariten ne vendet kryesore prej nga origjinon trafikimi.

Fenomen kriminal nderkombetar per nga natyra, trafikimi eshte gjithashtu nje fenomen multiformesh. Format e trafikimit synojne te privojne personat nga autonomia e tyre, nga liria e tyre, dhe te nenshtrojne personat nepermjet formave te ndryshme e te rend ate keqtrajttimeve fizike dhe psikologjike. Ekzistojne tre forma kryesore te trafikimit te qenieve njerezore²⁷:

1. Trafikimi me qellim ushtrimin e punes se detyruar;
2. Trafikimi me qellim shfrytezimin seksual;
3. Trafikimi me qellim perdorimin e organeve njerezore;

²² Shih per me teper: "Traite d'êtres humains", e disponueshme ne <http://www.interpol.int/fr/Criminalit%C3%A9/Trafic-d'%C3%AAtres-humains/Traite-d%E2%80%99%C3%AAtres-humains>, konsultuar ne shtator 2014

²³ Shih: "Traite des êtres humains » ne Enciklopedine Wikipedia, e disponueshme ne http://fr.wikipedia.org/wiki/Traite_des_%C3%AAtres_humains

²⁴ Per kete shih: Ministère des Affaires étrangères de la France (2014), *La France et la lutte contre la traite des êtres humains*, ne faqen web: <http://www.diplomatie.gouv.fr/fr/politique-etrangere-de-la-france/droits-de-l-homme/lutte-contre-la-traite-des-etres/>

²⁵ Shih: Commission européenne, Eurostat – DG affaires intérieures (2013), *Trafficking in human beings*, fq.13

²⁶ Keto statistika jane marre nga faqja web e sipercituar.

²⁷ Po aty

2.2 Trafikimi i qënieve njerëzore sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria shqiptare nuk e ka fenomen të prodhuar prej saj, trafikimin. Në periudha të ndryshme historike mund të flitet për mungesën totale të kësaj veprimtarie si dhe mund të përmendet këtu edhe historia shumë vjeçare e periudhës së komunizmit. Arsyet e mungesës së këtij fenomeni në shoqërinë tonë para ndryshimeve të ndodhura pas vitit 90', lidhen me një sërë faktorësh ku përmendim: mënyrën e jetesës së shoqërisë shqiptare, rolin dhe pozitën e gruas në shoqëri si dhe traditat dhe zakonet. Gjatë kohës së sundimit të Mbretit Zog, prostitucioni si element i lidhur ngushtë me trafikimin, ishte i njohur dhe i bazuar në ligj. Shumë studjues kanë nxjerrë në pah mungesën historike të trafikimit apo formave të tjera të shfrytëzimit për qëllim përfitimi në vendin tonë .

Ky fenomen nuk ka patur përhapje edhe po ta shohim në planin krahasimor me vendet e tjera, duke përmendur edhe Greqinë, Italinë apo dhe deri Anglinë, të cilat këtë fenomen e kanë patur të zhvilluar në faza të qytetërimit të tyre. Të paktën trafikimi nuk përmendet në librat mbi historinë e Shqipërisë, në të drejtën tonë zakonore, në libra kronikanësh, gjeografësh, albanologësh, në folklorin shqiptar etj. Ky 'përjashtim', lidhet, para së gjithash, me njëfarë puritanizmi karakteristik, përgjithësisht me jetën tradicionale të shqiptarëve, një jetë e mbyllur, 'në mbrojtje', në një familje të mbyllur, patriarkale, në të cilën gjithçka, përfshirë edhe jetën seksuale të pjesëtarëve të saj, ishte rreptësisht e koduar dhe e kontrolluar.

Pohimi se trafikimi "nuk ka histori" duhet kuptuar si një fakt: Shqipëria, përgjithësisht, nuk ka prodhuar të tilla dukuri "së brendshmi". Megjithatë, Shqipëria ka qenë në udhëkryqe historike e gjeografike dhe është "populluar" nga pushtues të kulturave të ndryshme: kristiano-romake, turko-islame, austro-hungareze, sllavo - bullgare apo sllavo-serbomalazeze, greke, italiane, gjermane etj. Rruga "Egnatia", për shembull, që përshkon Shqipërinë, mbart një histori shekullore dhe siç është logjike apo edhe siç theksohet në burime të ndryshme, përgjatë saj ka patur motele e hane në të cilat edhe seksi është ofruar si shërbim. Në hanet e udhëtarëve këtë prostitucion e kanë ushtruar kryesisht vajza jetime, të cilat e bënin këtë shërbim veç punës së tyre. Por ato mund të kenë qenë edhe objekt trafikimi, në kuptimin që ka marrë sot kjo fjalë. Shqipëria ka qenë, madje për shumë kohë, arenë luftërash të të tjerëve apo një vend i pushtuar. Megjithatë, shqiptarët kanë ruajtur identitetin e tyre 'vendor': gjuhën, zakonet, kodin e tyre etiko-moral etj. Falë imunitetit kulturor të shqiptarëve dhe paraardhësve të tyre, pushtimet nuk ka lënë gjurmë të qenësishme, megjithë ndikimin e pamohueshëm. Këtë pohim e gjejmë edhe për pushtimin pesëshekullor osman. Por, kjo periudhë, edhe përsa i përket trafikimit të grave, nuk ka kaluar pa lënë gjurmë. Nuk vërtetohet që trafikimi i grave dhe adoleshenteve të ketë ekzistuar si fenomen edhe në gjysmën e parë të shekullit XX, kohë në të cilën vërtetohet përhapja e prostitucionit në Shqipëri, madje edhe legalizimi i tij (vitet 1920-1944), në atë kohë e vlerësuar si masë për ruajtjen e shëndetit dhe moralit publik. Lidhur me këtë çështje ka patur disa hulumtime bazuar kryesisht në burime arkivore. Dhe, nga dokumentacioni i arkivuar, del se në Shqipërinë e kësaj periudhe tregu legal i prostitucionit plotësohej vetëm ose kryesisht nga prostituta 'vullnetare'. Pra, nuk njihej trafikimi i grave dhe vajzave për shfrytëzim seksual apo qëllime të tjera fitimprurëse. Kjo konfirmohet edhe nga burime zyrtare të kohës. Kështu, për

shembull, në një letërkëmbim të ministrit të Punëve të Brendshme, të datës 11 shtator 1935, thuhet²⁸⁾:

“Kam nderin t’ju parashtroj se, në Shqipëri, nuk ekziston tregtia e të bardhëve, qoftë për gra ose për djem”.

Për më tepër, në tetor 1937, Shqipëria ka aderuar edhe në Konventën Ndërkombëtare për Zhdukjen e Tregëtisë së Grave dhe Fëmijëve. Në këto kushte trafikimi në vendin tonë njohu lindje të plotë dhe lulëzim në masë vetëm pas ndryshimeve të ndodhura në vitet 90-të. Normalisht që në lindjen dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie ndikuan një sërë faktorësh të cilët jo vetëm që çuan në lindjen e saj por dhe në zhvillimin me hapa të mëdhenj të saj.

Pavarësisht se kjo vepër penale ka njohur lindjen e saj në vendin tonë me ndryshimet e ndodhura në vitet 90-të, parashikimi i parë ligjor për këtë vepër penale ka ndodhur me ndryshimet e ndodhura në Kodin Penal në vitin 2001 me ligjin Nr. 8733, datë 24.01.2001.

Mbetet për tu zgjidhur fakti se cilat janë arsyet dhe faktorët të cilët bënë të mundur që kjo vepër penale mos të gjente parashikimin ligjor si e tillë në Kodin Penal të R.Sh-së që nga momenti i ndryshimeve në ligjin tonë penal, ku mundet të përmendim atë të vitit 1995. Megjithatë në një analizë të hollësishme mund të konkludojmë që një ndër faktorët mundet të ketë qenë dhe mosnjohja e fenomenit në tërësi dhe veprës penale në veçanti. Në këtë mënyrë edhe në momentin e parashikimit në ligjin tonë penal të kësaj vepre penale, institucionet tona të drejtësisë u përballën me konfondime të cilat vinin si rezultat i mungesës së praktikës dhe njohjes teorike të situatës.

Me fillimin e hapjes së kufijve por dhe me përballjen e shtetit shqiptar me disa ndryshime të karakterit ekonomik, politik dhe gjeografik, fenomeni i trafikimit njohu një lulëzim të menjëhershëm dhe erdhi duke u përhapur në masë. Ndoshta në këtë arritje ndikoi dhe mosreagimi ligjor në kohën e duhur ku u deshën gati 10 (dhjetë) vjet për të reaguar, duke qenë se vetëm pas 10 (dhjetë) viteve erdhi parashikimi ligjor për këtë figurë vepre penale. Ky afat dhjetë vjeçar u përdor nga trafikantët në mënyrën më të mirë të mundshme duke mos kursyer si viktima të trafikimit persona të ndryshëm dhe duke përdorur për efekt të realizimit të qëllimit të tyre mënyra nga më të ndryshmet. Edhe pas parashikimit në ligjin penal si vepër penale të trafikimit, problemet e hasura ishin nga më të shumtat për disa arsye, të cilat lidhen me moskuptimin e mirë të ligjit nga ana e profesinistëve, ekzistenca e disa figurave të veprave penale të ngjashme në përmbajtjen e tyre, si dhe në lidhje me faktin se në momentin e parë sipas Kodit Penal të vitit 2001, trafikimi si dispozitë u parashikua si dispozitë blanket, element ky prania e të cilit vështirësoi zbatimin e saj. Formulimi i kësaj dispozite, nga ana e ligjvënësit, me anë të një norme blanket, ku përmbajtja e veprës penale nuk jepej në vetë dispozitën, e vështirësoi edhe më tej punën për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të kësaj vepre penale. Nisur nga fakti që, kjo vepër penale ishte një vepër penale e re, e pa hasur më parë në praktikën gjyqësore shqiptare, ishte e domosdoshme që, nga ana e ligjvënësit kjo vepër penale të parashikohej me një dispozitë përshkruese, ku të jepej në mënyrë të qartë, përmbajtja dhe

²⁸⁾ Dokument i Arkivit të Shtetit

elementet e kësaj vepre penale. Duhet të arrinim në vitin 2004, që të kishim një parashikim të tillë ligjor, ku me ndryshimet e reja të ndodhura në Kodin Penal²⁹⁾ u parshikua se:

“Trafikimit i personave” është rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, ose përfitimit nga gjendjashoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies së përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë.

Parashikimi i mësipërm, në vitin 2004, përfaqëson një arritje për ligjin tonë penal nga njëra anë, por dhe një përpjekje objektive në kuptimin dhe identifikimin e plotë të fenomenit. Për herë të parë u përcaktua në mënyrë të qartë vepra penale konkrete, dhe përmbajtja e dispozitës është e plotë. Fillimisht, sipas ndryshimeve të vitit 2004, trafikimi përmbli dhej në tre dispozita ku ndarja e tyre në nenet 110/a, 114/b dhe 128/b të Kodit Penal ishte në varësi të karakteristikave të moshës dhe të gjinisë së personit – viktimë trafikimi. Në këtë mënyrë kur ligji parashikonte Trafikimi i Personave, neni 110/a i Kodit Penal bëhet fjalë për të gjithë personat e rritur të cilët ishin objekt trafikimi. Neni 114/b i Kodit Penal parashikon trafikimin e femrave. Kjo ndarje bëhet në varësi të faktit, nëse i dëmtuari është fëmijë, në këtë rast zbatohet neni 128/b i Kodit Penal, nëse është femër mbi 18 vjeç, në këtë rast zbatohet neni 114/b i Kodit Penal dhe nëse është mashkull mbi 18 vjeç dhe në këtë rast zbatohet neni 110/a i Kodit Penal.

Nga ana tjetër, duhet të mbajmë parasysh faktin se, pavarësisht se këto tre vepra penale janë vepra penale të ndryshme dhe zbatohen në varësi të rrethanave konkrete, që kanë të bëjnë me të dëmtuarin, të shpjeguara më lart, këto tre vepra penale në thelb, janë të njejta dhe kanë të njejtën natyrë. Një gjë e tillë rezulton, jo vetëm nga përmbajtja e tyre, ku, po të shikojmë formulimet e secilës prej tyre, me ndonjë përjashtim të vogël, tek masat e dënimit, ato janë pothuajse identike, aq sa është e vështirë të gjesh dallime ndërmjet tyre, por edhe nga qëllimi i njejtë që kanë këto vepra penale, i cili ka të bëjë me parandalimin dhe ndëshkimin e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore. Me ndryshimet e ndodhura me Ligjin nr. 144/2013, neni 114/b i Kodit Penal u shfuqizua, duke mbetur vetëm dy dispozita ligjore në lidhje me trafikimin, që u emërtuan ‘Trafikimi i personave të rritur³⁰⁾’ dhe ‘Trafikimi i të miturve’, respektivisht parashikuar nga nenet 110/a të Kodit Penal dhe 128/b të Kodit Penal. Përcaktimi i konceptit të trafikimit të personave, nga ana e ligjvënësit shqiptar, i bërë në Kodin Penal në fuqi, është në përputhje me kuptimin që i jep këtij koncepti “Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar” dhe dy Protokollat Shtesë të saj, të cilët janë bërë pjesë e brendshme e legjislacionit shqiptar, me anë të Ligjit nr. 8920, datë 11.7.2002.

Për të analizuar këtë figurë vepre penale, do të marret në analizë dhe do të përcaktohet fillimisht elementët e figurës së veprës penale.

Le të analizojmë sa më poshtë në dhënien e kuptimit për veprën penale të kryer:

⁵³⁾Neni 110/a I Kodit Penal të RSH-se.

⁵⁴⁾Ligji Nr 144/2013, shpallur me dekretin 8176 dt 14.05.2013.

- veprimi i njeriut,
- rrezikshmëria shoqërore,
- kundërligjshmëria,
- përcaktueshmëria e veprës penale në ligj,
- përgjegjësia penale e autorit.

Elementët themelore të një vepre penale mundet të ndahen në elementë objektivë dhe elementë subjektivë.

Elementët objektivë mund të ndahen në elementë formalë dhe elementë materialë.

Në grupin e elementëve objektivë bëjnë pjesë:

- Veprimi i njeriut,
- Rrezikshmëria shoqërore,
- Kundërligjshmëria.

Veprat penale janë të drejtuara kundër të mirave apo vlerave të cilat janë të mbrojtura në sistemin juridik.

Të mirat juridike që janë të mbrojtura në të drejtën penale janë dhe objekt i veprës penale.

Objekti i veprës penale është e mira juridike kundër së cilës është e detajuar vepra penale³¹.

Në të drejtën penale njihen dy lloje të objektit të veprës penale:

1. Objekti i Përgjithshëm,
2. objekti grupor.

Objekti i përgjithshëm është dhe njeriu dhe bashkësia shoqërore.

Objekt i përgjithshëm është dhe tërësia e të gjitha të mirave materiale që janë që janë të mbrojtura nga e drejta penale.

2.3 Zhvillime të tjera në legjislacionin shqiptar

Për shkak të shtrirjes së dukurisë së trafikimit në mënyrë intensive nga ana e shtetit shqiptar është synuar marrja e një sërë masash me qëllim parandalimin apo dhe goditjen e kësaj figure vepre penale. Një tjetër zhvillim pozitiv³² ka qenë edhe miratimi i ligjit Nr. 9509, datë 3.4.2006 "*Për shpalljen e Moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë, i cili pezullon të gjitha lëvizjet e mjeteve motorike lundruese shqiptare në ujërat territoriale dhe të brendshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe transportin e mjeteve lundruese në rrugë tokësore, për një periudhë prej tre vjetësh për të parandaluar dhe goditur trafiqet e paligjshme, përfshi këtu edhe atë të personave, kryesisht drejt Italisë. Si rezultat i miratimit të këtij ligji që nga periudha e hyrjes së tij në fuqi është ulur ndjeshëm numri i rasteve të trafikimit në rrugë detare. Një hap tepër i rëndësishëm në drejtëm të plotësimit të kuadrit ligjor për trafikimin, është edhe miratimi i Konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve*

³¹) Kambovski V, E drejta penale e përgjithshme, Shkup 2007, fq 141-162

³²) Leskoviku M., Trafikimi i qenieve njerëzore, trajtim juridiko-penal dhe kriminologjik, Tiranë 2006 fq 24-36..

Njerëzore" e cila u ratifikua nga Kuvendi me ligjin Nr. 9642, datë 20.11.2006.Procedura transparente janë krijuar me Prokurorinë e Përgjithshme dhe atë të Krimeve të Rënda, si dhe partnerët ndërkombëtarë lidhur me ndjekjet penale të realizuara nga Policia e Shtetit. Në kuadër të forcimit të gjyqësorit, një hap i rëndësishëm është pajisja e Gjykatës së Krimeve të Rënda me elementët e duhur teknikë për mbrojtjen dhe sigurinë e nevojshme për viktimat e trafikimit që dëshmojnë gjatë një procesi gjyqësor, me "videokonferencë".

Në këtë trajtim nuk mund të lëmë pa përmendur edhe zhvillime të tjera të legjislacionit shqiptar. Këto zhvillime përfshijnë miratimin e disa ligjeve, si: ligji "Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale", "Për mbrojtjen e dëshmitarit", "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", etj.Nga pikëpamja procedurale, vlen të përmendet krijimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda, e cila është gjykata kompetente për gjykimin e veprave penale të trafikimit. Me Ligjin Nr.9276, datë 16.9.2004, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", u bënë disa ndryshime të rëndësishme procedurale:

2.4 Bashkëpunimi me drejtësinë

Personi nën hetim ose i pandehuri, që akuzohet për një krim të rëndë, të kryer në bashkëpunim, kur bashkëpunon me prokurorin dhe gjykatën, duhet të japë informacion të plotë dhe pa asnjë rezervë ose kusht për të gjitha faktet, ngjarjet dhe rrethanat, që shërbejnë si prova vendimtare për zbulimin, hetimin, gjykimin dhe parandalimin e krimeve të rënda dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara prej tyre.Për dënimin e tij zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 28 të Kodit Penal.

Kushtet e bashkëpunimit caktohen në marrëveshjen e mbrojtjes, të hartuar sipas dispozitave të posaçme ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Kur marrëveshja e bashkëpunimit realizohet gjatë gjykimin, gjykata që shqyrton çështjen vendos uljen e masës së dënimit ose përjashtimin nga dënimi, sipas nenit 28 të Kodit Penal. Kur bashkëpunimi realizohet gjatë ekzekutimit të vendimit të dënimit, bashkëpunëtori i drejtësisë mund të kërkojë nga gjykata që e ka dënuar ose nga ajo e vendit të ekzekutimit ndryshimin e dënimit të dhënë. Gjykata vendos pasi merr edhe mendimin e prokurorit.Marrëveshja e bashkëpunimit mund të revokohet kur bashkëpunëtdri i drejtësisë shkel kushtet e përcaktuara ose bën deklaramë të rreme.

Kompetencat e Gjykatës për Krime të Rënda

Gjykata e krimeve të rënda gjykon krimet e parashikuara nga rienet 73, 74, 75, 79 shkronjat "c" dke "ç", 109, 109/b, 110/a, 111, 114/b, 128/b, 219, 220, 221, 230, 230/a, 230/b, 231, 232, 233, 234, 234/a, 234/b, 278/a, 282/a, 283/a, 284/a, 287/a, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal, duke

përfshirë edhe rastet kur ato janë kryer nga subjekte, që janë në kompetencë të gjykatave ushtarake ose nga të miturit."

Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur

Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur zhvillohet nën

a. masa të veçanta për mbrojtjen e tyre, të cilat përcaktohen nga gjykata, kryesisht ose me kërkesën e palëve.

b. Kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361 të KPP.

c. Kur ndaj personit që do të pyetet është vendosur ndryshimi i identitetit, gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme për të bërë të mundur që fytyra dhe zëri i personit të mos jenë të dallueshme për palët. Në rast se është e domosdoshme njohja e identitetit ose këqyrja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm për përmbushjen e këtij veprimi. Në këtë rast gjykata urdhëron marrjen e masave të nevojshme për të mënjeluar pamjen e dallueshme të fytyrës së personit, të cilit i është ndryshuar identiteti.

Në kuadër të këtij trajtimi, përta bërë sa më të plotë kuadrin ligjor në fuqi, do të përmendja edhe miratimin e:

Ligjit nr. 8633, datë 18.09.2000 *"Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 t"*. Qëllimi i tij është të rregullojë mënyrën e regjistrimit, të klasifikimit, të përdorimit dhe të kontrollit të mjeteve lundruese me motor, me tonazh neto të regjistrit nën njëzet ton (20NT) dhe ka për qëllim disiplinimin e përdorimit dhe sigurimin e kontrollit të këtyre mjeteve, për të parandaluar kryerjen e veprave penale.

Ligji nr.10173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë."^{3K} y ligj rregullon masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes. Në zbatim të këtij ligji, ndër të tjera parashikohet edhe shtrirja e nocionit "krim i rëndë", ku si vepra të tilla penale përmenden edhe ato të të parashikuara në nenet 110 shkronja "a", 114 shkronjat "a" e "b", 128 shkronja "b", të Kodit Penal, nene të cilat lidhen konkretisht me format e ndryshme të trafikimit, si dhe dispozitat e tjera penale, që shprehimisht përfshihen në zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Ndërkohë, paralelisht me përmirësimin e legjislacionit material apo procedural penal, angazhimi dhe sensibilizimi i shtetit dhe organizmave ndërkombëtarë, i organizatave joqeveritare kombëtare ose ndërkombëtare, kanë ardhur vazhdimisht në rritje për të luftuar fenomenin e trafikimit në Shqipëri. Qeveria shqiptare ka hartuar Strategjinë kombëtare të Luftes kundër Trafikimit të Qenieve Njerezore si dhe ka krijuar mekanizma që të mundesojnë realizimin e saj.

Të gjitha këto masa do të ndikojnë në përmirësimin e situatës së trafikimit në Shqipëri, por nuk janë të mjaftueshme pa një koordinim të mirë të institucioneve përgjegjëse për zbatimin

e tyre praktik, për të cilin ka ende shumë për të bërë, në mënyrë që këto struktura të mos ngelen formale dhe apatike, por t'i shërbejnë qëllimit për të cilin janë ngritur. Theks i veçantë vihet veçanërisht në zbatimin e ligjit nga gjykata. Këto të fundit kanë një rol kryesor në luftimin e këtij fenomeni, pasi, nëpërmjet vendimeve të tyre mund t'i japin goditje krimi të organizuar. Ligji nr. 9284, datë 30.09.2004 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimi të organizuar*" Ky ligj përcakton rrethin e personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe kompetencat dhe kriteret për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që lidhen me këto krime. Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja e krimi të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të këtyre pasurive. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave mbi të cilët ekzistonnjëdyshimi arsyeshëm,i bazuar në prova për kategori të caktuar veprash penale,³⁸ku përfshihenedhe veprat penale që lidhen me trafikimin, si dhe ndaj një rrethi personash të caktuar.

KREU III

TRAFIKIMI DHE KRIMI I ORGANIZUAR

3.1 Kuptimi i trafikimit dhe viktimës së trafikimit.

Në fjalorin shqiptar nuk mund të gjejmë një përcaktim për termin “trafikim”, për faktin se ky fenomen përfaqëson një dukuri që nuk ka lindur në Shqipëri, por është hasur vetëm pas rënies së komunizmit dhe ndërrimit të sistemeve. Në kuptimin e përgjithshëm termi trafikim gjendet në kuptimin e një fjale që tregon “të bërit tregëti”. Në ditët e sotme është pranuar shprehja se trafikimi i personave si një dukuri sociale, është fenomen ndërkombëtar dhe siç sqarohet dhe më sipër, është shfaqur në vendin tonë gjatë viteve të tranzicionit postkomunist dhe paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore. Kjo për arsye se dhunon liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, duke e trajtuar këtë të fundit si mall tregu, me një shkelje të dukshme të dinjitetit njerëzor. Kategoritë e personave më të prekur nga ky fenomen janë:

1. Personat, të cilët largohen nga vendet e origjinës drejt vendeve më të zhvilluara, kryesisht personat e botës së tretë.
2. Femrat dhe fëmijët e rrëmbyer ose të tërhequr nga premtimet për punë nga organizatat kriminale.
3. Personat që largohen nga lufta apo persekutimi.
4. Përkufizimi i “trafikimit të qenieve njerëzore” jepet në shumë gjuhë ndërkombëtare si dy protokollat e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.

- *Kuptimi i viktimës së trafikimit.*

Për të përcaktuar se çfarë është trafikimi, duhet të analizojmë disa detaje që lidhen me faktin se çfarë ka ndodhur, mënyra se si ka ndodhur, përse ka ndodhur. Në këtë mënyrë do të nxjerrim në pah:

Aktin si veprim³³⁾(për të përcaktuar se çfarë është bërë),

³³⁾Konventa e Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar, Protokollin e Palermos 2000,

Mjetet konkrete me të cilat është kryer akti, të cilët përcaktojnë faktin se si është bërë, Qëllimi ishfrutëzimit, me anë të të cilit përcaktohet se përse kjo është bërë. Kur flitet për aktin si veprim kemi parasysh të gjitha ato veprime të cilat kryhen me qëllimin e posaçëm trafikimit me qëllim përfitimi. Një analizë e detajuar është e detyrueshme për mjetet e përdorura për të arritur qëllimin, dhe në funksion të kësaj mjetet e përdorura për të kryer veprimin.

Protokolli i Trafikimit³⁴ kërkon qëkrimi i trafikimit të definohet përmes një kombinimit të tre elementeve përbërëse jo vetëm në ekzistencën e njerit prej tyre, komponent individual, edhe pësenëdisarastekëto elemente individuale, të cilat mundet të qëndrojnë të shkëputura nga njëra tjetra, mundet të formojnë vepra penale në mënyrë të pavarur.

Për ta ilustruar mund të paraqesim një shembull, që lidhet konkretisht me aktin errëmbimitose mbajtjen e tjetrit pa pëlqim nëpërmjet përdorimit të forcës. Një element i tillë, po të qëndrojë i shkëputur, përbën një figurë tjetër të veprës penale. Në kushtete legjislacionit penal, këta elemente përbërëse mund të identifikohen si elementë objektivë dhe elementë mendorë.

Vepra penale e trafikimit kryhet me elementet e mëposhtem:

Rekrutimi, nënkupton fazën e njohjes dhe të afrimit me qëllim krijimin e besimit tek personi që do të trafikohet. Krijimi i besimit mundet të realizohet në forma të ndryshme por e rëndësishme është që viktima të ketë bindjen e plotë që zgjedhja dhe zgjidhja që rekrutuesi i jep është më e mira dhe më e drejta. Rastet e trafikimit të kryera që në fazë rekrutimi janë të shumta. *Transporti*, përfaqëson realizimin e lëvizjes së viktimës të trafikimit drejt destinacionit konkret. Marrja përsipër e lëvizjes, kryerja e saj si dhe realizimi konkret i saj, gjetja e mjeteve të posaçme për kryerjen e transportit.

Elemente të tjerë janë dhe: *Transferimi, strehimi, marrja e njëpersoni.*

Të gjitha këto veprime duhen kryer nëpërmjet:

- “Përdorimit të forcës”
- “Kërcënimit”
- “Shtrëngimit”
- “Rrëmbimit”
- “Mashtrimit”
- “Abuzim të pushtetit apo të pozitës së dobësisë”
- “Dhëniesose marrjes së përfitimeve”

Legjislacioni ynë penal parashikon si vepra penale:

Trafikimi i personave, neni 110/a³⁵ i Kodit Penal.

Trafikimi i femrave, neni 114/b³⁶ i Kodit Penal,

Trafikimi i të miturve, neni 128/b³⁷ i Kodit Penal.

Kualifikimi i mësipërm bazohet në subjektin e dëmtuar ose më saktë karakteristikat që ka ai. Kështu:

⁵⁸) Protokolli i Palermos 2000.

⁵⁹) Kodi Penal i RSH-se, neni 110/a.

³⁶) Kodi Penal i RSH-se, neni 114/b.

³⁷) Kodi Penal I RSH-se, neni 114/b.

Në rastin e trafikimit të personave, sipas parashikimeve të nenit 110/a të Kodit Penal, subjekti i dëmtuar nga vepra, i quajtur ndryshe viktimë, është çdo person që rekrutohet, transportohet, transferohet etj, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose forma të tjera të shfrytëzimit.

Në rastin e parashikimeve, sipas nenit 114/b të Kodit Penal, subjekti i dëmtuar nga vepra penale, i quajtur ndryshe viktimë, përfaqëson një kategori të posaçme, konkretisht femra.

Në rastin e parashikimeve, sipas nenit 128/b të Kodit Penal, subjekti i dëmtuar nga vepra penale, i quajtur ndryshe viktimë, përfaqëson një kategori tjetër të posaçme, që janë të miturit.

Ndaluam në specifikimin e kësaj ndarjeje, duke qenë se dhe mënyra e trajtimit, duke përfshirë këtu dhe asistencën për viktimën/dëshmitare në procesin penal është në varësi të karakteristikave që ka subjekti i dëmtuar. Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore është një ndër prioritetet më të mëdha për shoqërinë në përgjithësi dhe për organin e ushtrimit të ndjekjes penale, në veçanti. Organi i akuzës drejton hetimin dhe kryen të gjitha veprimet që i çmon të nevojshme në funksion të zgjidhjes së çështjes, duke realizuar kështu ushtrimin e detyrave të tij kushtetuese. Detyra kryesore ka të bëjë me kryerjen e veprimeve të nevojshme me qëllim zbulimin e faktit penal të ndodhur, zbulimit të autorësisë së faktit dhe të bashkëpunëtorëve të tjerë të përfshirë në të. Në kuadër të realizimit të këtyre veprimeve të nevojshme si nga provat në procesin penal janë dhe provat me dëshmitarë. Për efekt analize, paraqitet fillimisht një prezantim të nocionit “dëshmitar”;

Me “dëshmitar” do të kuptojmë çdo person që zotëron informacion me vlerë për procesin penal, për të cilin ai ose ajo ka dëshmuar ose është i aftë të dëshmojë, dhe që nuk bën pjesë tek ‘bashkëpunëtori i drejtësisë’.

Kur flasim për viktimën e krimit, e cila mundet të jetë dëshmitare në procesin penal, është mëse e kuptueshme vlera që ka dëshmia e viktimës. Sidoqoftë, nuk mundemi ti japim më shumë vlerë kësaj dëshmie sesa çdo lloji tjetër prove të marrë gjatë hetimeve. Gjatë³⁸ punës tonë konstatojmë një “vulnerabilitet” të viktimave/dëshmitare, element ky për të cilin jemi të detyruar të marrim masat mbrojtëse me qëllim pakësimin e efektit të krimit mbi viktimën dëshmitare. Në realizimin e detyrave të tij, duke përfshirë dhe mbrojtjen e viktimave, Prokurori bëhet “bashkëudhëtar” me një sërë institucionesh të tjera duke përfshirë dhe O.J.F-të. Praktika e viteve të fundit ka nxjerrë në pah një bashkëpunim të frytshëm me O.J.F-të, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në trajtimin e rasteve të ndyshme në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të viktimave dëshmitare në proces. Bashkëpunimi i ngushtë me O.J.F-të, na krijon lehtësira në kuadër të zbatimit me përpikmëri të ligjit, i cili parashikon një trajtim të posaçëm për viktimën e trafikimit. Bashkëpunimi me O.J.F-të ka ardhur gjithnjë e në rritje, duke patur parasysh rezultatet e arritura dhe ndikueshmërinë e tyre në ecurinë e mbarë procesit.

Nëpërmjet bashkëpunimit, arrijmë tu sigurojmë viktimave të trafikimit trajtimin ekonomik kur ato kanë nevojë dhe trajtimin psikologjik që është i nevojshëm në çdo moment. Në praktikën e përditëshme, vepra penale, subjekti i saj dhe viktimë duhen trajtuar si pjesë e të njëjtit problem, të ndërlidhura ndërmjet tyre dhe jo si çështje të ndara, siç mundet të jetë trajtuar në kohë të ndryshme. Kjo bëhet në funksion të luftës me efikasitet kundër kriminalitetit dhe

³⁸) Roli aktin i organizatave jofitimpruese në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Imeraj E, Tirane 2011, fq 130-136.

realizimit të interesit parësor “*mbrojtjes së shoqërisë në përgjithësi*”. Viktimat e trafikimit kanë ecurinë e tyre, që nga momenti i parë i ndodhjes së veprës penale e në vazhdimësi. Gjatë gjithë kësaj ecurie, vihet re se viktimat e trafikimit përballen, ose më saktë kalojnë në disa faza që e bëjnë pozitën e tyre vulnerabël. Ajo çfarë ne, duhet të mbajmë parasysh dhe ajo çfarë tejçon fryma e legjislacionit në fuqi, në përjasje dhe me legjislacionin ndërkombëtar, ka të bëjë me një trajtim dinjitoz të personave që janë dëmtuar nga vepra penale. Në varësi të fazave, në të cilat kalojnë viktimat e trafikimit në aspektin procedural, një moment i rëndësishëm për tu trajtuar përfaqësohet nga tërësia e parashikimeve ligjore të cilat sigurojnë mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Me konceptin “viktimë krimi”, kuptohen personat, të cilët individualisht apo në mënyrë kolektive kanë pësuar lëndime, duke përfshirë këtu edhe lëndimet fizike ose mendore, tronditje psikike, humbje ekonomike, ose përkeqësim të të drejtave të tyre themelore, me anë të veprimeve apo mosveprimeve të subjekteve të krimit. Në kuadrin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe në referencë të mënyrave të kryerjes së këtyre veprave viktimat të trafikimit, do të quhen personat që janë vënë në pozita të tilla që lidhen me shfrytëzim për prostitucion, realizimin e formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shfrytëzimin për punë, shfrytëzimin për shërbime të detyruara, vënia në skllavëri, forma të tjera të shfrytëzimit, si dhe vënia në përdorim apo transplantim të organeve.

Në kuadrin e një procesi penal, viktimat e trafikimit kanë të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore. Procedimet penale fillojnë në dy mënyra: nëpërmjet kallëzimit të bërë në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga personi i dëmtuar ose viktimat e trafikimit, dhe, me anë të kallëzimit të bërë nga të tjerë. Në rastin e parë, kallëzimi i bërë nga viktimat e trafikimit përfaqëson një të drejtë që ka viktimat, e cila është e drejta për të kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale. Në disa raste praktike, viktimat e trafikimit hyjnë në kontakt me O.J.F të ndryshme operuese, duke marrë aty së pari, dijeninë në lidhje me këtë të drejtë të tyre për të kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale. O.J.F-të në shumicën e rasteve kanë persona të specializuar, të cilët iu sigurojnë viktimave këshillime juridike dhe mbështetje psikologjike. Ka ndodhur që depozitimi i kallëzimit, në prokurori është bërë pas marrjes së konsultimeve përkatëse. Me fillimin e procedimit, vijojnë fazat e tjera, që konsistojnë në dhënien e deklarimeve të viktimës para organit procedues fillimisht dhe vazhdojnë me marrjen pjesë në proces, me paraqitjen e kërkesës për prova. I dëmtuari gjatë fazës së procedimit ka të drejtë të marrë dijeni për veprimet e kryera. Në çdo moment, duhet të mbajmë parasysh trajtimin me dinjitet dhe profesionalizëm të viktimës së krimit.

Një ndër të drejtat, për realizimin e së cilës është patur bashkëpunim me O.J.F-të, është e drejta që ka viktimat për kompensim ose shpërblimin e dëmit. Sipas parashikimeve tona procedurale, viktimat dëshmitare në proces, ose i dëmtuari në proces nuk ka një mbrojtës të tijin, ndaj dhe në praktikën e përditshme një funksion i tillë është ushtruar nga përfaqësues të organizatave të ndryshme. Subjekti i kryerjes së veprës penale ka gjithmonë një qëllim të caktuar në rastin e veprave që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, realizimin e përfitimit monetar, realizimin e çdo lloji forme tjetër të përfitimit. Legjislacioni procedural parashikon si koncept termin “i dëmtuar nga vepra penale”, ku përveç kategorive të tjera, bëjnë pjesë dhe viktimat e trafikimit. Në parashikimet e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale gjejmë të sanksionuara drejtat që ka një person i dëmtuar nga vepra penale. I dëmtuari nga vepra penale ka të drejtë të kërkojë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit. Këtë të drejtë mundet t’a

realizojë duke bërë të mundur paraqitjen e kërkesave në organin proçedues, duke kërkuar marrjen e provave. Në rast mospranimi të kërkesave të bëra para organit proçedues ka të drejtën e ankimit në Gjykatë. Të drejtat që i takojnë të dëmtuarit, shtrihen dhe tek trashëgimtarët e tij, dhe në mungesë të zotësisë juridike të të dëmtuarit, kjo e drejtë i takon dhe perfaqësuesit të tij ligjor. Një tjetër element që konsiderohet si e drejtë e të dëmtuarit nga vepra penale, është dhe padia civile në proçesin penal e parashikuar në nenin 61 të Kodit të Proçedurës Penale.

Sipas parashikimeve të këtij neni, personi që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij, kanë të drejtë të ngrenë padi civile në proçesin penal kundër të pandehurit ose kundër të paditurit civil duke kërkuar kthim pasurie dhe shpërblim dëmi. Viktimat e trafikimit përveç dëmeve të tjera pësojnë dhe ato që ne i quajmë dëme ekonomike. Lidhur me këtë pikë, do të ndalemi në një trajtim më të hollësishëm për vetë karakterin e çështjes dhe interesin që ajo paraqet. Të gjitha format me anë të të cilave realizohet trafikimi i qenieve njerëzore bëjnë që viktimat e trafikimit, për aq kohë sa ndodhen në varësinë e subjekteve të krimit, janë të kufizuara në të gjitha llojet e të drejtave të tyre, duke përfshirë këtu dhe ato ekonomike.

Një problem mjaft i rëndësishëm, duke e parë çështjen në këtë këndvështrim, është dhe përcaktimi në mënyrë të drejtë i dëmit që u është shkaktuar këtyre viktimave.

Është e nevojshme të përcaktohet dhe të përllogaritet jo vetëm dëmi, shpërblimi i tij, por dhe mënyra e realizimit të këtij shpërblimi. Në praktikën e përditshme gjyqësore, megjithëse ka raste të shumta të veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, ka munguar shqyrtimi dhe zgjidhja e padisë civile në proçesin penal (të paktën në praktikën e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë).Arsyet e një rezultati të tillë janë nga më të ndryshmet ndër të cilat, zhvillimi i gjykimit të çështjes penale në formën e gjykimit të shkurtuar (neni 403 e vijues i Kodit të Proçedurës Penale). Në disa raste, subjekti ose autori që ka kryer veprën penale kërkon aplikimin e gjykimit të shkurtuar. Ndërkohë që organi i akuzës, nisur nga parashikimet ligjore që lidhen me zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet, dhe për ekonomi gjyqësore, pranon zhvillimin e proçesit me gjykim të shkurtuar. Problemi i hasur lidhet me fatin që do të ndjekë padia civile e paraqitur nga i dëmtuarinë proçesin penal.

Nga pikëpamja juridike, zgjidhja mund të realizohet në të dy anët, domethënë, të pranohet shqyrtimi i padisë civile, në proçesin penal qoftë dhe me gjykim të shkurtuar ose të veçohet padia civile e cila më pas mund të ngrihet në gjykatën kompetente.Jo vetëm zbatimi i gjykimit të shkurtuar çon në veçimin e padisë civile në proçesin penal.Kjo mund të ndodhë dhe në rastet kur çështja penale shqyrtohet me gjykim të zakonshëm.Më të komplikuar paraqiten rastet në të cilat ka më shumë se një të pandehur në proçes, ndërkohë që padia civile ka lidhje vetëm me njërin prej tyre. Edhe në këtë rast vendoset veçimi i padisë civile, e cila më pas zgjidhet në një proces civil.Një moment problematik, lidhet dhe me “durimin” që paraqet i dëmtuari.Kjo nënkupton, zgjatjen në kohë të realizimit të të drejtave të tij. Ndarja, apo veçimi i padisë civile, bën që i dëmtuari nga vepra penale të përballlet me dy proçese gjyqësore, proçesin penal për provueshmërinë e fajësisë së të pandehurit dhe proçesin civil që lidhet me realizimin e të drejtave të kërkuara prej tij.Në rastin e proçesit civil, gjykata për ti dhënë zgjidhje padisë civile është e detyruar të presë vendimin e fajësisë në lidhje me veprën penale të kryer nga subjekti.Përballja me seanca të shumta gjyqësore ndikon jo mirë në gjendjen psikologjike të viktimës e cila shpesh manifeston lodhje.

Kemi një rast të vetëm ku bashkëpunimi me O.J.F-në, ka bërë të mundur që e dëmtuara D.S, ka arritur të përfitojë me padi civile një shumë të konsiderueshme të hollash si dëm i shkaktuar nga vepra penale.

Fakti penal nga i cili është dëmtuar D.S, lidhet me trafikimin jashtë shtetit të të dëmtuarës, e cila në kohën e trafikimit ka qenë e mitur, duke bërë që vepra e kryer nga subjekti të kualifikohet sipas parashikimeve ligjore të nenit 128/b të Kodit Penal.

Shtetasja D. S, nën ndikimin e dhunës fizike dhe psikologjike, mashtrimit për martesë, krijimit të një jete më të mirë, për disa vite me radhë ka qenë, siç quhet “punëtore seksi”, duke punuar për llogari të të pandehurit A.A.Në përfundim të hetimit paraprak, në bashkëpunim me përfaqësuesit ligjorë të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, e dëmtuara paraqiti një padi civile, në të cilën kërkon shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale.Padia civile u paraqit nga e dëmtuara që në fazën e hetimeve paraprake dhe me vendim, prokurori pranoi futjen e saj në fashikull.

Padia civile u paraqit nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, Tiranë së bashku me kërkesën për gjykim dhe aktet, në lidhje me procedimin penal në ngarkim të të pandehurit A. A, i akuzuar për kryerjen e veprës penale sipas nenit 128/b të Kodit Penal. I pandehuri kërkoi aplikimin e gjykimit të shkurtuar, si formë e zhvillimit të gjykimit në lidhje me këtë çështje, kërkesë kjo e pranuar nga Gjykata.Meqënëse padia civile e paraqitur, nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ish in aktet e dosjes, gjykata vendosi veçimin e padisë civile, e cila më pas u shqyrtua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë si gjyq civil.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në vendimin e saj e deklaroi fajtor të pandehurin, vendim ky që u përdor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për padinë civile, të cilën e kishte marrë në shqyrtim, duke vendosur në favor të të dëmtuarës.

Ky është prezantimi më konkret i përballjes së të dëmtuarës, me dy procese gjyqësore, procesin penal dhe procesin civil. Secili nga proceset në kuadër të respektimit të procedurave përkatëse kanë të nevojshme një kohë të caktuar, kohë e cila nuk ishte aspak e lehtë për tu kaluar me “durim”, nga e dëmtuara. Përfaqësuesit e O.J.F-së siguruan përfaqësimin në mungesë të të dëmtuarës, në proces duke ndikuar ndjeshëm në mbarëvajtjen e saj.

Një tjetër problem lind dhe pas daljes së vendimit të gjykatës që ka pranuar padinë civile, dhe lidhet konkretisht me ekzekutimin e këtij vendimi. Vështirësia në ekzekutim e ka zanafillën tek faktorë të tillë që konsistojnë në qenien i izoluar të subjektit të veprës penale. Duke qenë i izoluar, subjekti i kryerjes së veprës penale nuk siguron të ardhura dhe nuk kryen asnjë lloj aktiviteti. Në shumë raste autorët bëjnë tjetërsimin e pasurisë së vënë nga vepra penale, ku e tjetërsojnë atë për efekt fshehjeje apo dhe efekte të tjera. Ndodh shpesh që regjistrimi i pasurive të tyre bëhet në emër të personave të tjerë. Në të shumtën e rasteve autorët e veprave penale e regjistrojnë pasurinë e tyre në emër të personave të tjerë, që në kuadër të informalitetit i cili ka karakterizuar shoqërinë shqiptare deri ne ditët e sotme, është e vështirë të kemi një rezultat pozitiv. Ka mjaft raste në të cilat autorët e veprave penale, si rezultat i mënyrës së tyre të jetesës, humbasin pasuritë e fituara nga vepra penale. Paraqitëm një sërë faktorësh, të cilët e vështirësojnë apo e bëjnë të pamundur realizmin e të drejtave ekonomike të viktimave të trafikimit nëpërmjet shpërblimit të dëmit. Viktima mundet të kërkojë si një e drejtë sigurimin e padisë civile, e drejte kjo e parashikuar ne nenin 63 të Kodit të Proçedurës Penale. Ky nen parashikon të drejtën që ka personi për të kërkuar sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit, me sigurim padie deri në momentin e përfundimit të çështjes penale. Kjo është një e drejtë tjetër që parashikimet tona proçeduriale i atribuojnë të dëmtuarit nga vepra penale. Për efekt ilustrimi do të ndalemi në trajtimin e një rasti tjetër praktik në të cilin do të prezantojmë vështirësitë me të cilat haset viktima e trafikimit si rezultat i proçedurave të ndjekura gjatë hetimeve paraprake.

E dëmtuara K. F ka depozituar kallëzim për vepër penale të kryer nga i pandehuri A.G, vepër kjo e kualifikuar sipas nenit 114/b.³⁹ Si rezultat i jetesës së përbashkët për disa vite me radhë, e dëmtuara dhe i pandehuri kanë një fëmijë të mitur. Me vendim gjykate para fillimit të proçesit penal, e dëmtuara K. F ka arritur të njohë atësinë e fëmijës, dhe të përftojë çdo muaj për të, një pension mujor në formën e detyrimit për ushqim.

Forma me të cilën i pandehuri e detyroi për disa vite me radhë të dëmtuarën të ushtronte prostitucion dhe të ardhurat të shkonin ne favor te tij, lidhej me premtimin që ai i bënte asaj se ata të dy, ishin një çift normal dhe në momentin më të parë që do të siguronin një shumë të mjaftueshme të ardhurash për një jetë luksoze, ajo do të shkëputej nga prostitucioni.

Më vonë, me ardhjen në jetë të fëmijës së tyre, e dëmtuara u detyrua të ushtrojë prostitucion si një mjet i kërkuar nga i pandehuri qe ky i fundit të njihje atësinë e fëmijës së lindur.

Vetëm duke ushtruar prostitucion dhe duke siguruar shuma të mëdha të hollash e dëmtuara ka arritur të marrë atësinë e fëmijës nga i pandehuri pasi i mituri kishte mbushur moshën tre vjeç.

³⁹⁾ Trafikimi i femrave, neni 114/b sipas Kodit Penal i RSH-se

Problemi me të cilin u has e dëmtuara pas depozitimit të kallëzimit lidhej me faktorë ekonomikë pasi si rezultat i burgosjes së të pandehurit A. Ç, të dëmtuarës iu ndërpre pensioni mujor, si detyrim ushqimor për fëmijën e saj të mitur.

Ndërkohë që u has dhe me probleme psikologjike duke qënë se si rezultat i pasjes së një fëmije me të pandehurin, i mituri ruante marrëdhënie familjare me familjarët e të pandehurit, të cilët filluan të ndikojnë në psikologjinë e fëmijes së mitur.

Në këtë mënyrë e dëmtuara, ndodhej pa mjete monetare për të jetuar dhe nën trysinë psikike të familjarëve të saj. Kjo ndikoi negativisht në psikologjinë e viktimës, duke e bërë atë të luhatej në pozicionin e mbajtur prej saj si dëshmitare në procesin penal.

Dhe në këtë rast, në sajë të një bashkëpunimi të frytshëm me O.J.F-të u krijua mundësia e dhënies ekonomike për të dëmtuarën, dhe dhënia e mbështetjes psikike me konsultimin me punonjës social.

Kjo ndikoi pozitivisht në psikologjinë e viktimës, duke bërë që ajo të ishte këmbëngulëse për ecurinë e procesit penal.

Raste të tilla, apo të tjera që karakterizohen nga vështiresi të tilla hasen shpesh, dhe kanë ndikimin e tyre në ecurinë e procesit penal. Normalisht që, synimi ynë parësor është dënimi i autorit të veprës penale dhe si rezultat i problematikës së përmendur më sipër, ky synim në disa raste mbetet i vetmi. Megjithatë, qoftë dhe për realizimin e këtij synimi ne duhet të vlerësojmë, domosdoshmërinë e mbrojtjes së viktimës nga momenti i pësimt të aktit kriminal dhe deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale. Çdo person i dëmtuar nga vepra penale ka nevojë për mbrojtje të menjëherëshme. Si persona për t'u ofruar mbrojtje konsiderohen të gjithë ata persona që njëherësh konsiderohen si viktima sipas akteve kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe kanë nevojë për një gjë të tillë. Një problem më vete me rastin e mbrojtjes së viktimave është marrja e masave që të mos ndodhë riviktimizimi i tyre apo i ashtuquajturit viktimizim sekondar. Ata që kanë mbijetuar nga vepra penale, përballë një trajtimi jo të denjë, përballë mungesës së mbrojtjes, dhe përballë një trajtimi jo të drejtë nga organet e drejtësisë si organi procedues apo gjykata, mundet të provojnë edhe një viktimizim të dytë nga sistemi i drejtësisë. Fazat në të cilat kalojnë viktimat e trafikimit gjatë procesit penal perfshijnë momente të vështira, me të cilat haset viktima, e cila është e detyruar, të kujtojë momente të vështira, si dhe të përballlet me autorin e veprës penale.

Për evitimin e situatave të tilla, duhet treguar kujdes dhe profesionalizëm. Jemi munduar që në punën tonë të përditshme të tregohemi të kujdesshëm në trajtimin e viktimës/dëshmitare, duke patur sukses në një farë mënyre. Kur flitet për sukses, e nisim që nga momenti i parë që lidhet me akomodimin e viktimës, (vendosja në qendra), trajtimin psikologjik të saj, (pasja e

kontakteve me psikologë dhe punonjës socialë në mënyrë të vazhdueshme), krijimi i një situatë drejt një jetese normale, (akomodimi në qendër shoqërohet me program trajtues specifik që përfshin shkollim, punësim, etj), si dhe ndjekja e procedurave ligjore për përfaqësimin e padisë civile. Duke i vendosur viktimat e trafikimit në kushte të tilla trajtimi, kemi mundësinë e mbajtjes së viktimës gjithnjë në korent për procesin penal, gjithnjë të interesuar. Trajtimi i viktimës së krimit, mbrojtja juridike e saj është një problem i madh i sistemit të drejtësisë penale dhe një ndër synimet tona kryesore.

Të drejtat që u takojnë viktimave të krimit me parashikimin e tyre në akte ndërkombëtare dhe kombëtare qëndrojnë në të njëjtin nivel me të drejtat ligjore, dhe si të tilla konsiderohen pjesë e pandarë e të drejtave të njeriut. Studimet dhe praktikat e ndryshme që janë bërë, tregojnë për një luftë efikase kundër kriminalitetit. Përveç gjyqimit dhe dënimit të autorit të veprës penale është e domosdoshme që edhe subjektit tjetër të aktit kriminal t'i ofrohet ndihmë dhe mbrojtje juridike. Për realizimin e ndihmës, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së nevojshme juridike duhet të merren në konsideratë, nevojat specifike dhe pozita delikate, vulnerabël e viktimës si rezultat i ndikimit të viktimizimit në të. Gjithashtu duhet të mbajmë parasysh se humbjet e viktimës janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Bashkëpunimi praktik, me të gjitha organizmat institucionalë apo jo, është shumë i rëndësishëm dhe i paevitueshëm. Vetëm në sajë të këtij bashkëpunimi, do të arrijmë të trajtojmë viktimat e trafikimit sipas parashikimeve përkatëse. Nga ana tjetër, ajo çfarë është më e rëndësishme është rregullimi i bazës ligjore në drejtim të realizimit efikas për shpërblimin e viktimave të trafikimit. Legjislati ynë dhe marrjen në mbrojtje të dëshmitarit, por që në rastin e praktikës tonë për veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore nuk kanë ndodhur.

3.2 Shkaqet e trafikimit

Shkaqet e trafikimit janë të ndryshme⁴⁰ dhe të shumëllojshme por ato që ndikojnë drejtëpërdrejtë në trafikun e qenieve njerëzore janë :

- Faktorët ekonomikë (ekonomi e shkatërruar, papunësi e madhe etj.)
- Faktorët socialë (martesat, divorcet, dhuna në familje, mungesa e perspektivës për të ardhmen, papunësi etj.)
- Faktorët politikë (mungesa e stabilitetit politik, trazirat civile, lidhja e politikës me krimin e organizuar etj.)
- Dhunë fizike
- Dhunë psikologjike
- Dhunë seksuale
- Dhunë ekonomike

Trafikantët synojnë, gjejnë dhe rekrutojnë duke bërë pre njerëzit me premtime, me qëllim realizimin e të ardhurave më të larta, për të përmirësuar situatat ekonomike. Ata mbështesin prindërit dhe familjet në fshatra apo dhe në qytete duke përfitur nga situata e tyre ekonomike.

⁴⁰) Roth V. Defining human trafficking and identifying the victims. 2011, fq 15-36

Nga ana tjetër shoqëritë përballen dhe me luftën dhe konfliktin, të cilat çojnë në lindjen dhe zhvillimin e situatave kriminale në përgjithësi dhe lidhen direkt me trafikimin në veçanti. Kategoritë më të prekura janë gratë dhe fëmijët, jo vetëm për shkak të tregut të punës por dhe për shkak të burimeve të tyre të kufizuara ekonomike.

Grupet e tjera të synuara kryesore përfshijnë:

njerëz nga familjet me të ardhura të ulëta,
minoritetet etnike,
refugjatët dhe emigrantët e paligjshëm,
njerëzit me nivel të ulët të arsimimit,
vajzat e reja të larguara nga shtëpia.

Shkaqet e trafikimit mundet të klasifikohen në faktorë të brendshëm dhe faktorë të jashtëm. Por, faktorët kryesore që ndikojnë janë gjendja ekonomike si dhe ekzistenca e personave në nevojë. Nuk mundet të lihet pa përmendur shkaqet familjare që lidhen, më së shumti, me dhunën në familje. Fëmijët apo gratë e dhunuara fizikisht psikologjikisht apo seksualisht brenda familjes, janë të destinuar të jenë viktima të mundshme të trafikimit. Dhuna në familje dhe sjellja në të, mbetet një problem i madh, pasi shndërrohet në një faktor tepër të madh, ku gjejnë burim subjektet kriminale për zgjerimin e viktimave të trafikimit.

Tipologjia më e zakonshme klasifikuese për personat që përdoren për qëllime trafikimi, ka të bëjë me femrat, qofshin ato të mitura apo të rritura. Për këtë arsye, në raport me moshën e viktimës së trafikimit klasifikohet dhe vepra penale në dy parashikime ligjore, nisur nga fakti nëse personi është i rritur apo i mitur. Veprat penale që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore paraqesin si veçori:

Kompetencën lëndore⁴¹ të ushtrimit të ndjekjes penale nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, çënojnë integritetin moral dhe fizik të personit, shoqërohen me cënim dhe kufizim të pjesshëm ose të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të individit, Duhet pohuar që në fillim se nuk është aspak i lehtë identifikimi i rasteve apo, më saktë, gjetja e provave të plota në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore.

Si persona të trafikuar mundet të jenë përfaqësues nga të gjitha klasat sociale, racat dhe profesionet. Megjithatë, si kontribut i praktikës, janë evidentuar disa tipologji personash të përfshirë më shpesh në trafikim si më poshtë:

Së pari, viktimat e trafikimit zakonisht janë femra, si në moshë të rritur ashtu dhe në moshë të mitur.

Së dyti, në më shumë se 1/3 e rasteve, këto kategori vijnë nga shtresa të varfra shoqërore, duke përcaktuar se një shkak dominant është niveli i ulët ekonomik.

Së treti, në pikëpamje numerike, meshkujt e shfrytëzuar dhe të trafikuar në vendin tonë, janë më pak në numër, pasi rastet e trafikimit të femrave dominojnë.

⁴¹) Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale të RSH-së.

Së katërti, shumica e rasteve rrjedhin nga familje në krizë ekonomike e morale, me prindër të divorcuar ose të braktisur.

Së pesti, një grup më vete përfaqësohet nga shtresa rome, të cilët kanë dhe problemin e qënies së tyre të paregjistruar, ku shkak kryesor për trafikimin bëhet dhe mënyra e tyre e jetesës.

Së gjashti, disa nga rastet përfaqësohen nga martesat e rreme.

Sa për subjektet kriminale të prirur drejt kësaj veprimtarie ata janë nga më të ndryshmit, ku moshat nga 25 deri në 40 vjeç janë më të prirur drejt veprimeve të tilla.

3.3 Dhuna në familje si faktor që ndikon në trafikim.

Dhuna në familje është sjellje abuzive mes njerëzve që jetojnë së bashku në një moment të caktuar, ose që kanë jetuar së bashku prej kohësh, të cilët mund të kenë ose jo fëmijë. Shkollimi dhe trajnimi tradicional i ka mësuar punonjësit të policisë se dhuna në familje është një çështje private e “brendshme”, se përgjithësisht është e pranueshme kur një person dominon apo ushtron kontroll nëpërmjet kërcënimeve, forcës dhe dhunës fizike, ndaj një ose disa personave më të dobët. Ky tashmë është mentalitet në kapërcim e sipër, megjithëse efektet afatgjatë të dhunës tek viktima mund të vazhdojnë, duke u transmetuar edhe tek brezat pasardhës.

Kështu për shembull një vajzë, dëshmitare e abuzimeve të babait ndaj nënës së vet, ka shumë mundësi të jetojë e varur nga dhuna dhe në jetën e saj, duke qënë se ky është shembulli më të cilin është rritur. Në këtë mënyrë ajo i bindet tutorit të saj, që e shfrytëzon apo e trafikon duke e detyruar nëpërmjet dhunës. Për të ilustruar më mirë sesi ndikon ambienti dhunë tek individët, po pasqyrojmë më poshtë tiparet që mbartin personat, të cilët për shkak të dhunimit të tyre, e kanë më të lehtë të shndërrohen në viktima trafikimi. Individët e dhunuar janë lehtësisht më të menaxhueshme, për pasojë, dhe mund të shfrytëzohen për këto arsye:

Së pari, vetëvlerësimi i ulët i shkaktuar nga abuzimet fizike dhe/apo ato seksuale, të ushtruar ndaj tyre më parë. Kjo bën që ata të mashtrohen më shpejt, sapo iu afrohet ndonjë person me anë të gënjeshtreve.

Së dyti, ndjenja e pasigurisë dhe paaftësisë për t’u besuar të tjerëve. Kjo i bën ata të krijojnë dhe të kërkojnë veçse një marrëdhënie tepër të ngushtë, nga e cila nuk mundet të shkëputen dot.

Së treti, ata nuk marrin përgjegjësitë për sjelljet që kryejnë, madje nuk pranojnë të kenë kryer aktin konkret, duke qënë se çdo veprim i kryer prej tyre, është konsumuar në kushtet e dhunës.

Së katërti, shfaqin nevojën për t’u kontrolluar nga të tjerët, duke qënë se kanë një shkallë shumë të ulët vetbesimi.

Rekrutimi dhe mënyra e realizimit të trafikimit, është një detyrë parësore që duhet

dokumentuar nga organet e specializuara të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme. Nga një vështrim “tangjent” i këtyre të dhënave të publikuara rezulton se mënyra kryesore e përdorur për trafikim është mashtrimi, kryesisht duke premtuar punë dhe martesë. Por, nuk përjashtohen as premtimi për shkollë, specializim apo vizitë turistike. Më i shpeshtë është mashtrimi i kombinuar me rrëmbimin e dhunshëm, apo pengmarrja, por dhe rekrutimi direkt, duke u bërë i ditur motivi, apo blerja nga të afërmit, deri tek rekrutimi me dëshirë apo kërkesën për të ushtruar profesionin e prostitutës. Me përjashtim të rastit kur ekziston vullneti i lirë i femrës, në të gjitha rastet e tjera, subjektet janë viktimat të trafikut për të ushtruar prostitucion.

Sidoqoftë, për çdo viktimë ka një rast (histori) të veçantë. *Për shembull, një e mitur nga Tirana, u shit tek trafikantët nga babai i saj, disa vajza nga Fieri u shitën nga “të fejuarit” e tyre, një nga Berati u detyrua nga bashkëshorti të prostitutojë, etj. Në gjithë këto raste, motivi ka qenë ai i fitimit. Por, çuditërisht kjo ka ndodhur edhe për shifra mjaft të vogla, madje qesharake. Vitet e fundit janë vërejtur dhe tentativat për të perfeksionuar rekrutimin, nëpërmjet krijimit të agjencive të ndryshme legale turistike, specializimit dhe fshehjes së trafikut nëpërmjet aktiviteteve legale të këtyre firmave.*

Statistikisht, rezultojnë nga burimet zyrtare mënyrate e trafikimit. Në vitin 2001, 17% e tyre janë mashtruar me premtime për punë, 21% me martesë të rreme, kryesisht në Itali, ndërsa 8% janë shitur nga familja për nevoja ekonomike. Rreth 40% e tyre u përkasin zonave rurale, ndërsa rreth 80% janë mbi moshën 20 vjeçare. Për shkak të problemeve sociale dhe ekonomike, të punës së vështirë në bujqësi, jetës së vakët kulturore, largimit të një mase të madhe të rinjsh në emigracion, mundësitë më të mëdha për mashtrim mes premtimeve të gënjeshtër, zonat rurale mbeten dhe aktualisht furnizueset kryesore të këtij trafik. Madje rekrutimi me dëshirë i përket pikërisht këtyre zonave, ku 40% janë minorene, pra që kanë marrë një vendim pa qenë aspak të vetëdijshme mbi pasojat në të ardhmen.

Përtej rekrutimit, faza pasuese e këtij procesi është përgatitja psikologjike dhe fizike për të ushtruar profesionin e prostitutës, lëvizja drejt destinacionit, mbërritja dhe fillimi i aktivitetit. Pavarësisht nga mënyra e rekrutimit, synohet kalimi në këto faza për të realizuar përgatitjen graduale të femrës për të ushtruar profesionin e ardhshëm. Si mjete ndihmuese për arritjen e këtij qëllimi janë përdorimi i drogës dhe vartësia prej saj, përfshirja në aktivitete seksuale të dhunshme e në grup, përfshirja në vepra të lehta penale, apo të pamoralshme, dhuna fizike, apo psikike, etj. Është ky një proces që trafikantët e quajnë degjenerim, për ta pasur më të lehtë përdorimin e viktimit të trafikuar si mjet shfrytëzimi dhe pasurimi për ta. Lëvizja për qëllim trafikimi parakupton marrjen e femrës nga vendbanimi dhe përgatitja e kushteve për të realizuar mbërritjen në destinacion. Këtu hyjnë angazhimet për të siguruar dokumentet më të domosdoshme, si vizat, lejet e qëndrimit dhe vend-qëndrimet, duke i siguruar dhe mbajtur ato nën kontroll, nëpër baza të sigurta. Me mbërritjen në destinacion sigurohet vend-qëndrimi, “vendi i punës” dhe detyrimi për të ushtruar profesionin.

Gjithë veprimet e përmendura janë direkt, prandaj edhe që “lenë gjurmë” ose prova në mjedisin ku kryhet. Kjo mundëson parandalimin apo zbulimin nga ana e organeve kompetente dhe vënien e tyre para drejtësisë. Duke njohur format dhe metodat e përdorura nga trafikantët gjatë këtij procesi, shoqëria dhe sidomos vetë femrat, por edhe të afërmit apo kujdestarët e tyre, i

kanë të gjitha mundësitë e kontrollit dhe vetëkontrollit, për mos lejuar viktimizimin përmes këtij lloj trafikimit. Megjithatë, kultura e nevojshme në këtë drejtim ende është e mangët, prandaj në kurthet e trafikimit vazhdojnë të bien viktimat e rastit.

Sa i përket tipareve social - gjeografike, përgjithësisht, mund të themi sa ato janë me arsim fillor ose tetëvjeçar, por jo se mungojnë edhe ato me arsim të mesëm e të lartë. Niveli kulturor i tyre, pavarësisht nga arsimi, është i ulët dhe shumica kanë jetuar në mjedise familjare me probleme sociale, si p.sh., në familje të paqëndrueshme, me mungesë të njërit prind, me probleme ekonomike të rënda, me dhunë fizike apo seksuale etj. Pra përgjithësisht, rezulton që familjet e tyre nuk kanë qenë në gjendje të realizojnë funksionet e tyre themelore. Ndaj çdo ditë e më tepër trafikimi i ditëve të sotme mbetet një element mjaft shqetësues.⁴²

Mosha mesatare e femrave të trafikuar⁴³rezulton 21 vjeç, gati 95% e tyre kanë qenë të pamartuara më parë, ndërsa jetën seksuale e kanë filluar herët. Ka pasur edhe ndonjë rast kur janë braktisur familje të rregullta për të ushtruar këtë profesion. Tirana është në krye të listës së të trafikuarave, pastaj renditet Fieri, Vlora, Elbasani, Durrësi etj, por nuk mungojnë as rrethet e vogla si Gramshi, Kukësi, Dibra, Pogradeci e Përmeti. Fluksi i të trafikuarave ka pasur një ecuri konstante gjatë gjithë viteve, me një mesatare të përafërt prej 30 në vit. Madje, pas kthimit të tyre masiv nga policia italiane, e disi më pak nga ajo greke, në vend që ky numër të pësonte ulje, u rigjallërua, gjë që tregon se mjaft nga të rikthyerat u ricikluan nga rekrutuesit apo tutorët e tyre. Në sistemin e tregtisë së seksit përfshihen personat që “gjurmojnë” kandidatët e përshtatshëm e që do planifikohen për rekrutim. Pastaj, janë dhe personat që ndihmojnë direkt apo indirekt në këtë qëllim, ku hyjnë rekrutuesit, bashkëpunëtorët ndihmës, si transportues, shoqërues, strehues, rojet, kujdestarët, tutorët etj, mbi të cilët qëndron “kapua/kreu” apo “kupola”, që përgjithësisht është një person i padukshëm. Nëse ekzistojnë elementet e mësipërm, në të gjitha rastet kemi të bëjmë me bashkëpunim të cilësuar kriminal, pa folur pastaj për nivelin më të lartë të organizimit kriminal. Si rregull, rrjetet e trafikut të “mishit të bardhë” përbëhen nga elemente me prije kriminale, që krahas prostitucionit, kanë kryer edhe vepra të tjera kriminale, si trafikim droge, vrasje, pengmarrje, grabitje etj. Shtrirja gjeografike e elementëve të tillë është e pranishme në gjitha rrethet e vendit. Mosha mesatare e tyre varion nga 20-25 vjeç, me formim arsimor e kulturor të kufizuar ose të mangët, që shquhen për agresivitet dhe ashpërsi mendimi e veprimi. Qoftë dhe për sa më sipër, janë të gjitha shanset që këta të jenë evidentuar dhe kontrolluar nga policia, pavarësisht inefiçencës aktuale të sistemit të drejtësisë në luftën ndaj tyre.

Aktualisht, legjislacioni ynë përmban nene të veçanta mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe sanksione të rënda për autorët e veprave të tilla penale. Por para vitit 2000 nuk ka pasur ndonjë nen të veçantë ku të përmendej termi “trafik”.

⁴²Roth V., Defining human trafficking and identifying the victims. 2011, fq 6-22

⁴³ Strategjia kombetare luftes kunder trafikimit te qenieve njerezore, 2012,

Në janar 2001, duke u parë si problem i mprehtë dhe duke u ballafaquar me përvojën e vendeve të zhvilluara, u vendos të bëhen ndryshime në legjislacion. Kështu, më 24 janar 2001, në Ligjin nr. 8733 u bënë një seri ndryshimesh legjislative, u ndryshua neni 110, pika a e Kodit Penal për “Trafikimin e njerëzve”, “Shfrytëzimi i prostitucionit”, tek neni 114 dhe 114 a, ”Trafikimi i femrave për prostitucion”, neni 114/b, ”Trafikimi i fëmijëve” është tek neni 128/b, dhe në fund “Mbajtja e lokaleve për prostitucion” në nenin 115/b.

Termi “Trafikim i femrave për qëllime prostituimi”, konsiderohet vepër e rëndë penale, me dënim maksimal 15 vjet deri në burgim të përjetshëm. Si term, “trafikimi” është një përkufizim ndërkombëtar detyruës ligjor, i adaptuar në dhjetor 2000 edhe nga legjislacioni ynë. Neni 3 i ligjit përkatës shprehet prerazi dhe pa asnjë ekuivok, pra që nuk lejon asnjë shteg për keqinterpretime se: “Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi dhe pritja e personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës dhe formave të tjera të rrëmbimit, mashtrimit, gënjeshtërisë, abuzimit me pushtetin, pozitën, ose duke dhënë apo marrë pagesë e përfitime për të arritur marrëveshjen e një personi, duke pasur kontroll mbi personin për qëllime shfrytëzimi”.

Ndërsa termi “shfrytëzim” përfshin shfrytëzimin e të tjerëve për qëllime prostitucioni dhe forma të tjera shfrytëzimi seksuale, si shërbime për punë të detyruar, skllavërim ose praktika të ngjashme me të, zëvendësimin ose heqjen e organeve etj. Edhe ky përkufizim është bërë në legjislacionin tonë, madje pranë MB janë ngritur njësi të specializuara policore, si ajo e antitrafikimit, Policia Kufitare, ajo e antikrimin të Organizuar etj, ka edhe zyra rajonale apo organizma ndërkombëtare që bashkëveprojnë për koordinim dhe shkëmbimin e informacionit në luftë ndaj trafikut.

3.4 Teknikat e trafikimit

Kontaktet lokale - Trafikantët marrin ndihmën e personave lokalë dhe fshatarëve për të bërë identifikimin e familjeve në nevojë. Në këtë mënyrë trafikantët bëjnë një studim të mirë dhe të plotë të zonës. Shitje direkte - Gratë dhe fëmijët janë shitur për trafikantët nga prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes apo nga bashkëjetuesi apo bashkëshorti. Mashtrimi – mbetet forma më e përhapur për rekrutimin e njerëzve, agentët mashtrojnë prindërit dhe veprojnë duke joshur gratë dhe vajzat e reja me premtime të rreme për punë të mirë apo pagesa të larta apo dhe premtime për martesë të mira me burra të pasur. Shlyerje detyrimesh - Trafikantët ofrojnë stimuj ekonomikë dhe kredi financiare për prindërit të cilët si rezultat i mospagesës detyrohen ti lidhin fëmijët e tyre në seks-skllavërinë ose forma tjera shfrytëzuese të punës.

Mjedisi i punës = kushte të mjerueshme

Kushtet e punës dhe trajtimit, shpesh përfshijnë praktika të ngjashme me skllavërinë dhe mjediset e burgut dhe, për realizimin e qëllimeve shoqërohen dhe me:

Abuzim fizik dhe seksual që është thuajse e zakonshme.

Mosofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve mjekësore.

Puna me orë të gjata, me pak ose aspak pushim.

Trafikimi i qenieve njerëzore, shitja, transporti dhe fitimi nga qeniet njerëzore që janë të detyruar të punojnë për të tjerët, është ekuivalenca moderne e skllavërisë. Kundër vullnetit të tyre, miliona njerëz në mbarë botën janë të detyruar të punojnë për fitimin e të tjerëve, për shembull duke lypur, prostitucioni, robëria e pavullnetshme, duke punuar në dyqane ëmbëlsirash - madje duke bërë ushtarë fëmijët.

Trafikimi njerëzor është industria e tretë më e madhe në botë, pas armëve dhe lëndëve narkotike. Megjithatë, është aktiviteti kriminal në rritje më të shpejtë: rreth 27 milionë njerëz në mbarë botën janë parashikuar të jenë viktimat e skllavërisë, me rreth 50% e këtyre viktimave që në nën moshën 18 vjeçare.

Si ndodh procesi i trafikimit ?

Personat e trafikuar shpesh janë të skllavëruar apo në situata të skllavërisë për arsye të ndryshme për të cilat folëm dhe më sipër.

Trafikimi mund të ndodhë në këtë mënyrë: "Kjo është një praktikë e zakonshme për të bindur një grua të re për të lënë shtëpinë dhe për të kaluar në një vend fqinj të pasur, ku ajo mund të punojnë në shërbim të asaj familje ku shkon, për tu kujdesur për fëmijë ose për të rritur, për të punuar si kameriere në një restorant apo një bar, apo ndoshta dhe si një balerinë. Pas mbërritjes në vendin e premtuar, atyre iu mbahen aktet identifikuese duke mos iu dhënë mundësinë për të lëvizur dhe në një farë mënyre duke i detyruar të qëndrojnë aty.

Në mënyrë efektive, ajo është e burgosur, ose fizikisht ose financiarisht apo dhe mendërisht. Ajo është bërë për të punuar si një skllave në familje ose si një punëtorë bujqësore apo në fabrikë, në kushte të ngjashme me skllavërinë, ose në një bordello.

Skllavëria është një fenomen global, që ndodh brenda dhe përtej kufijve. Departamenti Amerikan i Shtetit vlerëson se 600,000 deri 820,000 burra, gra, dhe fëmijë (janë) trafikuar përtej kufijve ndërkombëtarë çdo vit. Me miliona të tjerë kurrë nuk kalojnë një kufi ndërkombëtar. Gati 80 për qind e personave të trafikuar janë gra dhe vajza dhe deri në 50 për qind janë fëmijë (dikush nën 18 vjeç). Është vlerësuar se më shumë se 17.000 njerëzve të trafikohen në Shtetet e Bashkuara çdo vit⁴⁴; një shtesë prej 200.000 fëmijë amerikanë konsiderohen "në rrezik" për trafikimin e industrisë së seksit. Në vitin 2004, policia kanadeze (RCMP) vlerësoi se 600-800 persona janë trafikuar çdo vit në Kanada dhe se shtesë 1,500-2,200 persona trafikohen nëpër Kanada dhe në Shtetet e Bashkuara.

Rusia është një burim i madh i grave të trafikuar globalisht për qëllime të shfrytëzimit seksual. Rusia është gjithashtu një destinacion i rëndësishëm dhe vend tranzit për personat e trafikuar për shfrytëzim seksual dhe të punës nga vendet e rajonit dhe fqinje në Rusi, dhe për në shtetet e Gjirit, Evropa, Azia, dhe Amerika e Veriut.

Që të ekzistojë trafikimi duhet të pranojmë që ka një kërkesë ndaj dhe vjen dhe oferta. Varfëria dhe Pabarazitë globale në sundimin e ligjit janë kushtet në të cilat trafikimi i qenieve njerëzore,

⁴⁴ Roth V., Defining human trafficking and identifying the victims. USA 2011, fq 56-122

gjen kushtet për lulëzim. Në rajonet më të varfëra të botës, ku mundësitë e arsimit dhe të punësimit janë të kufizuara, gjenden viktimat e trafikimit.

Njerëzit të cilët janë duke kërkuar mundësi për mbijetesë dhe tentojnë hyrjen në vende të tjera mund të merren nga trafikantët duke u mashtruar.

Trafikimi i fëmijëve shpesh përfshin shfrytëzimin e varfërisë së skajshme të prindërve. Këta të fundit mund t'u shesin fëmijët trafikantëve për të paguar borxhet ose për të fituar të ardhura, por mund të ndodhë që ata mund të jenë të mashtruar në lidhje me perspektivat e ardhme për një jetë më të mirë për fëmijët e tyre. Në Afrikën Perëndimore, fëmijët e trafikuar shpesh kanë humbur njërin ose të dy prindërit dhe janë të vetëm.

Pikërisht në vendet e botës së tretë ku ka nivel të ulët jetese dhe varfërie të madhe konstatohet:

- Papunësi
- Lëvizje pa kriter
- Mangësi në shërbimet e tjera në ndihmë të popullit.

-Një nga kategoritë kryesore që bien pre e këtij fenomeni janë personat që largohen nga vendet e origjinës, siç janë vendet aziatike dhe afrikane. Këtu përmendim edhe Shqipërinë, ku pas vitit 90, kemi një lëvizje masive të popullsisë si brenda dhe jashtë vendit, sepse kushtet e jetesës së tyre ishin dhe vazhdojnë të jenë të vështira. Faktori ekonomik së bashku me levizjen demografike të pakontrolluar, të shkaktuar nga liberalizimi ekonomik, kanë bërë që të rritet shumë oferta për potencial skllëvërisht, duke sjellë në mënyrë paralele dhe ulje të çmimit të punës së këtyre të fundit. Në realitetet e këtyre vendeve, por edhe në vendet e lindjes eurpiane, pas rrëzimeve të regjimeve totalitare, u vendos një nivel i ri ekonomik, i cili solli paralelisht edhe shkatërrimin e ekonomisë së centralizuar.

Për shkak të vështirësisë që pati adoptimi i ekonomisë së lirë, erdhi një varfërim i mëtejshëm i popullatës. Njëkohësisht, filloi të krijohet një hendek i madh midis klasave të shoqërisë, për arsyen e thjeshtë se pasuria filloj të përqendrohet në duart e një shtrese të caktuar, duke mos realizuar një shpërndarje të drejte të saj midis të gjithë individëve. Gjatë periudhës së tranzicionit, pati një lëvizje të popullatës nga zonat malore drejt rrethinave të qyteteve të mëdha, por dhe jashtë kufijve. Kjo ishte një nga arsyet kryesore të lindjes dhe zhvillimit të shumë dukurive negative siç është dhe trafikimi. Te lëvizja pa kriter, do të përfshijmë edhe ata persona të cilët nuk janë të stabilizuar në një vend të caktuar, pra që ndryshojnë në mënyrë të shpejtë vendbanimet e tyre. Pikërisht, këta individë apo grupime përbëjnë një element krimi, për shkak se shumë prej tyre merren me aktivitete të dyshimta, me trafikë të ndryshme. Por, nënvizojmë se nuk mund të përjashtohen edhe përpjekjet e tyre për punë të ndershme.

-Kategoria e dytë, janë femrat dhe fëmijët si kategoria më e pambrojtur dhe më fitimprurëse për organizatat kriminale. Këto të fundit i tërheqin ata me premtime për një jetë më të mirë ose duke i rrëmbyer me qëllim shfrytëzimin për prostitucion, transplant të organeve dhe për kryerjen e punës së zezë siç është rasti i të lypurit për të cilin shfrytëzohen kryesisht fëmijët.

-Kategoria e tretë, janë ata persona të cilët largohen nga vendet e origjinës për shkak të persekutimit, dhunës apo luftërave qofshin këto të brendshme ose jo si dhe konflikteve midis dy shteteve.

Dihet se luftërat sjellin një destabilitet ekonomik duke sjellë si rrjedhojë rritjen e papunësisë dhe kjo e fundit sjell edhe rritjen e varfërisë. Në rastet e luftërave të brendshme me

karakter etnik apo fetar, konfliktet sjellin automatikisht diskriminimin e një pjese të popullsisë. Këtyre faktorëve u shtojmë katastrofat natyrore, ngrohjen globale, rezultatet e sistemit ekonomik industrial. Janë këta disa prej faktorëve të cilët i shtyjnë njerëzit nga njera anë të migrojnë dhe nga ana tjetër sjellin për organizatat kriminale burime të mëdha për mbledhjen e “skllevërve”. Përveç faktorëve të brendshëm të cilët diktohen nga vendet e origjinës, kemi edhe faktorë të jashtëm të cilët diktohen nga vendet ku shkohet. Në vendin ku këta persona emigrojnë mund të gjejnë asistencë sociale globale, sisteme qeverisje demokratike, stabilitet politik e social.

Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri është ndikuar pak a shumë nga të njëjtët faktorë dhe mund të themi se vazhdon të ndikohet ende duke qenë se jemi në kushtet e krizës ekonomike botërore. Ky lloj “biznesi”, nëse do të mund ta quanim kështu, ka qenë shumë i parapëlqyer dhe fitimprurës për organizatat kriminale shqiptare. Viktimat e këtij trafiku kanë qenë dhe janë femrat, fëmijët, shtetas të tjerë shqiptarë dhe të huaj. Trafikimi është kryer duke përdorur rrugë të ndryshme legale dhe ilegale. Më i përhapur ka qenë ai nëpërmjet skafeve, ç’ka ka sjellë një numër të madh viktimash në det, për shkak të motit të keq, të mbingarkesës së skafeve ose të përplasjes së tyre me rojat bregdetare italiane. Për realizimin e trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime të ndryshme janë përdorur të gjitha rrugët e mundshme, si rrugët detare, ajrore dhe tokësore. Duke qenë se trafikimi dhe prostitucioni janë të lidhura ngushtë me njëri tjetrin edhe ky i fundit ndikohet nga të njëjtët faktorë duke shtuar në këtë rang faktorësh dhe mënyrën e çrregullt të të jetuarit, mungesën e arsimimit dhe edukimin e mangët, ekzistencën e shturjes së përgjithshme të shoqërisë, prirjes drejt liberalizimit të të gjitha strukturave të shoqërisë, shtetit, familjes dhe ndikimit të menaxherëve të prostitucionit ndërkombëtar.

KREU IV

GJENDJA AKTUALE E TRAFIKIMIT TE QENIEVE NJEREZORE

4.1 Trafikimi i qenieve njerëzore si figurë e veprës penale

Figura e veprës penale të trafikimit të personave paraqet një rrezikshmëri të lartë shoqërore. Për të përcaktuar rrezikshmërinë e saj shoqërore, i referohemi marrëdhënieve juridike të caktuara që ajo çënon dhe që gëzojnë mbrojtje të posaçme, si dhe sanksionin përkatës të parashikuar në ligj në lidhje me një vepër të tillë.

Rrezikshmëria e madhe e kësaj vepre penale në raport me marrëdhëniet juridike që ajo çënon duket në subjektet që kjo vepër prek, dhe konkretisht nëpërmjet saj çënohet integriteti dhe dinjiteti njerëzor. Nga ana tjetër ligjvënësi ka parashikuar marzhe shumë të larta dënimi në lidhje me këtë vepër penale të cilat fillojnë nga shtatë vjet burgim, për të vazhduar më tej me pesëmbëdhjetë vjet burgim dhe deri me burgim të përjetshëm.

Për shkaqet e mësipërme të cilat lidhen drejtëpërsëdrejti me individin, qenien e tij, dinjitetin e tij dhe integritetin fizik dhe moral të tij, fenomeni i trafikimit zgjon interesin e madh jo vetëm të studiuesve profesionistë por të mbarë komunitetit.

Vepra penale e trafikimit e cila në ligjin penal aktual është e ndarë në trafikim të personave të rritur dhe trafikim të personave të mitur, ka një sërë karakteristikash të cilat po i trajtojmë sa më poshtë:

Është vepër me rrezikshmëri të lartë shoqërore,

Është vepër e përhapur në mbare botën. Ka gjetur përhapje në shoqërinë shqiptare pas ndryshimeve të ndodhura në vitet 1990-të, Reagimi i parë ligjor i yni në lidhje me këtë vepër penale e ka zanafillën në vitin 2001.⁴⁵

Përsa i përket rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale, mbajmë parasysh disa elementë të cilat kanë të bëjnë me individin e çënuar nga vepra penale, pasojën e ardhur prej saj, mënyrën e përdorur për kryerjen e veprës penale. Kur flasim për individin e dëmtuar kemi parasysh nxjerrjen në pah të kategorisë së personave që janë viktimë trafikimi dhe me zanafillën e tyre si individë si rezultat i veprimtarisë kriminale. Në të shumtën e rasteve viktimat e trafikimit kanë një shndërrim të rrezikshëm në qenien e tyre njerëzore si rezultat i qenies së tyre viktimë trafikimi. Shndërrimi i tyre është si pasojë e dhunës psiko emocionale, fizike dhe seksuale që u është shkaktuar. Fenomene të tilla lënë gjurmë të pashlyeshme tek këta individë, çfarë i kthen ata në persona vulnerabël përgjatë gjithë kohërave. Më e rrezikshme paraqitet situata në rastet në të cilat vepra penale ka sjellë pasoja tek viktimat e trafikimit. Janë ato pasoja

⁴⁵ Kodi Penal i RSH-se,.

si dëmtime deri dhe vdekje të cilat janë parashikuar si rrethana cilësuese në legjislacionin tonë penal. Nga ana tjetër nuk mundet të lemë pa përmendur dhe mënyrën sesi është kryer vepra penale, duke qenë se veprimet kriminale mundet të kryhen në mënyra të ndryshme të cilat ndikojnë në përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore.

Siç është trajtuar dhe më sipër, kjo vepër penale ka përhapje të gjerë në gjithë botën dhe është lidhur ngushtë kjo përhapje me dy faktorë. Këta dy faktorë lidhen me ekzistencën e një tregu të mirëfilltë që ofron ‘punë’ dhe kërkon ‘punë’, si dhe realizimin e përfitimeve të mëdha si rezultat i kësaj veprimtarie. Shoqëria njerëzore njih sot vendet në zhvillim të cilat ofrojnë ‘lëndën e parë’, dhe vendet e zhvilluara të cilat ofrojnë tregun e gatshëm. Këto dy kombinime ndikojnë në zhvillimin e veprimtarisë kriminale, por ajo që është më e rëndësishmja është fakti se kjo veprimtari realizon përfitime të mëdha, për të cilat ka një impenjim të jashtëzakonshëm nga personat që kryejnë këto vepra penale. Pavarësisht se kjo vepër penale ka njohur praninë e saj në vendin tonë me ndryshimet e ndodhura pas vitit 90, parashikimi i parë ligjor për këtë vepër penale është kryer me ndryshimet e ndodhura në Kodin Penal në vitin 2001 me ligjin Nr 8733, datë 24.01.2001.

Mbetet për tu zgjidhur fakti se cilat janë arsyet dhe faktorët të cilët bënë të mundur që kjo vepër penale mos të gjente parashikimin ligjor si e tillë në Kodin Penal të RSh-së që nga momenti i ndryshimeve në ligjin tonë penal, (ku mund të përmenden ato të vitit 1995). Megjithatë në një analizë të hollësishme mund të konkludojmë që një ndër faktorët mundet të ketë qënë dhe mosnjohja e fenomenit në tërësi dhe veprës penale në vecanti. Në këtë mënyrë, edhe në momentin e parashikimit në ligjin tonë penal të kësaj vepre penale, institucionet tona të drejtësisë u përballën me konfondime të cilat vinin si rezultat, i mungesës së praktikës dhe njohjes teorike të situatës. Me fillimin e hapjes së kufijve, por dhe me përballjen e shtetit shqiptar me disa ndryshime të karakterit ekonomik, politik dhe gjeografik, fenomeni i trafikimit njohur një lulëzim të menjëhershëm dhe erdhi duke u përhapur në masë. Ndoshta në këtë arritje ndikoi dhe mosreagimi ligjor në kohën e duhur, ku u deshën gati 10 (dhjetë) vjet për të reaguar, (sepse vetëm pas 10 (dhjetë) viteve u krye parashikimi ligjor për këtë figurë vepre penale). Ky afat, dhjetë vjeçar, u përdor nga trafikantët në mënyrën më të mirë të mundshme duke mos kursyer si viktima të trafikimit persona të ndryshëm dhe duke përdorur për efekt të realizimit të qëllimit të tyre të mënyrave nga më të ndryshmet.

Edhe pas parashikimit në ligjin penal si vepër penale të trafikimit problemet e hasura ishin nga më të shumtat për disa arsye, të cilat lidhen me moskuptimin e mirë të ligjit nga ana e profesinostëve, ekzistenca e disa figurave të veprave penale të ngjashme në përmbajtjen e tyre, si dhe në lidhje me faktin se në momentin e parë sipas Kodit Penal të vitit 2001 trafikimi si dispozitë u parashikua si dispozitë blanket, element ky prania e të cilit vështirësoi zbatimin e saj. Formulimi i kësaj dispozite nga ana e ligjvënësit, me anë të një dispozite blanket, ku nuk jepej në vetë dispozitën, përmbajtja e veprës penale, e vështirësoi edhe më tej punën për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të kësaj vepre penale. Nisur nga fakti që kjo vepër penale ishte një vepër penale e re, a pa hasur më parë në praktikën gjyqësore shqiptare, ishte e domosdoshme që, nga ana e ligjvënësit kjo vepër penale të parashikohej me një dispozitë përshkruese, ku të jepej në mënyrë të qartë, përmbajtja dhe elementet e kësaj vepre penale.

Duhet të arrinin në vitin 2004, që të kishim një parashikim të tillë ligjor, ku me ndryshimet e reja të ndodhura në Kodin Penal u sanksionua:

“Trafikimi i personave” është rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies së përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga pese deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë”.

Parashikimi i mësipërm në vitin 2004 përfaqëson një arritje për ligjin tonë penal nga njëra anë por dhe një përpjekje objektive në kuptimin dhe identifikimin e plotë të fenomenit. Për herë të parë u përcaktua në mënyrë të qartë vepra penale konkrete, dhe përmbajtja e dispozitës është e plotë. Fillimisht sipas ndryshimeve të vitit 2004, trafikimi përmblihej në tre dispozita ku ndarja e tyre në nenet 110/a, 114/b dhe 128/b të Kodit Penal, ishte në varësi të karakteristikave të moshës dhe të gjinisë së personit – viktimë trafikimi. Në këtë mënyrë kur ligji parashikonte Trafikimin e Personave (neni 110/a i Kodit Penal) bëhet fjalë për të gjithë personat e rritur të cilët ishin objekt trafikimi. Neni 114/b i Kodit Penal parashikon trafikimin e femrave. Kjo ndarje bëhet në varësi të faktit, nëse i dëmtuari është fëmijë, në këtë rast zbatohet neni 128/b i Kodit Penal, nëse është femër mbi 18 vjeç, në këtë rast zbatohet neni 114/b i Kodit Penal dhe nëse është mashkull mbi 18 vjeç dhe në këtë rast zbatohet neni 110/a i Kodit Penal.

Nga ana tjetër, duhet të mbajmë parasysh faktin se, pavarësisht, këto tre vepra penale janë vepra penale të ndryshme dhe zbatohen në varësi të rrethanave konkrete, që kanë të bëjnë me të dëmtuarin, të shpjeguara më lart, këto tre vepra penale në thelb, janë të njëjta dhe kanë të njëjtën natyrë. Një gjë e tillë rezulton, jo vetëm nga përmbajtja e tyre, ku, po të shikojmë formulimet e secilës prej tyre, me ndonjë përjashtim të vogël, tek masat e dënimit, ato janë pothuajse identike, aq sa është e vështirë të gjesh dallime ndërmjet tyre, por, edhe nga qëllimi i njëjtë që kanë këto vepra penale, i cili ka të bëjë me parandalimin dhe ndëshkimin e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore. Me ndryshimet e ndodhura me ligjin nr 144/2013 neni 114/b i Kodit Penal u shfuqizua duke mbetur vetëm dy dispozita ligjore në lidhje me trafikimin, që u emërtuan Trafikimi i personave të rritur dhe Trafikimi i të miturve, respektivisht parashikuar nga nenet 110/a të Kodit Penal dhe 128/b të Kodit Penal.

Përcaktimi i konceptit të trafikimit të personave, nga ana e ligjvënësit shqiptar, i bërë në Kodin Penal në fuqi, është në përputhje me kuptimin që i jep këtij koncepti, “Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar” dhe dy Protokollat Shtesë të saj, të cilët janë bërë pjesë të brendshme të legjislacionit shqiptar, me anë të ligjit nr. 8920, datë 11.7.2002.

Për të marrë në analizë këtë figurë veprë penale do marrin në analizë dhe do të përcaktojmë fillimisht elementët e figurës së veprës penale.⁴⁶

Le të analizojmë sa më poshtë kuptimin e veprës penale të kryer:

- Veprimi i njeriut,
- Rrezikshmëria shoqërore
- Kundërligjshmëria,
- Përcaktueshmëria e veprës penale në ligj,
- Përgjegjësia penale e autorit.

Elementet themelore të një veprë penale mund të ndahen në:⁴⁷

Elemente objektive dhe Subjektive

Elementet objektive mund të ndahen në elemente: Formale dhe Materiale.

-Në grupin e elementeve objektive bëjnë pjesë: veprimi i njeriut, rrezikueshmëria shoqërore, kundërligjshmëria.

Veprat penale janë të drejtuara kundër të mirave apo vlerave të cilat janë të mbrojtura me sistemin juridik.

Të mirat juridike që janë të mbrojtura në të drejtën penale janë edhe objekt i veprës penale.

Objekt i veprës penale është e mira juridike kundër së cilës është e drejtuar vepra penale.

Në të drejtën penale njihen dy lloje të objektit të veprës penale:

1. Objekti i përgjithshëm
2. Objekt grupor

1. Objekti i përgjithshëm- është njeriu dhe bashkësia shoqërore. Objekt i përgjithshëm është tërësia e të gjitha të mirave materiale që janë të mbrojtura me të drejtën penale.

2. Objekti grupor- është jeta dhe trupi i njeriut- rregullimi shoqëror-juridik, siguria e vendit. Me objekt të veprimit nënkuptojmë personin apo vlerën tjetër juridike ndaj të cilit është ndërmarrë veprimi i kryerjes me ç'rast dëmtohet objekti që mbrohet nga e drejta penale.

Njeriu si subjekt i veprës penale është personi që kryen veprën penale.

Ana objektive⁴⁸ është pjesë përbërëse e veprës penale. Ajo paraqet tiparet dhe elementët e jashtëm kryesorë që karakterizojnë të gjitha veprat penale.

Mungesa e këtyre tipareve të jashtme shkakton mungesën e veprës penale ose të figurës së saj përkatëse. Çdo figurë e veprës penale ka karakteristikat e jashtme, që e dallojnë nga figurat e tjera.

⁴⁶Në disa botime juridike penale franceze pranohen se tre janë elemente të domosdoshme të figurës së veprës penale (objekti, ana objektive dhe ana subjektive) shih për shembull profesorin e shquar francez të së drejtës penale Philippe Conte

⁴⁷Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional
Protokolli i Palermos, 2000

⁴⁸Kaçupi S., E drejta Penale, pjesa e përgjithshme.

Ana objektive e veprës penale, në vija të përgjithshme, përcaktohet nga ana subjektive e saj, sepse veprimet ose mosveprimet janë shprehje e vullnetit të njeriut.

Ato ndikojnë reciprokisht tek njëra-tjetra, por në fund të fundit, është njeriu ai që zgjedh vendin, kohën, mënyrën dhe mjetet e kryerjes së veprës penale.

Elementët e anës subjektive marrin vlera në të drejtën penale vetëm kur materializohen, kur shfaqen nëpërmjet elementëve të anës objektive të figurës së veprës penale.

Rëndësia e anës objektive dhe e tipareve të saj përveç mungesës se veprës penale ose të figurës së saj qëndron edhe për:

Shmangjen e gabimeve në caktimin e kufijve të përgjegjësisë penale,

Zgjerimin ose kufizimin e padrejtë të saj,

Për dallimin e një figure nga figura tjetër, për cilësimin ligjor

Për vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të autorit të saj.

Ana objektive formohet nga bashkimi në një të tërë i hallkave përbërëse të veprimtarisë kriminale, e cila zhvillohet në kohë dhe në hapësirë.

Elementët përbërës kryesor të anës objektive të domosdoshëm për çdo figurë vepre penale konkrete, janë :

- Veprimi ose mosveprimi kriminal,
- Lidhja shkakësore,
- Pasoja,
- Mënyra,
- Koha,
- Vendi dhe ambienti i kryerjes së veprës penale.

4.2 Veprimi ose mosveprimi kriminal⁴⁹

Veprimi ose mos veprimi është element kryesor i domosdoshëm i çdo vepre penale. Vepra penale kryhet vetëm atëherë kur personi bën veprime të caktuara ose kur nuk vepron, megjithëse ishte i detyruar të vepronte.⁸⁰ Vepër penale pa veprim ose mosveprim nuk ka (nullum crimen sine actione). Me veprim, në kuptimin juridiko-penal, kuptohet ajo sjellje e një njeriu të caktuar që shfaqet në botën e jashtme, që përbën element të domosdoshëm të veprës penale të parashikuar në ligjin penal. Por,⁸¹ mendimet, ndjenjat, dëshirat, kur nuk manifestohen në botën e jashtme, nuk përbëjnë veprime në kuptimin e së drejtës

⁴⁹ Parandale J., Kriminologji-penallogji, viti 2002, fq 12-25

⁸⁰ Elezi I., "E drejta penale", Pjesa e posaçme, Tiranë 2000, f.86

⁸¹ Saliu I., "E drejta penale", *Pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2010, f.211.

Gjithashtu, V. Kambovski, nënvizon në veprën e tij "E drejta penale" (Pjesa e përgjithshme), Shkup 2010, f.152, të njëjtin përfundim se veprimi ose mosveprimi duhet të shkaktojë transformime në botën e jashtme, të japë rezultat fizik".

penale, pra nuk përbëjnë veprim si element të anës objektive të figurës së veprës penale.

Veprimi ose mosveprimi bëhet element i anës objektive të veprës penale në qoftë se shpreh vullnetin e lirë të personit.

Veprimi ose mosveprimi është mënyrë sjelljeje e një personi të caktuar, është shfaqja në botën e jashtme e mendimeve, ndjenjave, emocioneve, motiveve që e shtyjnë personin për ta kryer atë dhe e qëllimeve që kërkon të arrijë.

Lidhja midis veprimit dhe vullnetit e vetëdijes ekziston edhe në veprat e kryera me pakujdesi në formën e vetëbesimit të tepruar apo të neglizhencës.

Në këto raste personi ka qenë i detyruar dhe ka pasur mundësi reale të shprehë vullnetin e tij, por nuk e ka përdorur dhe është shkaktuar pasoja kriminale. Kur veprimi është i pavullnetshëm dhe pa vetëdije, nuk është element i veprës penale jo çdo veprimi i kryer me vullnet e me vetëdije është doemos element i veprës penale.

Tipar i veprimit në kuptimin penalo-juridik është që ai të jetë i kundërligjshëm dhe objektivisht shoqërisht i rrezikshëm.

Kundërligjshmëria e veprimit si shprehje juridike e rrezikshmërisë shoqërore qëndron në faktin që ai t'i përgjigjet përcaktimit të një figure penale konkrete, të jetë element përbërës i domosdoshëm i saj, i parashikuar në Kodin Penal.

Veprimi ose mosveprimi bëhet element i anës objektive të veprës penale në qoftë se shpreh vullnetin e lirë të personit.

Nuk janë element i veprës penale dhe as pjesë e anës objektive të saj veprimet e bëra nga :

- Të miturit nën moshën ligjore për përgjegjësi penale,
- Nga personat e papërgjegjshëm mendërisht,
- Të kryera në kushtet e mbrojtjes së nevojshme,
- Të nevojës ekstreme
- Në rrethana të tjera që përjashtojnë përgjegjësinë penale.

Ndryshimi midis veprimit dhe mosveprimit qëndron në formën e shfaqjes së vullnetit, jo në përmbajtje.

Në përmbajtje edhe veprimi, edhe mosveprimi janë sjellje antishoqërore dhe pjesë e anës objektive të figurës së veprës penale.

Kuptimi i mosveprimit (omission)

Mosveprimi është element i anës objektive të veprës penale vetëm atëherë kur personi nuk ka vepruar, ndërsa me ligj ose për shkak të profesionit a të detyrës ishte i detyruar të vepronte.

Me mosveprim në kuptimin penalo-juridik kuptohet moskryerja e atyre veprimeve, apo qëndrimi pasiv i personit, i cili ishte i detyruar t'i kryente, të vepronte, dhe si rrjedhojë e këtij qëndrimi, është shkaktuar pasoja e dëmshme. Nga mosveprimi preken ato marrëdhënie juridike të vendosura për të siguruar të mirat juridike apo vlerat shoqërore të rëndësishme që mbrohen posaçërisht nga legjislacioni penal.

4.3 Elementet përbërës të anës objektive te veprës penale.

Mosveprimi si krijese e ligjit, ka karakter normativ. Që këtej bëhet ndarja e veprave penale të mirëfillta që kryhen me mosveprim dhe vepra penale indirekte të kryera me mosveprim. Veprat penale të mirëfillta janë ato vepra penale që kryhen drejtëpërdrejtë me mosveprim, të cilat lidhen doemos me ardhjen e pasojës, për veprat penale indirekte të kryera me mosveprim kërkohet ardhja e ndonjë pasoje të dëmshme.

Lidhja shkakësore

Lidhja shkakësore është një ndër kushtet e përgjegjësisë penale. Ajo është pjesë dhe element i domosdoshëm i anës objektive, që përcakton se shkak i ardhjes së pasojës janë veprimet ose mosveprimet e autorit të veprës penale. Lidhja që ekziston midis shkakut dhe pasojës quhet lidhje shkakësore (kazuale). Ky rregull universal, që në të drejtën penale njihet me shprehjen latine “*nullum crimen, nulla poena sine causa*” (s’ka krim, s’ka dënim pa shkak), Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave ose mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore (neni 13 i Kodit Penal). Të drejtës penale i intereson lidhja midis shkakut dhe pasojës së këtij fenomeni që është vepra penale.

Në lindjen ose zhvillimin e një fenomeni mund të marrin pjesë një ose disa shkaqe, por jo të gjithë ata luajnë rol të njejtë. Midis tyre vetëm njëri është kryesor, vënia në lëvizje e të cilit lindi veprën penale dhe solli pasojën ose mundësinë e ardhjes së saj. Të tjerët janë rastësorë ose sekondarë. Edhe shkaqet ose lidhjet e rastit ndikojnë në lindjen, zhvillimin ose drejtimin që merr fenomeni, mund ta shpejtojnë ose ta ngadalësojnë ecurinë e tij, ndonjëherë janë edhe të domosdoshëm, por asnjëherë nuk e lindin atë. Personi përgjigjet për veprën penale kur veprimi ose mosveprimi i tij është shkak kryesor dhe jo ndër shkaqet e ardhjes së pasojës. Shkak kryesor quhet edhe shkak i domosdoshëm i drejtëpërdrejtë, sepse jo çdo shkak i domosdoshëm sjell pasojën. Ndodh që gjatë zhvillimit të procesit ndërhyjnë shkaqe të tjerë, të cilët e ndërpresin lidhjen shkakësore, nuk e lejojnë procesin të shkojë deri në fund, duke krijuar një dukuri të re, me lidhje të re shkak-pasojë. Lidhja shkakësore ekziston si në veprat penale të kryera me veprim, ashtu edhe në ato të kryera me mosveprim, si në veprat e kryera me dashje, ashtu edhe në ato të kryera me pakujdesi. Midis lidhjes shkakësore dhe anës subjektive ekziston lidhje e ngushtë, me ndikim të ndërsjelltë. Për derisa vepra penale është produkt i njeriut të përgjegjshëm, edhe lidhja shkakësore, si kusht i ekzistencës së saj, ekziston kur personi është në gjendje të kuptojë në përgjithësi zhvillimin e saj, pasojat e dëmshme që sjellin veprimet ose mosveprimet e tij. Veprimi i kryer nga një person i papërgjegjshëm, edhe pse është shkak objektiv i ardhjes së pasojës, do të quhet shkak i rastit dhe vepra penale një rast fatkeq.

Në rastin e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim midis dy a më shumë personash, shkak i domosdoshëm dhe i drejtpërdrejtë në ardhjen e pasojës ose i mundësisë së ardhjes së saj janë veprimet e ekzekutorit.

Shkak i domosdoshëm i drejtpërdrejtë të veprës penale, sipas teorisë të së drejtës dhe praktikës gjyqësore konsiderohet ai veprim ose mosveprim i drejtpërdrejtë që sjell në mënyrë të domosdoshme ardhjen e pasojës ose mundësinë e ardhjes së saj. *Teoria ekuivalente*⁵⁰⁾ quan kusht kryesor kushtin pa të cilin nuk do të vinte pasoja. “*conditio sine qua non*”,

Sipas kësaj teorie, kushtet janë ekuivalentë, të barabartë në ardhjen e pasojës, duke pasur parasysh jo të gjitha shkaqet, por ato që janë të nevojshëm për ardhjen e rezultatit kriminal. Pranimi i kësaj teorie lejon përgjegjësinë penale të personit edhe në ato raste kur veprimi ose mosveprimi i tij nuk ka qenë kryesor, por një ndër shkaqet e nevojshëm të ardhjes së pasojës.

Teoria adekuate, bazohet tek “shkak i tipik” i ardhjes së pasojës.

Esenca e kësaj teorie përmbledhet në mendimin se: personi përgjigjet penalisht në qoftë se veprimet ose mosveprimet e tij kanë qenë të përshtatshëm për ardhjen e pasojës, jo në rastin konkret, por në përgjithësi, domethënë të ketë qenë një veprim tipik, adekuat për ardhjen e asaj pasoje.

Konceptimi i tipikes dhe i adekuates është relativ dhe subjektiv, çka krijon vështirësi në përcaktimin e shkakut adekuat dhe lë shteg për interpretime dhe qëndrime subjektive.

Pasoja

Pasoja e veprës penale është cënimi, prishja ose shkatërrimi i marrëdhënies shoqërore të mbrojtur nga ligji penal, që përbën objektin e veprës penale. Me pasojë të veprës penale kuptohen ndryshimet që ndodhin nga veprimi ose mosveprimi i paligjshëm i personit. Pasoja ndahen në materiale ose jo materiale (formale).

-Pasoja materiale nënkuptojnë lëndimet trupore të njeriut, ku përfshihen: vdekja, plagosja dhe dëmtimet e tjera të shëndetit dhe dëmet materiale, ku futen pakësimi ose humbja e pasurisë dhe dëmtimi ose shkatërrimi i pronës.

-Pasoja jo materiale ose formale nënkupton rastet kur vepra penale quhet e konsumuar me kryerjen e veprimit ose të mosveprimit ose kur përfundimi i saj nuk lidhet me ardhjen e pasojave, më saktë me pasojë të dukshme. Termin “pasoja” ligji penal e përdor në dy kuptime:

Si marrëdhënie juridiko-penale të cënuar ose të rrezikuar nga vepra penale
Si dëmtim fizik ose material.

Pasoja mund të jetë element i domosdoshëm i veprës penale ose rrethanë cilësuese e figurës së veprës penale. Në mjaft raste vepra penale ose figura e saj lidhen me ardhjen e pasojave alternative ose me ardhjen njëkohësisht të dy ose më shumë pasojave. Kur pasoja është alternative, mjafton ardhja e njëres prej tyre për të ekzistuar vepra penale apo figura e saj.

⁵⁰Elezi I., Komentari i Kodit Penal .

Mënyra

Me mënyrë të kryerjes së veprës penale kuptohet renditja e veprimeve, metoda, dhe mjetet e përdorura, karakteri kronologjik dhe veçoritë e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale është pjesë e anës objektive të saj. Ajo futet në grupin e elementëve plotësues të anës objektive. Rol të madh në mënyrën e kryerjes së veprës luan elementi subjektiv, si karakteri dhe temperament i autorit të saj, motivi që e shtyn dhe qëllimi që kërkon të arrijë. Mënyra, ndikon në përcaktimin e shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës, të personit dhe të fajësisë së tij, në disa raste edhe si rrethanë rënduese, si rrethanë cilësuese e figurës së veprës penale ose për vetë ekzistencën e veprës penale.

Koha, vendi dhe ambienti

Me kohë, vend dhe ambient të kryerjes së veprës penale kuptohet tërësia e kushteve konkrete të marra së bashku në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm dhe shoqërisht i rrezikshëm, zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjen pasoja e dëmshme. Koha, vendi dhe mjedisi janë elementë plotësues ose dytësorë të anës objektive të veprës penale, sepse rregullisht, vepra ose figura e saj qëndron pavarësisht nga koha kur është kryer ose nga vendi apo mjedisi ku është kryer.

Koha, vendi dhe mjedisi kanë rëndësi për përcaktimin e shkallës së rrezikshmërisë shoqërore, rrjedhimisht edhe për caktimin e dënimit ndaj autorit të veprës penale.

Saktësimi i kohës së kryerjes së veprës penale merr rëndësi të veçantë për:

1. Zbatimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale ose të ekzekutimit të dënimit dhe për rehabilitimin e të dënuarit.
2. Për zbatimin e ligjit të kohës kur është kryer vepra penale ose të ligjit më të favorshëm, në se ligji i kohës së kryerjes së veprës dhe ligji i kohës së gjyqimit të saj janë të ndryshëm.
3. Për përcaktimin e moshës së përgjegjësisë penale ose të kalimit të moshës së miturisë, ku ndërpritet caktimi i gjysmës së dënimit me burgim i parashikuar për të miturit nga katërmbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.

Vendi ka rëndësi për :

1. Përcaktimin e kompetencës territoriale të gjykatës që do të gjykojë çështjen
2. Për zbatimin e ligjit sipas parimit territorial dhe të shtetësisë, në rastet kur veprimtaria kriminale shtrihet edhe në shtete të tjerë ose kur vepra penale është kryer jashtë territorit të vendit tonë. Në disa raste vendi është element përbërës i domosdoshëm i veprës penale, ndërsa ambienti element cilësues i figurës së saj.

4.4 Subjektet e veprës penale

Me subjekt të posaçëm⁵¹, të veprës penale kuptohet-personi që ka disa cilësi konkrete, të veçanta, dhe ti përdorë ato për kryerjen e veprës penale, si dhe veprat penale që kryhen të kërkojë përdorimin e këtyre cilësive.

Cilësia e veçantë e subjektit është element qenësor formues i figurës së veprës së kryer nga mbajtësi i kësaj cilësie. Mungesa e këtyre cilësive të subjektit e cilëson veprën sipas një dispozite tjetër penale ose nuk e dënon fare atë. Me subjekt të posaçëm janë veprat e kryera gjatë përmbushjes së detyrave nga punonjësit shtetërorë ose të shërbimit publik .

Subjekt i posaçëm mund të jetë personi për shkak të profesionit ose detyrave të veçanta që i ngarkon ligji. Subjekt të posaçëm ka edhe vepra penale e mosdhënies ndihmë nga personi që me ligj ose për shkak të detyrës detyrohej ta jepte atë. Ushtarakët e forcave të armatosura dhe personat e barazuar me ta janë subjekte të posaçëm të veprave penale ushtarake, të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak. Subjekt i posaçëm është edhe personi juridik, përgjegjësia penale e të cilit u parashikua për herë të parë në Kodin Penal në fuqi.

E drejta penale i ndan subjektet e veprës penale edhe në:

Subjekt aktiv, që është autori i veprës penale. Subjekte pasive, janë viktimat e krimit ose të dëmtuarit nga vepra penale. Viktima, është person apo grup i caktuar personash, të çdo forme të integritetit të tyre, të cilët si pasojë e krimit pësojnë dëme. Teorikisht me “dëm” përcaktohen çdo dëmtim, prishje, humbje, materiale apo morale si dhe çdo shkelje e të drejtave të personit apo të pronës. Në këtë kënd kemi këto ndarje:

Dëmi Moral është shkelje e të drejtave subjektive të shtetasve, fyerja e poshtërim i nderit, uljen e personalitetit në prani të personave të tjerë, ushtrimi i vuajtjeve morale.

Dëmi fizik është shkaktimi i dëmtimeve trupore, rrahje, dëmtimi i shëndetit, shkaktimi i vuajtjeve fizike.

Dëmi material shprehet në dëmtimin e pronës, pasurisë apo të drejtave pasurore, interesave përkatëse që sjellin si pasojë humbjen apo cënimin e të drejtës për ti gëzuar materialisht.

Viktimologjia

Është shkenca që merret me viktimën, ajo ndahet në dy drejtime kryesore:

Në viktimologji penale ose viktimologji e interaksionit. Viktimologji e përgjithshme ose viktimologji e orientuar. Objekti i viktimologjisë penale është studimi i viktimave të veprave të përcaktuara në ligjin penal. Ajo merret kryesisht me shkaqet e krimit në lidhje me rolin e viktimës në procesin penal si dhe studimin e marrëdhënieve ndërmjet viktimës dhe autorit të veprës penale.

Viktimologjia e përgjithshme orientohet në parandalimin dhe asistencën sociale për viktimat. Objekti i saj është studimi i rolit të viktimës me qëllim që të kufizohet rreziku për të qenë viktimë e krimeve si dhe dhënia e ndihmës ndaj saj.

Llojet e subjekteve pasive viktimave⁵²

⁵¹⁾ Komentari i Kodit Penal, Islami H, Hoxha A, Panda I, Tiranë 2011, fq 61 – 77.

⁵²⁾ Komentari i Kodit Penal.

Viktima e krimit mund të klasifikohen:

Viktima e krimit sipas karakteristikave personale e ato të sjelljes.

Viktimat me anomali psikike.

Viktimat në varësi të shkallës së pjesëmarrjes të të tjerëve në dëmin e pësuar.

Kuptimi dhe rëndësia e moshës

Mosha është elementet e domosdoshëm për përgjegjësi penale .

Personi në kohën e kryerjes së veprës penale duhet të ketë mbushur një moshë të caktuar me ligj. Ka përgjegjësi penale personi i cili në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën 14 vjeç ndërsa personi që ka kryer një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën 16 vjeç. (neni 12 i K.P). Gjykata vlerëson nëse i mituri në çastin e kryerjes së krimit ka mbushur apo jo moshën 14 vjeç. Mosha 14-18 vjeç përbën miturinë dhe subjektet e kësaj moshe quhen minorenë. Gjykata vlerëson dhe konstaton për çdo subjekt në veçanti shkallën e aftësisë të pjekurisë për të kuptuar e kontrolluar sjelljet e tij, ku përfshihen elementë të tillë si:

- Veçoritë biologjike që lidhen me moshën.
- Ndikimi në formimin e sjelljes së minorenit.
- Niveli kulturor, mësimor i minorenëve .
- Shkalla e ulët e nivelit moralo-ligjor.
- Sfera volitative dhe emocionale.

Përcaktimi i moshës për përgjegjësi penale nuk është një veprim mekanik, por mbështetet në të dhënat e shkencave biologjike dhe shoqërore, lidhur me zhvillimin fizik dhe intelektual të personit për të qenë në gjendje të kuptojë dhe të kontrollojë veprimtarinë e tij, pasojat shoqërisht të rrezikshme që mund të vijnë prej saj. Personi, që ka mbushur moshën 14 vjeç në çastin e kryerjes së veprës penale, ka marrë njohuri të mjaftueshme dhe mund të kuptojë se çfarë është krim e çfarë jo. Kundërvajtja penale kërkon që personi të ketë mbushur moshën 16 vjeç. Ky dallim është i domosdoshëm dhe bëhet për faktin se karakteri dhe rëndësia e kundërvajtjes penale nuk është aq e kuptueshme sa krimi. Gjatë vlerësimit nëse i mituri ka arritur ose jo aftësinë e pjekurisë, për të kuptuar e kontrolluar sjelljet te tij, kihet parasysh personaliteti i subjektit dhe për ta gjykuar sa më drejtë duhet të vlerësohen edhe kërkesa të tilla si:

Lloji i veprës penale të kryer⁵³⁾, Nëse i kryen për herë të pare ose jo, Çfarë roli ka luajtur në kryerjen e veprës penale ambienti familjar e shoqëror, që ndikon në sjelljen e të miturit, Njohja me karakterin e tij, Nëse vuan ose jo nga sëmundjet psikike, etj. Ne varësi me kriteret biologjik, socialo-psikologjik dhe kronologjik mund ti ndajmë moshat në llojet e mëposhtme:

v Mosha biologjike në kuptimin e sinonimeve funksionale, mjekësore e të tjera.

v Mosha kalendarike në kuptimin e gjendjes civile të pasaportës, kronologjike.

v Mosha socialo ligjore në kuptimin normativ, sociologjik, psikologjik shoqëror.

⁵³⁾ Konventa e OKB kundër Krimit te Organizuar Transnacional

Elezi I. Kaçupi S, Haxhia M, Komentari i Kodit Penal, Tiranë 2006, fq 110-120

Përgjegjësia penale për nivelin minimal të moshës, është limiti i fundit kalendarik i vendosur posaçërisht nga ligjbërësi në aktin normativ duke marrë parasysh kriteret biologjike mjekësore, psikologjike dhe sociale.

Mbushja e moshës për përgjegjësi penale lidhet me kohën e kryerjes së krimit ose të kundërvajtjes penale dhe jo me moshën e fillimit të procedimit penal apo të gjykimit të çështjes. Mituria fillon pasi personi të ketë mbushur moshën 14 vjeç, (kufiri më i ulët i saj) prej ku fillon përgjegjësia penale dhe mbaron kur ka mbushur moshën 18 vjeç (kufiri më i lartë i saj). Kjo ka rëndësi si për marrjen e personit në përgjegjësi penale, ashtu edhe për caktimin e dënimit ndaj tij. Për subjektet minorene të veprave penale ligja parashikon një sërë lehtësirash si: nuk mund ti jepet dënimi me burg të përjetshëm personave nën 18 vjeç i parashikuar në nenin 31 të K.P. Saktësimi i moshës bëhet nëpërmjet verifikimit të dokumenteve (çertifikatës së lindjes, apo çertifikatës së gjendjes familjare, dëftesës së shkollës etj.).

4.5 Kuptimi i anës subjektive dhe rëndësia e saj

Ana Subjektive e veprës penale përmban dhe shpreh qëndrimin psikik të personit ndaj veprimit ose mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm dhe pasojave të ardhura ose që rrezikojnë të vijnë prej tyre. Ana Subjektive e veprës penale zbulohet nga reflektimi i qëndrimit psikik në sjelljen e autorit të veprës penale. Subjekti i veprës penale si rregull është i lidhur me mangësinë e qëndrueshme të mos orientimit drejt vlerave e mos njohjen e tyre.

Kur flasim për anën subjektive, kemi parasysh, si element përbërës të saj, fajin, motivet dhe qëllimin, përmes të cilave shprehet dhe zbulohet qëndrimi psikik. Në kuadrin e anës subjektive studiohen edhe elementë të tjerë të lidhur me to, si lajthitja, rasti fatkeq dhe papërgjegjshmëria. Rëndësia e anës subjektive është parësore në këto drejtime:

Së paripër të përcaktuar përgjegjësinë penale,⁵⁴nëse ekziston ose jo vepra penale në një rast ku shfaqen elementët e jashtëm të saj.

Së dyti për të përcaktuar cilësimin ligjor të figurave të ngjashme të veprave penale ose me forma të ndryshme faji.

Së treti për caktimin e dënimit, për faktin se format e fajit, natyra e motiveve dhe qëllimi ndikojnë në shkallën e rrezikshmërisë.

Kuptimi dhe format e fajit

Faji, është element kryesor i veprës penale.

Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quket me faj personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi (neni 14 i Kodit Penal). Me faj kuptohet qëndrimi psikik që mban personi ndaj veprimit ose mosveprimit të paligjshëm dhe pasojave të dëmshme. Pa faj, personi

⁵⁴) Elezi I. Kaçupi S, Haxhia M, Komentari i Kodit Penal. Tiranë 2006, fq 99-151

nuk mund të ketë përgjegjësi penale. Faji në çdo rast ka karakter personal dhe duhet të vërtetohet gjatë procesit penal. E drejta penale e trajton dhe e vlerëson fajin në kryerjen e veprës penale, duke e lidhur me aftësinë intelektuale të personit për të kuptuar dhe kontrolluar sjelljen e tij. Fajtorë për kryerje të veprave penale deklarohen vetëm ata persona që veprojnë me vetëdije dhe me vullnet të lirë, që i kryejnë ato me dashje ose me pakujdesi. Fajësia ose mungesa e saj në kryerjen e veprës penale vlerësohen nga gjykata dhe deklarohen në vendimin e saj përfundimtar.

Format e fajit

Kodi Penal parashikon dy forma faji në kryerjen e veprës penale: dashjen dhe pakujdesinë. Nisur nga përmbajta e tyre, dashja ndahet në dashje direkte ose të drejtpërdrejtë dhe në dashje indirekte ose eventuale. Pakujdesia ndahet në pakujdesi në formën e vetëbesimit të tepruar dhe pakujdesi në formën e neglizhencës.

Dashja

Vepra penale kryhet me dashje, kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre ose, megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron ato, lejon ardhjen e tyre (Neni 15 i Kodit Penal). Dashja shfaqet në: dashje direkte dhe dashje indirekte që dallohen kryesisht nga qëndrimi psikik i personit ndaj pasojës.

Dashja direkte⁵⁵ ose e drejtpërdrejtë ekziston atëherë kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre.

Në dashjen direkte qëndrimi psikik i autorit të veprës penale është i njëjtë si ndaj veprimit ose mosveprimit të tij shoqërisht të rrezikshëm, ashtu edhe ndaj pasojave ose rezultatit tjetër kriminal që kërkon të arrijë me anën e tyre.

Dashja direkte paraqet si rregull shkallën më të lartë të fajësisë që mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit ndaj autorëve të veprave penale.

Dashja indirekte ose eventuale ekziston atëherë kur personi, njeh, kupton karakterin e paligjshëm të veprimeve ose mosveprimeve të tij megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron pasojat, me ndërjegje lejon ardhjen e tyre. Dashjen indirekte e dallojnë nga dashja direkte tre momente:

Dallimi i parë dhe kryesori lidhet me vullnetin, sepse personi në dashjen indirekte nuk e dëshiron ardhjen e pasojës, ndërsa në dashjen direkte e dëshiron atë.

Dallimi i dytë qëndron në faktin se në dashjen direkte personi vepron për ardhjen e pasojës së dëshiruar prej tij, ndërsa në dashjen indirekte lejon ardhjen e saj.

Dallimi i tretë ka të bëjë me sigurinë e parashikimit të ardhjes së pasojës. Në dashjen direkte personi është i sigurt për domosdoshmërinë e ardhjes së pasojës kurse në dashjen indirekte ai parashikon mundësinë e ardhjes së saj, por jo domosdoshmërinë e kësaj ardhjeje.

⁵⁵) Elezi I. Kaçupi S, Haxhia M, Komentari i Kodit Penal, Tiranë 2006 fq 112-114 .

Dashje e menjëhershme ose e paparamenduar, (*dolus repentinus*), kuptohen rastet kur mendimi për kryerjen e veprës lind aty për aty dhe personi vepron menjëherë për realizimin e saj.

Dashje e paramenduar, (*dolus praemeditatus*), ekziston në ato raste kur mendimi kriminal për kryerjen e veprës lind kohë përpara kryerjes së saj, kur mendimi përpunohet, merren masat përgatitore dhe pastaj kryhet vepra me gjakftohtësi. Në Dashjen e paramenduar subjekti parashikon me kohë veprën, pasojat, mjetet e rrethanat e tjera në të cilat do të veproje për të arritur pasojën e dëshiruar.

Dashje e përcaktuar (*dolus determinatus*) ekziston atëherë kur personi e ka identifikuar pasojën që dëshiron të arrijë, e cila mund të jetë e vetme ose alternative. Me dashjen e përcaktuar fajtori parashikon ardhjen e një pasoje të caktuar - konkrete, p.sh. dëmtimin e shëndetit të tjetrit, plagosjen e tij.

Dashja është alternative kur nga vepra vijnë dy a më tepër pasoja, gjë që ndodh zakonisht në veprat penale të përbëra ose me dy objekte, ku personi i ka përcaktuar pasojat duke synuar të arrijë vetëm njërin prej tyre.

Dashje e papërcaktuar (*dolus indeterminatus*) është ajo kur personi parashikon se me veprimin ose mosveprimin e tij do vijnë pasoja, pa i konkretizuar ato duke dëshiruar ardhjen e secilës prej tyre, veç e veç ose së bashku. Dashja e papërcaktuar, karakterizohet nga fakti se personi fajtor parashikon ardhjen e pasojave të dëmshme por jo se do t'i shkaktojë ndonjë dëm të caktuar konkret dhe nuk lejon me vetëdije ardhjen e një pasoje të tillë konkrete. Cilësimi ligjor i veprës së kryer me dashje të papërcaktuar bëhet duke marrë për bazë dëmin e ndodhur në fakt.

Motivet, qëllimi

Motivet dhe qëllimi janë elementë plotësues ose fakultativë të figurës së veprës penale. Motivet, në të drejtën penale, janë shtysat e brendshme që e bëjnë personin të kryejë veprën penale. Ato lindin nën ndikimin e faktorëve të jashtëm dhe shprehin gjendjen psikologjike dhe shpirtërore të personit, mentalitetin dhe botëkuptimin e tij lidhur me qëndrimin që duhet të mbajë ndaj këtyre dukurive që e ngacmojnë ose e shqetësojnë. Motivet janë të pranishme në shumicën e veprave penale të kryera me dashje direkte, sidomos në ato me dashje të paramenduar, ku vetëdija dhe forca e shprehjes së vullnetit janë në shkallën më të lartë.

Motivet, sipas peshës dhe vendit që zënë në anën subjektive, ndikojnë në shkallën e rrezikshmërisë të çdo vepre që kryhet me dashje direkte si dhe në shkallën e fajësisë së personit. Motivet shërbejnë si rrethana lehtësuese në caktimin e dënimit penal. Motivi shërben si rrethanë lehtësuese, sipas nenit 48/a të Kodit Penal, kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore. Motivet shërbejnë si rrethanë rënduese në caktimin e dënimit penal ndaj të pandehurit që deklarohet fajtor për veprën e kryer. Motivet e dobëta parashikohen si rrethanë rënduese në nenin 50 të Kodit Penal, shkronjat “a” dhe “j”. Prania e motiveve të dobëta, që e kanë shtyrë personin në veprimtarinë kriminale, dëshmon për shkallë fajësie më të lartë dhe për rrezikshmëri më të madhe të veprës dhe të autorit të saj. Motivi shërben edhe si rrethanë cilësuese e veprës penale. Prania e tij e cilëson atë, duke formuar një figurë tjetër të saj.

Persë i përket veprave penale te kryera me pakujdesi, as që mund të bëhet fjalë për motive në lidhje me mundësinë e ardhjes së pasojave të dëmshme. Merr rëndësi të madhe zbulimi i motivit që ka shtyrë personin të kryejë veprën penale me dashje, sepse kjo ndihmon në përcaktimin e saktë të formës së fajësisë dhe të shkallës së fajësisë, si dhe në marrjen e masave parandaluese. Qëllimi është objektivi që kërkon të arrijë personi me kryerjen e veprës penale. Qëllimi, si çdo pjesë e anës subjektive, ndikohet nga faktorët e botës së jashtme, por, në fund të fundit, është vetë njeriu që me ndërgjegje përcakton synimet e tij. Qëllimi ndryshon nga motivi sepse qëllimi është synim, objektivi, ndërsa motivi është shtysë, ndjenjë që nxit. Qëllimi e finalizon veprën, ndërsa motivi e inicion atë. Qëllimi ndryshon edhe nga pasoja. Qëllimi është ajo që kërkon të arrihet ose të përfitohet me ardhjen e pasojës, ndërsa pasoja është prishja ose shkatërrimi i marrëdhënieve juridiko-penale të mbrojtura nga ligji penal. Qëllimi është element i anës subjektive, kurse pasoja element i anës objektive të veprës penale. Dëshira dhe qëllimi janë në unitet, lind dëshira më parë, pastaj qëllimi dhe pa dëshirë nuk ka as qëllim. Qëllimi nuk është element përbërës i domosdoshëm i të gjithave veprave penale.

Në veprat penale të trafikimit objekt i drejtpërdrejtë i kësaj dispozite, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar lirinë e personit, përfshirë lirinë seksuale të tij, të drejtën e personit për të qenë i lirë dhe për të vendosur në mënyrë të vullnetshme mbi jetën e tij dhe mbi veprimet që ai dëshiron të kryejë, në raport me subjektet e tjerë të së drejtës, i cili përbën objektin parësor të kësaj vepre penale. Si objekt dytësor i kësaj vepre penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar jetën dhe shëndetin e personit, dinjitetin dhe personalitetin e tij, nga çdo veprim ose mosveprim kriminal.

Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet me veprime aktive të kundërligjshme, të cilët konsistojnë në:

a) **Elementi i parë**, ka të bëjë me rekrutimin, ose transportimin, ose transferimin, ose fshehjen ose pritjen e personit.

Në mënyrë që të kuptohet në mënyrë të saktë ky element dhe secila prej pjesëve përbërëse të tij, është e domosdoshme që të bëhet sqarimi i koncepteve “rekrutim i personit”, “transportim i personit”, “transferimi i personit”, “fshehja e personit” dhe “pritja e personit”. Rekrutimi i personit, si pjesë e anës objektive e figurës së kësaj vepre penale, ka të bëjë me gjetjen e personave dhe me nënshtrimin e tyre, qoftë me anë të dhunës fizike apo psikike, apo me anë të mashtrimit ose duke përfutur nga gjendja vulnerabël e tij, etj, me qëllim trafikimin e tyre.

Transportimi i personit, nënkupton zhvendosjen e këtij personi, nga një vend në një vend tjetër, qoftë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, qoftë jashtë këtij territori, me qëllim trafikimin e tij. Në mënyrë që të jemi para kësaj vepre penale të kryer në formën e transportimit të personit, nuk ka rëndësi nëse viktimja, transportohet me anë të mjeteve të transportit rrugor, ujor, ajror apo hekurudhor, e rëndësishme është që, viktimja jashtë vullnetit të saj dhe me qëllim trafikimin e saj, transportohet dhe lëviz nga një vend në tjetrin.

Transferimi i personit, me qëllim trafikimi, është një koncept i ngjashëm me transportimin, ku subjekti i veprës penale, e transferon një person nga një vend, në një vend tjetër, zakonisht jashtë shtetit, me qëllim që ta trafikojë. Pavarësisht se, transferimi i personit me qëllim trafikimi, është një koncept i ngjashëm me transportimin e personit, kjo nuk do të thotë se këto dy koncepte janë identike. Përkundrazi, këto koncepte kanë dallime ndërmjet tyre dhe si dallim të parë do të përmendim faktin se, transportimi i personit, përfshihet brenda konceptit të

transferimit, domethënë, është i vërtetë pohimi sipas të cilit, në çdo rast që kemi transferim të personit, detyrimisht kemi edhe transportimi të tij, por, pohimi i anasjelltë, nuk është i vërtetë, sipas të cilit, në çdo rast që kemi transportim të personit, kemi dhe transferimi të tij nga një vend në tjetrin.

Kjo për faktin se, transportimi mund të realizohet nga ana juridike edhe pa bërë transferimin e personit nga një vend në tjetrin, siç është rasti kur subjekti e transporton subjektin për disa kilometra, brenda të njëjtit qytet ose qark. Në këtë rast, nuk jemi para konceptit të transferimit të personit me qëllim trafikimi, sepse personi nuk është transferuar nga një vend në tjetrin, por thjesht është transportuar brenda të njëjtës zonë ose lokaliteti.

Koncepti i transferimit të personit, me qëllim trafikimi, kërkon detyrimisht transferimin e personit nga një rreth ose qark në tjetrin ose nga një shtet në tjetrin dhe jo thjesht transportimin e tij brenda të njëjtës zonë ose qark. Një dallim tjetër, që mund të bëhet ndërmjet “transferimit të personit” dhe “transportimit të personit”, për qëllime trafikimi, është fakti se tek transferimi subjekti i veprës penale, kryen një veprimtari kriminale më të gjatë në kohë, deri sa të arrijë plotësisht transferimin e viktimës, nga një qytet ose qark në një tjetër, ose nga një shtet në një tjetër, ndërsa tek “transportimi i personit”, për qëllime trafikimi, veprimtaria e subjektit të veprës penale, është më e shkurtër në kohë, ajo zgjat, zakonisht, disa orë dhe brenda kësaj periudhe subjekti konsiderohet se e ka kryer veprën penale të “Trafikimit të personave” në këtë formë. Fshehja e personit, nënkupton, mbajtjen të izoluar të personit nga ambienti i jashtëm dhe moslejimin e komunikimit të tij me persona të afërm të familjes apo me persona të tjerë, e bërë kjo me qëllim trafikimin e tij. Në mënyrë që të jemi para kësaj forme të kryerjes së veprës penale, kërkohet detyrimisht që viktimës t’i hiqet liria dhe të mbahet e izoluar jashtë vullnetit të saj, duke i hequr çdo mundësi që ajo të komunikojë me persona të tjerë dhe me botën e jashtme.

Në mënyrë që vepra penale të konsiderohet si plotësisht e kryer nga ana e autorit të saj, mjafton që prej tij, të kryhet edhe vetëm në një nga format e mësipërme të realizimit të veprës penale, kuptohet kur ekzistojnë edhe dy elementët e tjerë të anës objektive, të cilët do të trajtohen më poshtë. Kjo do të thotë se, kur plotësohen edhe dy elementët e tjerë të anës objektive të kësaj vepre penale, subjekti do të konsiderohet se e ka kryer në mënyrë të plotë këtë veprë penale, në rastet kur ai ka bërë vetëm rekrutimin e personit, ose vetëm transportimin e personit, ose vetëm transferimin e personit ose vetëm fshehjen e personit ose vetëm pritjen e personit, me anë të mashtrimit ose kërcënimit apo përfitimit nga gjendja shoqërore e tij, etj, dhe më qëllim trafikimin e tij, pavarësisht se nuk e ka trafikuar këtë person, si dhe pavarësisht se nuk e ka shfrytëzuar këtë person. Për t’u konsideruar si plotësisht e kryer vepra penale e “Trafikimit të personave”, mjafton që subjekti të ketë bërë vetëm rekrutimin e personit, ose vetëm transportimin e personit ose vetëm transferimin e personit, ose vetëm fshehjen e personit ose vetëm pritjen e personit, me anë të mashtrimit ose kërcënimit apo përfitimit nga gjendja shoqërore e tij, etj, dhe më qëllim trafikimin e tij, pavarësisht se nuk e ka trafikuar këtë person, si dhe pavarësisht se nuk e ka shfrytëzuar atë.

b) Nga formulimi që ka përmbajtja e nenit 110/a të Kodit Penal, ku jepet edhe kuptimi i veprës penale të “Trafikimit të personave” konstatohet se:

Elementi i dytë i anës objektive të kësaj figure të veprës penale, mund të zbërthehet në disa elementë që konkretisht janë:

Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi ose fshehja ose pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të kërcënimit që i bëhet personit, me qëllim trafikimin e tij, ku, kërcënimi i personit, nënkupton dhunën psikike ose kanosjen që i bëhet personit.

Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja ose pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përdorimit të forcës, me të cilën kemi parasysh përdorimin e dhunës fizike, që subjekti i veprës penale ndaj të dëmtuarit. Dhuna fizike nënkupton, dëmtime dhe lëndime fizike që i bëhen personit, si rrahje, goditje me sende të ndryshme, shtyrje, rrezime për tokë, deri tek plagosja e lehtë, që i bëhen të dëmtuarit me qëllim trafikimin e tij.

4. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të formave të tjera të shtrëngimit, me të cilat do të kuptojmë, të gjitha ato veprime të cilat ndikojnë në mënyrë thelbësore në vullnetin e të dëmtuarit, duke i hequr atij plotësisht lirinë që të disponojë për veten e tij, të cilat janë të ndryshme nga dhuna fizike apo psikike. Si veprime të tilla, mund të përmendim, për shembull, lënien e të dëmtuarit pa ushqim, ose mos sigurimi për të dëmtuarin të kushteve minimale higjeno-sanitare ose të fjetjes etj.
5. Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi ose fshehja ose pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet anë të rrëmbimit, kur subjekti i veprës penale me veprimet e tij të kundërligjshme, plotëson të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Rrëmbimi”.
6. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të mashtrimit, kur subjekti përdor gënjeshtren ose shpërdoron besimin e të dëmtuarit, me qëllim trafikimin e tij.
7. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të shpërdorimit të detyrës, kur në veprimet e subjektit të veprës penale, ekzistojnë të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. I vetmi dallim që ekziston në këtë rast, është fakti se, subjekti veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e kryen, me qëllim trafikimin e të dëmtuarit.
8. Rekrutimi, ose transportimi ose transferimi, ose fshehja ose pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore e të dëmtuarit, kur subjekti e kryen veprën penale, duke shfrytëzuar disa nga këto rrethana që lidhen me të dëmtuarin si:
 - gjendja e rëndë ekonomike e të dëmtuarit, ku i dëmtuari nuk ka asnjë mjet për jetesë;
 - gjendja e keqe familjare e të dëmtuarit, për shembull, e dëmtuara është rritur pa prindërit ose është rritur me prindër të divorcuar, të cilët kanë lidhur martesë të re ose e dëmtuara është e divorcuar dhe është e vetme me ose pa fëmijë të mitur etj;
 - niveli i ulët arsimor i të dëmtuarit;

- izolimi nga bota e jashtme që mund të ketë pasur i dëmtuari, si pasojë e kushteve të rënda ekonomike ku është rritur;
- mentaliteti dhe traditat në disa raste të disfavorshme ku është rritur i dëmtuari etj.

9. Rekrutimi ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përfitimit nga gjendja fizike apo psikike e të dëmtuarit, ku me gjendje të rëndë fizike, do të kuptojmë rastet kur i dëmtuari është i dëmtuar rëndë fizikisht, për shembull, është pa këmbë ose është me një këmbë, ose kur personi nuk shikon ose nuk dëgjon, apo kur është i paralizuar dhe ecën me karrocë invalidi etj. Me gjendje të rëndë psikike të të dëmtuarit, do të kuptojmë rastet kur, i dëmtuari ka zhvillim të vonuar mendor ose vuan nga sëmundje mendore, të cilat e bëjnë të paafte për të kuptuar, plotësisht, veprimet që kryhen në dëm të tij dhe pasojat që vijnë prej tyre.
10. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të dhënies së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, kur subjekti i veprës penale, jep një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimin e tij.
11. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, kur subjekti i veprës penale, merr një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimin e tij.

Në mënyrë që vepra e “Trafikimit të personave” të konsiderohet e kryer, në mënyrë të plotë, nga ana e subjektit të veprës penale, mjafton të provohet se ai ka përdorur qoftë edhe një nga format e mësipërme për të realizuar trafikimin e personit. Pra, vepra penale do të konsiderohet plotësisht e kryer në qoftë se subjekti bën rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen, ose pritjen e personave, e ka bërë qoftë edhe vetëm me anë të kërcënimit ose qoftë edhe vetëm me anë të përdorimit të forcës ose qoftë edhe vetëm me anë të formave të tjera të shtrëngimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të rrëmbimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të mashtrimit ose qoftë edhe vetëm me anë të shpërdorimit të detyrës ose qoftë edhe vetëm me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore, psikike apo fizike ose qoftë edhe vetëm me anë të marrjes ose dhënies së pagesave për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër. Në qoftë se, rezulton që, subjekti e ka kryer veprën, në dy ose më shumë prej këtyre formave të trajtuara më lart dhe të parashikuara në dispozitë, ai nuk do të përgjigjet aq herë në sa forma e ka kryer veprën, por, do të përgjigjet vetëm një herë, dhe fakti që ai e ka kryer veprën me anë të disa prej këtyre formave, tregon për rrezikshmërinë e madhe të tij, fakt që duhet të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

c) Elementi i tretë, i referohet faktit që rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, i bërë ose me anë të kërcënimit, ose me anë të përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, ose me anë të mashtrimit, ose me anë të shpërdorimit të detyrës, ose me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore e të dëmtuarit, ose me anë të përfitimit nga gjendja fizike apo psikike, ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon

një person tjetër, duhet të bëhet ose me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, ose me qëllim shfrytëzimin e punës ose shërbimeve të detyruara, ose me

qëllim skllavërimin e personit ose formave të ngjashme me të, ose me qëllim vënien në përdorim ose transplantimin e organeve, ose me qëllim të çdo shfrytëzimi tjetër.

Nga përcaktimi i mësipërm, rezulton se ky element i kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të personave” shfaqet në një ose disa prej këtyre mënyrave:

- a) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për qëllime prostitucioni;
- b) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për forma të tjera të shfrytëzimit seksual;
- c) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për punë të detyruar;
- ç) Shfrytëzimi i personit për shërbime të tjera të detyruara;
- d) Shfrytëzimi i të dëmtuarit si skllav;
- e) Shfrytëzimi i të dëmtuarit në pozita të ngjashme me skllavërinë;
- f) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për vënien në përdorim të organeve;
- g) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për transplantim të organeve;
- h) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për çdo qëllim tjetër të kundërligjshëm.

KREU V

TRAFIKIMI DHE KRIMI I ORGANIZUAR

5.1 Trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimi i organizuar

Problematika që lidhet me krimin e organizuar po haset gjithnjë e më tepër në ditët e sotme. Gjithnjë e më tepër është rritur niveli i bashkëpunimit mes organizatave kriminale. Si rezultat i globalizimit të ekonomisë janë shtuar mundësitë për zhvillimin e krimit të organizuar. Me Ligjin Nr. 8920, datë 11.7.2002, "Për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj", Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara dhe dy Protokollat shtesë të saj. *Sipas këtij ligji është vendosur:*

Ratifikohet "Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj, "Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare" dhe "Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve". Në nenin 1 të Konventës është bërë i qartë dhe është deklaruar qëllimi i konventës e cila ka si qëllim të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar. Në vijimësi është përcaktuar nga konventa se çfarë kuptohet me një sërë termash duke treguar dhe grupin kriminal.

(a) "Grup kriminal i organizuar"⁵⁶ nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në

harmonimi me njeri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime ose vepra penale serioze, të përcaktuara si të tilla në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitime financiare ose materiale.

⁵⁶) Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional

Në këtë këndvështrim analizojmë se duhet të ekzistojnë këta elementë⁵⁷⁾:

ekzistenca e grupit për një periudhë të zgjatur në kohë,
përbërja e grupit duhet të jetë në numër tre ose më shumë persona,
veprimet e tyre duhet të jenë në unitet dhe në harmoni me njëra tjetrën,
- zgjatja në kohë e veprimtarisë kriminale.

(b) "Krim serioz" nënkupton atë akt që përbën një vepër penale të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë.

Konventa ka dhënë kuptimin dhe për grupin e strukturuar duke parashikuar:

(c) "Grup i strukturuar" nënkupton një grup që nuk është formuar në mënyrë të rastësishme për kryerjen e menjëhershme të një vepre penale dhe që nuk nevojitet të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësimit në të ose të ketë një strukturë të zhvilluar.

(d) "Pasuri" nënkupton pasuritë e çdo lloji, fizike ose jofizike, të luajtshme ose të paluajtshme, reale ose joreale, dhe dokumentet ose instrumentet ligjore, të cilat vërtetojnë një titull ose interes tek këto pasuri.

(e) "Të ardhura nga krimi" nënkupton çdo pasuri që rrjedh ose që është fituar, direkt ose indirekt, nëpërmjet kryerjes së një vepre penale.

(f) "Bllokim" ose "konfiskim" nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, shkëmbimit, rregullimit ose zhvendosjes së pasurisë, ose marrjen përkohësisht në ruajtje ose kontrollimin e pasurisë në baze të një urdhri të lëshuar nga gjykata ose ndonjë autoritet tjetër kompetent.

(g) "Konfiskim" , i cili përfshin në raste të veçanta gjobën, nënkupton privimin e përhershëm nga pronësia me anë të një urdhri gjykate ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

(h) "Vepër penale bazë" nënkupton çdo vepër penale, si rezultat i së cilës të ardhurat janë nxjerrë me qëllim që të bëhen subjekt i një vepre penale në mënyrën e përshkruar në nenin 6 të kësaj Konvente.

(i) "Shpërndarje e kontrolluar"⁵⁸⁾ nënkupton teknikën që lejon kalimin e ngarkesave të paligjshme ose të dyshimta, përmes ose në territorin e një ose më shumë Shteteve, me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve të tyre kompetente, me qëllim që të hetohet një vepër penale dhe të identifikohen personat e përfshirë në kryerjen e veprës penale.

(j) "Organizatë rajonale e integritit ekonomik" nënkupton një organizatë të krijuar nga shtete sovraane të një rajoni të caktuar, tek e cila Shtetet Anëtare kanë transferuar kompetenca në lidhje me çështjet që rregullohen nga kjo Konventë dhe që është e autorizuar në mënyrën e duhur në përputhje me procedurat e saj të brendshme që të nënshkruajë, ratifikojë, pranojë, miratojë, ose aderojë në të; referimet tek "Shtetet Palë", në bazë të kësaj Konvente, do të aplikohen ndaj këtyre organizatave brenda kufijve të kompetencës së tyre.

Konventa e Palermos dhe protokollat kanë si qëllim bashkëpunimin ndërkombëtar, element ky i parashikuar që në nenin 1 të kësaj konvente.

Pjesë përbërëse e legjislacionit ndërkombëtar, ka fuqi detyruese për shtetet dhe jo për shtetasit, pranimi i tekstit përfundimtar realizohet me nënshkrim, pasohet nga ratifikimi dhe implementimi që konsiston në përfaqësimin e legjislacionit të brendshëm me atë ndërkombëtar.

⁵⁷⁾ Koça A. Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qënieve njerëzore fq 106-114..

⁵⁸⁾ Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional,

Konventa + Protokoll, detyrojnë shtetet të marrin masa kundër krimit të organizuar, transnacional dhe të nxisin bashkëpunimin.

Konventa e Palermos + Protokollet Vendosin minimumin bazë të standardeve me synim që masat e marra nga shtetet nënshkruese të sigurojnë efektivitetin e masave kolektive ndërkombëtare.

Çdo instrument që në dispozitat e para bën përkufizimin e termave:

- jep elementet e veprës penale me të cilat merret;
- përcakton rrethanat e aplikimit të dispozitave;
- synon standartizimin e terminologjisë mes shteteve.

Përmbajtja e konventës tregon parashikimet për krimet e veçanta duke i quajtur si të tilla: pjesëmarrja në grupe kriminale të organizuara⁵⁹⁾,

pastrimi i parave,
korrupsioni,

pengimi i drejtësisë,

Protokollet parashikojnë vepra penale shtesë dhe secila merret me trajtimin e tyre.

Iu jep shteteve nënshkruese detyrimin për marrjen e masave të tjera të brendshme:

- legjislacion dhe praktika që kufizon hapësirat e aktivitetit të krimit të organizuar;
- për rritjen e mundësisë së kontrollit (banka, pika kalimi, pasaporta, etj);
- parashikim të veprave penale shtesë në mbështetje të atyre kryesore.

Nga ana tjetër parashikohet detyrimi për bashkëpunim ndërkombëtar:

- detyrimi për ekstradim;
- për ndihmë juridike;
- për shkëmbim informacioni.

Një tjetër moment i rëndësishëm i parashikuar është dhe detyrimi për trajnime dhe asistencë teknike:

- detyrime për të trajnuar punonjësit;
- për të parashikuar fonde për teknikën e nevojshme dhe ekspertizë;
- përdorimin e fondeve të konfiskuara për këtë qëllim.

Nga ana tjetër janë parashikuar dhe disa elemente për parandalimin duke parashikuar:

Detyrimin për marrjen e masave që ndihmojnë në parandalimin e veprave penale.

Protokolli i Palermos. Plotësim i Konventës së OKB Kundër Krimit të Organizuar Trans-Nacional (dhjetor 2000). Për herë të parë bëhet një përcaktim i plotë detyrues i trafikimit duke u bërë bazë për legjislacionet e brendshme.

Neni 3 “Trafikim i personave⁶⁰⁾ do të thotë:

a) rekrutim, transportim, transferim, strehim apo pritje të personave, me anë kërcënimi apo përdorimi të forcës apo formave të tjera të detyrimit, të marrjes me forcë, të mashtrimit, të gënjeshtërs, të abuzimit me pushtetin ose të shfrytëzimit të një pozicioni delikat, apo të marrjes apo dhënies së pagesave apo përfitimeve të ndryshme, për të arritur pranimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi duhet të përfshijë, si minimum, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose të formave të tjera të detyrimit, të punës

⁵⁹⁾ Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional

⁶⁰⁾ Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional
Protokolli i Palermos, 2000

apo shërbimeve të detyruara, të skllavërisë apo praktikave të ngjashme me skllavërinë apo të heqjes së organeve ose shërbimet;

b) Pëlqimi i një viktime të trafikimit për shfrytëzimin e shpjeguar më sipër do të jetë i pavlefshëm nëse është përdorur një nga mjetet e detyrimit të parashikuara më lart;

c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi do të konsiderohet “trafikim i njerëzve” edhe nëse nuk përdoret asnjë nga mjetet e përcaktuara në pikën (a);

d) ”Fëmijë“ do të thotë çdo person nën 18 vjeç.

Konventa e KE: Konventa Evropiane për Veprime kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore Maj 2005, Varshavë. Kërkon të forcojë mbrojtjen e komunitetit evropian nga ky fenomen dhe të ngrejë në një nivel më të lartë statndartet tashmë të vendosura nga Protokollu i Palermos dhe akte të tjera. Kjo Konventë u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë me 20.11.2006.

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

të parandalojë dhe luftojë trafikimin e qenieve njerëzore nëpërmjet garantimit të barazisë gjinore;

të mbrojë të drejtat e njeriut të viktimave të trafikimit,

të ndërtojë një kuadër gjithë përfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave dhe dëshmitarëve, nëpërmjet garantimit të barazisë gjinore

të sigurojë hetim dhe ndjekje penale efektive të trafikimit,

të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në përpjekjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me qëllim që të sigurojë implementim efektiv të parashikimeve të Konventës nga palët.

Kjo Konventë ngre, një mekanizëm specifik monitorimi.

KREU VI

PROVAT KRYESORE NË NJË PROCES PENAL PËR TRAFIKIMIN E QËNIEVE NJERËZORE.

6.1 Provat kryesore në një proces penal për trafikimin e qënieve njerëzore.

Procedimi penal fillon me marrjen dijëni për veprën penale,⁶¹ e cila shërben si bazë për fillimin e hetimeve paraprake. Hetimet paraprake përbëjnë një nga fazat më të rëndësishme të procedimit penal. Gjatë kësaj faze merren provat e nevojshme të cilat shërbejnë për evidentimin e faktit penal të mdodhur, individualizimin e autorëve të kryerjes së veprës penale, dhe marrjen e masave të sigurimit për autorët. Gjatë fazës së hetimeve paraprake kryhen ato veprime hetimore të cilat çmohen të nevojshme nga ana e prokurorit në funksion të vërtetimit të akuzës.⁶²

Zbulimi dhe fiksimi procedural i provave janë dy momente që kanë lidhjetë drejtëpërdrejtë mes tyre. Gjatë procesit hetimor është e nevojshme jo vetëm zbulimi i provave të duhura por dhe fiksimi procedural i tyre. Arrihet në këtë përfundim duke patur parasysh:

Prova merret sipas rregullave procedurale të përcaktuara.

Janë dispozitat procedurale të cilat rregullojnë mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe të gjykimit të veprave penale si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.⁶³

Zbulimi dhe fiksimi i provave është mjaft i rëndësishëm duke qënë se me kalimin e kohës, nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm provat mund të dëmtohen, zhduken apo ndryshojnë.

Për çdo vendimarrje të Gjykatës që konkludon me deklarinimin fajtor të të pandehurit nevojiten provat e mjaftueshme të cilat tregojnë që vepra penale është kryer dhe se kjo vepër penale është kryer nga i pandehuri. Provat mbi të cilat mbështetet akuzat duhet të jenë të ligjshme dhe të marra nga një prej burimeve të përcaktuara në ligj. Një përcaktim i tillë përbën kushtin për vlefshmërinë e tyre. Sa më sipër, faktet që merren nga burime të paparashikuara në ligj dhe të dyshimta nuk kanë vlerën e provës. Organi i akuzës për çdo çështje që ka në hetim dhe për pasojë për çdo person ndaj të cilit ushtrohet ndjekja penale konkludon me njoftim të akuzës, vetëm nëse ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme që tregojnë se cili është autori i veprës penale.

Me të dhënat e mjaftueshme duhet të kuptohet provat e mbledhura nga organi i akuzës.

Prova nuk mund të përdoret nëse ajo është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara në ligj, duke qënë së askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.⁶⁴ Në këtë mënyrë është shumë e rëndësishme kur flitet për provën dhe

⁶¹ Neni 280 i Kodit të Procedurës Penale të RSh-së.

⁶² Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen dhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Neni 148 i Kushtetutës së RSh-së.

⁶³ Respektimi i normave procedurale, neni 2 i Kodit të Procedurës Penale të RSh-së.

⁶⁴ Neni 2 i Kushtetutës së RSh-së.

kuptimin e saj, llojet e saj, mënyrat e marrjes etj, duke bërë që parashikimet procedurale ti kushtojnë rëndësi të posaçme.

Objekt i provave⁶⁵ janë faktet që kanë lidhje me veprën penale, me akuzën që ngreprokuroria, me fajësinë e të pandehurit, me caktimin e masave të sigurimit, dënimit dhe përgjegjësinë civile. Në mënyrë që një fakt të ketë vlerë, duhet të ketë lidhje me çështjen, të ketë dalë nganjeri prej burimeve ligjore, si dhe të jetë marrë sipas rregullave procedurale. Sipas kodit të procedurës penale organet e ngarkuara me marrjen e provave janë prokuroria, policia gjyqësore si edhe gjykata. Kjo e fundit merr provat në seancë me kërkesën e palëve duke përjashtuar ato prova të ndaluara me ligj apo që nuk janë të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Në këtë mënyrë, gjykata arrin që të vërë në jetë edhe një nga parimet më të rëndësishme që është ai i disponimit të provës.

Mbledhja e provave nuk është një fazë e cila bëhet vetëm gjatë hetimeve paraprake pasi vazhdon gjatë gjykimit të çështjes. Nga ana tjetër dhe vetë gjykata ka të drejtën për të disponuar edhe kryesisht në marrjen e provave. Kur flitet për marrjen e provave me kërkesë të palëve në process nuk përjashtohet nga marrja e tyre dhe nga ana e gjykatës, e cila ka të drejtë të marrë provat që i çmon të dobishme për shqyrtimin gjyqësor të çështjes dhe kryesisht. Ndër llojet kryesore të provave të përcaktuara në dispozitat procedurale janë dëshmia, pyetja e të pandehurit dhe e palëve private, ballafaqimet, njohjet, eksperimenti, ekspertimi, provat materiale dhe dokumentat.⁶⁶ Nga ana tjetër pranohet se të dhënat e përfuara nëpërmjet mjeteve të kërkimit të provës, pranohen si prova. Për sa më sipër mundet të përmendim të dhënat e përfuara nga kqyrjet, kontrollet, sekuestrimet, apo përgjimet.

Mundet që gjatë procesit të lindë e nevojshme marrja e një prove e cila nuk rregullohet me ligj, dhe në rastin kur kërkohet marrja e një prove që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marre atë në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cënon lirinë e vullnetit të personit⁶⁷. Si prova të tilla mundet të përmenden filmimet, fotografimet, etj. Për të dhënë një detajim mbi kuptimin e provës referohemi parashikimeve ligjore dhe konkretisht:

Provat janë njoftime mbi fakte dhe rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren nga njeri prej burimeve të përcaktuara në ligjin procedural penal në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjshmërisë së tij.⁶⁸

Që një provë të quhet e vlefshme në procesin penal, ajo duhet detyrimisht të ketë njëkohësisht tre elementët e mëposhtëm;

- Të japë e të pasqyrojë njoftime e të dhëna rreth fakteve dhe rrethanave të kryerjes së një veprë penale të caktuar dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.
- Të merret prej burimeve të njohura e parashikuara nga ligji procedural penal.
- Këto prova duhet detyrimisht që të merren e administrohen sipas rregullave të parashikuara nga ligji procedural në dispozitat të veçanta për secilën provë.

⁶⁵ Neni 150 i Kodit të Procedurës Penale të RSH-së.

⁶⁶ Llojet e provave, Kreu II, Kodi i Procedurës Penale të RSH-së.

⁶⁷ Neni 151/3 i Kodit të Procedurës Penale të RSH-së.

⁶⁸ Neni 149 i Kodit të Procedurës Penale.

Përcaktimi i këtyre elementëve lidhet direct me qëllimin që ka procesi penal në vetvete si dhe respektimin e standarteve demokratike të garantuara nga kushtetuta, nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni në fuqi. Siç e thamë elementi i parë i domosdoshëm që njoftimi të jetë provë në procesin penal është përmbajtja e këtij njoftimi. Është pikërisht përmbajtja e cila përbën objektin e të provuarit. Nëse prova nuk jep njoftime në lidhje me objektin e të provuarit në procesin penal, ajo nuk mund të jetë provë në procesin penal, ndonëse mund të jetë marrë nga burimet ligjore dhe sipas rregullave të përcaktuara nga ligji procedural. Në rastet kur një provë nuk jep njoftime që lidhen me objektin e të provuarit, praktikagjyqësore ka mbajtur qëndrim duke mos e marrë atë në administrim, dhe nëse ajo është marrë e ka konsideruar si provë të papërdorshme për procesin penal, pasi i ka munguar lidhja me objektin e të provuarit. Më konkretisht përmendim:

“si shkresat, dokumentat, ashtu dhe objekte të natyrës materiale për tu paraqitur si shkak për rishikimin e vendimit, duhet të plotësojnë dy kushtë; të kenë dalë pasi vendimi ka marrë formë të prerë dhe të jenë prova në kuptimin që i jep provës ligjvënësi sipas nenit 149 të Kodit të Procedurës Penale.⁶⁹

‘ vërtetimet e paraqitura nga i gjykuari⁷⁰, ku pleqësia e fshatit Peshkëpi është shprehur se i gjykuari ka ardhur të banojë në këtë fshat në qershor 2005, gjenden nga ky Kolegj si tëpapërshtatshme në formatin ligjor për të provuar vendbanimin apo vendqëndrimin e tëgjykuarit,.. aq më pak që këto akte nuk mund të provojnë se i gjykuari ka përdorur apo joElementi i dytë lidhet me detyrimin e marrjes së këtij njoftimi nga burimet e njohuranga ligji procedural penal. Ligji procedural penal ka njohur si burim prove; dëshmitarin, të pandehurin, palët private, eksperimentin, ekspertimin dhe provat materiale e dokumentare.

Çdo njoftim i cili nuk është marrë nga burimet e mësipërme të provës penale penale, pavarësisht vlerës dhe cilësisë tij nuk mund të ketë vlerën e provës në procesin penal. Këtu mund të përmendim të dhënat dhe njoftimet që merren për shkak të veprimtarisë operative nga ana e organeve të policisë, rreth veprës penale dhe autorësisë saj. Këto të dhëna dhe njoftime shërbejnë organit të hetimit që në formën e duhur ligjore të kërkojë provën. Kur njoftimi ndonëse lidhet me objektin e të provuarit nuk është marrë në rrugën e duhur ligjore dhe nga burimet e provave sipas ligjit nuk përbën provë në procesin penal. Në këtë mënyrë nuk përbën provë në procesin penal informacioni i marrë nga policia në rrugë operative. Ky informacion mundet të shërbejë vetëm si akt mbi të cilin fillon procedimi penal por jo provë në kuptim të ligjit, pasi nuk është marrë nga burimet ligjore të njohura nga ligji procedural penal. Praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrim duke mos i konsideruar këto njoftime me vlerën e provës në një proces penal.

Elementi i tretë ka të bëjë me respektimin e kërkesave të ligjit procedural mbi mënyrën e marrjes së njoftimit, të provës nga ana e subjekteve procedurale. “Posaçërisht Gjykata Kushtetuese është shprehur se, në nenin 32/2 të Kushtetutës të R. Shqipërisë parashikohet se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në dispozitat e titullit IV të K.Pr.Penale, përcaktohen rregullat e përgjithshme të

⁶⁹ Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr 6/2002.

⁷⁰ Vendim i Gjykatës së Lartë. 2008

marrjes së provave penale sipas llojit tyre, ndërsa për marrjen e tyre gjatë gjykimit të çështjes janë bërë parashikimet e seksionit III të Titullit VII të këtij Kodi. “Mënyra e marrjes provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Praktika gjyqësore gjyqësore në mjaft raste është ndeshur me kërkesën e palëve për administrimin në cilësinë e provës të deklaratave noteriale, deklarimeve të bëra nga subjekte procedurale apo persona të ndryshëm para noterit, deklarime këto në lidhje me objektin e të provuarit në procesin penal. Ligjvënësi në parashikimet e nenit 149 të K.Pr.Penale nuk e ka konsideruar deklaratën noteriale në cilësinë e provës në procesin penal. E themi këtë pasi thëniet e dëshmitarëve, të pandehurve, dëmtuarve apo personave të tjerë merren dhe administrohen nga ana e organeve proçeduese dhe jo nga subjekte të tjera të cilat ligji proçedural nuk i ka njohur si të tillë. Në këtë rast deklaratës noteriale i mungon elementi (itretë) i domosdoshëm, ai i marrjes dhe administrimit në formën dhe mënyrën e kërkuar nga ligji proçedural. Në rastin konkret deklarimi, kallëzimi, thëniet e të pandehurit, palëve private etj. nuk janë marrë nga policia gjyqësore apo prokurori (në hetim) apo nga gjykata në gjykimin e çështjes, në formën e kërkuar nga ligji dhe në respektim të kërkesave të tij.

Sidomos në rastet e trafikimit të qënieve njerëzore depozitimi para gjykatës i deklaratës noteriale në të cilën e dëmtuara ka ndryshuar tërësisht thëniet e saj, në raport me ato të dhëna gjatë fazës së hetimeve paraprake përbën një dëmtim të procesit penal. Por pa hyrë në analizë të përmbajtjes së deklaratës noteriale, gjykata nuk duhet të pranojë marrjen e saj si provë në procesin penal duke qënë se është një provë e cila nuk ka formën e duhur ligjore.

Të njëjtin qëndrim kanë mbajtur dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në një çështje me objekt rishikimin e vendimit gjyqësor të formës prerë, në lidhje me vlerën e deklaratave noteriale ka arsyetuar se

“...tre deklaratat noteriale nga pikëpamja e formës proçedurale të marrjes tyre, nuk janë prova në kuptimin që i jep provës penale ligjvënësi. Fakti që tre deklaratimet janë redaktuar nga ana e noterit nuk sjell asnjë ndryshim, pasi deklaratimet e bëra para noterit nuk u japin atyre cilësinë e provës në kuptimin e nenit 149 të K.Pr.Penale.

Duhet thënë se pavarësisht se përmbajtja e deklaratës noteriale ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e të provuarit dhe kjo deklaratë është marrë nga burime të ligjshme të njohura nga ligji si të tilla (dëshmitari, deklaruesi i dëmtuari) ato nuk mund të kenë cilësinë e provës në procesin penal pasi janë marrë dhe administruar jo në formën dhe mënyrën e kërkuar nga ligji. Në vazhdimësi këtë qëndrim ka mbajtur edhe praktika gjyqësore dhe konkretisht; “me të drejtë gjykatat nuk kanë pranuar si provë deklaratën noteriale të të dëmtuarës, jo vetëm për faktin se ajo vjen ndesh me sa e dëmtuara ka pranuar në kallëzim dhe në deklaratimet e dhëna, por deklarata noteriale nuk përbën provë, pasi sipas nenit 151 të K.Pr.Penale, provat gjatë hetimeve paraprake merren nga organi që proçedon dhe në gjykim merren nga gjykata mbi kërkesën e palëve apo dhe kryesisht.

Sipas rregullave procedurale verifikimi dhe vlerësimi i provës bëhet gjatë shqyrtimit gjyqësor, i cili bazohet në parimin e kontradiktoritetit.

Por mund të ndodhë që të dhënat për veprën penale, për shkak të natyrës së tyre mund të dëmtohen, humbasin⁷¹.

Në një proces hetimi apo gjykimi që lidhet me trafikimin e qënieve njerëzore secila provë ka vlerën e saj, por ndër më kryesoret mundet të rendisim:

- Dëshmia si provë në proces, ku evidentojmë dëshminë e të dëmtuarës nga vepra penale. Dëshmia e të dëmtuarës është dëshmi direkte duke qënë se e dëmtuara gjatë pyetjes që përbëjnë objekt prove ka dijeni në mënyrë direkte për ato çfarë kanë ndodhur.
- Dëshmitë e marra nga persona që kanë dijeni për veprën penale duke qënë se kanë qënë të pranishëm ose kanë ardhur në dijeni nga persona të tjerë për faktet e ndodhura. Dëshmia e tyre mundet të jetë direkte ose indirekte. Përcaktohet se dëshmia është indirekte në rastet kur ata tregojnë rrethana të cilat i kanë mësuar nga persona të tjerë.
- Pyetja e të pandehurit duke qënë se është personi i përfshirë direkt në veprimtari dhe jep detaje për rrethanat e deklaruara nga viktimi e trafikimit. Edhe i pandehuri apo i bashkëpandehuri në një procedim të lidhur mundet të tregojnë rrethana të dobishme duke nxjerrë në pah elementë që lidhen me ngjarjen e ndodhur dhe mënyrën e ndodhjes së saj.

Dëshmitari⁷² pyetet për faktet që përbëjnë objekt prove. Ai nuk mund të dëshmojë për qëndrimin moral të të pandehurit, përveçse kur çështja lidhet me fakte që vlejnë për përcaktimin e personalitetit të tij në lidhje me veprën penale dhe me rrezikshmërinë shoqërore.

Në rastin e trafikimit të qëieve njerëzore është e nevojshme, sidomos gjatë pyetjes së të dëmtuarës të nxirret në pah dhe qëndrimi emocional i mbajtur nga i pandehuri. Në një rast të tillë dëshmitari nuk mundet të shmanget pa përmendur dhe qëndrimin moral të të pandehurit.

Pyetja e dëshmitarit⁷³ mund të shtrihet edhe në marrëdhëniet e farefisnisë dhe të interesave që ekzistojnë ndërmjet dëshmitarit dhe palëve apo dëshmitarëve të tjerë, si dhe mbi rrethanat, vërtetimi i të cilave është i nevojshëm për vlerësimin e besueshmërisë së tij. Dëshmia mbi faktet që shërbejnë për të përcaktuar personalitetin e të dëmtuarit nga vepra penale pranohet vetëm kur akuza e të pandehurit duhet të çmohet në raport me sjelljen e të dëmtuarit. Dëshmitari pyetet për fakte të caktuara. Ai nuk mund të dëshmojë për çka flitet në publik dhe as të shprehë vlerësime personale, me përjashtim të rasteve kur ato nuk mund të ndahen nga dëshmia për faktet.

Kur dëshmitari⁷⁴, për njohjen e fakteve, u referohet personave të tjerë, gjykata, me kërkesën e palës ose edhe kryesisht urdhëron që këta të thirren për të dëshmuar.

Mosrespektimi i dispozitës së paragrafit 1 i bën të papërdorshme thëniet mbi faktet, të cilat dëshmitari i ka mësuar nga persona të tjerë, me përjashtim të rasteve kur pyetja e tyre është e pamundur për shkak se kanë vdekur, janë të sëmurë rëndë ose nuk gjenden. Dëshmitari nuk mund të pyetet për fakte që i ka mësuar nga personat që janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional ose shtetëror, me përjashtim të rasteve kur këta persona kanë deklaruar për të njëjtat fakte ose i kanë përhapur ato me ndonjë mënyrë tjetër. Nuk mund të përdoret dëshmia e atij që refuzon ose që nuk është në gjendje të tregojë personin ose burimin nga të cilët ka marrë dijeni

⁷¹Komentari i Kodit të Procedurës Penale, Islami H, Hoxha A, Panda I, Tiranë 2003, fq 212.

⁷²Neni 153 i Kodit të Procedurës Penale.

⁷³.neni 153/2 i Kodit të Procedurës Penale.

⁷⁴Dëshmia indirekte, neni 154 i Kodit të Procedurës Penale.

për faktet që pyetet. Çdo person ka zotësi për të dëshmuar,⁷⁵ me përjashtim të atyre që për shkak të të metave mendore ose fizike nuk janë në gjendje të dëshmojnë. Kur për vlerësimin e thënieve është i nevojshëm verifikimi i aftësive fizike ose mendore për të bërë dëshmi, gjykata edhe kryesisht mund të urdhërojë verifikimet përkatëse.

Sidomos në rastet e trafikimit të qëieve njerëzore për shkak të situatës problematike që kalojnë viktimat e trafikimit gjatë jetesës së tyre ngrihen pretendime në lidhje me përgjegjshmërinë e tyre mendore e për pasojë dhe pretendime për vërtetësinë, rregullsinë e thënieve të viktimave të trafikimit. Në një proces penal nuk mund të pyeten si dëshmitarë:

a) personat që, për shkak të metash fizike ose psikike, nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt;

b) të pandehurit në një vepër penale të përbashkët ose në një procedim të lidhur edhe kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të çështjes, i pafajësisë ose i dënimit, me përjashtim të rasteve kur vendimi i pafajësisë ka marrë formë të prerë;

c) ata që në të njëjtin procedim kryejnë ose kanë kryer funksionin e gjyqtarit ose të prokurorit; ç) i padituri civil.

Dëshmitari është i detyruar të paraqitet në gjykatë⁷⁶, t'u përmbahet urdhrave të saj dhe t'u përgjigjet me vërtetësi pyetjeve që i bëhen. Dëshmitari nuk mund të detyrohet të dëshmojë për fakte, nga të cilat mund të lindte përgjegjësia penale për të.

Në një proces gjyqësor penal nuk janë të detyruar të dëshmojnë:

a) gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit, sipas përcaktimeve të nenit 16, me përjashtim të rasteve kur kanë bërë kallëzim ose ankim ose kur ata apo një i afërm i tyre janë të dëmtuar nga vepra penale,

b) bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore,

c) bashkëshorti i ndarë nga i pandehuri,

ç) ai që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të,

d) ai që është i lidhur me të pandehurin me marrëdhënie birësimi.

Gjykata u bën të njohur personave të mësipërm të drejtën për të mos dëshmuar dhe i pyet ata nëse duan të përfitojnë nga kjo e drejtë. Mosrespektimi i këtij rregulli e bën të pavlefshme dëshminë. Dëshmitari është i detyruar të paraqitet në Gjykatë për të dëshmuar, në rast se ka njoftim të rregullt për datën dhe orën e seancës gjyqësore. Kur dëshmitari, i thirrur rregullisht, nuk paraqitet në vendin, ditën dhe orën e caktuar, pa patur pengesa të ligjshme, gjykata mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm. Personi i shoqëruar me detyrim nuk mund të mbahet në dispozicion tej kohës së nevojshme për praninë e tij dhe sidoqoftë jo më shumë se njëzet e katër orë. Përgjegjësia për dëshmi të rreme ose refuzim për të dëshmuar Kur gjatë pyetjes dëshmitari bën thënie kontradiktore, jo të plota ose që janë në kundërshtim me provat e marra, gjykata ia vë në dukje duke e paralajmëruar për dëshmi të rreme. Të njëjtin paralajmërim i bën edhe dëshmitarit që pa të drejtë nuk pranon të dëshmojë. Kur dëshmitari ngul këmbë në mospranimin

⁷⁵Zotësia për të dëshmuar, neni 155 i Kodit të Procedurës Penale.

⁷⁶Neni 157 i Kodit të Procedurës Penale.

për të dëshmuarose kur del se dëshmitari bën dëshmi të rreme, gjykata i kërkon prokurorit që të procedojë sipas ligjit.

Taktika e marrjes në pyetje te dëshmitarit

Pyetja është veprimi hetimor⁷⁷ dhe gjyqësor me anë të të cilit organi procedues merr drejtëpërsëdrejti thënie që kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes nga i dëmtuari, kallëzuesi, i pandehuri etj. Këto thënie janë rezultat i një procesi të ndërlikuar psikologjik. Formimi i këtyre thënieve kalon tre faza dhe konkretisht:

- Perceprimi,
- Kujtesa,
- Riprodhimi.

Perceptimi është procesi psiqik me anë të të cilit pasqyrohet vetëdija mbi sendin, objektin dhe dukurinë në tërësi. Kujtesa përbëhet nga një tërësi procesesh sit ë mbajturit mend, ruajtja, njohja dhe të riprodhuarit. Riprodhimi është procesi i pasqyrimin të thënieve të para apo të dëgjuara.

Te tre këto procese paraqesin rëndësi në veprat penale që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore.

Një tjetër provë në procesin penal janë dhe ballafaqimet të cilat në rastin e trafikimit të qënieve njerëzore paraqesin rëndësi duke qënë se e dëmtuara vihet përballë të pandehurit duke konfirmuar variantin e saj dhe merr kështu dijeni me atë çfarë do të përballët në shqyrtimin gjyqësor të çështjes. Ballafaqimi⁷⁸, lejohet vetëm ndërmjet personave që janë pyetur, kur ka mos përputhje midis tyre për fakte dhe rrethana të caktuara. Organi procedues, pasi u kujton deklaratimet e mëparshme personave që do të ballafaqohen, i pyet nëse i konfirmojnë ose i ndryshojnë ato, duke i ftuar, kur lind nevoja, për të bërë kundërshtimet reciproke. Në procesverbal shënohen pyetjet e bëra nga organi procedues, deklaratimet e bëra nga personat e ballafaquar dhe gjithçka tjetër që ka ndodhur gjatë ballafaqimit.

Kur lind nevoja për të proceduar në njohjen e një personi,⁷⁹ organi procedues fton atë që duhet të bëjë njohjen që të përshkruajë personin duke treguar të gjitha shenjat që mban mend dhe e pyet nëse ka qenë thirrur më parë për të bërë njohjen si dhe për rrethana të tjera që mund të ndikojnë në vërtetësinë e njohjes. Në procesverbal shënohen veprimet që kryhen dhe deklaratimet e bëra nga personi që bën njohjen.

Pasi largon atë që duhet të bëjë njohjen, organi procedues siguron praninë e të paktën dy personave sa më të ngjashëm me atë që duhet të njihet. E fton këtë të fundit të zgjedhë vendin e tij në raport me të tjerët duke u kujdesur që të paraqitet, sa të jetë e mundur, në të njëjtat kushte në të cilat do të kishte qenë parë nga personi i thirrur për njohje. Pasi paraqitet personi që do të bëjë njohjen gjykata e pyet nëse njeh ndonjërin nga ata që i paraqiten për njohje dhe, në rast se po, e fton të tregojë se cilin njeh dhe ta saktësojë nëse është i sigurt. Kur ka arsye të mendohet se personi i thirrur për të bërë njohjen mund të frikësohet ose të ketë ndikime të tjera nga prania e personit që duhet njohur, organi procedues urdhëron që veprimi të kryhet pa e parë ky i fundit të parin. Në procesverbal shënohen, me pasojë pavlefshmërie, mënyra e zhvillimit të njohjes. Organi procedues mund të urdhërojë që zhvillimi i njohjes të dokumentohet edhe me fotografime ose filmime.

⁷⁷Begeja, S. Kriminalistika, vëllimi II, Tiranë 2011,

⁷⁸Neni 169 i Kodit të Procedurës Penale.

⁷⁹Neni 171 i Kodit të Procedurës Penale.

Kur duhet proceduar në njohjen e provave materiale ose të sendeve të tjera që lidhen me veprën penale, organi procedues vepron duke respektuar rregullat për njohjen e personave, për aq sa mund të zbatohen. Pasi gjenden, kur është e mundur, të paktën dy objekte të ngjashme me atë që duhet njohur, organi procedues e pyet personin e thirrur për njohje nëse njeh ndonjërin prej tyre dhe, në rast se po, e fton të deklarojë se cilin ka njohur dhe ta saktësojë nëse është i sigurt. Në procesverbal shënohen, me pasojë pavlefshmërie, mënyra e zhvillimit të njohjes. Në rastet e trafikimit të qënieve njerëzore njohja e personit apo dhe njohja me fotografi janë mjaft të përhapura duke qënë se e dëmtuara shpesh nuk ka dijeni për emrat e personave që kanë qëndruar me të. Madje mundet të ndodhë të mos ketë dijeni dhe për emrat e personave që e kanë trafikuar duke qënë se personat prezantohen me emra të rremë, të sajuar dhe të pavërtetë. Gjatë këtyre procesve provë e rëndësishme janë dhe ekspertimet.

Ekspertimi,⁸⁰ lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore. Nuk lejohen ekspertimet për të përcaktuar profesionizmin në veprën penale, prirjet kriminale, karakterin dhe personalitetin e të pandehurit dhe në përgjithësi cilësitë psikike që nuk varen nga shkaqet patologjike. Caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse. Kur ekspertimi shpallet i pavlefshëm ose duhet të bëhet ekspertim i ri, organi procedues merr masa, kur është e mundur, që detyra e re t'i besohet një eksperti tjetër. Vendimi i organit procedues për caktimin e ekspertit i njoftohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij, duke i bërë të ditur se ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit, të propozojë ekspertë të tjerë, të marrë pjesë vetë në ekspertim, kur është e mundur, dhe të parashtrijë pyetje për ekspertin. Kur kërkimet dhe vlerësimet paraqiten shumë komplekse ose kërkojnë njohuri të ndryshme në disa degë, organi procedues ua ngarkon kryerjen e ekspertimit disa ekspertëve. Eksperti është i detyruar të kryejë detyrën e tij, me përjashtim të rasteve kur ekziston një nga shkaqet që e përjashtojnë atë nga qenia ekspert ose kur pretendon se nuk është kompetent ose nuk ka mundësitë kryejë ekspertimin dhe kërkesa e tij pranohet nga organi procedues.

Ka një sërë rastesh të papajtueshmërisë me detyrën e ekspertit:
nuk mund të kryejë detyrën e ekspertit:

- a) i mituri, ai që ka ndalim ligjor ose i është hequr zotësia juridike për të vepruar ose vuan nga një sëmundje mendore;
- b) ai që është pezulluar, qoftë edhe përkohësisht, nga detyrat publike ose nga ushtrimi i një profesioni;
- c) ai, ndaj të cilit janë marrë masa sigurimi personal;
- ç) ai që nuk mund të pyetet dëshmitar apo të merret përkthyesose që ka të drejtë të mos bëjë dëshmi ose përkthim.

Palët mund të kërkojnë përjashtimin e ekspertit në rastet e parashikuara dhe për përjashtimin e gjyqtarit. Kur ekziston një shkak përjashtimi, eksperti është i detyruar

⁸⁰Neni 178 e vijues i Kodit të Procedurës Penale.

ta deklarojë. Deklarimi i shkakut të përjashtimit nga vetë eksperti ose kërkimi i përjashtimit nga palët mund të paraqiten derisa të mos jetë bërë caktimi i detyrës dhe, kur shkaqet kanë lindur aty për aty ose janë njohur më pas, para se eksperti të ketë dhënë mendimin e tij. Mbi deklarin e ekspertit për përjashtim ose të kërkesës përpërjashtimin e tij vendos, me urdhër, organi procedues që ka caktuar ekspertimin. Në disa raste lind e nevojshme kryerja e ekspertimit biologjik, sidomos kur viktimat e trafikimit pretendon të ketë fëmijë si rezultat i bashkëjetesës me të pandehurin.

6.2 Sigurimi provës në procesin penal

Sigurimi i provës në vetvete përfaqëson mundësinë procedurale për të marrë një provë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Një ndër arsytet e lejimit të sigurimit të provës është dhe krijimi i mundësisë që të merret një provë e cila rrisht rrezikun që të mos merret në të ardhmen për arsye të ndryshme. Prova merret nga gjykata por me kërkesën e prokurorit, të pandehurit apo të dëmtuarit akuzues. Gjykata duhet të bëjë vlerësimin e kërkesës së paraqitur nëse ajo është në përputhje me kërkesat e ligjit procedural dhe vetëm pas kësaj vendos në lidhje me pranueshmërinë ose jo të saj. Megjithatë fakti që gjyqtari bën një ndërhyrje të tillë gjatë hetimeve paraprake nuk i jep atij në këtë mënyrë një rol drejtues apo administrues të hetimit pasi ai thjesht vihet në lëvizje vetëm me kërkesën e palëve. Gjykatësi nuk ka fuqi në kërkimin e provës, ato mbeten sërish në duart e prokurorit, i cili bën administrimin e tyre në fashikullin e gjykimit. Në këtë mënyrë nuk çenohet parimi i pavarësisë institucionale. Sigurimi i provës duhet të bëhet vetëm në rastet e përcaktuara në mënyrë taksative ngaligji dhe gjykatësi duhet të jetë në rolin e ruajtësit të ligjit dhe të parimit të kontradiktoritetit. Ai duhet të marrë masa që ky institut të mos kalojë kufijtë ligjor. Ky institut nuk i ka shpëtuar edhe debateve përsa i përket marrëdhënies prokurori – gjykatë.

Në literaturën italiane është pretenduar se gjyqtari duke ndërhyrë në këtë mënyrë në hetime mund të çenonte pavarësinë e këtij institucioni dhe se prokurori duke kërkuar formimin e provës që në këtë fazë të procedimit, kjo do të zbehte në një fare mënyre rolin e debatit në seancën gjyqësore. Pra nuk do të kishim një seancë të mirëfilltë ku formimi i provës do t'i nënshtrohej debatit. Mirëpo një argument i tillë nuk qëndron, pasi gjykata vihet në lëvizje vetëm me kërkesën e palëve, të cilët me anë të kërkesave të tyre përcaktojnë fare qartë kufijtë objektiv dhe subjektiv të këtij instituti. Sigurimi i provës paraqet këto veçori:

- Mundet të realizohet me kërkesë të palëve,
- Prova që kërkohet të merret nuk merret dot në një periudhë të mëvonshme,
- Respektohet afatet kohore të përcaktuara,

Pra sigurimi i provës paraqitet si një mjet që zbatohet në mënyrë përjashtimore vetëm kur mund të provohet rëndësia e formimit të provës para se çështja të ketë shkuar në gjykatë.

RASTET E SIGURIMIT TË PROVËS

Rastet e sigurimit të provës janë parashikuar në Nenin 316 të kodit të procedurës penale dhe janë:

- a) Marrja e dëshmisë nga një person, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ai nuk mund të pyetet për shkak sëmundje apo pengese tjetër serioze.
- b) Marrja e dëshmisë kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune, kanosje apo premtimi për të dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi apo të bëjë dëshmi të gënjeshtërt.
- c) Pyetja e të pandehurit për fakte që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e të tjerëve, kur ekzistojnë shkaqet e përmendura më lart.
- d) Ballafaqimi i personave që para prokurorit kanë bërë deklarime kundërthënëse, kur ekzistojnë shkaqet e përmendura në gërmat “a” dhe “b”.
- e) Ekspertimi apo eksperimenti kur ato lidhen me persona, sende a vende, gjëndja e të cilave mund të pësojë ndryshime të pashmangshme.
- f) Njohja e personave apo e sendeve kur për arsye të vecanta nuk mund të shtyhet veprimi i njohjes deri në procesin gjyqësor.

Pjesa më e madhe e këtyre rasteve, përfshihen në kategorinë e atyre veprimeve që nuk mund të shtyhen deri në procesin gjyqësor, ndërsa të tjerët hyjne në veprimet e papërsëritshme si psh:

- marrja e dëshmise së një personi të sëmurë rëndë,
- apo kur ka pengesa serioze për tu paraqitur në séancë gjyqësore, si dhe ekspertimi dhe eksperimenti në lidhje me objekte apo vende të cilët mund t’i nënshtrohen në mënyrë të pashmangshme ndryshimeve.

Termi veprime që nuk mund të shtyhen deri në procesin gjyqësor është parashikuar në kod. Përmes qartësisimit të kufijve brenda të cilëve mund të gjejë aplikim instituti i sigurimit të provës, ligji ka dashur që t’i ofrojë gjykatësit parametrat e saktë mbi bazën e të cilëve të verifikojë dhe vlerësojë rastin konkret që i paraqitet nëse ai përfshihet në kërkesat e Nenit 316 të kodit të procedurës penale.

Në rastin e dëshmisë disa nga kushtet për të janë të vlefshme edhe për disa akte të tjera

2. a) Marrja e dëshmisë nga një person, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ai nuk mund të pyetet për shkak sëmundje apo pengese tjetër serioze.

Në këtë rast bëhet fjalë për ata persona të cilët janë dëmtuar nga vepra penale, jeta e tyre është në rrezik, për ata persona të cilët janë të moshuar, ç’ka i pengon ata të paraqiten në seancë apo kur për të njëjtët persona ekziston frika se me kalimin e kohës ata mund të vdesin duke mos deklaruar atë që dinë për veprën penale apo edhe të humbasin kujtesën.

Në kodin e procedurës penale nuk ka një përcaktim të saktë të termit “pengesë serioze” dhe si do të vlerësoje gjykata një rast të tillë, çka ndoshta mund ta kthente një situatë edhe në abuzive. Përmendëm pak më lart se në një sëmundje jo vetëm duhet të jetë e dukshme por edhe të vërtetohet nga mjekë specialiste, cka e lehtëson disi punën e gjykatës, por rasti i “pengesës serioze” nuk ka gjetur një formulim në legjisllacionin tonë, por vlerësohet rast pas rasti.

KREU VII

PROBLEME TEORIKE DHE PRAKTIKE GJATË GJYKIMIT DHE HETIMIT TË ÇËSHTJEVE QË LIDHEN ME TRAFIKIMIN E QËNIEVE NJERËZORE

7.1 Ndjekja penale dhe trafikimi i qenieve njerëzore

Në çdo fazë të veprimtarisë hetimore sidomos në çështjet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore hasim si elementë të spikatur sa më poshtë;

Së pari

Momenti që lidhet me identifikimin e veprimtarisë kriminale.

Së dyti

Momenti që lidhet me identifikimin e viktimës së trafikimit.

Së treti

Momenti që lidhet me identifikimin e autorit apo autorëve të përfshirë në veprimtarinë e trafikimit.

Fillimisht na duhet të përgatisim planin hetimor në sajë të të cilit të percaktohen veprimet që do të kryhen, në lidhje me fillimin e veprimtarisë hetimore që nga fillimi i çështjes dhe me rëndësinë e të pasurit një mendësi të qartë dhe të përcaktuar saktë mbi metodologjinë e hetimit. Fillimisht marrim të dhëna të cilat ndikojnë në mbledhjen e informacionit me qëllim që të përcaktohet nëse ndodhemi apo jo para një veprimtarie kriminale, nëse ka viktima kjo veprimtari dhe nëse janë bashkëpunuese apo jo këto viktima.

Plani hetimor çon dhe në dhënien e zgjidhjes për probleme të tilla si:

A duhet regjistruar çështja penale për të filluar veprimtarinë hetimore.

Si duhet trajtuar çështja penale pas regjistrimit të saj,

Përcaktimi i grupit të hetimit dhe ndarja e veprimeve konkrete që do të kryhen.

Qëllimi kryesor i hetimit është zbulimi i veprimtarisë së kundraligjshme, ndaj dhe plani hetimor organizohet në mënyrë të tillë që të:

të mundësojnë të dhëna të sakta, të bazuara në prova për veprimtarinë, autorin dhe identifikimin e viktimës së trafikimit,

të mundësojë gjetjen e provave shkresore,

të sigurojë emrat e personave që kanë dijeni për rrethanat e çështjes të cilët me dëshminë e tyre i japin zgjidhje asaj,

të sigurojë dëshminë e viktimës së trafikimit.

Duhet të siguroheni se argumentimi i secilit vendim të marrë nga ana jonë është i dokumentuar mjaftueshëm, pra që procesi lidhur me vendimin mund ti rezistojë çdo lloj procesi gjyqësor.

Një plan hetimor duhet të përmbajë:

Metodologjinë e përdorur për planin,

Veprimet konkrete të kryera nga secili.

Pse është e rëndësishme të kemi një fillim të mbarë dhe të dokumentuar siç duhet.

Profesionalizimi i çdo hetimi të rëndësishëm, apo çështjeje procedurale, matet me cilësinë e produktit të nxjerrë.

Ndaj dhe faza e parë e fillimit të hetimit përfshin objektiva si më poshtë:

Strategjike – ato vendime rreth qëllimit, se çfarë do të arrihet me anë të hetimit, ose

Taktike – ato vendime ky fokusi i hetimit mund të zhvendoset ose targetet mund të ndryshojnë.

Gjatë procesit hetimor duhet të mendojmë me kujdes rreth:

se cili do të jetë rezultati pas vendimit të ndërmarrë,

se si vendimi është në përputhje me provat e mbledhura gjatë hetimit,

Gjatë hetimit duhet të kemi kujdes mënyrën e trajtimit të viktimës së trafikimit:

krijimin e besimit,

trajtimin me dinjitet,

sigurimin e mbrojtjes nëse e ka të nevojshme.

Në titullin VI të kreut II, nenet 280 e vijues të Kodit të Proçedurës Penale parashikohet “Marrja dijani për veprën penale” – Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e tyre dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët. Rastet më të shumta të fillimit të ndjekjes penale për veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore fillojnë si çështje në bazë të kallëzimit të bërë nga shtetasit sipas parashikimeve të nenit 283 të Kodit të Proçedurës Penale.

Në rang të kallëzimeve të bëra nga shtetasit për këto vepra penale, do të evidentojmë si kallëzues sa më poshtë:

- kallëzimi i bërë nga e dëmtuara,

- kallëzimi i bërë nga familjarët e të dëmtuarës,

- kallëzimi i bërë nga persona të tjerë.

Ne rastin e parë kur kallëzuese është vetë e dëmtuara nga vepra penale, orientohemi direkt në marrjen në pyetje të të dëmtuarës, duke u munduar për të realizuar një pyetje sa më të detajuar në mënyrë që të marrim sa më shumë informacion mbi veprën e kryer, personat e përfshirë, si dhe provat për identifikimin e veprës dhe të autorëve.

Vepra penale e trafikimit është vendosur për herë të parë në Kodin Penal në vitin 2001 dhe me pas me ndryshimet e ndodhura në vite si në 2004 dhe ndryshimet e fundit të kryera në 2013, japin kuptimin e figurave të veprave penale në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore.

Marrja në pyetje e të dëmtuarës gjatë fazës së hetimeve paraprake bëhet duke kordinuar këta elemente:

- synimi i organit hetimor për të marrë sa më shumë informacion dhe detaje provuese për veprën dhe autorin,

- vendosja e një kontakti të drejtëpërdrejtë me të dëmtuarën në mënyrë që asaj/atij ti krijohet “besimi”, për ndjekjen e drejtë të çështjes,
 - krijimi i kushteve të pershtatshme për marrjen në pyetje,
- Marrja në pyetje si proces bazohet në synimin për të nxjerrë në pah:

Elementët bazë të trafikimit:

Zbulimin e rekrutimit të personit që do të shfrytëzohet;

Elementet që lidhen me zhvendosjen e personit nga një vend në tjetrin; kalimin e kufirit shtetëror apo të disa kufijve shtetërorë;

Elementet që lidhen me shfrytëzimin – pas mbërritjes në destinacionin e fundit viktimat e trafikuar i nënshtrohet shfrytëzimit, duke iu nënshtuar një sërë mekanizmash detyrues që nga përdorimi apo kërcënimet për përdorimin e dhunës deri në shfrytëzimin e pozicionit të dobët ekonomikisht të viktimës dhe izolimit të saj.

Dëshmia e “të dëmtuarit” ose e “viktimës” ka rëndësi të veçantë dhe konsiderohet prova kyçe në një proces penal.

Gjatë marrjes në pyetje të të dëmtuarës (shprehemi në këtë mënyrë duke qenë se në shumicën e rasteve, viktimat në proces është femër), kemi parasysh faktin se përveç interesit tonë parësor që të zbulojmë sa më shumë elemente provues për veprën dhe autorët, të realizojmë një trajtim të mirë për të dëmtuarën, duke i krijuar ambientin e duhur dhe situatën e favorshme për të deklaruar.

Nisur nga fakti se viktimat janë në një gjendje jo shumë të mirë nga pikepamja psikologjike, edhe metodologjia për marrjen në pyetje është në përshtatshmëri me psikologjinë e saj.

Kjo realizohet jo vetëm në funksion të trajtimit sa më të mirë të personit që merret në pyetje por dhe për faktin se dhe ne si organ hetimor kemi më tepër rezultat në hetim, duke qenë se viktimat duke u ndjerë mirë, ka më tepër mundësi të realizojë një variant të detajuar duke specifikuar detajet e ngjarjes së ndodhur.

Në një proces hetimi për veprat penale në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore është e nevojshme kryerja e veprimeve të ndryshme hetimore në sajë të të cilave kemi mundësinë e sigurimit të provave.

Në funksion të këtij hetimi është dhe marrja në pyetje e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit dhe konkretisht:

- Deklarimet e dhëna nga vetë e dëmtuara,
- Deklarimet e dhëna nga familjarët,
- Deklarimet e dhëna nga persona të tjerë.

Në rastin më të mirë ne arrijmë të sigurojmë të dhëna të mjaftueshme në funksion të mbledhjes së provave për një çështje trafikimi në rastet kur kallëzueset është vetë e dëmtuara ose viktimat e trafikimit.

Në rastin kur kallëzuesi është vetë viktimat e trafikimit, rastet praktike kanë nxjerrë në pah se hetimi është më i lehtë për tu kryer. Shprehemi në këtë mënyrë duke qenë se e dëmtuara përfaqëson personin direkt që është cënuar nga vepra penale dhe që ka dijeni të drejtëpërdrejtë për rrethanat e ngjarjes së ndodhur.

Është detyrë primare mbrojtja e viktimës (interesi më i lartë i të miturit);

Hetimi duhet të ketë si qëllim grumbullimin e provave duke minimizuar rrezikun e dëmtimit të viktimës dhe personave të tjerë;

Hetimi është efektiv nëse përdoren metodat e hetimit dhe teknikat e posaçme;

Prokurori/OPGJ duhet të vlerësojnë në çdo rast të hetimit të TQNJ aplikimin e të gjitha mënyrave të kërkimit të provës në mbështetje të ligjit;

Intervistimi i personave viktimë të trafikimit është një proces që kërkon durim dhe profesionalizëm.

Synohet të përshtatet një procedurë e sigurtë dhe etike.

Bazuar në përvojën e deritanishme numri më i madh i viktimave të trafikimit janë të seksit femër.

Akomodimi i viktimës në strehëza (prioritet mirëqenia e viktimës);

Ndihma psikologjike, financiare, rehabilitim;

Intervistimi (në një dhomë konfidenciale, ku persona të tjerë nuk janë të përfshirë, nuk hyjnë ose dalin persona të tjerë) – kontakti me prokurorin dhe OPGJ;

Konsultat e vazhdueshme me prokurorin dhe OPGJ për ecurinë e procesit, për problematikat e tij duke i dhënë siguri viktimës se çështja e saj po hetohet/gjykohet në mënyrën e duhur.

Faza e parë e Intervistimit:

a) Hyrja

Që viktimë të ndjehet rehat, vihet në dijeni paraprakisht se kush do ta intervistojë dhe pse ndodhet në vendin ku po kryhet intervista.

b) Konfidencialitetit

I shpjegohet viktimës arsye përse po intervistohet dhe si do të veprohet me informacionin që do të merret nga viktimë.

c) Vendosja e raportit

Vendosja e raportit të besimit;

Viktimës i shpjegohet se nuk ka kryer asgjë të keqe;

Faza e dytë e intervistimit:

a) Pyetjet e hapura – për sqarimin e plotë të historisë

b) Pyetje specifike – “Çfarë” “Ku”, “Kur”, “Pse”, “Si”, “Kush” me anë të të cilave mund të merren më shumë detaje.

Faza e mbylljes së intervistës:

Viktimës i shpjegohet se nëse ka diçka tjetër për të shtuar apo për të korrigjuar.

Fundi i intervistës duhet të sigurojë që viktimë të largohet me një ndjenjë sigurie dhe mbështetje gjatë procesit të hetimit.

Kushtet e vendosjes në mbrojtje:

dhënia e dëshmisë për fakte e rrethana që përbëjnë provë në një procedim penal;

për shkak të dëshmisë, dëshmitari ndodhet në gjendje rreziku;

gjendja e rrezikut duhet të jetë aktuale, konkrete dhe serioze;

për shkak të së cilës jeta e shëndeti i dëshmitarit apo personit të lidhur me të janë në rrezik;

dëshmia duhet të jetë për vepra penale jo më pak se 4 vjet në minimum;

dëshmitari duhet të pranojë me vullnet të lirë se pranon programin e mbrojtjes dhe të marrë pjesë aktivisht në zbatimin e tij;
dëshmitari duhet të pranojë të japë dëshmi të plotë, pa kushte dhe rezerva të japë të dhëna të bazuara që përbëjnë prova vendimtare për zbulimin e krimeve dhe autorëve të tyre;

Rast praktik

Rrethanat e faktit :

Në dt. 19 qershor 2010 deportohet nga Greqia viktima M.B, 17 vjeç, 8-klasë, banuese në fshatin Zaloshnjë.

Viktima M.B kallëzon në polici:

Në maj 2010 viktima njihet me shtetasin Valter.

Në dt.18 maj 2010 viktima largohet nga shtëpia pa dijeninë e prindërve.

Valteri e prezanton me shokun e tij të pandehurin Ermal.C.

Viktima, Valteri dhe Ermali me të dashurën e tij Antuelën me makinën e Ermalit shkojnë në Durrës.

Ndërkohë vëllai i viktimës kishte paraqitur kallëzim në polici për largimin e saj nga shtëpia.

Valteri njoftohet për këtë fakt dhe i telefonon kushërirës së tij në Durrës Merita. Viktima qëndron në shtëpinë e Meritës derisa e marrin vëllezërit dhe e kthejnë në shtëpi në Zaloshnjë.

Ermali prej disa muajsh ishte kthyer nga emigracioni nga Greqia dhe jetonte vetëm në shtëpinë e prindërve në Vodicë.

Viktima qëndron 10 ditë në shtëpinë e Ermalit në Vodicë. Ajo ka dëshmuar se ka qenë nën kontrollin e Ermalit.

Ditën e shtatë ose të tetë Valteri e ka takuar vikimën dhe i ka treguar se ishte i martuar, me dy fëmijë.

Valteri dhe Ermali i kanë thënë viktimës se po përpiqeshin t'i gjenin punë në Greqi, ku do të prostituonte dhe fitimet do t'i ndanin bashkë.

Viktima deklaron se për shkak të ndjenjës së turpërimit për ikjen nga shtëpia nuk mund të kthehej pranë familjes dhe në rrethanat kur nuk ka patur zgjidhje tjetër, ka pranuar të shkojë në Greqi për të punuar si prostitutë.

Viktima nuk u tregon familjarëve për lidhjen me Valterin.

Të nesërmen viktima largohet përsëri nga shtëpia pa dijeninë e prindërve.

Valteri e strehon viktimën në një hotel në Çorovodë për dy ditë.

Valteri bisedon me Ermalin dhe ky pranon që viktima të qëndrojë në shtëpinë e tij në Vodicë.

Ermali e udhëzon viktimën se do të shkonte në Athinë, ku do ta priste një shok i tij me emrin A.B dhe ky person do t'i gjente punë si prostitutë derisa ata të shkonin në Greqi.

Ermali me makinën e tij e ka çuar viktimën deri në Berat, ku e ka përcjellë tek autobusat e linjës për në Sarandë. Ai e ka udhëzuar se në Sarandë do ta priste një shok i tij i cili do ta çonte në Greqi.

Ermali i ka dhënë viktimës numrin e telefonit të A.B, që kur të shkonte në Greqi ti telefononte për t'a pritur.

Në Sarandë viktimën e priste personi, i cili e ka transportuar me gomone në qytetin e Korfuzit.

Viktima ka biseduar në telefon me A.B, i cili e ka udhëzuar se do të udhëtonte me traget deri në Patra, me taksì për Athinë.

Vitkima ndalohet nga policia greke në tragetin e linjës Korfuz-Patra sepse udhëtonte pa dokumente.

Në dt.14 korrik 2010 ndalohet Ermali dhe ndaj tij caktohet masa “arrest në burg”.

Valteri shpallet në kërkim.

Veprimet hetimore të kryera ne lidhje me rastin:

Pyetja e viktimës me imtësi për rrethanat në prani të psikologes;

Vënia në përgjim urgjent i numrave celularë në përdorim të Valterit dhe Ermalit;

Pyetja e familjarëve të viktimës;

Pyetja e personave që kishin dijeni për rrethanat e veprës (si dhe Antuela);

Këqyrja e vendeve, ku viktima dëshmonte se kishte qenë;

Këqyrja e telefonit të Ermalit;

Analiza e tabulateve telefonike dhe qelizat e vendondodhjes;

Komunikimi me autoritetet greke për rrethanat e ndalimit të viktimës;

Verifikimi i numrit të telefonit në përdorim të pritësit A.B në Greqi;

Përgjim ambiantal i bisedës ndërmjet Ermalit dhe viktimës;

Marrja e dëshmisë së viktimës në gjykatë gjatë hetimeve me proçedurën e sigurimit të provës;

Dhënia e dëshmisë me dyer të mbyllura;

Shoqërimi i viktimës nga punonjësit e prokurorisë dhe me mjete të sigurta sa herë nevojitej të paraqitej në prokurori dhe gjykatë;

Prokuroria vendosi pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit Valter.

I dyshuari Ermal u akuzua për kryerjen e veprës penale “Trafikim i të miturve”, parashikuar nga neni 128/b/1 i K.P.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr.22, datë 22.07.2011 ka deklaruar fajtor të pandehurin Ermal për veprën penale “Trafikim i të miturve” në bashkëpunim, neni 128/b/3 i K.P.

Vendimi është prishur nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr.60, datë 21.10.2011 duke deklaruar fajtor të pandehurin Ermal për nenin 128/b parg.1 i K.P (nuk është kryer në bashkëpunim).

Të drejtat e viktimës së trafikimit në proçesin penal⁸¹⁾.

Do ndalojmë në kuptimin juridik që i jep ligji penal termit “viktimë” në përgjithësi dhe viktimë trafikimi në veçanti duke përcaktuar se me viktimë do të kuptohet personi, ose personat e dëmtuar nga vepra penale. Evidentimi i detajuar i të drejtave të viktimës në proçesin penal është shumë i rëndësishëm duke patur parasysh dhe faktin se vetë dëshmia e personit të dëmtuar është shumë e rëndësishme si provë në proçes, pavarësisht se konsiderohet e njëjtë me të gjitha provat e tjera.

⁸¹⁾ Kodi Penal i R.Sh-se.

Kodi i Proçedurës Penale i RSH-se.

Në Kodin e Proçedurës Penale nuk është parashikuar ndonjë ndarje e thënieve të viktimës nga dëshmitarët e tjerë për qëllime proçeduriale me përjashtim të ndarjes së specifikuar në nenin 59 K.Pr.Penale, i cili jep dhe përkufizimin e të dëmtuarit akuzues.

Sipas përmbajtjes së dispozitës përkatëse në parashikimet e nenit 59 të Kodit të Proçedurës Penale bëjnë pjesë: “Dëmtime të tjera me dashje” gjobë ose me burgim deri 6 muaj, neni 90 K.Penal, “Pragosja e rëndë nga pakujdesia” gjobë ose me burgim deri 1 vit, neni 91 I Kodit Penal, neni 92 “Plagosje e lehtë nga pakujdesia” gjobë dhe vepra të tjera si “Dhunimi banesës”, “Fyerja”, “Shpifja”⁸²⁾, etj. Pra ky nen nuk përcakton si të dëmtuar viktimën e trafikimit.

Për rastet e parashikuara në nenin 59, Kodi ka parashikuar që viktima të ketë një status të veçantë, atë të dëmtuarit akuzues. Viktima në këto raste i drejtohet drejtëpërsëdrejti Gjykatës sipas formës dhe mënyrës së parashikuar në nenin 60 K.Pr.Penale dhe mosrespektimi i kësaj dispozite parashikon kthimin e kërkesës. Vetë viktima ka detyrimin të sjellë provat e nevojshme, për provimin e fajësisë së personit, të cilin ajo e akuzon, si person i cili ka kryer veprën penale. Prokurorit gjatë këtij proçesi nuk i është përcaktuar ndonjë rol, me përjashtim të atij që në rast se e konsideron me vend mund të kërkojë dënimin e të pandehurit ose pafajësinë. Këto vepra në fakt janë të gjitha kundërvajtje penale, me përjashtim të asaj që parashikohet në nenin 254 K.Penal, e cila është krim dhe parashikon një dënim deri në 5 vjet burgim.

Në proçesin penal në fazën e hetimit kryhen këto veprime:

Pyetja e viktimës nga oficeri i policisë gjyqësore ose nga prokurori kur viktima është e mitur, Kqyrja e të dëmtuarit (viktimës) nga eksperti mjeko ligjor. Përcaktimi i detyrave që i caktohen ekspertit, pyetja e familjarëve të viktimës nga oficeri i policisë gjyqësore, marrja e një psikologu gjatë fazës së hetimit për të miturin dhe viktimën, kryerja e ballafaqimit mes viktimës dhe agresorit, venia në dijeni e viktimës për mënyrën e përfundimit të hetimeve dhe zgjidhjen që i është dhënë çështjes.

Gjatë fazës së hetimit pyetja e të dëmtuarit (viktimës) realizohet nga oficeri i policisë gjyqësore ose nga prokurori, pa pjesëmarrjen e të pandehurit ose të avokatit të pandehurit, me përjashtim të rasteve kur nevojitet ballafaqimi i të dëmtuarit me të pandehurin (neni 170 K.Pr.Penale), prandaj edhe impresioni i të dëmtuarit nuk është në të njëjtën shkallë që është kur ai dëshmon përpara Gjykatës.

Rast tjetër kur i pandehuri mund të takohet me të dëmtuarin nga vepra penale është edhe atëherë, kur duhet realizuar njohja e personit të dyshuar nga i dëmtuari (neni 171 K.Pr.Penale), por ky veprim mund të realizohet edhe pa u parë nga i dyshuari, kur mendohet se viktima mund të frikësohet nga i dyshuari, ose të ketë ndikime të tjera nga prania e të dyshuarit (neni 171/2 K.Pr.Penale). Ajo që është e papërcaktuar në Kodin e Proçedurës Penale është rasti kur fëmija kërkon të bëjë një kallëzim penal dhe prindi nuk e realizon një kallëzim të tillë. Shumë e ndjeshme është situata në rastet e keqtrajtimit, të shfrytëzimit, dhunimit apo edhe torturimit të fëmijëve, nga ana e prindërve ose e të afërmeve të tjerë. Ka një mungesë të theksuar në këtë drejtim nga ana proçeduriale, Po t’i shtojmë këtij fakti edhe mentalitetin e mos ndërhyrjes në punët familjare tek të tjerët, gjendja bëhet edhe më e rëndë dhe pasojat janë këto që po shohim çdo ditë e më shumë. Mendojmë se ndër personat të cilët duhet të kenë detyrimin ligjor për

⁸²⁾ Kodi Penal i RSH-se.

shkak të profesionit të kallëzimit të veprave të tilla penale duhet të futen edhe punonjësit socialë. Në bazë të nenit 155 K.Pr.Penale: Çdo person ka zotësi për të dëshmuar, me përjashtim të atyre që për shkak të metave mendore ose fizike, nuk janë në gjendje për të dëshmuar.

Neni 156 K.Pr.Penale: Nuk mund të pyeten si dëshmitarë: personat që për shkak të metash fizike ose psikike nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt. Nuk ekziston asnjë lloj dallimi për t'u pyetur si dëshmitarë ndërmjet viktimës dhe një dëshmitari të zakonshëm.

Të pandehurit në një vepër të përbashkët ose në një procedim të lidhur edhe kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të çështjes, i pafajësisë ose i dënimit, me përjashtim të rasteve kur vendimi i pafajësisë ka marrë formë të prerë. Në këto raste personi mund të pyetet si person i dyshuar ose i dënuar (sipas nenit 38 K.Pr.Penale), duke i bërë me dije të drejtën e tij të mos përgjigjet, në qoftë se nuk dëshiron.

Ata që në të njëjtin procedim kryejnë ose kanë kryer funksionin e Gjyqtarit ose Prokurorit.

Nuk ekziston asnjë dallim për t'u pyetur si dëshmitare, ndërmjet viktimës dhe një dëshmitari të zakonshëm.

Në bazë të nenit 164 K.Pr.Penale: Kur dëshmitari i thirrur rregullisht nuk paraqitet në vendin, në ditën dhe orën e caktuar, pa pasur pengesa të ligjshme, Gjykata mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm.

Për më tej do të ndalojmë me përballjen e viktimës me procesin gjyqësor duke përcaktuar pozicionin procedural të viktimës ose familjarëve të tij gjatë procesit gjyqësor, marrja në pyetje e palevë gjatë procesit gjyqësor dhe shënimi i tyre kur konsiderohen të papërshtatshme.

Marrja e përgjigjeve për sjelljet e viktimës para ngjarjes ose pas saj.

Ajo çfarë është më e vështira gjatë procesit gjyqësor është kontakti i viktimës me agresorin. Kjo situatë paraqet vështirësi duke qenë se në disa raste ndodh që të paraqesë "turbullim" tek viktimat e cilat manifeston të këtu turbullim dhe në përgjigjet që i jep gjykatës.

Një moment i rëndësishëm për tu trajtuar është dhe marrja në pyetje e të miturit gjatë procesit penal, si dhe marrja në mbrojtje e familjarëve të viktimës së trafikimit.

Kontakti i viktimës me agresorin në Gjykatë është i drejtëpërdrejtë, gjë që bën në jo pak raste të ketë efekt negativ. Presioni i viktimës nga publiku në sallë, që në pjesën më të madhe të rasteve janë familjarë të të pandehurit, përballja me të pandehurin dhe avokatin e tij, janë impresione të ndryshme nga ato që ka pasur gjatë hetimit të çështjes.

Në ligjin "Për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda", është parashikuar që pyetja e dëshmitarit (pra edhe viktimës) mund të bëhet: Në praninë e të pandehurit dhe mbrojtësit, por pa kontakt vizual; pa iu komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit identiteti i dëshmitarit; pa treguar burimet për të dhënat e dëshmitarit. Gjithashtu edhe tek Ligji 9205 datë 15.02.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", janë përcaktuar edhe menyrat e mbrojtjes (ku ndër ta mund të jetë edhe viktimat). Një masë për ndihmues të miturit i është dhënë neni 361/5 K.Pr.Penale ku parashikohet: *Pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të bëhet nga kryetari, mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve.* Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve. Kur çmohet se pyetja e drejtëpërdrejtë e të miturit nuk e dëmton gjendjen

psikologjike të tij, kryetari urdhëron që pyetja të vazhdojë fillimisht nga ai që e ka kërkuar dhe të përfundojë nga ai që e ka kërkuar. Urdhëri mund të revokohet gjatë pyetjes. Mendojmë se duhet parashikuar një dispozitë ku pyetja e viktimës dhe e të miturit të realizohet pa kontakte vizive me të pandehurin dhe avokatin e tij sidomos për vepra të cilat viktima ka pasur (shfrytëzim, dhunë fizike, apo psikike, apo kur ka rrezik që kontakti viziv të ndikojë në mënyrë negative tek viktima).

Dëmshpërblimi i viktimës së trafikimit⁸³⁾

I dëmtuari gjatë fazës së procedimit ka të drejtë të marrë dijëni për veprimet e kryera. Në çdo moment, duhet të mbajmë parasysh trajtimin me dinjitet dhe profesionalizëm të viktimës së krimit. Një ndër të drejtat për realizimin e së cilës kemi patur bashkëpunim me O.J.F-të, është e drejta që ka viktima për kompesim ose shpërblimi i dëmit. Sipas parashikimeve tona proceduriale, viktima dëshmitare në proçes ose i dëmtuari në proçes nuk ka një mbrojtës të tijin, ndaj dhe në praktikën e përditshme një funksion i tillë është ushtruar nga përfaqësues të organizatave të ndryshme.

Subjekti i kryerjes së veprës penale ka gjithmonë një qëllim të caktuar në rastin e veprave që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, realizimin e përfitimit monetar, realizimin e çdo lloj forme tjetër të përfitimit. Legjislacioni procedurial parashikon si koncept termin “i dëmtuar nga vepra penale”, ku përveç kategorive të tjera, bëjnë pjesë dhe viktimat e trafikimit. Në parashikimet e nenit 58 të Kodit të Proçedurës Penale gjejmë të sanksionuara të drejtat që ka një person i dëmtuar nga vepra penale. I dëmtuari nga vepra penale ka të drejtë të kërkojë proçedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit. Këtë të drejtë mundet ta realizojë duke bërë të mundur paraqitjen e kërkesave në organin proçedues, duke kërkuar marrjen e provave. Në rast mospranimi të kërkesave të bëra para organit proçedues, ka të drejtën e ankimit në Gjykatë.

Të drejtat që i takojnë të dëmtuarit, shtrihen dhe tek trashëgimtarët e tij dhe në mungesë të zotësisë juridike të të dëmtuarit, kjo e drejtë i takon dhe përfaqësuesit të tij ligjor. Një tjetër element që konsiderohet si e drejtë e të dëmtuarit nga vepra penale është dhe padia civile në proçesin penal e parashikuar në nenin 61 të Kodit të Proçedurës Penale. Sipas parashikimeve të këtij neni, personi që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij, kanë të drejtë të ngrënë padi civile në proçesin penal kundër të pandehurit ose kundër të paditurit civil duke kërkuar kthim pasurie dhe shpërblim dëmi. Viktimat e trafikimit përveç dëmeve të tjera pësojnë dhe ato që ne i quajmë dëme ekonomike.

Në lidhje me këtë pikë ne do të ndalemi në një trajtim më të hollësishëm për vetë karakterin e çështjes dhe interesin që ajo paraqet.

Të gjitha format me anë të të cilave realizohet trafikimi i qenieve njerëzore bëjnë që viktimat e trafikimit, për aq kohë sa ndodhen në varësinë e subjekteve të krimit janë të kufizuara në të gjitha llojet e të drejtave të tyre, duke përfshirë këtu dhe ato ekonomike. Një problem mjaft i

⁸³⁾ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.

rëndësishëm duke e parë çështjen në këtë këndvështrim është dhe përcaktimi në mënyrë të drejtë i dëmit që u është shkaktuar këtyre viktimave. Lind e nevojshme të përcaktohet dhe të përlllogaritet jo vetëm dëmi, shpërblimi i tij por dhe mënyra e realizimit të këtij shpërblimi.

Në praktikën e përditshme gjyqësore, megjithëse kemi raste të shumta të veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, rastet në të cilat padia civile në procesin penal të jetë shqyrtuar dhe të ketë marrë një zgjidhje përfundimtare, të paktën në praktikën e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, mungojnë. Arsyet e një rezultati të tillë janë nga më të ndryshmet ndër të cilat, zhvillimi i gjykimit të çështjes penale në formën e gjykimit të shkurtuar (neni 403 e vijues i Kodit të Procedurës Penale). Në disa raste, subjekti ose autori që ka kryer veprën penale kërkon aplikimin e gjykimit të shkurtuar. Ndërkohë që organi i akuzës, nisur nga parashikimet ligjore që lidhen me zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet dhe për ekonomi gjyqësore, pranon zhvillimin e procesit me gjykim të shkurtuar. Problemi i hasur lidhet me fatin që do ndjekë padia civile e paraqitur nga i dëmtuarinë procesin penal. Nga pikëpamja juridike, zgjidhja mund të realizohet në te dy anët, dmth të pranohet shqyrtimi i padisë civile, në procesin penal qoftë dhe me gjykim të shkurtuar, ose të vecohet padia civile e cila më pas mund të ngrihet në gjykatën kompetente.

Jo vetëm aplikimi i gjykimit të shkurtuar çon në veçimin e padisë civile në procesin penal, kjo mund të ndodhë dhe në rastet kur çështja penale shqyrtohet me gjykim të zakonshëm.

Më të komplikuar paraqiten rastet në të cilat ka më shumë se një të pandehur në proces, ndërkohë që padia civile ka lidhje vetëm me njërin prej tyre.

Edhe në këtë rast vendoset veçimi i padisë civile, e cila më pas zgjidhet në një proces civil.

Një moment problematik, lidhet dhe me “durimin” që paraqet i dëmtuari.

Kjo nënkupton, zgjatjen në kohë të realizimit të të drejtave të tij.

Ndarja apo vecimi i padisë civile bën që i dëmtuari nga vepra penale të përballet me dy procese gjyqësore, procesin penal për provueshmërinë e fajësisë së të pandehurit dhe procesin civil që lidhet me realizimin e të drejtave të kërkuara prej tij.

Në rastin e procesit civil, gjykata për ti dhënë zgjidhje padisë civile është e detyruar të presë vendimin e fajësisë në lidhje me veprën penale të kryer nga subjekti.

Përballja me seanca të shumta gjyqësore ndikon jo mirë në gjendjen psikologjike të viktimës e cila shpesh manifeston lodhje. Kemi një rast të vetëm ku bashkëpunimi me OJF-në ka bërë të mundur që e dëmtuara D.S, ka arritur të përfitojë me padi civile një shumë të konsiderueshme të hollash si dëm i shkaktuar nga vepra penale.

Fakti penal nga i cili është dëmtuar D.S, lidhet me trafikimin jashtë shtetit të të dëmtuarës, e cila në kohën e trafikimit ka qënë e mitur, duke bërë që vepra e kryer nga subjekti të kualifikohet sipas parashikimeve ligjore të nenit 128/b të Kodit Penal.

Shtetasja D.S, nën ndikimin e dhunës fizike dhe psikologjike, mashtrimit për martesë, krijimit të një jete më të mirë, për disa vite me radhë ka qënë, sic quhet “punëtore seksi”, duke punuar për llogari të të pandehurit A. A.

Në përfundim të hetimit paraprak, në bashkëpunim me përfaqësuesit ligjorë të Qendrës për Nisma Ligjore qytetare, e dëmtuara paraqiti një padi civile, në të cilën kërkontë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale.

Padia civile u paraqit nga e dëmtuara që në fazën e hetimeve paraprake dhe me vendim prokurori pranoi futjen e saj në fashikull.

Padia civile u paraqit nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, Tiranë së bashku me kërkesën për gjykim dhe aktet, në lidhje me procedimin penal në ngarkim të të pandehurit A.A, i akuzuar për kryerjen e veprës penale sipas nenit 128/b të Kodit Penal.

I pandehuri kërkoi aplikimin e gjykimit të shkurtuar, si formë e zhvillimit të gjykimit në lidhje me këtë çështje, kërkesë kjo e pranuar nga Gjykata. Meqënëse padia civile e paraqitur, nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet e dosjes, gjykata vendosi vecimin e padisë civile, e cila më pas u shqyrtua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë si gjyq civil.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në vendimin e saj e deklaroi fajtor të pandehurin, vendim ky që u përdor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për padinë civile, të cilën e kishte marrë në shqyrtim, duke vendosur në favor të të dëmtuarës.

Ky është prezantimi më konkret i përballjes së të dëmtuarës, me dy procese gjyqësore, procesin penal dhe procesin civil.

Secili nga proceset në kuadër të respektimit të procedurave përkatëse kanë të nevojshme një kohe të caktuar, kohë e cila, nuk ishte aspak e lehtë, për tu kaluar me ‘durim’, nga e dëmtuara.

Përfaqësuesit e OJF-së siguruan përfaqësimin në mungesë të të dëmtuarës, në proces duke ndikuar ndjeshëm në mbarëvajtjen e tij.

Një tjetër problem lind dhe pas daljes së vendimit të Gjykatës që ka pranuar padinë civile dhe lidhet konkretisht me ekzekutimin e këtij vendimi.

Vështirësia në ekzekutim e ka zanafillën tek faktorë të tillë që konsistojnë në qenien e izoluar të subjektit të veprës penale. Duke qënë i izoluar, subjekti i kryerjes së veprës penale, nuk siguron të ardhura, dhe nuk kryen asnjë lloj aktiviteti.

Në shumë raste autorët bëjnë tjetërsimin e pasurisë së vënë nga vepra penale, ku e tjetërsojnë atë për efekt fshehjeje apo dhe efekte të tjera.

Ndodh rëndom që regjistrimi i pasurive të tyre bëhet në emër të personave të tjerë. Në të shumtën e rasteve autorët e veprave penale e regjistrojnë pasurinë e tyre në emër të personave të tjerë, që në kuadër të informalitetit i cili ka karakterizuar shoqërinë shqiptare deri ne ditët e sotme, është e vështirë të kemi një rezultat pozitiv.

Ka mjaft raste në të cilat autorët e veprave penale, si rezultat i mënyres së jetesës së tyre, humbasin pasuritë e fituara nga vepra penale.

Paraqitëm një sërë faktorësh, të cilët e vështiresojnë apo e bëjnë të pamundur realizmin e të drejtave ekonomike të viktimave të trafikimit nëpërmjet shpërblimit të dëmit.

Viktima mundet të kërkojë si një e drejtë sigurimin e padisë civile, e drejte kjo e parashikuar ne nenin 63 te Kodit te Proçedures Penale.

Ky nen parashikon të drejtën që ka personi për të kërkuar sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit, me sigurim padie deri në momentin e përfundimit të çështjes penale.

Kjo është një e drejtë tjetër që parashikimet tona proceduriale i atribuojnë të dëmtuarit nga vepra penale.

Për efekt ilustrimi do të ndalemi në trajtimin e një rasti tjetër praktik në të cilin do të prezantojmë vështirësitë me të cilat haset viktimat e trafikimit si rezultat i procedurave të ndjekura gjatë hetimeve paraprake.

E dëmtuara K.F ka depozituar kallëzim për veprë penale të kryer nga i pandehuri A.G, veprë kjo e kualifikuar sipas nenit 114/b të Kodit Penal. Si rezultat i jetesës së përbashkët për disa vite me radhë, e dëmtuara dhe i pandehuri kanë një fëmijë të mitur. Me vendim gjykate para fillimit të procesit penal, e dëmtuara K.F ka arritur të njohë atësinë e fëmijës dhe të përftojë çdo muaj për te, një pension mujor në formën e detyrimit për ushqim. Forma me të cilën i pandehuri e detyroi për disa vite me radhë të dëmtuarën të ushtronte prostitucion dhe të ardhurat të shkonin në favor të tij, lidhet me premtimin që ai i bënte asaj, se ata të dy ishin një çift normal dhe në momentin më të parë që do të siguronin një shumë të mjaftueshme të ardhurash për një jetë luksoze, ajo do të shkëputej nga prostitucioni.

Më vonë, me ardhjen në jetë të fëmijës së tyre, e dëmtuara u detyrua të ushtrojë prostitucion si një mjet i kërkuar nga i pandehuri që ky i fundit të njihte atësinë e fëmijës së lindur.

Vetëm duke ushtruar prostitucion dhe duke siguruar shuma të mëdha të hollash e dëmtuara ka arritur të marrë atësinë e fëmijës nga i pandehuri pasi i mituri kishte mbushur moshën tre vjeç. Problemi me të cilin u has e dëmtuara pas depozitimit të kallëzimit lidhet me faktorë ekonomikë pasi si rezultat i burgosjes së të pandehurit A. Ç, të dëmtuarës iu ndërpre pensioni mujor, si detyrim ushqimor për fëmijën e saj të mitur.

Ndërkohë që u has dhe me probleme psikologjike duke qënë se si rezultat i pasjes së një fëmije me të pandehurin, i mituri ruante marrëdhënie familjare me familjarët e të pandehurit, të cilët filluan të ndikojnë në psikologjinë e fëmijës së mitur.

Në këtë mënyrë e dëmtuara, ndodhet pa mjete monetare për të jetuar dhe nën trysninë psikike të familjarëve të saj.

Kjo ndikoi negativisht në psikologjinë e viktimës, duke e bërë atë të luhatej në pozicionin e mbajtur prej saj si dëshmitare në procesin penal.

Dhe në këtë rast në sajë të një bashkëpunimi të frytshëm me OJF-të u krijua mundësia e dhënies ekonomike për të dëmtuarën, dhe dhënia e mbështetjes psikike me konsultimin me punonjës social.

Kjo ndikoi pozitivisht në psikologjinë e viktimes, duke bërë që ajo të ishte këmbëngulëse për ecurinë e procesit penal.

Raste të tilla, apo të tjera që karakterizohen nga vështirësi të tilla hasen shpesh, dhe kanë ndikimin e tyre në ecurinë e procesit penal.

Normalisht që, synimi ynë parësor është dënimi i autorit të veprës penale, dhe si rezultat i problematikës së përmendur më sipër, ky synim në disa raste mbetet i vetmi. Megjithatë qoftë dhe për realizimin e këtij synimi ne duhet të vlerësojmë, domosdoshmërinë e mbrojtjes së viktimës nga momenti i pësimi të aktit kriminal dhe deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale.

Çdo person i dëmtuar nga vepra penale ka nevojë për mbrojtje të menjëherëshme.

Si persona për t'u ofruar mbrojtje konsiderohen të gjithë ata persona që njëherësh konsiderohen si viktimat sipas akteve kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe kanë nevojë për një gjë të tillë.

Një problem më vete me rastin e mbrojtjes së viktimave është marrja e masave që të mos ndodhë riviktimizimi i tyre apo i ashtuquajturit viktimizim sekondar.

Ata që kanë mbijetuar nga vepra penale, përballë një trajtimi jo të denjë, përballë mungesës së mbrojtjes, dhe përballë një trajtimi jo të drejtë nga organet e drejtësisë si organi procedues apo gjykata, mundet të provojnë edhe një viktimizim të dytë nga sistemi i drejtësisë. Fazat në të cilat kalojnë viktimat e trafikimit gjatë procesit penal përfshijnë momente të vështira, me të cilat haset viktimat, e cila është e detyruar, të kujtojë momente të vështira, si dhe të përballë me autorin e veprës penale. Për evitimin e situatave të tilla, duhet treguar kujdes dhe profesionalizëm.

Jemi munduar që në punën tonë të përditëshme të tregohemi të kujdesshëm në trajtimin e viktimës/dëshmitarëve, duke patur sukses në një farë mënyre.

Kur flasim për sukses, e nisim që nga momenti i parë që lidhet me akomodimin e viktimës, (vendosja në qendra), trajtimin psikologjik të saj, (pasja e kontakteve me psikologë dhe punonjës socialë në mënyrë të vazhdueshme), krijimi i një situatë drejt një jetese normale, (akomodimi në qendër shoqërohet me program trajtues specifik që përfshin shkollim, punësim, etj), si dhe ndjekja e procedurave ligjore për përfaqësimin e padisë civile.

Duke i vendosur viktimat e trafikimit në kushte të tilla trajtimi, kemi mundësinë e mbajtjes së viktimës gjithnjë në kontakt për procesin penal, gjithnjë të interesuar.

Trajtimi i viktimës së krimit, mbrojtja juridike e saj është një problem i madh i sistemit të drejtësisë penale dhe një ndër synimet tona kryesore.

Të drejtat që u takojnë viktimave të krimit me parashikimin e tyre në akte ndërkombëtare dhe kombëtare qëndrojnë në të njëjtin nivel me të drejtat ligjore, dhe si të tilla konsiderohen pjesë e pandarë e të drejtave të njeriut. Studimet dhe praktikat e ndryshme që janë bërë, tregojnë për një luftë efektive kundër kriminalitetit.

Përveç gjyqimit dhe dënimit të autorit të veprës penale është e domosdoshme që edhe subjektit tjetër të aktit kriminal t'i ofrohet ndihmë dhe mbrojtje juridike.

Për realizimin e ndihmës, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së nevojshme juridike duhet të merren në konsideratë, nevojat specifike dhe pozita delikate, vulnerabël e viktimës si rezultat i ndikimit të viktimizimit në të. Gjithashtu duhet të mbajmë parasysh se humbjet e viktimës janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Bashkëpunimi praktik, me të gjitha organizmat institucionalë apo jo, është shumë i rëndësishëm dhe i përvitueshëm. Vetëm në sajë të këtij bashkëpunimi, do të arrijmë të trajtojmë viktimat e trafikimit sipas parashikimeve përkatëse. Nga ana tjetër, ajo çfarë është më e rëndësishme është rregullimi i bazës ligjore në drejtim të realizimit efikas për shpërblimin e viktimave të trafikimit. Legjislacioni ynë dhe marrjen në mbrojtje të dëshmitarit, por që në rastin e praktikës tonë për veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore nuk kanë ndodhur.

7.2 Gjendja aktuale e trafikimit të qenieve njerëzore ne RSH-së.

Në vitet e fundit, autoritetet shqiptare kanë marrë një sërë masash të rëndësishme për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore (THB). Një ndër këto masa të ndërmarra është dhe ngritja e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Task Forcës Kombëtare Antitrafik, Mekanizmit kombëtar të referimit dhe Komiteteve rajonale anti-trafikim. Nga ana tjetër dhe në Prokurorinë për Krime të Rënda, që në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale ka kompetencën lëndore të ushtrimit të ndjekjes penale për figurat e veprës penale në lidhje me trafikimin e qeniesnjerëzore, është ngritur një sesion i posaçëm i cili heton vetëm figurat e veprës penale në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Krijimi i këtyre strukturave siç është vlerësuar dhe nga organizma të ndryshëm, ka përforcuar koordinimin e të gjithë aktorëve përgjegjës. Nga ana tjetër sipas mendimit tim këto struktura të krijuara janë më efikase dhe për shkak të bashëkpunimit të ngushtë me njëri tjetrin dhe qenien në kontakt të vazhdueshëm.

Është tashmë e rastit që për disa vite me radhë të realizohet miratimi dhe zbatimi i strategjive shumëvjeçare kombëtare së bashku me planet e veprimit të cilat kanë si qëllim për të mbuluar të gjitha aspektet e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në veçanti, janë bërë përpjekje për parandalimin e trafikimit, sidomos për trafikimin e fëmijëve. Nga ana tjetër ka patur organizime të shumta trajnimesh me institucionet përgjegjëse me qëllim identifikimin e viktimave të trafikimit. Megjithatë për të arritur një qasje gjithëpërfshirëse për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, mendoj se autoritetet shqiptare duhet të forcojnë masat kundër trafikimit të njerëzve. Mbajtja nën një vëzhgim të përhershëm i çështjeve të lidhura me trafikimin, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i bazës kombëtare të të dhënave duke lejuar ndjekjen e trendeve të trafikimit janë të një rëndësie të veçantë në këtë kontekst.

Përmbledhje e kuadrit ligjor dhe të politikave në fushën e veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Korniza ligjore

Përveç Konventës së Këshillit të Evropës kundër trafikimit, Shqipëria ratifikoi Protokollin për parandalimin, ndalimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, duke patur një plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar ("Protokollin e Palermos"), në 21 gusht 2002.

Në bazë të nenit 122 të Kushtetutës së Shqipërisë, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor të vendit dhe zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur miratimi i një ligji është i detyrueshëm për zbatimin e tyre.

Një traktat ndërkombëtar i ratifikuar me ligj ka përparësi ndaj parashikimeve ligjore kombëtare, parashikime këto ligjore të cilat mund të jenë të papajtueshme me këtë traktat.

Në përputhje me rrethanat, autoritetet shqiptare kanë theksuar se Konventa e Këshillit të Evropës kundër trafikimit, është pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe merr përparësi mbi çdo ligj apo rregullore administrative që do të ishte në kundërshtim me të.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, përmban dy dispozita kryesore që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore: Neni 110 (a) ("trafikimi i personave të rritur), dhe Neni 128 (b) ("trafikim i të miturve").

Kuadri ligjor i luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore plotësohet me një sërë parashikimesh të tjera dhe në mënyrë të veçantë po përmendim:

- Ligji Nr. 9959 i datës 17 korrik 2008 "Mbi të huajt";
- Ligji Nr. 10173 i datës 22 tetor 2009 "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" etj.

Vitet e fundit ka një rënie të ndjeshme të fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore në vendin tonë dhe kjo ka ardhur si rezultat jo vetëm i masave të marra por dhe si rezultat i ndikimit të një sërë faktorësh, politikë, ekonomikë dhe gjeografikë. Në këtë mënyrë hapja e kufijve dhe lëvizja pa viza me vendet e Evropës ka ndikuar drejtpërsëdrejti.

Në një aspekt studimor nisur dhe nga rastet e hetuara dhe të gjykuara të Trafikimit të Qenieve njerëzore, rezulton se vitet e fundit ka një ulje të ndjeshme të numrit të këtyre çështjeve.

Që nga viti 2004 e deri në vitin 2013 në Gjykatën e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë janë gjykuar 88 (tetëdhjetë e tetë) raste që lidhen me veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Po të shohim zanafillën e këtyre çështjeve në vite, shohim se nga viti 2004 e deri në vitin 2011 numri i çështjeve në gjykim ka qënë thujse në stadi të njëjta, ndërsa dy vitet e fundit ka një rënie totale të numrit të çështjeve të gjykuara.

Në vitin 2004 në GJSHKR janë gjykuar gjithsej 5 (pesë) çështje që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore. Dy prej të cilave kanë qënë për veprën penale të Trafikimi i të miturve, sipas

parashikmeve të nenit 128/b të Kodit Penal dhe 3 (tre) të tjerat kanë qënë për veprën penale të Trafikimi i femrave, parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal.

Në të pestë rastet e gjykuara vendimi i dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka konkluduar me deklarinimin fajtor të të pandehurit, vendim ky i cili ka mbetur në fuqi në katër raste deri në Gjykatën e Lartë.

Në vitin 2005, në GJSHKR janë gjykuar gjithsej 18 tetëmbëdhjetë çështje që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore. Dy prej të cilave kanë qënë për veprën penale të Trafikimi i të miturve, sipas parashikmeve të nenit 128/b të Kodit Penal dhe 1 prej të cilave ka qënë për veprën penale të Trafikimi i Personave, parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal. Ndërsa pjesa tjetër janë gjykuar për veprën penale të Trafikimi i femrave sipas parashikimeve të nenit 114/b i Kodit Penal. Në rastet e gjykuara gjykata ka vendosur pafajësinë e të pandehurit për një rast të vetëm, ndërsa për dy raste të tjera ka vendosur kalimin e akteve organit të akuzës.

Në vitin 2006 në GJSHKR janë gjykuar gjithsej 14 (katëmbëdhjetë) çështje që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore. Tre prej të cilave kanë qënë për veprën penale të Trafikimi i të miturve, sipas parashikimeve të nenit 128/b të Kodit Penal dhe pjesa tjetër për veprën penale të Trafikimi i femrave sipas parashikimeve të nenit 114/b i Kodit Penal.

Në rastet e gjykuara gjykata ka vendosur pafajësinë e të pandehurit për dy raste.

Në vitin 2007 në GJSHKR janë gjykuar gjithsej 7 (shtatë) çështje që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore. Tre prej të cilave kanë qënë për veprën penale të Trafikimi i të miturve, sipas parashikimeve të nenit 128/b të Kodit Penal dhe pjesa tjetër për veprën penale të Trafikimi i femrave sipas parashikimeve të nenit 114/b i Kodit Penal.

Në rastet e gjykuara gjykata ka vendosur pushimin e gjyqimit për një rast të vetëm.

Në vitin 2008 në GJSHKR janë gjykuar gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë) çështje që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore, 6 (gjashtë) prej të cilave kanë qënë për veprën penale të Trafikimi i të miturve, sipas parashikimeve të nenit 128/b të Kodit Penal dhe pjesa tjetër për veprën penale të Trafikimi i femrave sipas parashikimeve të nenit 114/b i Kodit Penal.

Në rastet e gjykuara gjykata ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit vetëm për një rast të vetëm.

Në vitin 2009 në GJSHKR janë gjykuar gjithsej 5 (pesë) çështje që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore, 1 (një) prej të cilave ka qënë për veprën penale të Trafikimi i të miturve, sipas parashikimeve të nenit 128/b të Kodit Penal dhe pjesa tjetër për veprën penale të Trafikimi i femrave sipas parashikimeve të nenit 114/b i Kodit Penal.

Në rastet e gjykuara gjykata ka vendosur në të gjitha rastet deklarinimin fajtor të të pandehurve.

Në vitin 2010 në GJSHKR janë gjykuar gjithsej 8 (tetë) çështje që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore, vetëm 1 (një) prej të cilave ka qënë për veprën penale të Trafikimi i të miturve, sipas parashikimeve të nenit 128/b të Kodit Penal dhe pjesa tjetër për veprën penale të Trafikimi i femrave sipas parashikimeve të nenit 114/b i Kodit Penal.

Në rastet e gjykuara gjykata ka vendosur vetëm në një rast deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit.

Në vitin 2011 në GJSHKR janë gjykuar gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) çështje që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore, ku 4 (katër) prej të cilave kanë qënë për veprën penale të Trafikimi i të miturve, sipas parashikimeve të nenit 128/b të Kodit Penal dhe pjesa tjetër për veprën penale të Trafikimi i femrave sipas parashikimeve të nenit 114/b i Kodit Penal.

Në rastet e gjykuara gjykata ka vendosur vetëm në një rast deklarimin e pafajshëm të të pandehurit.

Në vitin 2012 në GJSHKR janë gjykuar gjithsej 2 (dy) çështje që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore, ku të dyja kanë qënë për veprën penale të Trafikimi i femrave sipas parashikimeve të nenit 114/b i Kodit Penal.

Në rastet e gjykuara gjykata ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit.

Në vitin 2013 në GJSHKR është gjykuar gjithsej vetëm 1 (një) çështje që lidhet me trafikimin e qënieve njerëzore, ku bëhej fjalë për veprën penale të Trafikimi i femrave sipas parashikimeve të nenit 114/b i Kodit Penal.

Në rastin e gjykuar gjykata ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit.


Për një pasqyrim sa më të plotë po paraqesim tabelën e mëposhtëme:

Çështje gjyqësore të gjykuara sipas viteve.


Viti 2004	5 çështje të gjykuara
Viti 2005	18 çështje të gjykuara
Viti 2006	14 çështje të gjykuara
Viti 2007	7 çështje të gjykuara
Viti 2008	17 çështje të gjykuara
Viti 2009	5 çështje të gjykuara
Viti 2010	8 çështje të gjykuara
Viti 2011	11 çështje të gjykuara
Viti 2012	2 çështje të gjykuara
Viti 2013	1 çështje e gjykuar

Përfundimi i analizave statistikore është se kjo dukuri e njëherazi, kjo vepër penale, ka një dinamikë në ulje. Kjo evidentohet qartë dhe nga numri i çështjeve të gjykuara.

Ndarja sipas figurave të veprave penale.



ÇËSHTJE TË GJYKUARA SIPAS VITEVE



7.3 Proçesi gjyqësor në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore

E drejta për gjykim të drejtë është një normë e së drejtës ndërkombëtare që lidhet me të drejtat e njeriut, e projektuar për të mbrojtur individët nga kufizimi i paligjshëm dhe arbitrar i lirisë ose privimit të të drejtave të tjera themelore, ku më e njohura nga të cilat është e drejta e jetës dhe lirisë së personit. Gjithashtu procesi i rregullt ligjor garanton të drejtën për një gjykim të drejtë e cila është me rëndësi themelore në një shoqëri demokratike, duke zënë një vend qendror në sistemin e Konventës. Objekti dhe qëllimi i tyre përmban parimin e sundimit të ligjit, mbi të cilat një shoqëri e tillë është e bazuar dhe ndërtuar, si dhe pasqyron një pjesë të trashëgimisë së përbashkët të shteteve palë të Konventës, sipas Hyrjes së Konventës. Neni 6 është dispozitë e Konventës e kërkuar më shpesh nga aplikantët në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata).

E drejta për gjykim të drejtë mund të duket një shembull i pastër apo “rast paradigmantik” e asaj që ne nënkuptojmë nga një "e drejtë" dhe me siguri besohet gjerësisht që njerëzit e kanë një të drejtë të tillë dhe se për të kërkuar ata në përgjithësi fillimisht nuk godasin në menyrë absurde. Qëllimi kryesor i këtij materiali është t'i përgjigjet pyetjes se cilat janë standardet bazë ligjore që duhet të përdoren në vlerësimin e ndershmërisë së një gjyqi. E dyta është se si duhet të përgatitet një mision vëzhgimi gjykimi dhe i realizuar në praktikë.

E drejta për gjykim të drejtë konsiderohet zakonisht aq kryesore në sistemin tonë të drejtësisë dhe aq shumë si një pjesë e trashëgimisë sonë ligjore që për të mohuar se njerëzit në përgjithësi e kanë një të drejtë të tillë mund të duket e barazvlershme me dëmtimin e traditave tona ligjore si një e tërë. E drejta për gjykim të drejtë mund të duket një shembull i pastër apo “rast paradigmantik” e asaj që ne nënkuptojmë nga një "e drejtë" dhe me siguri besohet gjerësisht që njerëzit e kanë një të drejtë të tillë dhe se për të kërkuar ata në përgjithësi fillimisht nuk godasin në menyrë absurde. Unë shpresoj gjithsesi që të paraqes arsyet te cilat i çojnë njerëzit, në fakt për të menduar se nuk kanë të drejtë për një gjykim të drejtë. Rëndësia themelore e kësaj të drejte është ilustruar jo vetëm nga organi i gjerë i interpretimit që ajo ka gjeneruar, por më së fundi, me një propozim për ta përfshirë atë në të drejtat jo të pacënueshme të parashikuara në nenin 4 (2) të KNDCP.

E drejta për gjykim të drejtë është e zbatueshme për përcaktimin e të drejtave dhe detyrave të një individi nën akuzë ligjore dhe në lidhje me përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij apo saj. Termi "akuzë ligjore" i referohet llojeve të ndryshme të procedurave gjyqësore - për shembull, duke përfshirë procedurat administrative - sepse koncepti i akuzës ligjore është interpretuar si varësi nga natyra e së drejtës të përfshirë më tepër se statusi i njërës prej palëve.

Për shkak të specifikave të çdo rasti individual dhe interesave të organizatave monitoruese, një interpretim i detajuar i qëllimeve të vëzhgimit gjyqësor nuk është i mundshëm. Qëllimet kryesore të përgjithshme mund të përmbledhen si më poshtë⁸⁴⁾:

T'i bëjë të njohur gjykatës, autoriteteve të vendit dhe për publikun e gjerë interesin dhe shqetësimin për gjykimin në fjalë;

Për të inkurajuar një gjykatë t'i japë të akuzuarit një gjykim të drejtë.

Ndikimi i pranisë së vëzhguesit në një sallë gjyqi nuk mund të vlerësohet me saktësi matematikore. Megjithatë, vëzhguesit dhe avokatët mbrojtës kanë vënë në dukje se prania e një monitorimi shpesh ndryshon atmosferën në sallën e gjyqit dhe lehtëson mbrojtjen ndër të tjera,

⁸⁴⁾ Konventa Evropiane e të Drejtave të njeriut, neni 6.

duke e bërë gjykatën më të vëmendëshme mbi argumentet e mbrojtjes, inkurajimin e mbrojtësit dhe të pandehurit që të jenë më të rreptë për të kundërshtuar pretendimet e akuzës, në tërheqjen e vëmendjes së mediave ndaj gjykimit, etj;

Është e drejtë e të pandehurit për të marrë më shumë informacion në lidhje me drejtimin e gjykimit, natyrën e çështjes kundër të akuzuarit dhe të legjislacionit sipas të cilat ai/ajo po gjykohet; dhe për të mbledhur informacion të përgjithshëm të së shkuarës për rrethanat politike dhe ligjore që çojnë në gjyq dhe që ndoshta ndikojnë rezultatin e tij.

Në kuptimin më të gjerë, monitorimi i gjykimit përbëhet jo vetëm nga prania fizike e vëzhguesit në sallën e gjyqit për të paktën një pjesë të procedurës, por, po aq e rëndësishme, të detyrës për të përgatitur menjëherë një raport për organizatën që ai ose ajo përfaqëson, me konkluzione mbi drejtësinë e gjykimit të vërejtur.

Kriteret bazë për një gjykim të drejtë⁸⁵⁾

Standardet kundër të cilit një gjykim është për t'u vlerësuar në aspektin e drejtësisë janë të shumta, komplekse, dhe vazhdimisht në zhvillim. Ata mund të përbëjnë detyrime që janë të përfshira në traktatet e të drejtave të njeriut për të cilat shteti është palë. Por, ato gjithashtu mund të gjenden në dokumente të cilat, edhe pse jo zyrtarisht të detyrueshme, mund të merren për të shprehur se në cilin drejtim zhvillohet ligji. Për të shmangur sfidat e mundshme të natyrës ligjore të standardeve të angazhuara në vlerësimin e ndershmërisë së një gjykimi, monitoruesit duhet t'i referohen normave të origjinës të pamohueshme ligjore.

Ato janë: 1. Ligjet e vendit në të cilin gjykimi po mbahet; 2. Traktatet e të drejtave të njeriut për të cilat ai vend është palë, dhe 3. Normat e të drejtës zakonore ndërkombëtare .

Para vëzhgimit të një gjykimi, një monitorues duhet të lexojë materialet përkatëse që kanë të bëjnë me legjislacionin vendas. Për shkak të sistemeve të ndryshme ligjore dhe rendit ligjor të përfshirë, si dhe fazave të ndryshme të zhvillimit të tyre, nuk është e mundur të hartohet një listë e plotë e teksteve thelbësore. Një listë minimale do të përfshijë: i) Kushtetutën e shtetit, veçanërisht dispozitat e saj për të drejtat e njeriut dhe sistemin gjyqësor; ii) Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të tij; iii) Statutet mbi krijimin dhe juridiksionin e gjykatave dhe zyrës së prokurorit publik, dhe iv) Vendimet historike gjyqësore që i përkasin të drejtave të njeriut, veçanërisht në vendet me jurisprudencë gjyqësore. Qëllimi i vëzhguesit në këtë nivel të shqyrtimit është të vlerësojë nëse dispozitat e aplikueshme të ligjit vendor që garantojnë një gjykim të drejtë janë zbatuar dhe nëse po, në çfarë mase. Dihet mirë se ndërsa kushtetutat dhe statutet në përgjithësi ofrojnë disa masa të drejtësisë në procedurën penale, zbatimi nga gjykatat shpesh nuk është adekuat.

Para se të ndërmerret një mision vëzhgimi i një gjykimi, monitoruesi duhet të gjejë se në cilat traktate të të drejtave të njeriut shteti përkatës është palë. Më e rëndësishmja nga këto është KNDCP, e cila përmban disa artikuj përkatës në vlerësimin e drejtësisë së një gjykimi.

E drejta për një gjykim të drejtë për një vepër penale konsiderohet të fillojë jo "vetëm pas depozitimit zyrtar të një akuze, por më tepër në datën në të cilën veprimtaritë shtetërore ndikojnë ndjeshëm gjendjen e personit në fjalë". Kjo mund të përkojë padyshim me momentin e arrestimit, në varësi të rrethanave të çështjes. Garancitë për gjykim të drejtë duhet të vërehen që nga momenti i hetimit kundër të akuzuarit deri në procedurat penale, duke përfshirë çdo apelim,

⁸⁵⁾ Konventa Europiane e të Drejtave të njeriut, neni 6.

dhe ato të kenë përfunduar. Dallimi ndërmjet procedurave të paraburgimit, procedurave aktuale të gjykimit dhe pas gjykimit është nganjëherë në fakt i paqartë, dhe shkelja e të drejtave gjatë një faze mund të ndikojë në një tjetër fazë. Megjithatë nenet më të rëndësishme të KNDCP mund të ndahen lirshëm në këto tri kategori dhe ndarja ndonjëherë është e dobishme për qëllime të identifikimit se cilat çështje do të jenë me interes të veçantë në periudha të ndryshme kohore të procesit gjyqësor.

E drejta për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) parashikon:

Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë për një proces të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Vendimi duhet të jepet publikisht, por shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga të gjitha ose pjesë të gjykimit, në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve e kërkojnë, ose në masën e domosdoshme sipas mendimit të gjykatës në rrethana të veçanta kur publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajtor sipas ligjit.

Çdokush që akuzohet për vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

- (a) për t'u informuar menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;
- (b) të ketë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;
- (c) për t'u vetëmbrojtur personalisht ose me ndihmën e mbrojtësit të zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën ligjore, t'i jepet falas kur interesat e drejtësisë e kërkojnë;
- (d) të pyesë, ose të ketë pyetur dëshmitarët e akuzës dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- (e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur në Gjykatë.

Neni 6 garanton të drejtën për një gjykim të drejtë e cila është me rëndësi themelore në një shoqëri demokratike, duke zënë një vend qendror në sistemin e Konventës. Objekti dhe qëllimi i tyre përmban parimin e sundimit të ligjit, mbi të cilat një shoqëri e tillë bazohet dhe ndërtohet, si dhe pasqyron një pjesë të trashëgimisë së përbashkët të shteteve palë të Konventës, sipas Preambulës së Konventës. Neni 6 është dispozitë e Konventës që përdoret më shpesh nga aplikantët në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Si me dispozitat e tjera të Konventës, shumë nga termat e përdorura në nenin 6 mbajnë kuptim "autonom" dhe kërkojnë interpretim i cili mund të ndryshojë nga ai i dhënë në legjislacionin vendas apo autoritetet kombëtare. Prandaj, e drejta për një proces të drejtë përfshirë në nenin 6 nuk zbatohet për të gjitha procedurat gjyqësore në nivel vendas. Të dy konceptet e përdorura nga Konventa, "përcaktimi i akuzës penale" dhe "përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve civile" janë autonome; kështu përmbajtja e tyre mund të ndryshojë nga kualifikimet e dhëna nga ligjet kombëtare.

Ndërsa, Neni 6 (2) dhe (3) përmban dispozita të veçanta që përcaktojnë standardet e zbatueshme procedurale shtesë vetëm për ata që akuzohen për “vepër penale”, neni 6 (1) zbatohet për procedimet “penale” dhe “civile”. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se shumica e çështjeve të sjella në vëmendjen e Gjykatës me rrezik "kriminal" të nenit 6 kanë shqetësuar drejtësinë e akteve procedurale nga ana e zyrtarëve të ndryshme të shtetit - në fazën e hetimit, gjykimit apo të apelit - që çojnë në dënimin e një personi. Megjithatë, çështjet e sjella në vëmendjen e Gjykatës sipas kreut "civil" të nenit 6 kanë prekur mbi tre grupe të veçanta problemesh:

a) mungesa e mundësisë për t'iu drejtuar gjykatës për të përcaktuar një mosmarrëveshje "civile", b) drejtësia e procedurave gjyqësore ku hyrja në një gjykatë nuk është e kufizuar, c) të drejtën për të marrë ekzekutimin në kohë të vendimit gjyqësor me rastin e një rezultati të favorshëm të një mosmarrëveshje "civile". Ekziston një pyetje pragu për zbatueshmërinë e nenit 6; domethënë, nëse procedurat e veçanta ligjore kualifikohen si "përcaktim i të drejtave dhe detyrimeve civile ose një akuzë penale". Për nenin 6 të aplikuar nën titullin e tij "civil", duhet së pari të jetë një mosmarrëveshje ("kontestim") mbi një "të drejtë" ose "detyrim". Së dyti, kjo "e drejtë" duhet të ketë një bazë në ligjin kombëtar. Për më tepër, mosmarrëveshja në fjalë duhet ta përcaktojë atë "të drejtë" në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe vendimtare. Së fundi, kjo e drejtë apo detyrim duhet të jetë "civile" për nga natyra. Vetëm duke kaluar të gjitha testet e mësipërme, Gjykata do të ngarkohet me rastin e shqyrtimit të pretendimit të aplikantit nëse procedurat e kontestueshme vendase janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të Konventës.

Është e qartë se koncepti i "së drejtës dhe detyrimeve civile" mbulon çështje gjyqësore të zakonshme që ka karakteristikat më tipike të së drejtës private, të tilla si kontestet mes personave privatë që kanë të bëjnë, për shembull, me veprime delikti, kontrate si edhe të drejtë familjare. Megjithatë është më e vështirë për të përcaktuar nëse neni 6 (1) duhet të zbatohet gjithashtu për mosmarrëveshjet mes individëve dhe të drejtat e lidhura shtetërore të cilat në disa sisteme të së drejtës rregullohen nga publiku më tepër se sfera e së drejtës private.

“Akuza penale”

Nocioni i "akuzës penale" në nenin 6, si koncepti i "të drejtave dhe detyrimeve civile", konsiderohet nga Gjykata si zotërimi i një kuptim autonom. Rastet janë ngritur shpesh ku sjellja e sulmuar karakterizohet nga autoritetet kombëtare si vepër disiplinore më tepër se një vepër penale. Në rastet në lidhje me një akuzë "penale" brenda kuptimit të Nenit 6, mbrojtja e kësaj dispozite fillon nga koha kur personi është akuzuar për një vepër penale. Megjithatë kjo nuk është domosdoshmërisht momenti kur akuzat formale janë bërë së pari kundër një personi të dyshuar se ka kryer një vepër penale. Për më tepër, pasi objekti i nenit 6 është që të mbrojtë një person gjatë gjithë procesit penal, dhe që nga akuzat formale nuk mund të sillen deri në një fazë mjaft të avancuar të një hetimi, është e nevojshme për të gjetur një kriter për hapjen e procedurës penale e cila është e pavarur nga zhvillimit aktual i procedurës në një rast specifik.

Të drejtat e procedurës paraprake

Ndalimi i arrestimit dhe paraburgimit arbitrar

Neni 9 (1) i KNDCP 10 thotë se "çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale." Liria e personit është interpretuar ngushtë, për të nënkuptuar lirinë e lëvizjes trupore, e cila ndërpritet kur një individ kufizohet në një hapësirë të veçantë të tillë si burg apo qendër paraburgimi. Siguria është marrë për të nënkuptuar të drejtën për të qenë i lirë nga ndërhyrjet me integritet personal nga personat privatë. Në bazë të nenit 9 (1) "Askush nuk mund t'i nënshtrohet arrestit apo ndalimit arbitrar" dhe "Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveç për arsye të tilla dhe në përputhje me procedurën e tillë siç përcaktohen me ligj".

"Çdo person i arrestuar duhet të informohet, në kohën e arrestimit, për arsyet e arrestimit të tij dhe të informohet menjëherë për çdo akuzë ndaj tij." Këto dispozita janë interpretuar për të nënkuptuar se kushdo që arrestohet duhet të informohet për arsyet e përgjithshme të arrestimit "në kohën e arrestimit," ndërsa informacioni pasues, që duhet të jepet "menjëherë," duhet të përmbajë akuza në kuptimin ligjor.

- E drejta për këshilltar ligjor

E drejta për të siguruar dhe komunikuar me avokatin është garancia e gjykimit të drejtë specifike më e shqyrtuar në praktikën e vëzhgimit të gjykimit, sepse tregohet që ajo të jetë shkelur më shpesh. Parimi 1 i Parimeve Themelore të Avokatëve deklaron se [a] "personat kanë të drejtë të kërkojnë ndihmën e një avokati të zgjedhur prej tyre për të mbrojtur dhe për të vendosur të drejtat e tyre dhe për t'i mbrojtur ata në të gjitha fazat e procedurës penale". Kjo e drejtë është veçanërisht e rëndësishme në rastet e paraburgimit dhe është diskutuar në këtë kontekst, në këtë seksion.

Megjithatë e drejta për avokat është gjithashtu një element i rëndësishëm i së drejtës për të përshtatur objektet për përgatitjen e mbrojtjes dhe të drejtën për një mbrojtje e cila do të diskutohet më vonë në këtë material.

E drejta për dalje të shpejtë përpara një gjyqtari për të sfiduar ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit

Neni 9 (3) i referohet posaçërisht të drejtave të personit të arrestuar apo të ndaluar për një vepër penale, i cili "do të çohet menjëherë para një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet." Gatishmëria është interpretuar nga Komitetit të të Drejtave të Njeriut (KDNJ) për të nënkuptuar se periudha e paraburgimit, para se një individ të silltet përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër, nuk mund të kalojë "disa ditë." Neni 9 (3) bën të qartë se paraburgimi "nuk duhet të jetë rregull i përgjithshëm" dhe pa dyshim parashikon një të burgosur me një pretendim të ligjshëm për ta liruar në shkëmbim të lirimit me kusht apo ndonjë garanci tjetër të paraqitjes në gjyq.

Ndalimi i torturës dhe e drejta për kushte njerëzore gjatë paraburgimit

Neni 7 i KNDCP ndalon torturën- ose trajtimin mizor, çnjerëzor ose poshtëruës apo ndëshkimin -dhe është një normë e së drejtës ndërkombëtare zakonore që gjithashtu i takon kategorisë *jus cogens*. Përkufizimi i torturës, e cila ndalohet me Statutin e ICC si një krim kundër njerëzimit kur kryhet në një bazë të gjerë ose sistematike, është pak më i gjerë në atë Statut se sa në Konventën e Torturës. Ndryshe nga Konventa e Torturës, përkufizimi i Statutit të ICC-së përfshin akte të kryera në mënyrë të pavarur prej çdo zyrtari publik (dmth nga individë privatë me motive private).

Ndalimi i paraburgimit të izoluar

KDNJ ka gjetur se paraburgimi i izoluar mund të shkelë nenin 7 të ICCPR-së që ndalon torturën, trajtimin çnjerëzor, mizor dhe poshtëruës.

Parimi 19 i Trupit të Parimeve thekson se një person i "ndaluar ose i burgosur ka të drejtë të vizitohet nga dhe të korrespondojë me, në mënyrë të veçantë, anëtarët e familjes së tij dhe do t'i jepet mundësia e duhur për të komunikuar me botën e jashtme, objekt i kushteve dhe kufizimeve të arsyeshme të përcaktuara me ligj ose rregullore të ligjshme." Në minimum, e drejta për të komunikuar me "botën e jashtme" përfshin të drejtën për të komunikuar me familjen e të ndaluarit, një avokat dhe një mjek.

Të drejtat themelore të garantuara me Nenin 6

E drejta për të hyrë në gjykatë, dhe barazia para gjyqit

Kjo është një nga të drejtat që nuk rrjedhin direkt nga teksti i Nenit 6 (1), dhe që është zhvilluar nga Gjykata. Kjo do të thotë që një individ duhet të jetë në gjendje të paraqesë një çështje para gjykatës për përcaktimin pa pengesa të parregullta ligjore apo praktike duke e paraqitur sipas mënyrës së tij ose të saj. Siç do të shihet, kjo e drejtë nuk është e pakualifikuar dhe merr formë mjaft të ndryshme në fushat civile dhe penale. E drejta për një gjykatë gjithashtu përfshin të drejtën për përfundimin e procedurave ligjore dhe të drejtën për të kërkuar ekzekutimin në kohë të një vendimi civil. Sipas interpretimit të Gjykatës, e drejta për një gjykatë është e qenësishme në nenin 6 (1), e drejta për qasje duke qenë një aspekt. Paaftësia për t'iu drejtuar gjykatës mund të bazohet tek të gjithë ata që ankohen se ai ose ajo nuk e ka pasur mundësinë të paraqesë një kërkesë në një gjykatë që ka juridiksion për të shqyrtuar të gjitha çështjet faktike dhe ligjore përkatëse për kontestin para saj dhe për të miratuar një vendim detyruës. Fjalja e parë e nenit 14 (1) parashikon se "Të gjithë personat janë të barabartë para gjykatave dhe tribunaleve" dhe interpretohet për të treguar se të gjithë personave duhet t'i jepet, pa diskriminim, e drejta për qasje të barabartë në gjykata.

Kjo, nga njëra anë, do të thotë se krijimi i gjykatave të veçanta për grupe të ndryshme njerëzish në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, politikës apo opinionit tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose statusit tjetër përbën shkelje të nenit 14 (1). Nga ana tjetër, krijimi i llojeve të caktuara të gjykatave të veçanta me juridiksion mbi të gjithë personat që i përkasin të njëjtës kategori, të tilla si personeli ushtarak, mbetet një çështje e mprehtë.

E drejta për një seancë të drejtë

E drejta për një proces të drejtë, siç parashikohet në nenin 14 (1) të KNDCP përfshin garancitë procedurale dhe garanci të tjera të parashikuara në paragrafet 2 deri 7 të nenit 14 dhe nenit 15. Megjithatë, është më i gjerë në fushëveprim, siç mund të konkludohet nga formulimi i nenit 14 (3) që i referohet të drejtave konkrete të renditura si "garanci minimale". Prandaj, është e rëndësishme të theksohet se edhe pse ka plotësuar të gjitha garancitë kryesore procedurale të paraqitura në paragrafët 2-7 të nenit 14 dhe dispozitave të nenit 15, gjykimi ende mund të mos përmbushë standardet e drejtësisë të parashikuara në nenin 14.

Neni 14 (1) i KNDCP gjithashtu garanton të drejtën e një gjykimi publik, si një nga elementet thelbësore të konceptit të gjykimit të drejtë. Megjithatë, ai gjithashtu lejon disa përjashtime nga ky rregull i përgjithshëm në rrethana të caktuara. Publiciteti i një gjykimi përfshin si natyrën publike të seancave - jo, duhet theksuar, të fazave të tjera në procedure - edhe publicitetin e gjykimit të dhënë përfundimisht për një rast. Kjo është një e drejtë që i përket palëve, por edhe publikut të gjerë në një shoqëri demokratike.

E drejta për një gjykatë kompetente, të pavarur dhe të paanshme e caktuar me ligj

Kuadri themelor institucional duke bërë të mundur gëzimin e së drejtës për një gjykim të drejtë është se procedurat në çdo rast penal (ose në një padi ligjore) duhet të kryhet nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj [Neni 14 (1)]. Arsyetimi i kësaj dispozite është për të shmangur arbitraritetin dhe/ose paragjykimet që potencialisht do të lindin në qoftë se kallëzimet penale do të vendosen nga një organ politik ose agjenci administrative. Një gjykatë duhet të jetë kompetente dhe e themeluar me ligj.

E drejta e prezumimit të pafajësisë

Në bazë të nenit 14 (2) të KNDCP "Çdo person i akuzuar për një veprë penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit." Si një komponent bazë të së drejtës për një gjykim të drejtë, prezumimi i pafajësisë, ndër të tjera, do të thotë se barra e provës në një gjykim penal bie mbi ndjekjen penale dhe se i akuzuari ka avantazhin e dyshimit.

E drejta e njoftimit të menjëhershëm për natyrën dhe shkakun e akuzave penale

Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij/saj, të gjithë kanë të drejtë, në barazi të plotë "për t'u informuar menjëherë dhe në mënyrë të detajuar në gjuhën që ai/ajo kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij/saj." Kjo detyrë për të informuar ka të bëjë me një përshkrim të saktë juridik të veprës penale ("natyra") dhe të fakteve të saj ("shkaku") dhe në këtë mënyrë është më e gjerë se të drejtat përkatëse të dhëna në Nenin 9 (2) të KNDCP të zbatueshme për të arrestuar.

E drejta për kohë dhe lehtësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes

Neni 14 (3) (b) i KNDCP parashikon se në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij apo saj çdokush ka të drejtë "Të ketë kohën dhe lehtësirat e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe të komunikojë me avokatin e zgjedhur prej tij". E drejta për kohën dhe lehtësirat e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes vlen jo vetëm për të pandehurin, por edhe për avokatin e tij mbrojtës si dhe duhet të respektohet në të gjitha fazat e procedurave.

E drejta për të mbrojtur veten personalisht ose përmes një këshilltari ligjor

E drejta për avokat në fazat paraprake të një gjykimi penal, siç u diskutua më parë në këtë material, është e lidhur në mënyrë të qartë me të drejtën për mbrojtje gjatë gjykimit të përcaktuar në nenin 14 (3) (d) të KNDCP. Dispozita thekson se çdokush ka të drejtë, në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij/saj të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike të zgjedhur prej tij; të informohet, nëse ai nuk ka ndihmë juridike, për këtë të drejtë; dhe të ketë ndihmë juridike të caktuar për të, në çdo rast kur kërkohet nga interesat e drejtësisë, dhe pa pagesë nga ana e tij, në çdo rast të tillë, nëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme të paguajë për të.

E drejta për të pyetur dëshmitarët

Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij/saj, çdokush ka të drejtë "Për të shqyrtuar, ose të ketë shqyrtuar, dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij në kushte të njëjta me dëshmitarët kundër tij". Kjo e drejtë është një element thelbësor i parimit të barazisë së palëve. Termat "për të shqyrtuar, ose kanë shqyrtuar" duhet të kuptohen si një njohje e dy sistemeve kryesore të së drejtës penale, hetimor dhe ai akuzues. Duhet të theksohet se, sipas vetë tekstit, mbrojtja nuk ka një të drejtë të pakufizuar të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve në favor të të pandehurit, por vetëm "nën të njëjtat kushte" si me dëshmitarët kundër tij/saj.

Nuk vendosen kufizime të tilla edhe për prokurorinë. Ndërsa një gjykatë ndihmohet në mënyrë të drejtë dhe të lirë në thirrjen e dëshmitarëve, ajo duhet ta bëjë këtë në përputhje me parimin e drejtësisë dhe barazisë së palëve. Kjo, nga ana tjetër, detyron që palët të trajtohen në mënyrë të barabartë në lidhje me paraqitjen e provave me anë të marrjes në pyetje të dëshmitarëve.

E drejta për përkthyes

Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij/saj çdokush ka të drejtë "Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq" [Neni 14 (3) (f)]. E drejta për përkthyes zbatohet në mënyrë të barabartë për shtetasit dhe të huajt, por nuk mund të kërkohet nga një person i cili është i aftë mjaftueshëm në gjuhën e gjykatës. Kur e drejta për ndihmën e një përkthyesi jepet, ajo është falas dhe në asnjë mënyrë nuk mund të kufizohet duke kërkuar pagesën nga i pandehuri pas dënimit.

Ndalimi për vetë-inkriminim

Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij/saj, çdokush ka të drejtë "Të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pohojë veten fajtor" [Neni 14 (3) (g)]. Kjo

dispozitë synon të ndalojë çdo formë të detyrimit, qoftë direkt ose indirekt, fizik apo mendor, dhe nëse para ose gjatë gjyqimit, që mund të përdoret për të detyruar të akuzuarin të dëshmojë kundër tij/saj apo të pohojë fajësinë.

Dallimi kryesor i kërkesës së "drejtësisë" nga të gjithë elementet e tjera të nenit 6 është se ajo mbulon procedurat si një e tërë, dhe pyetja nëse një person ka patur një gjykim "të drejtë", është parë me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo thjesht për një incident të veçantë apo defekt procedural; si rezultat, defektet në një nivel mund të zgjidhen në një fazë të mëvonshme.

Nocioni i "drejtësisë" është gjithashtu i pavarur nga mënyra se si procedura vendase interpreton një shkelje të rregullave dhe kodeve përkatëse me rezultatin që një defekt procedural që con në shkelje të procedurës vendase – madje edhe një rast flagrant - mund të mos rezultojë në vetvete në një gjykim "të padrejtë", dhe anasjelltas, një shkelje mund të ketë sipas nenit 6 edhe kur legjislacioni vendas është respektuar.

Një shqyrtim i statusit të zakonshëm të ligjit ndërkombëtar të vëzhgimit të gjyqimit është jashtë objektit të këtij shqyrtimi. Megjithatë, praktika e dërgimit dhe pranimit të vëzhguesve të gjyqimit sot është aq e përhapur dhe e pranuar sa tashmë mund të përbëjë një normë të së drejtës ndërkombëtare zakonore. Zhvillimi i shpejtë i institucionit të vëzhgimit gjykues gjatë disa dekadave të kaluara mund t'i atribuohet kryesisht njohurive dhe integritetit të individëve të cilët kanë shërbyer si vëzhgues. Në mënyrë që kjo metodë e monitorimit të të drejtave të njeriut të zgjerohet më tej, standartet e larta të arritura deri më tani duhet të ruhen dhe rafinohen vazhdimisht. Kjo, ndër të tjera, do të thotë se monitoruesit vetë duhet të jenë gjithnjë e më shumë individë të njohur me problemet e standartet vendore dhe ndërkombëtare për gjykim të drejtë. Në praktikë, ata duhet të sjellin në kryerjen e detyrës së tyre cilësitë e vërteta që monitorojnë: ndershmërinë dhe humanizmin.

KREU VIII

PROBLEME TEORIKE DHE PRAKTIKE GJATE GJYKIMIT TE CESHTJEVE QE LIDHEN ME TRAFIKIMIN E QENIEVE NJEREZORE

8.1 Zhvillimi i çështjes në formën e gjykimit të zakonshëm.

Si në të gjitha rastet e tjera të pandehurit gjatë gjykimit të çështjeve që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore kanë të drejtat që ligji procedural iu ofron. Ata mundet të kërkojnë që të zhvillojnë gjykimin në formën e gjykimit të zakonshëm ose në formën e gjykimit të shkurtuar. Thuajse në të gjitha rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, të pandehurit dëshirojnë që të zhvillojnë çështjen në formën e gjykimit të zakonshëm.

Kjo ndodh për disa arsye:

Së pari

Shpresojnë tek ndryshimi i thënieve të bëra nga e dëmtuara gjatë fazës së hetimeve paraprake.

Së dyti

kërkojnë përballjen në gjykim me viktimën e trafikimit, për efekt ballafaqimi.

Së treti

Shumica e të pandehurve nuk janë të bindur për fajësinë e tyre, duke qënë se edhe sikur të pranojnë veprimin e konsiderojnë si një ndihmë që u është dhënë viktimave të trafikimit.

Më poshtë po marrim në analizë rastin e zhvillimit të një çështjeje në formën e gjykimit të zakonshëm.

Çështja penale: Shteti kundër A.B dhe A.B

Fakti penal⁸⁶ sipas provave e akteve që u administruan në prani të palëve në seancë gjyqësore rezulton:

Në vitin 2008 e dëmtuara V, është larguar nga banesa e saj në fshatin Çermë pa dijeninë e prindërve. Ajo ka jetuar në banesa të ndryshme me shoqet në Tiranë dhe në tetor 2009 ka filluar punë si kamariere në një lokal. Gjatë kohës që punonte në këtë lokal është njohur me të pandehurin A. B, i cili frekuentonte si klient lokal. Në nëntor 2009 e dëmtuara V ka krijuar një lidhje dashurie me të pandehurin A. B dhe ka bashkëjetuar me të. Gjatë bashkëjetesës e dëmtuara ka mësuar faktin se i pandehuri ishte shpallur në kërkim nga policia pasi ishte i dënuar

⁸⁶⁾ Vendimi me Nr 105 dt 02.12.2013 i Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda, Tirane, nr. 105, dt. 02.12.2013,.

dhe kërkohej nga policia. Pas rreth një vit bashkëjetese, në nëntor 2010 i dyshuari A. B i ka deklaruar të dëmtuarës V se nuk kishin para për të jetuar dhe për këtë arsye i ka kërkuar asaj të punonte si prostitutë jashtë shteti.

E dëmtuara ka pranuar të prostitutojë duke qenë e detyruar për shkak të mbështetjes që i kishte dhënë ai gjatë lidhjes së tyre. Gjithashtu ajo ka deklaruar se ka pranuar të punojë si prostitutë duke mos patur dijeni për kushtet e prostituimit, por duke u nisur thjesht nga fakti se në këtë mënyrë do t'i shpërblente mirënjohjen që ai kishte treguar ndaj saj, duke i dhënë mbështetjen që asaj i mungonte nga familja. Në këto kushte i pandehuri në marrëveshje me vëllain e tij ka organizuar nisjen e të dëmtuarës për në Itali. E dëmtuara dhe i pandehuri kanë udhëtuar nga aeroporti i Rinasit për në Itali në datën 28 dhjetor 2011 bashkë me persona të tjerë. E dëmtuara dhe i pandehuri kanë qendruar disa ditë në qytetin Bergamo në një shtëpi me qira të cilën e kishte siguruar një mik i te pandehurit.

E dëmtuara V ka punuar në tregun e prostitucionit në Bergamo për rreth 4 ditë, ku nga puna e kryer ka përfituar 380 euro të cilat ja ka dhënë të pandehurit.

Ajo dhe i pandehuri janë kthyer në Shqipëri në datën 08 janar 2011. Pas kthimit në Shqipëri i pandehuri A.B i ka kërkuar përsëri të dëmtuarës të shkonte në Austri për të punuar si prostitutë pasi nuk kishin para për të jetuar. Në ndikimin e të njëjtave kushte si herën e parë e dëmtuara ka pranuar dhe bashkë me Ar. B, vëllane e të pandehurit janë nisur në datën 12 shkurt 2011 për në Austri. E dëmtuara V. S dhe Ar. B kanë qendruar disa ditë në Baden. I dyshuari Ar.B bashkë me një shokun e tij kosovar i ka gjetur punë të dëmtuarës në lokalitë e natës “Rouge”, ku ka punuar si prostitutë rreth një javë. Fitimet që ajo ka realizuar nga puna si prostitutë në lokalitë “Rouge” në shumën 350 euro ia ka dorëzuar të dyshuarit Ar. B, i cili nuk punonte.

Këto rrethana kanë dalë në pah gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes të zhvilluar në formën e gjykimit të zakonshëm, ku gjatë seancave të zhvilluara janë marrë provat e kërkuara nga palët. Në këtë mënyrë gjatë procesit janë administruar si provat me dëshmitarë ashtu dhe provat shkresore. Dëshmia kryesore në proces ishte ajo e të dëmtuarës dhe konkretisht shtetases V, deklaratimet e të cilës ishin marrë më parë në kohë me sigurim prove.

Në deklaratimet e saj dëshmitarja tregon:

*Largimin nga banesa e prindërve,
Mbërritjen në Tiranë,
Njohjen me të pandehurin A.B ,
Krijimin e lidhjes dashurore me të pandehurin A.B dhe fillimin e bashkëjetesës mes tyre,
Propozimi për të punuar si prostitutë,
Krijimi i kushteve për pranim nga e dëmtuara për të punuar si prostitutë,
Organizimi i transportimit të të dëmtuarës jashtë shtetit,
Shfrytëzimi i të dëmtuarës.*

Këto deklaratime janë mbështetur dhe nga deklaratimet e dhëna nga dëshmitarët e tjerë, pombi të gjitha këto deklaratime janë në unitet të plotë me njëra tjetrën dhe me provat e tjera të administruara në proces. Gjatë hetimit janë mundur të sigurohen prova të cilat kanë vërtetuar të gjithë dëshminë e dhënë nga e dëmtuara. Ndaj në këtë mënyrë përveç bindjes së brendshme

Gjykata e ka patur të lehtë të bëjë çmuarjen e provave sipas parashikimeve të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale. Çmuarja e provave⁸⁷ është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. *Përveç dëshmisë së dëshmitares gjykata përdori në proces dhe kundërshtimin e dëshmisë si dhe leximet e lejueshme.*

(Kundërshtimi i dëshmisë)⁸⁸

.....3. Deklarimet e dhëna para prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

(Leximet e lejueshme)⁸⁹

.....3. Leximi i deklarimeve të bëra nga shtetasi shqiptar ose i huaj, banues jashtë shteti, mund të bëhet në qoftë se ai është thirrur dhe nuk është paraqitur ose kur nuk gjendet, megjithë kërkimet e bëra nga policia gjyqësore, si dhe kur refuzojnë të dëshmojnë. Në këtë rast akti vlerësohet duke u ldhur me provat e tjera. *Neni 380 (Provat që mund të përdoren për të marrë vendim)*
Për të marrë vendim gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.

Si bazë për të provuar se cilët persona janë përfshirë në këtë aktivitet kriminal janë deklaratimet e bëra nga dëshmitarja e dëmtuar V.S dhënë në seancat gjyqësore të sigurimit të provës në datat 18.11.2011 e 28.11.2011. Nga hetimi gjyqësor i kësaj çështjeje rezultoi e provuar se deklaratimet e dëshmitares së dëmtuar V.S janë të vërteteta dhe përputhen dhe me provat dhe aktet e tjera të marra gjatë këtij gjykimi duke i konfirmuar kështu deklaratimet e dhëna prej saj si më poshtë:

Së pari: Fakti se e dëmtuara V.S ka qënë e lidhur me të pandehurin A.B i cili i ka kërkuar asaj të shkojë jashtë shteti pasi atij i duheshin para sepse ishte në ndjekje penale.

Së dyti: Fakti se e dëmtura V.S është shtyrë nga i pandehuri A.B që të pajiset me pasaportë e më pas të niset për në Itali e Austri gjithnjë nën shoqërimin e mbikëqyerjen e të pandehurit A.B që është vellai tjetër.

Së treti: Fakti se dëmtuara V.S në kohën kur ka qënë në Itali e shoqëruar nga i pandehuri Ar.B ka ushtruar prostitucion për katër ditë, ku ka fituar 380 euro të cilat ja ka dorëzuar të pandehurit.

Së katërti: Faktin se e dëmtuara V.S në kohën që ka qënë në Austri ka punuar si prostitutë për tre ditë në "Rouge", ku nga kjo punë ka përfituar shumë 350 euro të cilat ja ka dorëzuar të pandehurit Ar. B.

Së pesti: Fakti se dëshmitaria e dëmtuar V. S ka dërguar një pako si dhe 500 euro nga Austria për llogari të pandehurin A. B.

⁸⁷) Neni 152 i Kodit të Procedurës Penale të RSH-së.

⁸⁸) Neni 362 i Kodit të Procedurës Penale të RSH-së.

⁸⁹) Gjykata vendos edhe kryeisht që të lexohen, tërësisht apo pjesërisht aktet që përmbahen në fashikullin për shqyrtimit gjyqësor, neni 369 i Kodi të Procedurës Penal të RSH-së.

Së gjashti: Fakti që i pandehuri A B ka ushtruar dhunë fizike ndaj të dëmtuarës V.S, pasi ajo nuk kishte punuar si prostitutë gjatë gjithë kohës që kishte qëndruar në Austri provohet me deklaratimet e dëshmitarëve V.S, dhe dëshmiat e tjerë.

Nga tabloja e paraqitur rezulton:

Së pari: I pandehuri A.B pasi është njohur me të dëmtuarën V.S duke përfituar nga situata e saj vulnerabël (e vetme e larguar nga familja, pasi ajo kishte ambient armiqësor në familjen e saj) në fillim e ka mbajtur atë në banesë, më pas ka krijuar raporte intime me të megjithëse ishte i fejuar, duke krijuar tek ajo besimin se ai e donte vërtetë pra në këtë mënyrë ka realizuar skllavërimin e të dëmtuarës V. S jo në modelin klasik të rekrutimit nëpërmjet dhunës.

Së dyti: I pandehuri A duke patur një mendim tashmë të mirëfilltë kriminal i ka blerë të dëmtuarës V. S dhurata joshëse me qëllim që të krijonte tek kjo e fundit një varësi të detyrueshme ekonomike të cilën do ta shfrytëzonte më pas.

Së treti: I pandehuri A pasi tashmë kishte konsoliduar epërsinë e tij ndaj të dëmtuarës V, sepse ajo tani kishte detyrim ndaj tij (për të mirat që i kishte bërë ai), në vende e mjedise të ndryshme është shprehur se atij i duheshin para sepse ishte në proces gjyqësor. Në këto momente i është drejtuar asaj që ato duheshin të largoheshin jashtë shteti për të punuar, ofertë të cilën e dëmtuara e ka pranuar pasi ajo tashmë ndjehej si debitore ndaj tij për të mirat që ai i kishte bërë, por në asnjë moment pa ditur se çfarë ishte puna si prostitutë. Për të realizuar udhëtimin jashtë shteti i pandehuri A ka bashkëpunuar me vëllain e tij të pandehurin tjetër Ar, i cili nën udhëzimet e A.B-së ka shoqëruar e ndihmuar të dëmtuarën për të nxjerrë pasaportën biometrike.

Së katërti: I pandehuri A duke shfrytëzuar njohjet e tij, ka organizuar punën për dërgimin e të dëmtuarës V në Itali nën shoqërimin e mbikqyerjen e të pandehurit tjetër.

Së pesti: I pandehuri A.B ka kontrolluar nëpërmjet komunikimit me telefon gjithë veprimet që kryente e dëmtuara V jashtë shteti, megjithëse ajo ishte nën shoqërimin e mbikqyerjen e të pandehurit Ar. B.

Së gjashti: I pandehuri A në momentin kur është kthyer e dëmtuara V nga Austria, ka ardhur në dijeni se ajo nuk ka punuar gjatë gjithë kohës së qëndrimit të saj në Austri si prostitutë dhe për këtë shkak ka ushtruar dhunë fizike ndaj saj, duke i kërkuar asaj që ti shlyente borxhet që ajo tashmë i kishte atij.

Së shtati: Dhënia e pëlqimit nga e dëmtuara V.S për të punuar është bërë në kushtet e vënies së saj para detyrimit për të pëmbushur borxhet që ajo i kishte të pandehurit A.B. Pra vullneti i të dëmtuarës nuk ka qenë i lirë por i detyruar nga kushtet familjare, shoqërore ekonomike të imponuara dhe nga i pandehuri A.B. Në këtë rast jemi në përputhje me frymën e Protokollit të Dytë të Konventës Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr.8920 datë 11.07.2002.

Elementët e veprës penale të konsumuar nga të pandehurit janë:

Objekt i veprës penale Janë ato marrëdhënie juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe dinjitetin e shtetasve në tërësi dhe në veçanti integritetin trupor të tyre nga veprimet kriminale dhe që mbrohen posaçërisht nga legjislacioni penal nëpërmjet nenit 110/a-4 të Kodit Penal.

Nga ana objektive Të pandehurit veprën e kanë kryer me veprime aktive në bashkëpunim, veprime këto të kryera në vijimësi në harkun kohor nga nëntori 2010 deri në prill 2011.

Subjekt të veprës penale Janë të pandehurit A e Ar. B madhorë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, nga të cilët i pandehuri A i dënuar më parë, ndërsa i pandehuri Ar i rehabilituar.

Nga ana subjektive Veprën penale të pandehurit A.B dhe Ar.B e kanë kryer me qëllim realizimin e fitimit material me çdo kusht, dhe vetëm në sajë të largimit të të dëmtuarës është bërë e mundur minimizimi i pasojave të kryerjes së veprës penale, pra ndërprerja e shfrytëzimit të shtetasës V.S.

Si përfundim të pandehurit janë deklaruar fajtorë dhe dënuar me 15 vjet heqje lirie pasi kanë konsumuar plotësisht elementët e veprës penale “Trafikimi i personave të rritur”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/a-4 i Kodit Penal.

-Në masën dhe llojin e dënimit janë mbajtur parasysht:

Rrezikshmeria e veprës, rrezikshmëria e autorëve ku i pandehuri A ka qënë i dënuar më parë, ndërsa i pandehuri Ar është i rehabilituar, qëndrimin mohues të pandehurve të cilët mohojnë të kenë kryer veprën për të cilën akuzohen, kohën e shfrytëzimit të dëmtuarës e cila është relativisht e shkurtër afro 7 ditë në dy raste. Në këto kushte gjykata çmon se për secilin të pandehur duhet caktuar si masë dënimi ajo prej 15 vjet burgim.

Problemet e hasura gjatë gjykimit të çështjes

Nga kjo çështje nxjerrim në pah disa elementë për efekt analize:

Së pari

Ilustrojmë në rang praktik një ndër format e trafikimit dhe konkretisht nëpërmjet rekrutimit me qëllim shfrytëzimi seksual. I dënuari A.B e ka gjetur të dëmtuarën në një gjendje vunerabël, të shkëputur nga familja dhe e vetmja strehë e jetesës së saj është bërë i pandehur.

I dënuari ka krijuar me të dëmtuarën marrëdhënie afektive duke ndikuar në psikologjinë e saj në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Së dyti

Në ngjarjen ë mësipërme hasim dhe një fakt tjetër që i dënuari është mundur ta shfrytëzojë, faktin që e dëmtuara ka dhënë pëlqimin me veprime konkludente. Por me të drejtë Gjykata në vendimin e saj ka konkluduar se i pandehuri është fajtor duke qënë se i është afuar, e ka joshur, mbajtur dhe më pas shfrytëzuar të dëmtuarën. Është mjaft i rëndësishëm ky fakt duke patur

parasysh se dhënia e pëlqimit në shumë raste shihet si një lloj marrëveshje për të kryer veprimtarinë, duke patur tendencë që vepra penale të kualifikohet si shfrytëzim prostitucioni dhe jo si trafikim. Gjykata arsyeton “Pra vullneti i të dëmtuarës nuk ka qenë i lirë por i detyruar nga kushtet familjare, shoqërore ekonomike të imponuara dhe nga i pandehuri A.B. Në këtë rast jemi në përputhje me frymën e Protokollit të Dytë të Konventës Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr.8920 datë 11.07.2002’.

Së treti

Procesi gjyqësor është bazuar në provat me dëshmitarë dhe provat shkresore. Ndërkohë është proceduar me sigurimin e provës që në fazën e hetimeve paraprake. Për efekt analize do ndaloj në trajtimin e faktit nëse sigurimi i provës është gjithnjë i detyrueshëm në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, dhe a është i efektshëm si mjet procedural. Për të dhënë një përgjigje të saktë nxjerrim në pah anët pozitive dhe negative të rastit konkret. Normalisht që sigurimi i provës realizohet në rastet kur përmbushen kriteret e përcaktuara në ligjin procedural.

Gjatë hetimeve paraprake, prokurori dhe i pandehuri mund të kërkojnë nga gjykata që të procedohet me sigurimin e provës⁹⁰⁾ në këto raste:

- a- në marrjen e dëshmisë së një personi, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ai nuk mund të pyetet në shqyrtimin gjyqësor për shkak sëmundjeje ose pengesë tjetër serioze;
- b- në marrjen e dëshmisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune, kanosje ose premtimi për t'i dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi ose të bëjë dëshmi të gënjeshtërt;
- c- në pyetjen e të pandehurit për faktet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e të tjerëve, kur ekziston një nga rrethanat e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b";
- ç- në ballafaqimin ndërmjet personave që para prokurorit kanë bërë deklaramë kundërthënëse, kur ekziston një nga rrethanat e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b";
- d- për një ekspertim apo eksperiment gjyqësor, kur prova ka të bëjë me një person, një send a një vend, gjendja e të cilëve mund të pësojë ndryshime të pashmangshme.

Duke parë kontekstin e ligjit sigurimi i provës është një mjet që i vjen në ndihmë qoftë të pandehurit ashtu dhe organit të akuzës. Do të thonim se nga ana e Gjykatës ka patur raste kur është vendosur deklarimi i pafajshëm i të pandehurit pavarësisht se çështja është dërguar për gjykim edhe pse është bërë sigurim prove. Kjo rrjedh dhe nga fakti se duke qënë se është një tjetër trup gjykues që bën sigurimin e provës dhe një tjetër trup gjykues që zgjidh çështjen në themel, gjykatës në rastin e sigurimit të provës i mungon kontakti i drejtëpërdrejtë me të dëmtuarën, me qëllim që të kuptojë para së gjithash dëmtimin psikologjik që i është shkaktuar asaj. Nga ana tjetër një tjetër anë negative është dhe fakti që deklaramet e marra me sigurim prove mundet të mos mbështeten në prova të tjera. Ndërsa si anë pozitive përmendim faktin se sigurimi i provës, konkretisht të dëshmisë së të dëmtuarës në proces është i rëndësishëm për shkak të mosndryshimit të thënieve nga ana e të dëmtuarës gjatë procesit gjyqësor.

⁹⁰⁾ Sigurimi i provës, neni 316 i Kodit të Proçedurës Penale të RSH-së.

8.2 Zhvillimi i çështjes në formën e gjykimit të shkurtuar

Në lidhje me faktin⁹¹ për të cilin u gjykua i pandehuri P Kaci, ka rezultuar se më datë 01.02.2010 policia gjyqësore në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Kukës ka shoqëruar pranë vendkalimit kufitar Morinë shtetasit P Kaci, me shtetasen E lindur në Bulqizë dhe me banim të përkohshëm në Babrru Tiranë dhe shtetasen M banuese në Kopliq Dibër. Këta shtetas do të shkonin në drejtim të Kosovës së bashku. Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës pasi bëri verifikimet e para ka nisur fillimisht procedimin penal ndaj të pandehurit P Kaci dhe ka përcjellë aktet e para procedurale në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Aktet procedurale policia gjyqësore Kukës, i ka sjellë në Tiranë për shkak se i pandehuri dyshohej se kishte kryer veprën penale të “Trafikimit të femrave” parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal.

Shtetasja E, me datë 02.02.2010, në Drejtorinë e policisë së Qarkut Tiranë, ka paraqitur një kallëzim penal ku ka shpjeguar se shtetasin P Kaci e ka njohur tek një lokal muzike në Tiranë në Rr. “Naim Frashëri”, ku ai ishte pronar këtij aktiviteti. Kallëzuesja ka punuar prej tre vjetësh në lokalin ku ushtronte aktivitetin tregëtar i pandehuri. Kohët e fundit ajo ka shpjeguar se është shfrytëzuar në mënyrë sistematike për prostitucion në qytetin e Tiranës në hotele të ndryshme dhe me klientë të ndryshëm e detyruar prej të pandehurit P Kaci. Ky i fundit i ka propozuar për ta marrë në Kosovë për të punuar po në një lokal nate si prostitutë dhe paratë e fituara do ti ndante me të. Për këtë fakt e dëmtuara E shpjegon se ka qenë e detyruar të nënshtrohet prej dhunës dhe shtrëngimit që ushtronte i pandehuri P Kaci.

Shtetasja M në deklarinimin që ka dhënë para policisë gjyqësore ka shpjeguar se qëllimi që do të shkonin në Kosovë me të pandehurin P Kaci ishte ushtrimi i prostitucionit dhe fitimet do ti ndanin së bashku. I pandehuri P Kaci i ka premtuar gjithashtu se punën e kishin të garantuar tek një miku i tij që kishte lokal në Kosovë dhe se do ti paguante për shërbimin që do të kryente kjo shtetase. Ndaj shtetasen M nuk janë nisur hetimet.

Në fazën e hetimeve paraprake prokuroria ka kërkuar në gjykatë që të sigurojë dëshminë (provën) e të dëmtuarës E. Gjykata me vendimin për sigurim prove nr.04 datë 11.02.2010 pranoi kërkesën e prokurorisë për të marrë këtë prove dhe në seancën e sigurimit të provës datë 19.02.2010 u administrua dëshmia e shtetasen së dëmtuar E. Ajo në këtë seancë rikonfirmoi faktin që kishte kallëzuar para policisë gjyqësore në lidhje me veprimet e të pandehurit P Kaci duke qartësuar momentin e rekrutimit dhe më pas transportimit të saj në drejtim të Kosovës me qëllim shfrytëzimin e saj si prostitutë.

⁹¹⁾ Vendimi Nr 10 dt 25.02.2011 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Kriem të Rënda, Tiranë me te pandehur P.Kaci.

Në fillim të dëshmisë së saj e dëmtuara E shpjegoi mënyrën e njohjes me të pandehurin P Kaci dhe formën se si i pandehuri duke shfrytëzuar gjendjen e saj sociale dhe ekonomike mjaft të vështirë e rekrutoi atë duke e shfrytëzuar si prostitutë në Tiranë me qëllim krijimin e një vartësie ndaj saj për të arritur më pas transportimin dhe zhvendosjen e të dëmtuarës në Kosovë për të ushtruar prostitucionin e detyruar nga rrethanat e krijuara prej të pandehurit.

Sipas elementëve të pasqyruar sa më lart i pandehuri ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të Trafikimit të femrave, sipas nenit 114/b të Kodit Penal, sipas të cilit: Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e femrave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tre milionë deri në gjashtë milionë lekë.

...

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtim dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarës, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë milionë deri në tetë milionë lekë.

Gjithashtu i pandehuri ka konsumuar dhe elementët e figurës së veprës penale sipas nenit 278/3 të Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”.

Argumentimi ligjor

I pandehuri P Kaci ka trafikuar për në drejtim të Kosovës shtetasen Elisabeta Sallaku. Ai fillimisht duke përfituar nga gjendja e saj vulnerabël e ka punësuar në lokalitetin e tij si kamariere dhe gjatë kësaj kohe ka përfituar duke e shfrytëzuar seksualisht në klientët e lokalitetit të dëmtuarën Elisabeta Sallaku. I pandehuri ka krijuar në këtë mënyrë një marrëdhënie varësie me të dëmtuarën. Si pasojë e këtij raporti, i pandehuri nuk ka nguruar që të ushtrojë dhunë ndaj të dëmtuarës me qëllim që të përfitonte shërbimet seksuale prej saj.

I pandehuri pasi e ka shfrytëzuar të dëmtuarën në Shqipëri, e ka marrë atë me qëllim trafikimin e saj në Kosovë. E dëmtuara në Kosovë do të ushtronte prostitucionin. Një fakti i tillë konfirmohet jo vetëm nga dëshmia e të dëmtuarës, por edhe nga deklarimi që ka dhënë shtetasja Mertia Manjani e cila edhe ajo me pëlqimin e saj do të ushtronte prostitucionin në Kosovë për qëllime fitimi.

Konkluzione për gjykimin e çështjes në formën e gjykimin të shkurtuar:

Gjykimin e shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore sepse:

thjeshton dhe shkurton procedurat e gjykimin,

rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimin,

Gjykimin e shkurtuar ka vlerë për të pandehurin sepse:

sjell përfitim për të pandehurin duke ulur masën e dënimit me 1/3,

sjell si pasojë mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm, Gjykimi i shkurtuar është në dëm të të dëmtuarit sepse: nuk pranohet padia civile në procesin penal.

8.3 Gjykimi në mungesë

Çështja penale shteti kundër Gj. Mirashi⁹²⁾

Që në fillim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje mbrojtja e të pandehurit Gj M, parashtroi disa kërkesa që kishin të bënin me mënyrën e regjstrimit të këtij procedimi nga ana e Prokurorisë si dhe për mos përfshirjen e saj në juridiksionin e kompetencën e kësaj gjykate.

Me vendim të ndërmjetëm të datës 03.02.2010, Gjykata, duke parë aktet e fashikullit të gjykimit, vendosi rrëzimin e pretendimeve të mbrojtjes pasi vlerësoi se, bazuar në nenin 75/a, 287 të K.Pr.Penale si dhe në bazë të nenit 6/2 të K.Penal, Prokuroria për Krime të Rënda, ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, ka patur të drejte, madje edhe detyrim ligjor, që të regjistronte procedimin penal ndaj shtetasit Gj. Lami (Mirashi) dhe të fillonte e vijonte ndjekjen penale ndaj tij.

Në këtë përfundim arriti Gjykata pasi çmon se organi i Prokurorisë duhet të rregjistrojë çdo njoftim që merr për ekzistencën e një veprë penale, pavarësisht se në çfarë mënyre e ka marrë njoftimin. Pas njoftimit, marrjes së dijenisë, Prokurori edhe me inisiativën e vet duhet të rregjistrojë procedimin penal e të fillojë ndjekjen penale, ashtu siç është vepruar në këtë çështje. Çështja u zhvillua në mungesë të të pandehurit duke qënë se ai i fshihej drejtësisë me qëllim shmangien nga procedimi penal.

Duke qënë se në këtë rast vepra penale kishte ndodhur jashtë territorit të RSH-së edhe provat për të provuar akuzën duhej të vinin me anë të letërporosisë.

Në përfundim të gjykimit Gjykata deklaroi fajtor të pandehurin Gj. M duke e dënuar atë me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk ka asnjë rast të zhvillimit të gjykimit të çështjeve që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore me gjykim të drejtëpërdrejtë për shkak të: natyrës komplekse të çështjeve, nevojës për veprime hetimore, mungesës së rasteve të flagrancës.

Problemet e hasura gjatë fazës së gjykimit mund të përmbliidhen sa më poshtë:

marrja në pyetje e një numri të madh dëshmitarësh të cilët ndikojnë në zgjatjen e shqyrtimit gjyqësor,

⁹²⁾ Vendimi me Nr 28 dt 23.04.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me të pandehur Gj. Mirashi.

zgjatja e procesit gjyqësor për shkak të kërkesës për ndihmë juridike që u është bërë autoriteteve të huaja kur është parë e domosdoshme marrja e provave jashtë territorit të R.Sh-së, moskrijimi i bindjes së brendshme tek Gjykata për fajësinë e të pandehurit kur operohet me sigurim prove për dëshminë e të dëmtuarës, duke ndikuar fakti i mosvendosjes së kontaktit të gjykatës me të dëmtuarin nga vepra penale, zgjatja e procesit gjyqësor con në humbjen e aktualitetit.

Problemet e hasura gjatë fazës së hetimeve paraprake:

Ndjekja penale fillon nëpërmjet disa rrugëve dhe konkretisht:

- kallëzimit të bërë nga i dëmtuari nga vepra penale,
- kallëzimi i bërë nga familjarët e të dëmtuarës nga vepra penale,
- kallëzimi i bërë nga shtetas të tjerë,
- referimi nga organet e policisë,
- rastet e flagrancës.

Gjatë hetimit të këtyre çështjeve penale hasen probleme të mëdha të cilat lidhen dhe me faktin sesi ka filluar ndjekja penale.

Në rastin kur kallëzimi bëhet nga e dëmtuara, haset vështirësi për shkaqet e mëposhtme:

- i dëmtuari nga vepra penale ose viktima e trafikimit për shkak të situatës së rënduar psikologjike e ka të nevojshme një kohë të mjaftueshme në dispozicion me qëllim që të japë dëshminë e tij. Ky proces mundet të marrë ditë të tëra, madje dhe javë. Në mundohemi ti japim kohën e duhur në dispozicion viktimës së trafikimit në mënyrë që të marrim një dëshmi të qartë dhe të saktë, se përndryshe deklaratimet e saj do të bëhen duke u referuar në data të gabuara, vende të gabuara apo dhe ngatërrim episodesh.
- i dëmtuari nga vepra penale mundet të ndryshojë qëndrim, dhe të mos pranojë të bashkëpunojë. Në raste të tilla për vetë karakterin kompleks që ka kjo veprë penale është e detyrueshme që të merren të dhënat nga dëshmitari kryesor. Duke qënë se veprimtaria e paligjshme zhvillohet në fshehtësi pa patur të dhënat bazë nuk mundemi të jemi të suksesshëm pasi veprime si këto janë të paregjistruara etj.

Në rastin kur kallëzimi bëhet nga familjarët e të dëmtuarit hasim vështirësi për shkaqet e mëposhtme:

- familjarët shpesh tregojnë rrethana për të cilat nuk kanë dijeni të drejtëpërdrejtë por janë rezultat i perceptimit të tyre,
- familjarët flasin me një urrejtje të jashtëzakonshme duke mos qënë korrektë dhe objektivë në deklaratimet e tyre.

Në rastin kur kallëzimi bëhet nga shtetas të tjerë, haset vështirësi për shkaqet e mëposhtme:

- këta shtetas mundet të jenë rastësorë në ngjarje dhe kanë dijeni të kufizuar.
- në të shumtën e rasteve edhe pse mundet të kenë më tepër dijeni nuk pranojnë të flasin ose bëjnë ta paditurit për shkaqe të mospërzierjes në ngjarje.
- duke qënë se vendi ynë është i vogël ndodh shpesh që dëshmitarët përtojnë të flasin për shkak të moskrijimit të konflikteve.

Probleme të tjera:

Kur e dëmtuara nuk pranon të qëndrojë në qendër rehabilitimi dhe largohet pa lënë adresë,
Kur e dëmtuara fillon të bashkëjetojë me të dyshuarin kryesor, madje ka patur raste që kanë lidhur dhe martesë gjatë kohës që kanë qënë të proceduar,
Është e nevojshme kryerja e veprimeve jashtë territorit të R.Sh-së, nëpërmjet letërporosisë të cilat zgjaten në kohë.

KREU IX

PANORAME KRAHASUESE DHE AKTET NDERKOMBETARE NE LIDHJE ME TRAFIKIMIN E QENIEVE NJEREZORE

9.1 “Trafikimi” i parë në këndvështrimin e legjislacionit penal të vendeve të ndryshme.

Duke qënë se trafikimi i qënieve njerëzore u bë një problem shumë i madh pasi u përhap në një mënyrë shumë të shpejtë, shumica e shteteve filluan të ndërmarin me shpejtësi masa të menjëhershme në drejtim të përgjigjes karshi këtij rreziku. Më poshtë po paraqesim disa veçori kryesore duke trajtuar në një analizë juridiko penale e krahasuase të legjislacioneve penale të disa shteteve si Italia, Franca, Gjermania, SHBA dhe Kosova. Synimi është që nepermjet analizës së këtyre kodeve, të evidentohen rregullimet ligjore me të mira që të krahasohen me legjislacionin tonë të brendshëm dhe të merret përvoja me të mire. Në këto kode spikat një teknike e qarte e inkriminimit të këtij fenomeni kriminal nën dritën e akteve juridike nderkombetare në fuqi.

9.1.a Legjislacioni penal Italian

Kodi Penal Italian aktualisht nuk përmban dispozita penale⁹³konkrete në lidhje me trafikimin. Autoritetet gjyqësore italiane për goditjen e trafikimit të qënieve njerëzore sot, operojnë me dispozita të tjera penale që parashikojnë si vepra penale një kategori sjelljesh që prezantohen gjatë një procesi trafikimi e kryesisht nëpërmjet sjelljeve që e vendosin individin në kushte skllavërie apo kushte të ngjashme me të si dhe nëpërmjet dispozitave ligjore që lidhen kryesisht me shfrytëzimin seksual. Italia është ndër të paktët shtete që e konsideron “trafikimin” si formë skllavërie dhe synon të godasë atë kryesisht nëpërmjet dispozitave penale që godasin skllavërinë dhe format e ngjashme me skllavërinë. Kështu në Kodin Penal Italian në Librin e Dytë, Kreun e III “Deliktet kundër lirisë personale” Seksioni I “*Delikte kundër personalitetit*” parashikohen një varg dispozitash në lidhje me skllavërinë: Neni 600 i K.Penal parashikon: “*Kushdo që redukton një person në skllavëri apo në një gjendje të ngjashme me skllavërinë dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet*”. Neni 601 i K.Penal parashikon: “*Kushdo që trafikon ose gjithësesi bën tregëti skllavërisht apo personash që janë në kushte të ngjashme me skllavërinë dënohet me burgim nga 5 deri në 20 vjet burgim*”.

⁹³) Kodi Penal Italian, nenet 600 e në vijim..

Neni 602 i K.Penal parashikon: *“Kushdo që, tej rasteve të parashikuara nënenet paraardhëse, ekstradon apo dorëzon një person që gjendet në një status skllavërie apo kushte të ngjashme me skllavërine ose e posedon ose e zoteron apo e mban në gjendje skllaverie ose kushte të ngjashme, denohet me burgim nga 3 në 12 vjet”*.

Edhe pse Kodi Penal Italian⁹⁴⁾ nuk parashikon se çfare nenkuptohet me konceptin reduktim (shnderim) në “skllaveri” apo “kushte të ngjashme me skllaverine”, jurisprudenca italiane i referohet koncepteve që janë perpunuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara Kunder Skllaverisë e vitit 1926 dhe Konventës Plotesuese për Zhdukjen e Skllaverisë, Tregëtisë së Skllaverive dhe InSTITUTEVE E PRAKTIKAVE TË NGJASHME ME SKLLAVERINE E vitit 1956. Jurisprudenca italiane me Vendimin e Seksioneve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të vitit 1996 ka argumentuar se lista e rasteve të situatave të ngjashme me skllaverinë që parashikohen në Konventën Plotesuese Kunder Skllaverisë e vitit 1956 nuk duhet kuptuar si një listë taksative por si një listë shembujsh dhe për të përcaktuar kushtet e ngjashme me skllaverinë duhet analizuar rast pas rasti çdo situatë faktike, nëse veprimet e të pandehurit kanë çuar në shndërrimin e personit të nënshtruar në kushtet materiale të skllaverisë dmth nënshkrimin e plote të tij ndaj pushtetit të një tjetri njesoj si skllavi ndaj padronit të tij.

Po kështu në një vendim të Gjykatës së Kasacionit të vitit 2004⁹⁵⁾, argumentohet se *“Nocioni “kushte të ngjashme me skllaverinë” që parashikohet në dispozitat ligjore ndër të cilat neni 600 i K. Penal, sjell situatën e vecante të një personi që vihet në kushtet e një “res” të zotëruar nga një tjetër; një situatë e tillë është atëherë kur viktimi, duke pësuar dhunë dhe presion psikologjik, vendoset në kushte të mjerueshme dhe të detyrimit, të tilla që të çojnë në prostitucionin nëpërmjet forcës dhe të shtypjes së lirisë personale nëpërmjet heqjes së aftësisë për të vepruar në mënyrë të pavarur”*.

Në shërbim të përfundimeve që do të terhiqen më poshtë në lidhje me legjislacionin Italian për trafikimin, me interes është të përmenden një seri amendamentesh të bërë në këto seksione duke ndërhyrur midis nenit 600 dhe 601, disa nëna që ildhen me prostitucionin e të miturve, pornografisë e të miturve, shpërndarjen e materialeve pornografike etj. Neni 600-bis i Kodit Penal *“Prostitucioni i të miturve”* bën të detyrueshme nxitjen, favorizimin apo shfrytëzimin e prostitucionit të një personi nën 18 vjeç duke parashikuar si denim burgimin nga 6 në 12 vjet si dhe gjohet në paragraf të dytë të këtij neni parashikohet denimi i personave që kundërshtojnë hollave apo përfitimeve të tjera ekonomike kryejnë akte seksuale me të mitura midis 14 dhe 16 vjeç e midis 16 e 18 vjeç. Neni 600-ter *“Pornografia me të mitur”* bën të detyrueshme sjelljen kriminale që synon të shfrytëzojë të miturit nën 18 vjeç për qëllime të realizimit të materialeve pornografike apo shfaqjeve pornografike duke parashikuar sanksione të rënda me burgim nga 6 në 12 vjet burgim sidhe me gjoba që arrijnë deri në 500 mijë lireta.

⁹⁴⁾ Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qënieve njerëzore. Tiranë 2006, fq 36-41.

⁹⁵⁾ Vendimi Nr. 21019, dt. 19.02.2004.

Ne paragrafet ne vijim te ketij neni ne menyre te detajuar parashikohen si vepra penale , shperndarja e materialeve pornografike me te mitur ne te gjitha format duke perfshire dhe mjetet telematike, apo shperndarja e njoftimeve ne lidhje me shfrytezimin e te miturve sipas paragrafit te pare. Ne vijim te kriminalizimit te pornografise me te mitur eshte dhe neni 600-ter i K.Penal i cili ben te denueshme shperndarjen apo disponimin e materialeve pornografike kur eshte ne dijeni se ato jane realizuar nepermjet shfrytezimit te te miturve. Me intereseshite dhe neni 600-quinques, "*Inisiativa turistike me perfshirje te shfrytezimit te prostitucionit te te miturve*" i cili synon te penalizojte te ashtuquajturin turizem seksual. Ligji nr.75 i vitit 1958 ose sic njihet Ligji Merlin.

Ky ligj ka patur per qellim kryesisht te godase shfrytezimin me dhune te prostitucionit dhe te beje te denueshme perfshirjen e te treteve ne prostitucion. Sipas ketij ligji edhe pse dekriminalizohet ushtrimi i prostitucionit privatisht, ndalohej prostitucioni neper shtepite publike i cili me pare kontrollohej nga shteti. Po keshtu ky ligj denon dhe personat qe shfrytezojne prostituta apo ata qe i drejtojne drejt prostitucionit duke perfshire dhe femrat e huaja. Sipas ketij ligji⁹⁶ parashikohet "nxitja apo transferimi i nje femre ne nje vend tjeter apo shtet tjeter per te ushtruar prostitucionin". Ligji i mesiperme edhe pse nuk i adresohet drejtperdrejt trafikimit, pasi e konsideron shfrytezimin e prostitucionit si nje krim kunder rendit publik dhe si nje krim kunder personit duke mos reflektuar natyren e shkeljes se rende te drejtave themelore te individit, ne situaten legjislative te Italise, jep kontributin e tij ne goditjen e trafikanteve qe merren me shfrytezimin e prostitucionit.

Dispozita te tjera penale ne sherbim te luftes kunder trafikimit jane dhe ato qe lidhen ne pergjithesi me lirine seksuale, Ligji nr 286 i vitit 1998 ne lidhje me imigracionin, neni 605 i K.Penal qe penalizon rrembimin apo heqien e paligjshme te lirise apo dispozitat qe lidhen me krijimin dhe pjesmarjen ne organizata kriminale, neni 416 i K.Penal, krijimin dhe pjesemarrjen ne nje organizate kriminale te tipit mafjoz neni 416-bis.

Nga analiza e dispozitave te mesiperme⁹⁷ mund te nxirren disa perfundime ne lidhje me legjislacionin penal Italian qe perdoret per te goditur trafikimin e qenieve njerëzore:

Italia nuk ka dispozita penale qe ne menyre te drejtperdrejtë kriminalizojne trafikun e qenieve njerëzore ne menyren se si eshte perkufizuar ai ne Konventen e Palermos. Italia e godet trafikimin e qenieve njerëzore nepermjet dispozitave mbi skllaverine duke e konsideruar trafikimin si forme skllaverie. Legjislacioni Italian fokusohet veçanerisht ne shfrytezimin seksual duke i konsideruar disa forma te agravuara te tij si situata skllaverie. Ne menyre te vecante Kodi Italian merr ne mbrojtje te miturit nga kercenimi i prostitucionit, pornografise etj. Kuadri ligjor penal merr ne konsiderate veçanerisht situaten fundore te trafikimit duke mbetur vulnerabel per goditjen e trafikimit ne situaten fillestare te tij.

⁹⁶) Ligji nr. 75 viti 1958, ligji Merlin, neni 3.

⁹⁷) Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qënieve njerëzore.. Tiranë 2006, fq 36-41.

9.1.b Legjislacioni penal gjerman

Analizen ne lidhje me Kodin Penal Gjerman⁹⁸⁾ do ta bejme duke e ndare ne dy periudha ; a) para nenshkrimit te Konventes se Palermos dhe protokolleve plotesuese; b) pas nenshkrimit te Konventes se Palermos.

a) Para nenshkrimit te Konventes se Palermos, ne Kodin Penal Gjerman trafikimi i qenieve njerezore parashikohej ne Kapitullin e 13 te Pjeses se Posacme “Krime kunder lirise seksuale” ne dy nene 180/b dhe 181 si dhe ne Kapitullin e 18 “Krime kunder lirise personale” ne nenin 236 “Trafikimi i femijeve”. Duke i perfshire ne kapitullin e 13 dy nenet e para, reflekohet qarte se sipas legjislatorit Gjerman trafikimi i qenieve njerezore kryesisht lidhej vetem me shfrytezimin seksual qe do te thote se eshte nje koncept me i ngushte se ai qe jep Protokolli i Dyte Shtese i Konventes se Palermos.

Keshtu ne nenin 180/b⁹⁹⁾te ketij Kodi “*Trafikimi i qenieve njerezore*”parashikohej sa me poshte: “*Kushdo qe per qellime te perfitimit material, ushtron influence mbi nje person tjeter, duke qene ne dijeni te nje situate detyrimi, shtyn nje person te perfshihet ne prostitucion apo te vazhdoje kete perfshirje, denohetjo me shume se 5 vjet burgim ose me gjobe. Kushdo qe per qellime te perfitimit material, ushtron influence mbi nje tjeter duke ditur situaten e pambrotjur te qendrimit te tij ne nje vend te huaj, duke e marre dhe perfshire ne akte seksuale, te cilat personi i kryen ne prani te nje te treti apo lejohet te kryhet ndaj personit nga nje i trete denohet njesoj.Kushdo qe ushtron influence:*

1. *mbi nje person, duke ditur situaten e pambrotjur te qndrimit te tij ne nje vend te huaj ose*

2. *mbi nje person nen 21 vjec*

per te shtyre personin të perfshihet apo te vazhdoje prostitucionin, denohet me burgim nga 6 muaj ne 10 vjet.

3. *Ne rastet e paragrafit 2, tentativa eshte e denueshme.*

Neni 181 i K.Penal “*Trafikimi serioz i qenieve njerezore*”parashikon:

“*Kushdo qe:I. me force, kanosje per per nje demtim te ndjeshem ose dredhi shtyn nje person tjeter te perfshihet ne prostitucion apo te vazhdoje ate,*

rekruton nje person tjeter me dredhi apo merr personin kunder vullnetit te tij me ane te kanosjes per demtim serioz apo dredhise, duke njohur situaten e pambrotjur te qendrimit te personit ne nje vend te huaj, per ta bere ate te kryej akte seksuale ne prani te nje personi te trete, apo te lejoje kryerjen e akteve nga te tretet mbi personin,

ne menyre profesionale rekruton nje person tjeter, duke ditur situaten e pambrotjur te qendrimit te personit ne nje vend te huaj, per te shtyre personin te peifshihet apo te vazhdoje prostitucionin,do te denohet me burgim nga 1 ne 10 vjet. Ne raste me pak serioze denimi do te jete me burg nga 6 muaj ne 5 vjet”

⁹⁸⁾ Po aty.

⁹⁹⁾ Kodi Penal Gjerman.

Nga dispozitat e mesiperme konstatohet se dispozitat mbi trafikimin me teper permbajne koncepte te shtytjes, nxitjes dhe shfrytezimit te prostitucionit se sa koncepte te trafikimit. Ato gjithashtu u referohen vetem situatave qe lidhen me prostitucionin dhe jo situatave te tjera. Dispozitat e mesiperme njohin konceptin e situates vulnerable te personave qe ndodhen ne nje vend te huaj duke penalizuar shfrytezimin e kesaj situate nga elemente kriminale per qellime te prostitucionit. Dispozitat qe permbajne koncepte me te aferta me konceptet e trafikimit jane ato te parashikuara ne paragrafet e 2 dhe te 3 te nenit 181 te K.Penal te cilat parashikojne rekrutimin nepermjet dredhise, kanosjes apo rrembimit me force te personit per ta perfshire ate ne prostitucion.

Ne lidhje me trafikimin e femijeve neni 236¹⁰⁰⁾ i K.Penal parashikon:

“Kushdo qe me neglizhnce te dukshme te detyrimeve te tij per perkujdesje dhe edukim, le femijen e tij nen 14 vjec per kompesim ose me qellim pasurimin e vet apo te nje personitjeter, denohet jo me shume se 5 vjet ose me gjobe. Kushdo qe ne kushtet e pershkruara, merr femijen dhe jep kompesimin, gjithashtu denohet njesoj. Kushdo qe pa autorizim:

1. realizon nje adoptim te nje femije nen 18 vjec,

2. perfshihet ne nje aktivitet qe ka si qellim qe nje person i trete te marre perfundimisht nje person nen 18 vjec dhe ne kete menyre vepron per kompesim apo me qellim pasurimin e vet apo te nje te treti, denohet me jo me shume se 3 vjet burgim apo gjobe. Nese autori, ne rastin e pikes 1, realizon sjelljen e femijes ne Gjermani apo jashte, denimi do te jete jo me shume se 5 vjet ose gjobe.

Tentativa denohet.

Burgim nga 6 muaj ne 10 vjet do t'i akordohet autorit nese:

1. vepron per perfitim, ne menyre profesionale apo si pjestar i nje grupi kriminal i formuar per veprimtari te vazhdueshme ne trafikimin e femijeve.

2. nepermjet veprimit e vendos femijen ne nje rrezik per demtim thelbesor te zhvillimit te tij fizik ose emocional”

Dispozita e mesiperme ka mjaft elemente te trafikimit qe fokusohen kryesisht ne disponimin e femijeve me qellim realizimin e perfitimeve por vete dispozita nuk fokusohet qarte ne elementet e abuzimit me te drejtat themelore te individit e ne vecanti te femijes. Kjo duket qarte si ne mosparashikimin ne dispozite te elementit te shfrytezimit ashtu dhe ne masat e denimit. Po keshtu ne ndihme te luftes kunder trafikimit te qenieve njerezore jane dhe mjaft dispozita te tjera te K.Penal qe ndonese nuk artikulojne drejtperdrejt trafikimin, penalizojne mjaft veprime qe evidentohen ne nje veper te tille. Keshtu neni 180 penalizon nxitjen e akteve seksuale me te miturit, neni 180/a penalizon favorizimin e prostitucionit, neni 181/a shfrytezimin e prostitucionit, neni 234 i K.Penal rrembimin, neni 239 i K.Penal heqien e paligjshme te lirise etj. b) Ne reflektim te detyrimeve te marra me nenshkrimin e

¹⁰⁰⁾ Kodi Penal Gjerman.

Konventes se Palermos dhe protokolleve shtese e sidomos te Protokollit per Parandalimin Shtypjen dhe Denimin e Trafikimit te Njerezve Vecanerisht te Grave dhe Femijeve, Gjermania beri ndryshimet perkatese ne raport me to. Keshtu me amendamentin 37 te vitit 2005, rezulton se qe nga Shkurti i 2005 kane hyre ne fuqi ndryshimet perkatesene K.Penal.

Me këto ndryshime trafikimi hyn ne kuader te kapitullit te 18 të këtij Kodi “Krime kunder lirise personale” duke i dhene nje kontekst te ri ne raport me Konventen. Me keto ndryshime behet nje risistemim i dispozitave te meparshme qe lidhen me trafikimin per qellime prostitucioni si dhe parashikohet si veper penale trafikimi i qenieve njerezore per qellime te punesimit shfrytezues, skllaverise, lidhjes me borxh e sherbime c'ka ishte me pare rregulluar me norma jashte K.Penal. Aktualisht trafikimi i qenieve njerezore¹⁰¹⁾ parashikohet ne dy dispozita baze; neni 232 i K.Penal “Trafikimi i qenieve njerezore per qellime te shfrytezimit seksual” dhe neni 233 i K.Penal “Trafikimi i qenieve njerezore per qellime te shfrytezimit te punes”. Keshtu neni 232 parashikon:

“Kushdo qe duke shfrytezuar nje situatë detyrimi apo te pambrojtur e cila eshte e lidhur me qendrimin e nje personi ne nje vend te huaj, detyron nje person tjeter te perfshihet apo te vazhdoje prostitucionin apo detyron personin te realizoje akte seksuale me apo ne prani te autorit ose te nje personi te trete denohet me burgim nga 6 muaj deri ne 10 vjet burgim.

Kushdo qe detyron nje person nen 21 vjec te perfshihet ne prostitucion apo te vazhdoje ate apo te perfshihet ne akte te tjera seksuale te listuara do te denohet njesoj.

Do te denohet sipas paragrafit te trete, kushdo qe :

1.detyron nje perssn tjeter me dhune , me kercenim per shkaktimin e nje demi serioz apo nepermjet detyrimit, te perfshihet apo te vazhdoje perfshirjen ne prostitucion apo akte te tjera seksuale te perfshira ne liste.

2. Sekuestron nje person me dhune, me kercenim per shkaktimin e nje demi serioz apo nepermjet detyrimit, me qellim qe t'a detyroje personin tjeter te perfshihet apo te vazhdoje perfshirjen ne prostitucion apo akte te tjera seksuale te perfshira ne liste”.

Neni 233 parashikon:“*Kushdo qe, duke shfrytezuar nje situatë detyrimi apo te pambrojtur e cila eshte e lidhur me qendrimin e nje personi ne nje vend te huaj, detyron nje person tjeter, te hyje ne skllaveri, lidhje me borxh apo sherbime ose te nise a vazhdojenje raport punësimi me të ose një të tretë, ne kushte pune qe nuk jane aspak te barabartame kushtet e pures së punëtorëve të tjerë denohet me burgim nfa 6 muaj ne 10 vjet.*

Kushdo qe detyron nje person nen 21 vjec te hyje ne skllaveri, lidhje me borxh apo sherbime ose te nise a vazhdoje nje raport punesimi te listuar me lart, denohet njesoj”.

Përveç tyre ne ndryshimet e bera parashikohet dhe favorizimi i trafikimit te qenieve njerezore ne nenin 233/a te K.Penal. P.sh drejtuesit e automjeteve mund te penalizohen sipas ketij

¹⁰¹⁾ Kodi Penal Gjerman.

neni per mbeshtetjen e operacioneve te trafikimit nepermjet transportimit te viktimave te trafikimit. Dispozitat aktuale mbi trafikimin pasqyrojne nje perpjekje per pershtatje te mentalitetit ligjvenes para nenshkrimit te Konventes, e kushtezuar nga qendrimi tradicional ndaj prostitucionit , me mentalitetin qe transmeton kjo Konvente per ta konsideruar trafikimin jo thjesht ne kontekstin e veprave seksuale.

Keshtu neni 232 i K.penal mbetet nje veper ne kuadrin e veprave seksuale edhe pse eshte sistemuar ne kreun e veprave penale kunder lirise personale.Dispozita, edhe pse sjell nje permiresim nga pikepamja sistematike, nuk vleresohet e arrire ne impaktin e saj ne raport me veprat jashte kontekstit te krimeve seksuale pasi ky regullim ekzistonte edhe pse i shperndare²⁹.Edhe pse ne pjesen pershkruese ajo qendron neutrale ne raport me gjinine e viktimes kuptohet se qellimi i saj lidhet me goditjen e trafikimit te femrave e vecanerisht te femrave te huaja. Dispozitat perqendrohen ne dy momente te vecanta — ne vulnerabilitetin e viktimes (situatet detyrimi apo te pambrojtur e lidhur me qendrimin e nje personi ne nje vend te huaj) dhe — mosha e viktimes (21 vjec) ne rastet kur nuk eshte prezent situata paraardhese.Gjithesesi, mbetet nje boshllek ne rastet kur autoret e veprave penale realizojne te ardhura nga rekrutimi i viktimave por qe nuk kane interes per pjesen fundore te trafikimit — shfrytezimin, per shkak te mungeses se qellimit te shtytjes ne kryerjen e akteve seksuale. Me te njejten llogjike eshte ndertuar dhe neni 233.

9.1.c Legjislacioni penal i Kosoves

Ne analizen e dispozitave te Kodit Penal te Kosoves ne lidhje me trafikimin e qenieve njerezore do te mbahen parasysh njekohesisht rregullimi ligjor qe behej sipas Kodit te vitit 2001 dhe rregullimi ligjor sipas versionit te vitit 2003 hyre ne fuqi me 6 prill 2004. Kodi Penal i Kosoves e parashikon trafikimin ne kapitullin e XIV te Pjeses se Posacme te tij. Sipas versionit te vitit 2001 ky kapitull titullohej "Krime kunder njerezimit dhe ligjit nderkombetar" ndersa sipas versionit te vitit 2003 ai titullohet " Krime kunder ligjit nderkombetar" Duke bere nje analize sistematike rezulton se ky kapitull eshte i dyti per nga renditja ne pjesen e posacme pas kapitullit te XIII "Krime kunder Kosoves dhe banoreve te saj". Ne kete menyre konstatohet se Kosova ne krahasim nga mjaft legjislacione te tjera e konsideron trafikimin e qenieve njerezore krahasimisht te rrezikshme sikurse dhe genocidin, krimet kunder njerezimit apo krimet e luftes. Nje karakteristike tjeter e perbashket per te dy versionet eshte parashikimi ne dispozitat paraardhese, i dispozites mbi skllaverine duke krijuar ne kete menyre nje vijim llogjik te dispozites mbi trafikimin si forme moderne e skllaverise. Ne versionin e viti 2001 trafikimi parashikohej ne nenin 134 te ketij kodi me titull "Trafikimi me njerez"¹⁰²⁾ dhe kishte kete permbajtje:

¹⁰²⁾Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qenieve njerëzore. Tiranë 2006 fq 42-46.

"Kush rekruton, transporton, transferon, strehon ose merr personat me ane te kanosjes, forces, shtrengimit, marrjes, mashtrimit, lajthitjes, keqperdorimit te kopetencave ose pozites se dobesise ose me ane te dhenies apo pranimit te pagesave ose benificioneve per te arritur pelqimin e nje personi per veprat e lartpermendura apo pelqimin e personit qe ka autoritet ligjor apo kunder nje person tjetër me qellim shfrytezimi te personave per prostitucion ose te formave te tjera te shfrytezimit seksual, te punes apo sherbimeve te detyrueshme, skllaverise apo kushteve te ngjashme me skllaverine ose te marrjes se organeve, denohet me burgim prej dy deri ne dhjete vjet burgim. Tentativa e vepres¹⁰³⁾ nga paragrafi 1 i ketij neni denohet.

Kush vepren nga paragrafi i 1 i ketij neni e kryer ndaj nje personi nen 18 vjec me qellim adoptimi, denohet me burgim prej tre ne 15 vjet .

Kush organizon nje grup njerezish me qellim te kryerjes se veprave nga paragrafi 1 dhe 3 i ketij kodi denohet me burgim prej tre ne 15 vjet .

Kush ndihmon nje tjetër ne ndermjetesimin e trafikimit ne njerez, denohet me burgim nga 6 muaj ne tre vjet.

Kush shfrytezon ose merr ndonje kundervlere apo siguron sherbim seksual te nje personi nese e di apo eshte dashur te dije, duke patur parasysh rrethanat objektive te vepres dhe rrethant subjective te kryesit dhe viktimes, se ky person eshte victime e trafikimit me njerez, denohet me burgim nga tre muaj ne 5 vjet.

Kush vepren e parashikuar ne paragrafin e mesiperme, e kryen kunder nje personi i cili eshte nen 18 vjeç, denohet me burgim nga dy deri ne dhjete vjet.

Pelqimi i viktimes se se vepres penale te trafikimit te trafikimit me njerez per shfrytëzimin e synuar, nuk e perjashton pergjegjesine penale nese ndonje nga menytrat nga paragrafi 1 i ketij neni, i jane perdorur kunder viktimes se vepres penale te trafikimit".

Ne versionin e vitit 2003 trafikimi qenieve njerezore parashikohet ne nenin 139 te ketij kodi si "Trafikimi i njerezve" dhe ka kete permbajtje: *"Kushdo qe perfshihet ne trafikimin e njerezve, do te denohet me burgim nga 2 ne 12 vjet. Nese vepra e parashikuar nga paragrafi 1 i ketij neni kryhet ndaj nje te mituri nen 18 vjec, autori do te denohet me burgim nga 3 ne 15 vjet. Kushdo qe organizon nje grup personash per te kryer vepren e parashikuar nga paragrafi 1 do te denohet me gjobe mbi 500 000 E dhe me burgim nga 7 ne 20 vjet.*

Kushdo qe me neglizhence lehteson kryerjen e trafikimit te njerezve do te denohet nga 6 muaj ne 5 vjet.

Sikurse konstatohet, teknika legjislative¹⁰⁴⁾ e perdorur ne versionin e viti 2003 vleresohet me e mire. Ajo krijon nje kuptim me te qarte te vepres penale te trafikimit te njerezve dhe

Kodi Penal i Kosovës.

¹⁰³⁾ Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qenieve njerezore. Tirane 2006, fq 35-36.

Kodi Penal i Kosovës.

¹⁰⁴⁾ Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qenieve njerezore. Tiranë 2006, fq 42-48.

lehteson perdorimin ne praktik prej punonjesve te drejtesise, duke ndare me vete pjesen pershkruese te dispozites e cila eshte e nevojshme kryesisht kur rasti qe paraqitet ne praktike nuk eshte i qarte.

Ne krahasim me versionin e vitit 2001 denimet kane nje rritje te lehte dhe ne nje rast parashikohet si denim joalternativ dhe gjoba. Veprat penale kane diferenca te medha mes minimeve dhe maksimumeve duke lene shume hapësire per qendrim subjektive. Ne versionin e vitit 2001 krijohet nje kontradite midis paragrafit te pare dhe te dyte. Evidentimi ne paragraf te dyte si forme e cilesuar e saj, i trafikimit per qellime adoptimi dhe denimin e ketij veprimi me rende se ne paragrafin e pare nuk gjykohej i drejte.

Kjo, pasi qellimet kriminale te trafikimit ne paragrafin e pare (skllaveria, shfrytezimi i ndryshem, heqja e organeve etj.) vleresohen si me te rrezikshme se qellimi kriminal i adoptimit. Nje ndryshim i rendesishem qe behet ne versionin e viti 2003 eshte parashikimi i faktit se shfrytezimi ne kuptim te ketij neni nuk do te kufizohet vetem ne rastet e permendura duke i dhene mundesine e interpretimit progresiv dispozites. Ne kete menyre shmanget problemi i pamundesise se penalizimit te rasteve te shfrytezimit tej atyre te permendura duke patur nje perqasje edhe me te mire me konceptet e Konventes se Palermos dhe vendimit te Keshillit te Evropes¹⁰⁵⁾ ne legjislacionin kuader te vitit 2002.

Parashikimi i denimit per tentativen ne versionin e vitit 2001 ishte i tepert dhe reflektonte (sikurse ne pergjithesi gjithe dispozita) nje implemetnim formal e joorganik te Protokollit te Palermos persa kohe qe tentativa dhe pergjegjesia per te parashikohej ne pjesen e pergjithshme te K.Penal.

Si i panevojshem është konsideruar dhe vendosja ne kete nen te paragrafeve (ne te dy versionet) qe lidhen me penalizimin e veprimeve per marrjen apo ofrimin e e sherbimeve seksuale me persona qe e dihet se jane viktimat te trafikimit. Kjo per dy arsye: se pari ato devijojne nga karakteri i pergjithshem trafikimit ne raport me qellimin kriminal dhe se dyti per nga objekti, ato afrojne me shume me veprat penale kunder integritetit seksual te parashikuar ne Kapitullin XIX. Po keshtu permendja¹⁰⁶⁾ e fjales "femi" (pa percaktuar moshe) qe behet ne piken "4" te paragrafit te fundit nuk eshte ne harmoni me pjesen tjeter te dispozites ku nje term i tille nuk perdoret. Ne vend te tij duhej thene "person nen 18 vjeç". Me interes eshte te thuhet gjithashtu se ne versionin e vitit 2003 jane renditur njera pas tjetres dispozitat: neni 137 "Skllaverimi, vendosja ne kushte te ngjashme me skllaverine dhe puna e detyruar"; neni 138 "Kontrabandimi i njerezve"; neni 139 "Trafikimi i njerezve"; neni 140 "Mbajtja e dokumenteve te identitetit te viktimave te skllaverise dhe trafikimit te njerezve". Kjo renditje krijon nje set te kompletuar dhe koherent te implementimit te Konventes se Palermos me dy protokollat shtese si dhe te Konventes Mbi Skllaverine. Evidentohen qarte pikat e takimit dhe diferencat konceptuale mes dispozitave bazuar dhe ne tekniken e re te shkruarit te tyre.

Kodi Penal i Kosovës.

¹⁰⁵⁾ Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qënieve njerëzore. Tiranë 2006, fq 42-48.

Kodi Penal i Kosovës.

¹⁰⁶⁾ Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qënieve njerëzore. Tiranë 2006, fq 42-48.

Kodi Penal i Kosovës.

Perfundimisht mund të thuhet se K.Penal aktual i Kosovës, pavaresisht nga disa probleme të vogla, vlerësohet mjaft i plotë dhe i pershtatshëm në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore duke prezantuar një krahasueshmeri shembullore si me aktet ndërkombëtare dhe me legjislacionet e vendeve të tjera euro-perendimore.

9.1.d Legjislacioni penal i Francës

Ajo që të tërheq vëmendjen qysh në fillim në këtë kod është parashikimi dhe detajimi mjaft i mirë që i bëhet përgjegjësisë penale të personit juridik për çdo veprë penale si dhe parashikimi i denimeve fikse për veprat penale ç'ka sipas të drejtës sone penale vjen në kundërshtim me parimin e individualizimit të përgjegjësisë. Në lidhje me Kodin Penal të Francës, për trafikimin e qenieve njerëzore, mund të flitet vetëm pas paketës amenduese të tij me Aktin nr. 2003 — 239 datë 18 Mars 2003.

Me këtë paketë ndryshimesh janë realizuar rreth 44 ndryshime në K.Penal të bera me synim përfaqësimin e kodit me Konventën e Palermos në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, me synimin e një lufte me të efektshme kundër veprave penale seksuale e vecanerisht të shfrytëzimit seksual, goditjen e shfrytëzimit të miturve për këtë qëllim dhe për qëllime të lypjes, luftën kundër punesimit në kushte johumane etj. Pas këtyre amendimeve, veprat penale¹⁰⁷⁾ në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore parashikohen në Librin II, "Krimet dhe kundërvajtjet kundër personave", Titulli II "Vepra penale kundër personit", Kapitulli V "Vepra kundër dinjitetit të personit", Seksioni I bis "Trafikimi i qenieve njerëzore" nën 225-4-1 deri në 225-4-9 të K.Penal.

Pershkrimi i dispozitave në lidhje me trafikimin është si më poshtë:

"Trafikimi¹⁰⁸⁾ i njerëzve është rekrutimi, transportimi, transferimi, akomodimi apo pritja e një personi në shkëmbim të një pagese apo të një përfitimi tjetër ose të një premtimi për pagese apo përfitim tjetër, me qëllim për ta vënë atë në dispozicion të një pale të tretë, të njohur ose jo, duke lejuar në këtë mënyrë kryerjen kundër atij personi të veprave penale të favorizimit të prostitucionit, dhunimit seksual, shfrytëzimit për lypje, apo vendosjen në kushte pune e jete jo të pershtatshme me dinjitetin njerëzor ose të detyroje atë person të kryejë ndonjë krim a kundërvajtje

Trafikimi njerëzor denohet me 7 vjet burgim dhe me gjobe me 150 000€.

Neni 225-4-2

Vepra e mesiperme denohet me 10 vjet burgim dhe me gjobe €1, 500, 000 kur ajo kryhet:

1° kundër një të mituri;

¹⁰⁷⁾Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qenieve njerëzore. Tiranë 2006, fq18-25

¹⁰⁸⁾Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qenieve njerëzore. Tiranë 2006, fq 21-36

Kodi Penal i Francës neni 225 -4-1.

2° kunder nje personi vulnerabiliteti i te cilit per shkak te moshes, semundjes, gjymtimit, paaftesise fizike apo mendore ose shtazanise, eshte e dukshme ose e njohur per autorin.;

3° kunder dy ose me shume njerezve;

4° kunder nje personi qe eshte jashte territorit te Republikes Franceze ose i sapo hyre ne territorin e Republikes Franceze;

5° kur personi ka ardhur ne kontakt me autorin nepermjet perdorimit te nje rjeti telekomunikacioni per shperndarjen e mesazheve nje audience te papercaktuar;

6° ne rrethana te cilat ne menyre direkte ekspozon personin kunder te cilit eshte drejtuar vepra, ndaj nje rreziku imendiat per vdekje apo per nje demtim te nje natyre qe shkakton gjymtim apo paaftesi te perhershme;

7° me perdorim te kanosjes, shtrengimit, dhunes ose sjelljes mashtruese kunder atij personi, familjes se tij apo dikujt qe mardhenie te rregullta me te;

8° nepermjet ushurimit te pushtetit legjitim, natyral apo adoptiv mbi viktimen parashikuar ne nenin 225-4-1 apo nga nje person qe zoteron autoritet mbi te ose kush abuzon me autoritetin qe i eshte dhene per shkak te pozites se tij,.

9° nga nje person, pozicioni i te cilit, kerkon perfshirjen e tij ne luften kunder trafikimit te qenieve njerezore apo te ruaj rendin publik.

Neni 225-4-3

Kur vepra kryhet nga nje grup i organizuar, vepra e parashikuar nga neni 225-4-1 denohet me 20 vjet burgim dhe me gjobe 63,000,000.

Neni 225-4-4

Vepra e parashikuar nga neni 224-4-1, kur kryhet e shoqeruar me vepra torture apo akte barbarie, denohet me burgim te perjetshem dhe gjobe 64,500,000.

Duke analizuar dispozitat e K.Penal Francez mbi trafikimin por dhe dispozitat e tjera te tij mund te konstatohet sa me poshte:Ligjvenesit francez nuk ka bere nje implementim formal te koncepteve mbi trafikimin por eshte perpjekur t'l perpunoje ato me qellim per t'l bere lehtesisht me te kuptueshme e te zbatueshme duke u perpjekur qe ky implementim te jete ne harmoni me dispozitat e tjera te K.Penal.Menyra e formulimit te pjeses pershkruese krijon nje devijim dhe problem ne te kuptuarit e trafikimit pasi ky formulim kerkon doemos ekzistencen e nje pale te trete ne trafikim dhe nuk penalizon rastet kur mund te jete i njeiti subjekt qe rekruton,transporton dhe shfrytezon nje viktime.

Interesant eshte fakti se ne ndryshim nga legjislacionet e tjera te analizuara , per te shmangur interpretimet, ligjvenesit francez, ne pjesen pershkruese i referohet "personit" dhe jo personave. Ne kete menyre shmanget dyshimi nese kjo veper do te qendroje ose jo kur trafikohet vetem nje person.

Per te realizuar objektivat e luftes kunder trafikimit, me ndryshimet e bera, ka kriminalizuar ne menyre te cilesuar, forma te tjera shfrytezimi si shfrytezimin per lypje, pune qe nuk eshte ne perputhje me dinjitetin, favorizimin dhe shfrytezimin e prostitucionit etj.Parashikohet pergjegjesia penale per personin juridik.¹⁰⁹Tentativa per kryerjen e veprave penale te ketij seksioni denohet njesoj

¹⁰⁹ Shih: Neni 225-4-6

si vepra e kryer, neni 225-4-7, Mund te perfitojne ne masen e denimit personat ,vepra e te cileve ke mbetur ne tentative vetem kur ata nepermjet njoftimit te organeve shtetore, kane parandaluar kryerjen e vepres, apo ardhjen e pasojave apo ka penguar kryerjen e vepres nga bashkepunetoret, (Neni 225-4-9).Ka parashikuar nje sere formash te qellimit kriminal ne trafikim te cilat nuk jane prezent ne nenin 3 te Protokollit te Palermos (shfrytezimi i lypjes, detyrimi per te kryer (viktima) vepra penale) por nga ana tjeter nuk ka parashikuar nje pjese prej atyre te pershkruara ne Protokoll si skllaverine apo forma te ngjashme, heqjen e organeve. Eshte e qarte se ligjvenesit francez ka perfshire ato raste qe ne realitetin francez perbejne problematike.

Dispozitat, nuk lene hapesine per interpretim progresiv te tyre pasi ne to nuk parashikohet mundesia e penalizimit te formave te tjera te shfrytezimit duke i dhene ketyre dispozitave nje karakter te ngurte.Terheq gjithashtu vemendjen parashikimi si forme e cilesuar e kryerjes se vepres penale, kur autori i saj eshte person qe ka per detyre te luftime trafikimit apo te ruaje rendin publik, neni 225-4-2 (pika 9). Ne pamje te pare kjo duket mjaft pozitive dhe ne raport me aktet nderkombetare. Por duke konstatuar se ne piken paraardhese te nenit 225-4-2 parashikohet si forme e cilesuar dhe me denim te njejte kryerja e vepres nga nje person qe "*abuzon me autoritetin qe i eshte dhene per shkak te pozites se tij*", mendoj se praktikisht pika 9 nuk ka ndonje efekt.

Me interes¹¹⁰ eshte gjithashtu te permendet neni 225-4-8 i ketij seksioni, formulim te cilin nuk e kam ndeshur ne legjislaçionet e tjera por qe eshte ndeshur shpesh ne praktiken gjyqesore. Problemi lidhet me mundesine e autoriteteve gjyqesore per te llogaritur burimet e jeteses se autoreve dhe viktimave te trafikimit Kjo per dy arsye; se pari per te provuar se autori i vepres nuk ka burime te ligjshme per te justifikuar gjendjen dhe se dyti per t'i krijuar mundesine viktimes per kompesim. Keshtu neni i mesipermpenalizon kedo qe duke qene se jeton ne prani te autoreve te trafikimit dhe viktimave nuk eshte ne gjendje te llogarise burimet korensponduese te menyres se jeteses se tij. Duhet thene se nga pikpamja teorike denimi per nje veprim te tille duket i ekzagjeruar edhe pse i krijon mjaft lehtesira organeve gjyqesore.

9.1.e Legjislacioni Penal i SHBA-së.

Kodi Penal i SHBA eshte pjese e Kodit te SHBA i cili eshte nje permbledhje e ligjeve ne fuqi ne ate shtet, i ndare ne tituj sipas objektit qe trajton. Kodi Penal perfshihet ne Pjesen e Pare te Titullit te 18 "*Krimet dhe Procedura Kriminale*" te Kodit te SHBA nen titullin "*Krimet*". Kodi Penal ne vetvete ndahet ne 123 Kapituj dhe dispozitat qe lidhen me trafikimin e qenieve njerezore i perkasin Kapitullit te 77 te tij te titulluar "*Punesim i padeshiruar per shkak te borxhit, skllaveria dhe trafikimi i njerezve*".

Me interes eshte te permendim se ne perpjekjet e SHBA ne luften kunder trafikimit te qenieve njerezore, nje impakt te rendesishem pozitiv luajti nje pakete ligjore e miratuar nga Kongresi Amerikan me 24 Janar 2000 dhe qe njihet si "Akti i vitit 2000 per Mbrojtjen e Viktimave te Trafikimit dhe Dhunes" i cili perben ne veteve nje grup masash

¹¹⁰ Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedural mbi Trafikimin e qënieve njerëzore. Tiranë 2006, fq 36-46.
Kodi Penal i Francës.

me karakter legjislativ dhe organizativ qe kishin si synim "Per te luftuar trafikimin e njerezve, vecanerisht ne tregetine e seksit, skllaverise, stirbimet e padeshiruara, te riaktivizojte programe federale per te parandaluar dhunen kunder grave si dhe qellime te tjera"¹¹¹⁾. Ky akt parashikon marrjen e masave qe synojne parandalimin e trafikimit, fuqizimin e ndjekjes penale dhe mbrojtjen e viktimave kryesisht te huaja qe hyjne ne SHBA per nje integrim sa me normal ne shoqerine amerikane. Ne interes te objektit te temes jane masat me karakter ligjor qe fuqizuan ndjekjen penale te trafikimit.

Ne kete menyre ne seksionin e 12 te keij akti parashikohen nje sere nenesh qe amendojne dispozitat e Kapitullit 77 te K.Penal apo te tjera qe shtohen ne kete kapitull. Keshtu ne nenet 1581, 1583 dhe 1584 qe lidhen me vendosjen e nje personi tjetër ne situatë skllaverie apo te ngjashme me te si dhe me tregetine e skllaverve behen ndryshime qe konsistojne ne dy drejtime; rritet minimumi i denimit nga 10 vjet ne 20 vjet; veprat behen te cilesuara ne rastet kur viktima vdes, kur per aritjen e qellimit perdoret rrembimi apo tentohet ai, perdoret abuzim i rende seksual apo tentohet ky abuzim apo kur tentohet te vritet viktima duke akorduar ne kete rast denime deri ne burgim te perjetshem dhe gjobe.

Me kete akt gjithashtu shtohen dispozita te reja (nenet 1589 "Puna e detyruar", 1590 "Trafikimi per punesim te padeshiruar, skllaveri, sherbime te padeshiruara apo pune me detyrim", 1591 "Trafikimi i seksit te miturve apo me force, detyrim apo mashtrim", 1592 "Sjellje jo ligjore ne lidhje me dokumentet per mbeshtetjen e trafikimit, punesimit te padeshiruar, skllaverise, sherbimeve te padeshiruara, apo punes se detyruar").

Neni 1590 parashikon se:

"Kushdo qe me dijeni rekruton, strehon, transporton, shperndan apo pranon me cdo mjet, nje person per pune apo sherbim ne shkelje te ketij kapitulli do te denohet me gjobe ose burgim jo me shume se 20 vjet apo se bashku. Ne rast kur viktima vdes, kur per aritjen e qellimit perdoret rrembimi apo tentohet ai, perdoret abuzim i rende seksual apo tentohet ky abuzim apo kur tentohet te vritet viktima denohet me burgim deri ne burgim te perjetshem ose gjobe, ose te dyja se bashku"

Kapitulli 77 ne pergjithsi dhe neni 1590 ne vecanti, jane ne te njejten linje me Protokollin e dhe duket me praktik ne aplikimin e tij pasi, kerkon me pak elemente per t'u provuar dhe keshtu mbulon me shume raste. Kjo pasi ne vend qe te provosh mashtrimin, shtrengimin, abuzimin me situaten vulnerable, ajo qe kerkohet eshte te provohet situata e skllaverise, punes se detyruar, punes e sherbimit te padeshiruar ku ne fakt jane te perfshira dhe keto elemente.

Po keshtu dhe neni 1591 paraqet mjaft interes per t'u analizuar ne raport me trafikimin per qellime te shfrytezimit seksual, permbajtja e te cilit eshte si me poshte: Kushdo qe me dijeni:

1. Ne ineres apo ne ndikim te interesit te trgetise se jashtme, ose ne nje bregdet apo territor te vecantre te SHBA, rekruton, terheq, strehon, transporton, shperndan apo pranon me cfardo mjeti nje person ose

2. Përfiton financiarisht apo cfardo vlere, nga pjesmarja ne nje siper marrje te perfshire ne nje akt te pershkruar ne paragrafin I duke ditur se ndaj personit do te perdoret force, mashtrim,

¹¹¹⁾ Kodi Penal i SHBA-së.

shtrengim per te shkaktuar perfshirjen e tij ne nje akt seksual komercial, apo duke ditur se personi nuk ka arritur 18 vjec dhe do te perfshihet ne nje akt seksual komercial do te denohet si me poshte:

b) Denimi¹¹² per vepren e parashikuar ne piken a) eshte nese vepra eshte realizuar me force, mashtrim, shtrengim apo nese personi i rekrutuar, terhequr, strehuar, transportuar shperndare apo pranuar nuk ka arritur moshen 14 vjec, me gjobe, me burgim ose me burgim te perjetshem apo te dyja se bashku.

Nese vepra nuk eshte kryer ne keto rrethana apo personi ka mbushur moshen 14 vjec por nuk ka arritur moshen 18 vjec, me gjobe ose me burgim jo me shume se 40 vjet apo te dyja se bashku.

c) Ne kete nen

1 Termi "akt seksual komercial" nenkupton çdo akt seksual, per realizimin e te cilit eshte dhe ne apo eshte mare nje vlere çfarëdo nga nje person.

2 Termi "shtrengim" nenkupton:

Kanosje per nje demtim serioz fizik apo kufizim fizik ndaj nje personi.

Ndonje skeme, plan apo sistem qe synon te beje personin te besoje se nese nuk realizon nje akt mund te coje ne nje demtim serioz apo kufizimfizim ndaj personit.

Abuzimi apo kanosja per te abuzuar me ligjin apo nje proces ligjor".

Nga analiza e dispozites rezulton se ajo kryesisht penalizon trafikimin e orientuar nga jashte per ne drejtim te SHBA nderkohe qe dispozitat mbi skllaverine dhe tregetine e sklleverve penalizojne te dy orientimetper ekzistencen e vepres baze, nuk eshte e domosdoshme ekzistenca e mjeteve te deformimit te vullnetit ne momentin e rekrutimit, transportimit, pranimit, strehimit, shperndarjes te parashikuara ne Protokollin eTrafikimit duke bere keshtu nje hap para tij. E rendesishme eshte qe autori te dije se keto mjete do te perdoren ne momentin e shfrytezimit.Ne lidhje me personat nen 18 vjec per ekzistencen e vepres, nuk eshte e rendesishme qe autori te dije se ndaj viktimes do te perdoret ndonje mjet deformimi te vullnetit ne momentin e shfrytezimit por eshte e mjaftueshme te dije se viktima eshte nen kete moshe.

Vepra behet vecanerisht e cilesuar dhe shkakton deri denim me burgim te perjetshem nese per rekrutimin, transportimin, pranimin, strehimin, shperndarjen apo pritjen e viktimes eshte perdorur ndonje prej mjeteve te deformimit te vullnetit te parashikuara apo nese personi eshte nen 14 vjec. Legjislatori amerikan i ka vendosur dispozitat e ketij kapitulli , per efekte te zbatimit te ligjit per mbrojtjen e deshmitareve, ne te njejtin nivel me veprat e kryera nga aktiviteti kriminal i organizuar. Kodi parashikon ne kete kapitull se tentativa per kryerjen e ketyre veprave do te denohet njesoj si vepra e kryer, duke theksuar dhe nje here rrezikshmerin e madhe shoqerore te tyre.Neni 1592 lidhet me raportet qe autoret mbajne ndaj dokumenteve te viktimave te trafikimit, punes se detyruar , skllaverise, lidhjes me borxh, sherbimeve te detyruara etj. te parashikuara si vepra penale nga ky kapitull. Keshtu sipas kesaj dispozite kushdo qe me dijeni shkateron , merr, konfiskon,fsheh apo

¹¹²⁾ Koça A., Punim i cituar , Tiranë 2006, fq 16-36.
Kodi Penal i SHBA-së.

zoteron pasporten apo dokumente te tjera imigrimi te nje personi tjetër me qellim perkrahjen e veprave te permendura me siper apo ne realizim te tyre mund te denohet mbi 5 vjet burgim. Ne menyre te shprehur ligjvenesi perjashton nga pergjegjesia penale per kete veper ata qe konsiderohen viktime te ketyre veprave.

9.2 AKTET DHE INSTRUMENTAT NDERKOMBETARE NE LIDHJE ME TRAFIKIMIN E QENIEVE NJEREZORE

9.2.a Perkufizimi ne te drejten nderkombetare

Trafikimi eshte nje fenomen transnacional. Pikerisht per kete arsye lufta kunder tij duhet te zhvillohet ne nje kuader nderkombetar. Organizata e kombeve te Bashkuara eshte sensibilizuar dhe ka reaguar e para ne kete drejtim me krijimin ne gjirin e Keshillit te te Drejtave te Njeriut, te Raportuesit te posacem per trafikimin e qenieve njerezore dhe te Raportuesit te posacem per format bashkekohore te skllaverise. Po keshtu zyra e Kombeve te Bashkuara kunder droges dhe Krimet kane leshuar iniciativen globale te Kombeve te Bashkuara per te luftuar trafikimin, ne bashkepunim me Organizaten Nderkombetare te Punes, Organizaten Nderkombetare per Migracionin, Komisariatit e larte te Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Njeriut.

Referuar nenit 3 te Protokollit shtese te Konventes se Kombeve te Bashkuara per luften ndaj kriminalitetit te organizuar e cila synon te mbroje ne menyre te vecante grate dhe femijet shprehja “trafik I qenieve njerezore” percakton ose nenkupton rekrutimin, transportimin, transferimin strehimin ose pritjen e personave nepermjet kercenimit per perdorim force ose perdorimit te forcesa formave te tjera shtrenguese si rrembimi, mashtrimi, shperdorimi I detyres ose I nje shtate qe karakterizon personin ose nepermjet ofrimit ose pranimit te marrjes se shperblimeve a avantazheve te tjera per te fituar pelqimin e nje personi i cili ka autoritet mbi nje person tjetër per qellime seksuale. Shfrytezimi nenkupton se paku shfrytezimin e prostitucionit, te skllaverise, te punes se detyruar dhe te marrjes se organeve njerezore.¹¹³ Pelqimi I viktimes nuk ka rendesi mjafton vetem perdorimi I mjeteve dhe teknikave te permendura si me siper qe vepra te jete konsumuar. Termi “femije” ne te drejten nderkombetare percakton cdo person qe ka mberritur deri nen moshen 18 vjec.¹¹⁴ Juridikisht edhe ne te drejten nderkombetare vleresohet se trafikimi I qenieve njerezore si aktivitet kriminal permban tre elemente: 1.

¹¹³Ministère des Affaires étrangères de la France (2014), *La France et la lutte contre la traite des êtres humains*, ne faqen web: <http://www.diplomatie.gouv.fr/fr/politique-etrangere-de-la-france/droits-de-l-homme/lutte-contre-la-traite-des-etres/>

¹¹⁴ Shih: Neni 3 I protokollit shtese te Konventes Kombeve te Bashkuara kunder kriminalitetit te organizuar qe synon te luftoje dhe parandaloje trafikimin e personave, ne menyre te vecante grave dhe femijve. (2000).

veprimin (rekrutimin, transportimin, etj); 2. Mjetin e perdorur (rrembimi, mashtrimi, etj); 3. Qellimin e shfrytezimit (prostitucioni ose forma te tjera te shfrytezimit seksual,etj).

Bashkësia ndërkombetar ka ndërmarë një varg veprimesh konkrete për të luftuar trafikimin e qënieve njerëzore. Referohet si pikënisje një periudhë të hershme që në vitet 1900.

Fillimisht përmendet Marrëveshja Ndërkombëtare për shtypjen e tregut të skllëvërve të bardhë i vitit 1904. Kjo marrëveshje përqëndrohet kryesisht në mbrojtjen e viktimave të tregtisë. Por, e rëndësishme përveç realizimit të mbrojtjes së viktimave të tregtisë, ishte dhe vënia në plan veprimi e dënimit të autorëve që merreshin me këtë veprimtari. Ndaj në Maj të vitit 1910 mes 13 shteteve u nenshkrua Konventa per Shtypjen e Trafikut te Skllëvërve te Bardhe qe synonte realizimin e ketij objektivi.

Akte te rendesishme ne lidhje me trafikimin mund te permendim:

Akte te Organizates se Kombeve te Bashkuara:

Konventa e OKB-së Për Shtypjen e Trafikut të Grave dhe Fëmijeve e 30 shtatorit te vitit 1921.

Konventa Për Shtypjen e Trafikut të Grave në Moshë Madhore e vitit 1933,

Deklarata Universale e te Drejtave te Njeriut — Dhjetor 1948.

Ky akt përfaqëson dokumentin bazë mbi te cilin u ndërtuan legjislacionet e shteteve në lidhje me liritë dhe të drejtat e njeriut. Në këtë deklaratë nuk ka të shkruara norma detyruese por parimet e vendosura nga kjo deklaratë vendosin dhe i detyrojnë shtetet të vendosin standarte, të cilat marrin përsipër të ruajnë lirite themelore, barazine, ndalimin e skllavërisë, torturës dhe trajtimit degradues.

Kjo deklaratë lindi si rezultat i nevojës¹¹⁵ duke qënë se përballja me mosrespektimin dhe përbuzjen e të drejtave të njeriut, kishte marrë përhapje të gjerë duke çuar drejt akteve barbare. Kanë qënë këto akte të cilat kanë ofenduar ndërgjegjen e njerëzimit.

Kjo deklaratë pranon lirinë e fjalës, të besimit dhe lirinë nga frika e skamja. Ajo çfarë nxjerr në pah kjo deklaratë është dhe detyrimi që të drejtat e njeriut të mbrohen me dispozita juridike, të cilat duhet të jenë garant për to. Konventa e Lidhjes së Kombeve Për Shtypjen e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të tjerëve, 1949. Kjo konventë përfaqëson konventën e parë të rëndësishme ne lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore. Jo se aktet e mëparëshme ishin më pak të rëndësishme por në këtë konventë pasqyrohet një detajim më i plotë dhe masa konkrete. Në njëfarë mënyre kjo konventë arrin të konsolidojë¹¹⁶ dhe të zgjerojë kuptimin që i është dhënë trafikimit dhe synimet e vendosura me anë të konventave të mëparëshme.

Me anë të kësaj konvente del qartazi dënimi i cdo personi që trafikon një tjetër per qëllime prostitucioni. Në këtë mënyrë, përcaktohet përgjegjësia penale e autorit të veprës penale. Nga ana tjetër në kuptim dhe zbatim të kësaj konvente do të mbajë përgjegjësi penale cdo person që shfrytëzon një person tjetër për qëllime prostitucioni. Një aspekt tjetër i kësaj konvente është dhe fakti se akte të tilla si trafikimi apo shfrytëzimi për prostitucion janë akte që bëhen të dënueshme pavarësisht nga vullneti i viktimës apo me saktë nga pëlqimi i dhënë nga i

¹¹⁵⁾ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. 1948.

¹¹⁶⁾ Koça A., Punim i cituar, Tiranë 2006, fq 9.

dëmtuari.Me anë të kësaj konvente bëhet e dënueshme mbajtja, menaxhimi,financimi i shtëpive publike apo lënia dhe marrja me qera e tyre. Gjithashtu bëhet e dënueshme tentativa dhe përgatija e veprave të mësipërme sikurse dhe pjesëmarrja në to. Konventa Mbi Skllavërinë e vitit 1926 dhe Protokollin e vitit 1953 që bëri amendimin e saj.

Kjo konventë nderkombetare përfaqëson të parën konventë në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore. Në këtë konventë jepet e përcaktuar definicioni i skllavërisë, punës së detyruar dhe trëtisë së skllavërisë. Kjo konventë dhe protokollin shtesë i saj synojnë të realizojnë si objektiva: Përcakton detyrimin e paleve të marrin masat për zhdukjen e skllaverisë në çdo formë të saj; Përcakton ndalimin e tregëtisë apo trafikut. Përcakton skllavërinë si "*Status apo gjendje e nje personi mbi të cilin ushtrohen nje apo të gjitha format e lidhura me të drejtën e pronësise*"Përcakton kuptimin e tregëtisë së skllavërisë si: *Akte që kanë të bëjnë me kapjen, blerjen apo largimin e nje personi me synim për tja nënshtruar skllaverisë; aktet që kanë të bëjnë me blerjen e nje skllavi me qëllim shitjen apo shkëmbimin e tij; aktet e heqjes dore nga ai për shitjen apo shkëmbimin e nje skllavi të marre për këto qëllime si dhe në përgjithësi çdo veprë e shitjes apo transportimit të skllavërisë.* Konventa Shtesë mbi Zhdukjen e Skllavërisë, Tregëtimit të Skllavërisë, të Instituteve e Praktikave të Ngjashme me Skllavërinë,⁷ Shtator 1956.Kjo konventë realizon:përpunon më tej konceptin e skllavërisë dhe formave moderne të shfaqjes (praktika të ngjashme) duke e zgjeruar objektin e ndalimit. Si forma të ngjashme me skllavërinë parashikon:Detyrimi me borxh.Gjendje shërbimi skllaverues.Institut apo praktike ku:

Nje grua jepet për martesë kundërt pagesës pa patur të drejtën e refuzimit.

E drejta e bashkeshortit apo familjes së tij për të çuar gruan të një tjetër.

E drejta për të trashëguar gruan pas vdekjes së bashkeshortit të saj.

Dhenia e femijes nga prinderit me qëllim shfrytëzimi.

Përpunon më tej konceptin e trafikimit,¹¹⁷ duke theksuar atë të fëmijëve,Kriminalizon aktet e skllavërisë.Marreshja Nderkombetare Për të Drejtat Civile dhe Politike — Qershor 1966.

Kjo marrëveshje sanksionon heqjen e skllavërisë dhe tregëtisë së skllavërisë, gjendjen e nënshtrimit dhe punës së detyruar duke parashikuar të palejuara të punës së detyruar.

Konventa Nderkombetare mbi të Drejtat Ekonomike,Sociale dhe Kulturore po e vitit 1966.

Kjo konventë plotëson konventën e mësipërme në lidhje me liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

Konventa mbi Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e vitit 1979 dhe Protokollin shtesë i vitit 1999. Parashikojnë detyrime për shtetet nënshkruese të marrin masa (duke përfshirë dhe masa legjislative) për shtypjen e të gjitha formave të trafikimit të grave dhe shfrytëzimin e prostitucionit të tyre.

Konventa e OKB-së e vitit 1989, Mbi të drejtat e fëmijëve dhe protokollin shtesë i vitit 2000.

- Jepet kuptimi i fëmijes si qenie njerëzore.

- Parashikohet¹¹⁸, detyrimi i paleve për mbrojtje prioritare të drejtave të femijeve pa dallime

¹¹⁷ Koça A., Punim i cituar, Tiranë 2006, fq 19-21

¹¹⁸ Koça A., Punim i cituar, Tiranë 2006, fq 21-22.

-detyron palet te marrin te gjitha masat per mbrojtjen e tyre nga perfshirja ne prostitucion,shfrytezim seksual apo pornografik, nga trafikimi ne çdo formë apo per ç'do qellim. Ne raport te ngushte me kete konvente e per qellime teorike,

Konventa mbi Mbrojtjen e te drejtave te Punetoreve Migrante dhe Anetareve te Familjeve te tyre e vitit 1990. Kjo konvente synon mbrojtjen e emigranteve dhe familjeve te tyre nga skllaveria, puna e detyruar duke percaktuar dhe rastet kur nuk do te quhen pune te detyruara.

Konventa Kunder Krimin te Organizuar nderkombetar e vecanerisht Protolli i Dyte Shtese Per Parandalimin, Shtypjen dhe Denimin e Trafikimit të Personave Vecanerisht te Grave dhe Femijeve (Protokolli i Palermos) viti 2000, Akte të Organizates Nderkombetare te Punes (ILO), Konventa nr.29 Per Punen e Detyruar e vitit 1930. Jepet koncepti i punes se sforcuar apo me detyrim si *"C'do Iloj pune qe kerkohet nga nje person me urdher, nen kercenimin e nje denimi dhe per te cilen ,personi ne fjale nuk eshte ofruar vullnetarishr* Perjashtohen disa raste nga ky koncept "sherbimi ushtarak, - detyrimet civile te shtetasve -punet qe urdherohen si rrjedhoje e nje denimi gjyqesor,- pune apo sherbim i urdheruar ne rastet e emergjences, - sherbime te vogla komunale te kryera nga anetaret e komunitetit". Konventa nr.105 e vitit 1956 qe ben plotesimin e konventes se mesiperme. Konceptet e perpunuara me tej ne lidhje me punen e detyruar japin mundesine per te bere dallimin nga skllaveria apo praktikat e e ngjashme me te , ku ne kete te fundit eshte i pranishem koncepti i pronesise mbi personin apo tagrave te tjera te lidhur me kete te drejte.Konventa mbi Veprim te Menjehershme per Ndalimin dhe Eliminimin e Formave me te keqia te Punes se Femijeve , e vitit 1999

Akte te Keshillit te Evropes

Konventa Evropiane mbi Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore e vitit 1950.

Konventa Evropiane per Veprime Kunder Trafikimit të Qenieve njerezore Maj 2005.

Nje numer rekomandimesh

Akte te Bashkimit Evropian

Vendimi Kuader i 19 Korrikut 2002 Mbi Luften Kunder Trafikimit te Qenieve njerezore.

Protokolli i Dyte Shtesë i Konventes Kunder Krimin te Organizuar Nderkombetar — Palermo (Itali) dhjetor 2000 Konventa e Palermos,¹¹⁹dhe protokollet shtesë të saj përbëjnë kulmin përpjekjeve të komunitetit ndërkombetar në luftën kundër krimin të organizuar në përgjithësi dhe trafikimit të qënieve njerezore në veçanti.Proceset globalizuese të fundit të mijëvjeçarit u shoqëruan dhe me një sërë problemesh të mëdha të cilat sollën rritjen e kriminalitetit e sidomos të atij në formën më të organizuar. Ndryshe nga ajo çfarë ndodh në bashkëpunimin zyrtar, grupet kriminale gjetën ura lidhëse nga më të ndryshmet duke bërë që krimi i organizuar të merrte përmasa të mëdha duke u shtrirë sin ë kohë ashtu dhe në hapësirë. U arrit shumë shpjet në një konkluzion që krimi i organizuar nuk njuh pengesa për shkak gjuhe, apo kufijsh, por vepron në drejtim të një qëllimi të vetëm 'realizmi i përfitimeve''.Parë në këtë këndvështrim u pa se masat e ndërmarra deri në atë kohë neprimjet aktesh apo aksionesh nderkombetare jo vetem qe nuk ishin te mjaftueshme por nuk godisnin te gjitha aspektet qe paraqiste realiteti i ri krimin nderkombetar ne pergjithesi dhe trafikimi ne vecanti.

¹¹⁹⁾ Koça A., Punim i cituar , Tiranë 2006, fq 16-35

Ky set instrumentesh,¹²⁰ prezantonte nevojën e perpjekjeve të përbashkëta të komunitetit nderkombëtar, pas konstatimit se, perpjekjet e vecuara të shteteve përballur me realitetin e ri nuk ishin të mjaftueshme. Protokollin e Palermos shënoi hapa para një drejtimi të:

Parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore duke u fokusuar vecanërisht te gratë dhe fëmijët.

Mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit nepermjet respektimit të të drejtave të tyre

Nxitjen e bashkëpunimit mes shteteve për arritjen e këtyre objektivave:

Realizimin e qëllimeve të përmendura më sipër Protokollin e Ben të mundur nepermjet:

Dhënies së perkufizimeve të nevojshme,¹²¹ Detyrimin për kriminalizimin e trafikimit sipas perkufizimeve të dhëna,¹²² Diferencimin e denimeve për forma të rënda të shfaqjes së krimit apo për shkak të subjektit të posaçëm, shtimit të mjeteve në duart e organeve të luftës kundër krimit nepermjet: - shkëmbimit të informacionit - trajnimit në lidhje me parandalimin, hetimin, të drejtat e viktimave, problemet gjinore, - bashkëpunimin me shoqëritë civile, - rritjes së masave të kontrollit në pikat e kalimit kufitar dhe rritjes së sigurisë së dokumenteve. Ruajtjes së balancës midis mbrojtjes së viktimes¹²³ dhe nevojës së përfshirjes në një proces penal duke vendosur interesin e viktimes si prioritar. Ndihmës dhe mbrojtjes së viktimes: ruajtjen e privacisë, informimin në lidhje me procedimin penal të mundshëm, rikuperimin fizik, psikologjik e social. Parandalimit - informimit të viktimave, zyrtarëve dhe publikut për këto fenomene dhe rreziqet, - Parandalimin nga riviktimizimi i mundshëm.

Arritja në një perkufizim të unifikuar për trafikimin ka qënë procesi më i vështirë e më kontradiktoria.¹²⁴ Më së fundi me këtë Protokoll për herë të parë shtetet kanë një perkufizim të unifikuar si një bazë për ngritjen e programeve të përbashkëta apo për harmonizimin e legjisllacioneve të brendshëm. Kështu neni 3 i Protokollit jep këto perkufizime të trafikimit të qënieve njerëzore:

"(a) "Trafikimi i personave" do të thotë rekrutim, transportim, transferim, strehim apo prije të personave, me anë të kërcenimit apo përdorimit të forcës apo të formave të tjera të detyrimit, të marrjes me forcë, të mashtrimit, të gënjeshtrës, të abuzimit të pushtetit ose të shfrytëzimit të një pozicioni delikat, apo të marrjes apo dhënies së pagesave apo përfitimeve të ndryshme për të arritur pranimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë, si minimum, shfrytëzimin e prostituimit të të tjerëve ose të formave të tjera të detyrimit, të punës apo shërbimeve të detyruara, të skllaverisë apo të praktikave të ngjashme me skllaverinë apo të heqjes së organeve;

Pranimi i një viktime të trafikimit për shfrytëzimin e shpjeguar më lart në nenparagrafin (a) të këtij neni do të jetë i pavlefshëm në rast se janë përdorur një nga mjetet e detyrimit të parashkruar në nenparagrafin (a);

¹²⁰ Koça A., Po aty, Tiranë 2006, fq 18-32.

¹²¹ Protokollin e Palermos, Neni 3.

¹²² Protokollin e Palermos. Neni 5.

¹²⁴ Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues krimnologjik dhe procedurial mbi Trafikimin e qënieve njerëzore. Tiranë 2006, fq 16-36.

*Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo pritja e nje femije per qellimin e shfrytezimit do te konsiderohet `trafikim i njerezve' edhe ne qofie se nuk perdoren asnje nga mjetet e percaktuara ne nen-paragrafin (a) te ketij neni;
"Femije" do te thote cdo person nen moshen tetembedhjete vjec."*

Nga përkufizimi i mesiperm¹²⁵ mund të evidentohen një sërë vecorish të nevojshme për t'u patur parasysh në analizën e kësaj vepre penale.

Se pari, përkufizimi i jep nje hapësire te gjere kuptimit te trafikimit duke e shtrire ate tej qellimeve te shfrytezimit seksual . Trafikimi eshte nje koncept i lidhur ngushte me skllaverine, praktikat e ngjashme me te dhe me punen e detyruar .Vete Protokolli nuk i jep keto perkufizime por ato jane dhene ne konventat e permendura me siper. Ai gjithashtu jep dhe raste te tjera te natyres shfrytezuese si heqien e organeve apo sherbimet.

Se dyti, paraqitja e rasteve që do të konsiderohen si shfrytëzim për efekte te trafikimit nuk perbenje liste me detyrim zbatimi te percaktuar por preznton parimin e zbatimit progresiv duke u dhene hapësire shtetve qe me implementimin e saj te mund teshtojne rastet e shfrytezimit ne raport me zhvillimet e se ardhmes.

Se treti, pavaresisht se Protokolli fokusohet kryesisht tek mbrojtja e grave dhe femijeve, eshte neutral ne aspektin gjinor.

Se katerti, pranon se trafikimi mund te qendroje jo domosdoshmerisht duke kaluar kufi nderkombetar.

Se pesti , autori i ketij krimi nuk mund te justifikohet se viktima (madhore) i eshte nenshtruar me deshire shfrytezimit nese per te aritur deri aty, ndaj saj eshte perdorur ndonje nga format e deformimit te vullnetit te parashikuara ne perkufizim.

Se gjashti, pranon si minimum te mjetit te perdorur per deformimin e vullnetit , mashtrimin, duke i dhene rendesi ne kete menyre te drejtes se individit per te qene i lire ne marrjen e vendimeve qe lidhen me jeten e tij sidomos per punen dhe levizjen.

¹²⁵⁾ Koça A., Vështrim Juridiko- Penal Krahasues kriminologjik dhe procedurial mbi Trafikimin e qënieve njerëzore.. Tiranë 2006, fq 16-18.

Se shtati, ne rastet kur viktimat eshte i mitur nuk eshte e rendesishme nese eshte perdorur apo jo ndonje nga mjetet e deformimit te vullnetit te parashikuara ne perkufizim. Ne kete menyre i garantohet nje mbrojtje me e mire te miturve.

Konventa Evropiane per Veprime kunder Trafikimit te Qenieve Njerezore Maj 2005, Varshave.

Ne kuader te perpjekjeve per te harmonizuar e koordinuar me mire luften kunder trafikimit te qenieve njerezore ne Kontinentin tone, Keshilli i Evropes hartoi Konventen Evropiane te permendur me siper. Duke konstatuar se Protokolli i Palermos vendosi bazat e aksionit nderkombetar kunder trafikimit dhe duke marre ne konsiderate te gjitha aktet nderkombetre ne lidhje me problemin, kerkoi te forcoje mbrojtjen e komunitetit evropian nga ky fenomen dhe te ngrej ne nje nivel me te lart statndartet tashme te vendosura. Kjo Konvente u ratifikua nga Kuvendi i Shqiperise me 20.11.2006 me Ligjin nr. 9642 "Per ratifikimin e Konventes se Keshillit te Europes Per masat kunder trafikimit te qenieve njerezore". Qellimi i kesaj Konvente eshte ai i parashikuar ne nenin 1 "Qellimet e Konventes": *Qellimet e kesaj Konvente jane te parandaloje dhe luftoje trafikimin e qenieve njerezore nepermejt garantimit te barazise gjinore; te mbroje te drejtat e njeriut te viktimave te trafikimit, te ndertoje nje kuader gjithperfishires per mbrojtjen dhe ndihmen e viktimave dhe deshmitareve, nepermjet garantimit te barazise gjinore si dhe te siguroje hetim dhe ndjekje penale efektive te trafikimit. te nxise bashkepunimin nderkombetar ne perpjektjet kunder trafikimit te qenieve njerezore . Me qellim qe te siguroje implementim efektiv te parashikimeve te Konventes nga palet, kjo Konvente ngre nje mekanizem specifik monitorimi.*

Kjo konventë ka një sërë veçorish dhe një sërë elemntësh të përbashkët me Protokollin e Palermos, por është e rëndësishme të evidentohen përmiresimet që sjell kjo konvente ne luften kunder trafikimit. Percakton se trafikimi i qenieve njerezore perben nje dhunim te drejtave te njeriut dhe nje shkelje te dinjitetit dhe integritetit te qenieve njerezore. Konventa Evropiane bazohet ne perkufizimin qe ben Protokolli per trafikun e qenieve njerezore . E reja qe sjell ajo eshte se jep perkufizimin e konceptit "viktime e trafikimit": "*Ç'do person fizik i cili ka gene subjekt i trafikimit te qenieve njerezore sic eshte percaktuar ne kete nen*". Nuk ben diference ne raport me viktimat e trafikimit dhe format e shfrytezimit. Nuk ben diferencim ne raport me karakterin (kombetar apo nderkombetar) te krimit te trafikimit. Duke ecur me tej se Protokolli, parashikon detyrimin e paleve per t'i konsideruar si rrethana renduese ne legjislacionin e brendshem, rastet kur; - vepra penale qellimisht apo nga neglizheca e madhe rrezikon jeten e viktimes, - vepra kryhet ndaj nje te mituri, - vepra kryhet nga nje nepunes ne ushtrim te detyrave te tij, - vepra kryhet ne kuader te nje organizate kriminale.¹²⁶ Orienton, uniformizimin e sanksioneve per veprat penale te trafikimit duke parashikuar ne nenin 23 qe "*denimet duhet te perfshijne ndeshkime qe perfshijne heqjen e lirise e cila con ne ekstradimin e trafikanteve*".

¹²⁶ Neni 24 i Konventës Evropiane për Veprime kundër Trafikimit. 2005.

Parashikon penalizimin e "klientit" qe vepron me ndergjegje kur pranon sherbimet e viktimes se trafikimit.¹²⁷ Kjo mase ndikon drejtperdrejt ne goditjen e nje prej faktoreve themelore te trafikimit sic eshte kerkesa. Ngre ne nje standart me te larte parashikimet ne lidhje me pergjegjesine e personit juridik duke e bere ate me te detajuar dhe lehtesisht me te implementueshme ne legjislacionet e brendshme.¹²⁸

Parashikon detyrime per nje mbrojtje me te mire te viktimave te trafikimit. (Neni 6). Mbrojtja konsiston ne disa drejtime si: ruajtja e privacise se tyre, dhenien e informacionit mbi procedurat gjyqesore e administrative, marrjen e masave per rikuperim fizik e psiko-social ne bashkepunim me organizata jo-qeveritare, strehimin e sigurte (Neni 11), mbrojtjen vecanerisht ndaj kercenimeve gjate nje procesi penal (Neni28), mbrojtjen gjate procedurave te identifikimit si te tille (Neni 10), kompesimin e viktimave etj. E drejta per te perfituar nga statusi si viktime nuk do te varet nga bashkepunimi ose jo me drejtesine.

Ne ndryshim nga Protokolli, Konventa i jep rendesi te vecante periudhes se reflektimit (periudha menjehere pas shkeputjes se viktimes nga trafikanti dhe paraqitja ne autoritet shteterore, periudha post-traumatike). Sipas Nenit 13, kjo periudhe nuk do te jete me pak se 30 dite brenda se ciles viktima prezumohet se shkeput perfundimisht lidhjet psiko-fizike me autorin dhe vendos nese do te bashkepuoje ose jo me autoritetet. Sikurse dhe Protokolli, Konventa pengon denimin e viktimave per vepra te kryera prej tyre gjate dhe per shkak te trafikimit. Neni 26.

Ne dallim nga Protokolli evidenton detyrimin per ndjekjen penale ex-officio krahas asaj ex-parte.¹²⁹ Krijon nje mekanizem monitorues eficient dhe te pavarur. Ky eshte nje dallim i rendesishem ne raport me Protokollin. Sipas nenit 36 te Konventes mekanizmi monitories do te perbehet nga nje grup ekspertesh qe do te vezhgojne menyren e zbatimit te Konventes. Ky grup eshte quajtur GRETA dhe do te perbehet nga 10 deri 15 anetare dhe do te beje vleresimin e zbatimit te Konventes nepremjet pyetesoreve derguar paleve apo dhe nepremjet vizitave ne to per te verifikuar gjendjen e zbatimit te saj.¹³⁰

¹²⁷⁾ Neni 6 i Konventës Evropiane për Veprime kundër Trafikimit. 2005.

¹²⁸⁾ Neni 11 i Konventës Evropiane për Veprime kundër Trafikimit. 2005.

¹²⁹⁾ Neni 27

¹³⁰⁾ Neni 38

Përfundime dhe rekomandime

Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen kompleks dhe nën ndikimin e shumë faktorëve. Ai ka një shtrirje të gjerë në të gjithë botën. Pavarësisht nga masat e marra në përgjithësi, prania e viktimave të trafikimit në shkallë kombëtare apo dhe ndërkombëtare është dëshmi e drejtëpërdrejtë e pranisë së fenomenit dhe rritjes së tij në mënyrë të vazhdueshme. Në funksion të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit, të parashikuara në Kushtetutë, vjen dhe legjislacioni penal. Mbrojtja e dinjitetit të individit është një element thelbësor në disa prej figurave të veprave penale, të parashikuara si të tilla në legjislacionin tonë. Me ndryshimet e ndodhura në shoqërinë shqiptare, me shndërrimet pas vitit 1990, edhe legjislacioni, si çdo fushë tjetër, u përball me problematika të reja, të cilat ishin në dimensione të konsiderueshme dhe në zhvillim e sipër. Gjatë këtij punimi janë bërë përpjekje për shpalosjen e problemeve kryesore që lidhen me fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore duke e trajtuar si në aspektin social dhe juridik, madje duke e parë ecurinë e këtij fenomeni në raport me dimensionet e reja të zhvillimit ligjor, shoqëror dhe politik të vendit tonë.

Me qëllim rritjen e efektivitetit të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore do të theksonim këto rekomandime:

Rritjen e nivelit profesional të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme të karakterit të edukimit të vazhdueshëm në fushën e veprave penale kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Lidhur me dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit, ndryshimet legjislative janë të domosdoshme, në mënyrë që t'u jepen zgjidhje problemeve që paraqet aktualisht instituti i padisë civile në procesin penal. Është i nevojshëm të bëhet amendimi i nenit 158 i Kodit të Procedurës Penale, që parashikon përjashtimin nga detyrimi për të dëshmuar i bashkëshortit/bashkëjetuesit edhe në rast se ka bërë kallëzim. Pyetja e viktimave duhet të kryhet në prani të psikologut ose punonjësit social gjatë hetimit dhe gjyqimit, kusht ky që duhet të parashikohet në dispozita të veçanta të Kodit të Procedurës Penale.

Ne Kodin e Procedurës Penale, duhet bërë ndryshime në nenin 59 të tij, për rastet kur kemi të bëjmë me ato lloj veprash penale ku kallëzuesit janë viktimat e dhunës. Të mos parashikohet ndjekja e tyre me ankimin e të dëmtuarit akuzues pasi të gjithë e dimë se sa të vështirë e kanë viktimat e dhunës të drejtohen vetë në Gjykatë dhe të iniciojnë një proces penal. Shpesh kjo ndodh dhe për shkaqe ekonomike, por më së shumti tërheqja e tyre, dhe mos paraqitja e kërkesës në Gjykatë ndodh nga frika e mospërsëritjes së dhunës. Në Kodin e Procedurës Penale, gjithashtu duhet të ndryshohet dhe neni 316 pika 5, që lidhet me mënyrën e pyetjes së dëshmitarit të mitur. Dëshmitari i mitur në çdo rast duhet të pyetet në prani të psikologut dhe kjo duhet të parashikohet koncretisht në ligj. Për këtë vlen të nënvizohet domosdoshmëria e pranisë së përhershme të punonjësit social apo psikologut pranë Zyrës së

Prokurorisë. Në Kodin e Procedurës Penale duhet të bëhen ndryshimet e nevojshme edhe për përcaktimin në të, të termit “*viktimë trafikimi*”, edhe pse aktualisht kjo i referohet parashikimeve të Konventës. Një gjë e tillë mendohet se është e nevojshme dhe për shkak të faktit se me Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale punojnë jo vetëm Prokurorët, Avokatët dhe Gjyqtarët por dhe aktorët tjerë të cilët ndihmojnë në dhënien dhe zbatimin e së drejtës.

Organet policore përfaqësojnë përballjen e parë të një organi shtetëror qoftë me fenomenin, me viktimën apo dhe me autorin. Prandaj në këtë drejtim Oficeret e Policisë Gjyqësore duhet të kenë kualifikimin e duhur dhe qëndrueshmëri të tyre në detyrë. Kjo për shkak të faktit se ka lëvizje të shpeshtë të këtyre punonjësve, problem ky që ndikon negativisht në kryerjen e hetimit cilësor dhe zgjidhjen e çështjes penale.

Është e detyrueshme të bëhen ndryshime dhe në rrafshin e parashikimeve ligjore në drejtim të sigurimit të provave nga autoriteti i huaj në një mënyrë më të shpejtë nga rruga e tanishme procedurale me anë të letërporosisë. Një rekomandim i mirë, do të ishte ndryshimi ligjor për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore, ku oficerët tanë do kishin mundësi të kryenin veprime konkrete me qëllim sigurimin e provave jashtë vendit tonë, në bashkëpunim me autoritetin e huaj. Kjo do çonte në përfundimin e çështjes në një mënyrë më të shpejtë e cilësore. Në raport me vendet e tjera, masat e dënimit të parashikuara në legjislacionin tonë penal janë të larta. I duhet kushtuar më shumë vëmendje goditjes së autorit të veprës penale, jo vetëm në burgosjen e tij por edhe sekuestrimin e aseteve të siguruara nga veprimtaria kriminale. Një arsytim i tillë është i lidhur ngushtë me faktin se dhe arsyeja e përfshirjes në krim të tyre bëhet për shkak të përfitimit material. Rekomandohet një jetë shkencore e profesionale më e shpeshtë, organizimi i konferencave, seminareve kombëtare e ndërkombëtare me këtë temë, botime në revista shkencore etj. Kurrikulat e fakulteteve të drejtësisë të Universiteteve Publike dhe Private të përfshijnë më tepër orë mësimore për trajtimin e këtyre figurave të veprave penale.

BIBLIOGRAFI

I. Doktrinë

- Elezi I. “E drejta Penale –Pjesa e Posaçme”, Ribotim, Shtëpia Botuese “P.SH 2015” Tiranë, 2007.
- Omari L. “Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike”, Botimi i tetë, Botimet “Elenea Gjika” Tiranë, 2004.
- Islami H., Hoxha A., Panda I., “Komentari i Kodit të Proçedurës Penale të RSh”, Tiranë Morava 2003.
- Kambovski V., “E drejta penale (Pjesa e përgjithshme), Shkup , 2007.
- Commission européenne, Eurostat – DG affaires intérieures “Trafficking in human beings”, 2013.
- Sokoli L., Gëdeshi I., “Trafikimi Rasti i Shqipërisë”, Tiranë, 2006.
- Thomas McGinn, “Prostitution, Sexuality and the Law in Ancient Rome” Oxford University Press, January 2003.
- Udhërrëfyes Referimi për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Europë, UNICEF, Tiranë, 2007.
- Paketë burimore e praktikave të mira kundër trafikimit njerëzor, USAID, Tiranë, 2009.
- Compensation for trafficked and exploited persons in the OSCE region, OSCE/OHDIR, ĘarsaĘ-Poland, 2008.
- GuidĘ për instrumentet e zgjedhura ligjore të BE-sĘ mbi migracionin, IOM, VienĘ, Gusht 2005.
- Elezi I., Kaçupi S., Haxhia M., “Komentari i Kodit Penal të RepublikĘs sĘ ShqipĘrisĘ”, GEER, TiranĘ, 2006.
- Elezi I., Hysi V., “politikat Kriminale” PEGI, TiranĘ, 2006.
- Hysi V., “Kriminologji” Kristalina KH, TiranĘ, 2005.
- Philippe Conte “Droit Penal”, 2003.
- M. Maguire, R. Morgan, R. Reiner, “The Oxford Handbook” of Criminology”, Third edition, Oxford University Press, 2003.
- Kambovski V., E drejta penale (pĕrkthimi shqip), Shkup 2010.

Raport Vlerësimi për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore 2005-2007, Ministria e Brendshme, Zyra e koordinatorit kombëtar për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Tiranë, 2008.

“Shprehi në praktikat e punës me viktimat e trafikimit”- Manual informimi për ofruesit e shërbimeve psiko-sociale, Instituti Shqiptar i Studimeve Sociale dhe Psikologjike, Tiranë.

Hetemi M., Jashari N., Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit me komentin.

Raporti i III-të Kombëtar Periodik mbi Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË), Ministria e Jashtme e Shqipërisë, Tiranë, 2008.

Situata e përpjekjeve në Shqipëri për Luftën Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore 2007-2008, USAID, 2008.

Trafficking in Human Beings in South Eastern Europe, Report provided by UNICEF, UNOHCHR and OSCE/OHDIR, ëith the administrative assistance of UNDP in Bosnia and Herzegovina, 2004.

Trafficking in Persons: Global Patterns United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC), April 2006.

Salihu I., “E drejta Penale- pjesa e përgjithshme”, Universiteti Fama, Prishtinë, 2008.

Salihu I., “E drejta Ndërkombëtare Penale”, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2005.

E. Ciconte “I flussi e le rotte della trata dall’ East Europe”, Ravenna 2005.

Projekti Rajonal CARPO, Përditësim i Raportit të vitit 2006 mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimi Ekonomik në Europën Juglindore, Këshilli I Europës , Strasburg, 2007.

Elezi I., “Komentari i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal”, Albin, Tiranë 2001.

Elezi I., “Komentari i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal”, Albin , Tiranë 2004.

Puto A. “Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në përqsje me Kushtetutën e Shqipërisë”, Albin , Tiranë 2002.

Çela K., “E drejta e punës”, ILAR, Tiranë 2014.

Çela K., Haxhi P., “E drejta e krahasuar e punës”, ILAR, Tiranë 2002.

Gruda Z., “Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut”, Nr. II, Prishtinë, 2000.

Ternova G., “ Interpretime të Kodit Penal” Tiranë, 2000.

Trafficking in human beings-legal aspects, South East European University, December 2006, FYROM.

G.Fiandaca, E. Musco, Diritto penale, Parte generale.

G. Fiandaca, E. Musco, Diritto penale, Parte special.

Leskoviku M., “Njohja me legjislacionin shqiptar mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe disa problem që dalin në praktikën gjyqësore”, Revista Studime Juridike, Fakulteti i Drejtësisë, UT, Tiranë, Nr. 2, 2005.

Anastasi A., Revista “Ligji –mundësi zhvillimi për gratë”, botim i Qendrës për nisma ligjore qytetare, Viti VIII i botimit, Nr. 1 (18), Tiranë, mars 2008.

J. Pradel, ProcédurePénale, Paris 1995.

Grup autorësh, “Monitorimi i vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër dhe Vlorë për periudhën 2001-2003, në lidhje me trafikimi ne qenieve njerëzore”, publikim i projektit me të njëjtin titull të ndërmarrë nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare me financim të Ambasadës së SHBA, Tiranë, 2005.

Manuel, Droit Penal et procedure penale, Paris 1994.

Grup autorësh “Kërkim Studimor mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore”, Kosovë, 2007.

J.Pradel, Droit Penal general, Paris 1994.

Gwendolyn Mannered, “Trafficking in the women for the purpose of sexual exploitation and transpornder cooperation”, UK, 2000.

Leskaj V., Dragoti E., Karaj Th., Todhri F., “Albanian Society in the face of Challenges of trafficking in the women and girls”, Tiranë, 2004.

Poda Z., “Krimi I organizuar transnacional-sistem dhune dhe pushteti”, Morava, Tiranë, 2005.

Hysi V., “Penalogjia”, PEGI, Tiranë, 2006.

Ekzekutimi I vendimeve penale, Tiranë, 2004.

Rhona K.M.Smith, “Textbook on International Human Rigths”, Secon Edition, Oxford University Press, 2005.

Europeanizimi i së drejtës Penale, Tiranë 2007.

Prokurori kundër Dradoljub Kunarac, et.al, Case n. IT-96-23 & IT 96-23/1 A, Judgement, 12 Qershor 2002, ICTY.

Çështja Siliadin vs Francës, app. 73316/01, GJEDNJ, Strasbourg, dt. 26.07.2005.

Çështja De Wilde, Ooms, dhe Versyp kundër Belgjikës, GJEDNJ, Strasbourg, dt. 18.06.1971.

Konventa plotësuese për ndalimin e skllavërisë, tregtisë me skllavër dhe të institucioneve dhe praktikave të ngjashme me skllavërinë, OKB, hyrë në fuqi më dt. 30 Prill 1957.

Shala Xh., “Siguria Kombëtare dhe sfidat e integritetit”, Tiranë, 2003, Kreu “Antitrafikët”, për një luftë permanente”, fq. 24-57.

“Ensuring Human Right Protection in Countries of Destination: Breaking the Cycle of Trafficking” Helsinki, 2004.

Fjalori i Shqipes së Sotme, Toena, Tiranë 2002.

Black’s Law Dictionary, USA, 1991.

Vocabulaire juridique, Paris 1997.

Enciklopedia del Diritto, De Agostini, Novara, 1992.

“Trafikimi i qënieve njerëzore dhe roli i shkollës në prandalimin e tij, IOM, Tiranë, 2003.

Binaku L., “Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut”, EDLORA, Tiranë, 2005.

Deering’s, “Penal Code- including penal provisions of other codes”, Lexis Nexis, California Desktop Code Series, Edition of 2005, Title 10.5: “Violent Crimes against Women” pg. 14 140-14 150.

Halili R., “Kriminologjia”, Universiteti I Prishtinës, Prishtinë, 2002, 2005.

Bistra Netkova, “Concept, scope of application, state obligation, and violation of the right to be free from slavery ëith respect to trafficking in women”.

La tratta degli Schiavi Oliver Petre 2010.

La schiavitù del nostro tempo, 2010.

Human Trafficking. A globale perspective. Louise Shelley, 2010.

Defying human trafficking, 2011.

Fjalori latinisht-shqip, viti 1966,

Kriminologji- panalogji, viti 2002 (Jani Parandale).

Marek Antoni Novicki, Rreth konventës europiane.

Mandro A., E drejta romake.

Përmbledhje aktesh ndërkombëtare.

Elezi I., Komentari i Kodit Penal të RSH.

E drejta penale e përgjithshme, përshtatur nga Sokol Ngresi.

II. Konventa dhe Akte Normative

Përmbledhje legjislacioni për sistemin e drejtësisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tiranë, 2004.

Ligji Nr.9110, datë 24.7.2003” Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave per Krimet e Renda”

Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit përmes masave parandaluese kundër pasurisë”, fletorja zyrtare nr. 181, datë 24 dhjetor 2009.

Konventa e OKB për ndjekjen e tregtisë së qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, 1949.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, si dhe dy protokolleve shtesë: Mbi parandalimin dhe ndëshkimin trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”, si edhe “Kundër trafikut të migrantëve në rrugë tokësore, ajrore dhe detare”, ratifikuar me Ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002.

“Manual i Prokurorit dhe i Policisë Gjyqësore”, Tiranë, 2003.

“Analizë e sistemit të Drejtësisë penale të Shqipërisë, Raporti i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë”, OSCE, Pegi, Tiranë, 2006.

Vendim i Këshillit mbi përfundimin, në emër të Komunitetit European të Protokollit për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikut të njerëzve, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së OKB-së kundër krimit të organizuar transkombëtar, 2004.

Braho K., “Masat parandaluese pasurore të parashikuara në ligjin për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, revistë Shkencore “Jeta Juridike”. Botim i Shkollës së Magjistraturës, Tiranë, Nr. 2, 2007.

Vendim Unifikues Nr. 1, datë 25.01.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të RSH. Trafficking in human beings-legal aspects, South East European University, FYROM, December 2006.

Direktivë e Këshillit 2004/81/KE e prillit 2004 mbi lejet e qëndrimit që u janë dhënë shtetasve të një vendi të tretë që janë viktimë e trafikut të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një

veprimi për të lehtësuar emigracionin e paligjshëm të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente.

Direktivë e Këshillit 2004/80/KE e 29 prillit 2004 në lidhje me kompensimin e viktimave të krimit.

VKM Nr. 1140, datë 30.7.2008 “për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit”.

Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të qënieve njerëzore 2008-2010, Ministria e Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, Tiranë.

Strategjia kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve Viktima të trafikimit 2008-2010, Ministria e Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, Tiranë.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i azhurnuar, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Tiranë.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, I azhurnuar, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Tiranë.

Codice penale, Milano 1992.

Code Penal, Paris 1997.

Ligji nr. 9509, datë 3.4.2006 “Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lunduese në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 8633, datë 18.09.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lunduese me motor, me tonazh nën 20 t”.

Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësië”.

Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit, Ministria e Brendshme, Tiranë, Korrik 2007.

Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për trafikimin e qënieve njerëzore”.

Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktimat të trafikimit, Këshilli i Ministrave, Tiranë, 2005.

Raporte të Departamentit të Shtetit të SHBA në lidhje me trafikimin e qëniveve njerëzore, periudha 2006-2009.

Të dhëna statistikore të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
Vjetari Statistikor, Botim Vjetor i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë.
Të dhëna të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, Tiranë, 2008.

Burime interneti :

Këshilli i Ministrave: www.km.gov.al

Ministria e Brendshme www.moi.gov.al

Ministria e Jashtme www.mfa.gov.al

Qendra e Publikimeve Zyrtare: www.qpz.gov.al

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta: www.mpcsshb.gov.al

Ambasada e SHBA në Tiranë: www.usembassy.al

Këshilli i Europës: www.coe.int

Bashkimi European: www.europa.eu

“Traite d’êtres humains”, <http://www.interpol.int/fr/Criminalit%C3%A9/Trafic-d%C3%AAtres-humains/Traite-d%E2%80%99%C3%AAtres-humains>

Traite des êtres humains, http://fr.wikipedia.org/wiki/Traite_des_%C3%AAtres_humains

Ministère des Affaires étrangères de la France (2014), La France et la lutte contre la traite des êtres humains, ne façen web: <http://www.diplomatie.gouv.fr/fr/politique-etrangere-de-la-france/droits-de-l-homme/lutte-contre-la-traite-des-etres/>